



PEFA

Raport i Vlerësimit të Performancës

Shqipëria

Raport Nr. 123426 - AL



© 2018 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore

1818 H Street NW

Washington DC 20433

Telefon: 202-473-1000

Internet: www.worldbank.org

Ky punim është një produkt i stafit të Bankës Botërore me kontribut nga burime të jashtme. Gjetjet, interpretimet, dhe përfundimet e shprehura në këtë punim nuk reflektojnë në mënyrë të domosdoshme pikëvështrimet e Bankës Botërore, të Bordit të Drejtorëve Ekzekutive apo të qeverive që ata përfaqësojnë.

Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave që janë përfshirë në këtë punim. Kufijtë, ngjyrat, denominimet, dhe informacioni i treguar në ndonjë hartë në këtë punim, nuk nënkupton asnjë gjykim nga ana e Bankës Botërore në lidhje me statutin ligjor të ndonjë territori apo miratimin ose pranimin e atyre kufijve.

Të drejtat dhe lejimet

Materiali në këtë punim është subjekt i të drejtës së autorit. Meqënëse Banka Botërore inkurajon shpërndarjen e njohurive, ky punim mund të riprodhohet, i plotë apo në pjesë, për qëllime jo fitimprurëse për sa jepet njohje e plotë e autorësisë për këtë punim.

Çdo pyetje mbi të drejtat dhe licensat, përfshirë këtu të drejtat e ndërvarura, duhet të adresohet në Zyrën e Publikimeve të Bankës Botërore, Grupi i Bankës Botërore, 1818 H Street NW, Washington, DC 20433, USA; fax: 202-522-2625; e-mail: pubrights@worldbank.org



SHQIPËRIA

**Raporti i vlerësimit të performancës lidhur
me llogaridhënien për shpenzimet dhe
financat publike (PEFA)**

Mbështetur në PEFA 2016

1 dhjetor 2017

Vlerësim pasues

Normat orientuese të këmbimit valutor

1 dollar amerikan = 128,17 lekë shqiptare

1 euro = 135,23 lekë shqiptare

(sipas kursit të datës 30 dhjetor 2016)

Viti fiskal

1 janar - 31 dhjetor

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtime	iv
Falënderime	vii
Përmbledhje e raportit	ix
1. Hyrje	1
1.1 Arsyeya dhe qëllimi	1
1.2 Menaxhimi dhe kontrolli i cilësisë së vlerësimit	1
1.3 Metodika e vlerësimit	3
2. Informacion për kontekstin e vendit	5
2.1 Situata ekonomike e vendit	5
2.2 Trendët fiskalë dhe buxhetorë	6
2.3 Kuadri ligjor dhe rregullator për MFP-në	8
2.4 Kuadri institucional për MFP-në	9
2.5 Karakteristika të tjera të MFP-së dhe mjedisi në të cilin funksionon	12
3. Vlerësimi i performancës së MFP-së	14
3.1 SHTYLLA I : Besueshmëria e buxhetit	14
TP-1. Shpenzimet faktike agregate	14
TP-2. Përbërja faktike e shpenzimeve	15
TP-3. Të ardhurat faktike	17
3.2 SHTYLLA II: Transparenca e financave publike	20
TP-4. Klasifikimi i buxhetit	20
TP-5. Dokumentimi i buxhetit	21
TP-6. Operacionet e qeverisjes qendrore jashtë raporteve financiare	23
TP-7. Transfertat drejt qeverisjes vendore	26
TP-8. Informacioni për performancën lidhur me realizimin e shërbimeve	30
TP-9. E drejta e publikut për informacione fiskale	33
3.3 SHTYLLA III: Menaxhimi i aktiveve dhe pasiveve	36
TP-10. Raportimi i risqeve fiskale	36
TP-11. Menaxhimi i investimeve publike	41
TP-12. Menaxhimi i aktiveve publike	46
TP-13. Menaxhimi i borxhit	49
3.4 SHTYLLA IV: Strategjia fiskale dhe përgatitja e buxhetit në bazë të politikave	53
TP-14. Parashikimi makroekonomik dhe fiskal	53
TP-15. Strategjia fiskale	58
TP-16. Perspektiva afatmesme në përgatitjen e buxhetit të shpenzimeve	62
TP-17. Procesi i përgatitjes së buxhetit	66
TP-18. Shqyrtimi i buxheteve nga legjislativi	69
3.5 SHTYLLA V: Parashikueshmëria dhe kontrolli në zbatimin e buxhetit	73
TP-19. Administrimi i të ardhurave buxhetore	73
TP-20. Kontabiliteti i të ardhurave	79
TP-21. Parashikueshmëria e shpërndarjes së burimeve brenda vitit	81
TP-22. Detyrimet e prapambetura në shpenzimet buxhetore	84

TP-23 . Masat kontrolluese në listë-pagesat	86
TP-24 . Prokurimi	92
TP-25. Sistemi i kontrollit të brendshëm për shpenzime jo paga	97
TP-26. Auditimi i brendshëm	101
3.6 SHTYLLA VI: Kontabiliteti dhe raportimi	107
TP-27. Paprekshmëria e të dhënave financiare	107
TP-28. Raportet buxhetore gjatë vitit	110
TP-29. Raportet financiare vjetore	112
3.7 SHTYLLA VII: Shqyrtimi dhe auditimi i jashtëm	114
TP-30. Auditimi i jashtëm	114
TP-31. Shqyrtimi që u bën legjislativi raporteve të auditimit	117
4. Përfundime nga analiza e sistemeve të MFP-së	120
4.1 Vlerësimi i integruar i performancës së MFP-së	120
4.2 Efektiviteti i kuadrit të kontrollit të brendshëm	124
4.3 Pikat e forta dhe pikat e dobëta të MFP-së	126
4.4 Ndryshimet e performancës në krahasim me vlerësimin e fundit	127
5. Procesi i reformës së MFP-së në qeveri	129
5.1 Qasja për reformat e MFP-së	129
5.2 Veprimet e kohëve të fundit dhe aktuale të reformës	130
5.3 Aspekte institucionale	131
Shtojcat	
Shtojca 1. Përmbledhje e treguesve të performancës	134
Shtojca 2. Përmbledhje e gjetjeve për kuadrin e kontrollit të brendshëm	143
Shtojca 3A. Burimet e informacionit: anketa dhe raporte analitike	146
Shtojca 3B. Burimet e informacionit sipas treguesve	147
Shtojca 3C. Lista e personave të intervistuar	160
Shtojca 4. Krahasimi i performancës në bazë të versionit të mëparshëm të PEFA-s	163
Shtojca 5. Tabelat e llogaritjeve për TP-1, TP-2 dhe TP-3	176

SHKURTIME

AB	Auditimi i brendshëm
AFMIS	Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar në Shqipëri
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ALL	Leku shqiptar
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BQSH	Banka Qendrore e Shqipërisë (Banka e Shqipërisë)
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DMIP	Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganës
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DRTM	Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj
DTH	Degë Thesari
EM	Ekipi Mbikëqyrës
FIAA	Shoqata e Investitorëve të Huaj të Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IB	Institucion buxhetor
IHD	Investimet e huaja direkte
INSTAT	Instituti i Statistikës
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit
KAF	Kuadri Afatmesëm Fiskal
KASHB	Kuadri Afatmesëm i Shpenzimeve Buxhetore
KBFP	Kontrolli i brendshëm financiar publik
KBR	Kontrata të bazuara në rezultate
KE	Komisioni Evropian
KFQ	Klasifikimi i Funksioneve të Qeverisë
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
KMSHC	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
KPP	Komisioni I Prokurimit Publik
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
LOB	Ligji Organik i Buxhetit
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
LSHC	Ligji për Shërbimin Civil
LLUTH	Llogaria Unike e Thesarit
MA	Ministria e Arsimit
MDA	Ministri, departamente dhe agjenci
ME	Ministria e Ekonomisë
MF	Ministria e Financave
MFK	Menaxhimi financiar dhe kontrolli
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MRP	Menaxhimi i risqeve të përputhshmërisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
NIPT	Numri identifikues i personit të tatueshëm
NP	Ndërmarrje publike

NSH	Ndërmarrje shtetërore
NJJB	Njësi jashtë-buxhetore
NJQH	Njësia Qendrore e Harmonizimit
NJQV	Njësi e qeverisjes vendore
OJQ	Organizata joqeveritare
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PEFA	Llogaridhënia për Shpenzimet dhe Financat Publike
PK	Plani Kontabël
PPP	Partneritetet Publike Private
PRE	Programi i reformës ekonomike
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
QQ	Qeverisja qendrore
QQB	Qeveria qendrore buxhetore
SAFE	Fuqizimi i Mjedisit të Llogaridhënies dhe Funksioneve të Besuara
SAMB	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit
SECO	Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike
SEKSP	Standardet Evropiane të Kontabilitetit të Sektorit Publik
SFSH	Statistikat financiare shtetërore
SIDBNJ	Sistemi i Informacionit të Drejtimit të Burimeve Njerëzore
SIFQ	Sistemi i Informacionit Financiar të Qeverisë Shqiptare
SIGMA	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SMB	Strategjia e Menaxhimit të Borxhit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
SHSHP	Shqyrtimi i Shpenzimeve Publike
TADAT	Mjeti i Vlerësimit Diagnostikues për Administratat Tatimore
TAP	Tatimi mbi të ardhurat personale
TF	Tatimi mbi fitimin
TI	Teknologjia informatike
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TR	Termet e referencës
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
USAID	Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-ve
VF	Viti fiskal

FALËNDERIME

Këtë raport e ka hartuar një ekip i Bankës Botërore i udhëhequr nga Bogdan Constantinescu (Bashkëdrejtues i Ekipit të Projektit) dhe Elena Nikulina (Bashkëdrejtuese e Ekipit të Projektit), me asistencë nga Hilda Shijaku, Jonida Myftiu, Manjola Malo, Julia Dhimitri, Andrew Mackie, Phil Sinnett dhe Donika Qesja. Ky vlerësim është kryer në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e Bashkimit Evropian.

Ekipi i vlerësimit dëshiron të falënderojë veçanërisht zotin Erjon Luçi, Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, dhe ekipin e tij për të gjithë mbështetjen e dhënë gjatë të gjithë procesit dhe për bashkërendimin e punës me ministri, organe dhe institucione të ndryshme. Ekipi i projektit dëshiron të shprehë falënderime të sigjerta për mbështetjen e dhënë nga të gjithë zyrtarët dhe për bashkëpunimin me palët homologe në Shqipëri.

Ekipi dëshiron të nënvizojë kontributet e dhëna nga Edina Halapi dhe Sybille Schmidt (Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri), Philipp Keller dhe Sigita Stafa (Ambasada Zvicerane/Sekretariati Shtetëror për Bashkëpunim Ekonomik), Jens Reinke, Linda Spahia dhe Suzanne Flynn (Fondi Monetar Ndërkombëtar), Dennis Wesner (Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-së), Holy Tiana Rame (Sekretariati i PEFA-s) dhe Antonio Blasco (Banka Botërore) për vlerësimin kolegjial. Ekipi dëshiron të falënderojë veçanërisht edhe zonjën Jamie Lazaro (Banka Botërore) për redaktimin.



Shqipëria

Llogaridhënia për Shpenzimet dhe Financat Publike (PEFA)
Raport i Vlerësimit të Performancës
Mbështetur në PEFA 2016

1 dhjetor 2017

Procesi i kontrollit të cilësisë i ndjekur në përgatitjen e këtij raporti i përmbush të gjitha kërkesat e Sekretariatit të PEFA-s, duke fituar kështu vlerësimin "PEFA CHECK".


Sekretariati i PEFA-s
29 janar 2018

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Qëllimi, mbulimi dhe administrimi i vlerësimit

Vlerësimi Llogaridhënia për Shpenzimet dhe Financat Publike (PEFA) synon t'i sigurojë Qeverisë së Shqipërisë një diagnozë objektive të përditësuar të performancës së menaxhimit të financave publike (MFP) në nivel qendror në bazë të metodikës më të fundit PEFA. Ky vlerësim vendos një pikënisje të re PEFA duke përdorur metodikën PEFA 2016 dhe jep një përditësim të ndryshimeve të performancës pas vlerësimit të bërë më 2011 me metodikën e mëparshme. Procesi ka siguruar njohuri të përbashkëta të performancës së MFP-së dhe të atyre dimensioneve që kanë nevojë për përmirësim. Pritet që rezultatet ta ndihmojnë qeverinë në monitorimin e zbatimit dhe përditësimin e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020.

Palët e interesit të vlerësimit PEFA janë autoritetet kombëtare dhe partnerët kryesorë për zhvillim të përfshira në MFP në Shqipëri. Ky vlerësim është ndërmarrë bashkërisht nga Qeveria e Shqipërisë dhe Banka Botërore. Ministria e Financave e Shqipërisë¹ ka luajtur rolin udhëheqës nga ana e qeverisë, ndërsa Banka Botërore ka luajtur rolin udhëheqës nga ana e partnerëve për zhvillim. Këshilli ekzistues për mbikëqyrjen e zbatimit të reformës së qeverisë për MFP-në ka qenë qendra e ekipit të mbikëqyrjes së vlerësimit. Në të kishte përfaqësues nga Ministria e Financave, Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganës, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Komisioni i Prokurimit Publik. Në ekipin e mbikëqyrjes kishte përfaqësues nga Banka Botërore, FMN-ja, Komisioni Evropian, USAID dhe Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike



Besueshmëria e buxhetit	Transparenca fiskale	Menaxhimi i aktiveve dhe pasiveve	Strategjia fiskale dhe përgatitja e buxhetit në bazë të politikave	Parashikueshmëria dhe kontrolli në zbatimin e buxhetit	Kontabiliteti dhe raportimi	Shqyrtimi dhe auditimi i jashtëm
-------------------------	----------------------	-----------------------------------	--	--	-----------------------------	----------------------------------

Vlerësimi mbulon qeverisjen qendrore dhe pasqyron statusin e sistemit të MFP-së më prill 2017. Vlerësimet e treguesve mbështeten në të dhënat për 2014-2016.

1. Informacionet për emrat dhe funksionet e ministrave reflektojnë situatën në kohën kur është kryer vlerësimi. Një riorganizim i qeverisë në vitin 2017 e bashkoi Ministrinë e Financave me Ministrinë e Ekonomisë duke e riemërtuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Disa funksione të Ministrisë së Punës janë transferuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Vlerësimi i integruar i performancës së MFP-së

Rezultatet e vlerësimit tregojnë ecuri mikse në të shtatë shtyllat e kuadrit PEFA 2016, siç ilustron nga tabela 1 më lart. Notat për 15 nga të 31 treguesit janë nga A në B, që reflekton një performancë të fortë, ndërsa notat për 16 treguesit e tjerë janë nga C në D, që reflekton performancë të dobët. Çdo shtyllë ka pika të forta dhe pika të dobëta, një përmbledhje e shkurtër e të cilave jepet më poshtë, ndërsa analiza më e hollësishme jepet në Kapitullin 4. Notat sipas treguesve dhe dimensioneve jepen në Tabelën 1.1.

Besueshmëria e buxhetit. Të ardhurat dhe shpenzimet faktike agregate përputhen me buxhetin e miratuar në periudhën e vlerësimit. Por besueshmërinë e procesit buxhetor e cenon një luhatje e madhe në përbërjen funksionale të shpenzimeve.

Transparenca fiskale. Qeveria ka marrë vlerësim të mirë sa u takon disa treguesve të shtyllës së transparencës fiskale, përfshirë klasifikimin e buxhetit, dokumentimin e buxhetit dhe të drejtën e publikut për të parë informacionin fiskal. Megjithatë, shqetësim janë boshllëqet në informacionin për të ardhurat dhe shpenzimet e njëjësive jashtëbuxhetore, burimet që marrin njësitë e realizimit të shërbimeve, si edhe mungesa e transparencës në një pjesë të konsiderueshme të transfertave të pushtetit vendor.

Menaxhimi i aktiveve dhe pasiveve është i dobët dhe ka nevojë për vëmendje. Menaxhimi i borxhit del në pah si një fushë me performancë të fortë në këtë shtyllë. Nga ana tjetër, menaxhimi i investimeve publike përbën sfidë madhore. Dobësitë në përzgjedhjen e projekteve, së bashku me mungesën e të dhënave të plota dhe me sistemet e dobëta të monitorimit, e cenojnë efektivitetin dhe efikasitetin e vendimeve të menaxhimit të financave publike. Megjithëse qeveria mban evidenca bazë të aktiveve financiare, nuk ka asnjë evidencë të gjithanshme të aktiveve jofinanciare. Monitorimi dhe raportimi i risqeve fiskale ka nevojë për përmirësim.

Strategjia fiskale dhe përgatitja e buxhetit në bazë të politikave. Perspektiva afatmesme është e integruar mirë në proceset e planifikimit makrofiskal dhe përgatitjes së buxhetit. Aspektet teknike të procesit të përgatitjes së buxhetit janë të zhvilluara mirë, por fokusi strategjik i buxhetit dobësohet nga devijimet nga kalendari ekzistues, lidhjet e dobëta me strategjitë sektoriale dhe fokusi i kufizuar që ka Kuvendi për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA).

Parashikueshmëria dhe kontrolli në zbatimin e buxhetit. Megjithëse ka përmirësim solid në disa fusha të kësaj shtylle, ka ende sfida. Megjithëse sistemi i prokurimit publik është përmirësuar, ende një pjesë e konsiderueshme të kontratave jepen përmes procedurave pa konkurrim. Puna për modernizimin e sistemeve të teknologjisë informatike dhe të ligjeve të buxhetit përbën zhvillim pozitiv por kërkon kohë që të integrohet plotësisht në institucionet buxhetore, shumë prej të cilave ende përdorin sisteme të mbajtura me dorë dhe procedura të vjetruara. Megjithëse stoku i detyrimeve të prapambetura buxhetore në përgjithësi është pastruar, nuk ka qenë plotësisht e mundur të parandalohet plotësisht krijimi i detyrimeve të reja të prapambetura dhe MF nuk ka një qasje të raportimit në sistem për monitorimin e detyrimeve të prapambetura nëpërmjet sistemit të Thesarit. Mbahen teprica monetare të konsiderueshme jashtë llogarisë unike të thesarit, të cilat nuk konsolidohen, duke i zvogëluar mundësitë për menaxhim të likuiditetit. Ka gjithashtu hapësirë të konsiderueshme për përmirësim të sistemeve të mbledhjes së të ardhurave. Organet e të ardhurave fiskale janë në proces të zbatimit të një procesi të strukturuar dhe sistematik të vlerësimit të riskut dhe funksioni i mbledhjes së borxhit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) vuan nga dobësi serioze.

Kontabiliteti dhe raportimi. Rakordimi i llogarive dhe paprekshmëria e të dhënave financiare janë pika të forta të sistemit të MFP-së, por ka ende pika të dobëta në raportimin fiskal. Raportimi buxhetor gjatë vitit dhe në fund të vitit mund të përmirësohet për t'u dhënë mundësi përdoruesve të krahasojnë realizimin e buxhetit me buxhetin e miratuar.

Shqyrtimi dhe auditimi i jashtëm. Mbulimi me auditim të jashtëm është i gjerësishëm, por zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së ka rënë, ndërsa numri gjithsej i rekomandimeve të dhëna nga KLSH është rritur. Nuk ka asnjë sistem për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve të bëra nga legjislativi, në bazë të konstatimeve kryesore të auditimeve.

Vlerësimi i efektit të dobësive të MFP-së

Një sistem efektiv i MFP-së është thelbësor për zbatimin e politikave publike dhe për të arritur objektivat strategjike kombëtare përmes mbështetjes së disiplinës fiskale agregate, shpërndarjes strategjike të burimeve dhe realizimit efikas të shërbimeve. Më poshtë jepet një përmbledhje e shkurtër e efektit të dobësive të identifikuar të MFP-së në këto tre nivele të rezultateve buxhetore.

1. *Disiplina fiskale agregate*

Në një nivel agregat qeveria i ka arritur objektivat fiskalë, por disiplina fiskale cenohet nga luhatjet e mëdha në përbërjen e shpenzimeve sipas funksionit. Këto kryesisht kanë të bëjnë me pastrimin e detyrimeve të prapambetura të mbartura nga më parë, kostot e papritura të zbatimit të projekteve të investimeve dhe, në vitin 2015, mosrealizimin e planit të të ardhurave. Pas mosrealizimit të të ardhurave në vitin 2015, përmirësimet në parashikimin e të ardhurave tregojnë se qeveria ka procedurë më të mira për hipotezat makroekonomike dhe për vlerësimin e politikave të reja.

Masat e marra për ta fuqizuar angazhimin dhe masat kontrolluese të shpenzimeve kanë qenë efektive në pastrimin e detyrimeve të prapambetura të mbartura nga e shkuara, por shqetësim mbetet mosparandalimi plotësisht i akumulimit të detyrimeve të prapambetura të reja. Rritja e funksionalitetit të sistemit të informacionit të thesarit siguron informacione të gjithanshme për angazhimet e shpenzimeve dhe pagesave të cilave u ka ardhur afati. Përdorimi i informacioneve të tilla është i kufizuar, në mungesë të kërkesave të standardizuara për monitorim dhe raportim të rregullt.

Qeveria mbetet e cenueshme ndaj tronditjeve fiskale për shkak të mos monitorimit, raportimit dhe menaxhimit adekuat të risqeve të tilla fiskale si veprimtaritë thuajse fiskale të shoqërive tregtare publike, partneritetet publike private (PPP) ose pasivet e tjera të kushtëzuara (siç janë sigurimet e bimëve bujqësore, sigurimet e depozitave dhe çështjet gjyqësore të pambyllura ende).

2. *Shpërndarja strategjike e burimeve*

Shpërndarja e fondeve buxhetore pasqyron objektivat dhe prioritetet e politikave afatmesme, të hartuara në përputhje me kërkesat e paraqitura nga ministritë në kuadër të PBA-së. Por fokusi strategjik i buxhetit pengohet nga vëmendja e kufizuar që tregon Kuvendi për shqyrtimin e PBA-së. Gjithashtu, gatishmëria dhe cilësia e strategjive sektoriale nuk janë të njëjta për të gjitha dhe natyra tejet ambicioze e disa prej strategjive sektoriale ekzistuese i shndërron në dokumente thjesht aspiruese duke i ulur mundësitë për t'i vënë në jetë nëpërmjet buxhetit.

Dobësitë në menaxhimin e investimeve publike ua ulin efektin në mbështetjen e objektivave të qeverisë për zhvillim shoqëror dhe ekonomik. Ndër çështjet që kanë nevojë për vëmendje përfshihen mungesa e shqyrtimeve globale të projekteve të investimeve kapitale dhe monitorimi dhe raportimi.

3. *Përdorimi efikas i burimeve në funksion të realizimit të shërbimeve*

Elementet përbërëse bazë të kuadrit shqiptar të MFP-së ekzistojnë, por kanë nevojë për ngritje të kapacitetit për t'u fokusuar te performanca dhe efikasiteti dhe efektiviteti i realizimit të shërbimeve. Praktikrat e prokurimit publik po përmirësohen, por niveli i lartë i kontraktimit të drejtpërdrejtë e cenon efikasitetin e realizimit të shërbimeve dhe arritjen e vlerës më të mirë për fondet e shpenzuara për blerjet e qeverisë. Auditimi i brendshëm vijon të përqendrohet te përputhshmëria e jo te trajtimi i problemeve të sistemit apo të performancës. Kontrollat e performancës nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) sapo kanë filluar të bëhen dhe këto raporte nuk publikohen ose nuk bëhen objekt i diskutimeve më të gjera në shoqëri. Shqetësim të veçantë përbën mungesa e përgjithshme e reagimit nga niveli drejtues lidhur me rekomandimet e lëna nga KLSH dhe legjislativi, çka mbase do të thotë se nuk shfrytëzohen mundësitë për ta përmirësuar efikasitetin e përdorimit të burimeve.

Ndryshimi i performancës që pas vlerësimit të fundit

Ky është i treti vlerësim i performancës së MFP-së për Shqipërinë, mbështetur në kuadrin PEFA. Po të krahasohet performanca agregate në nivel treguesi midis këtij vlerësimi dhe vlerësimit të fundit të kryer më 2011, nuk ka pasur asnjë ndryshim të performancës për të gjashtëmbëdhjetë treguesit. Për pesë tregues ka pasur përmirësim të performancës dhe për shtatë tregues është vërejtur një notë më e ulët. Nga të shtatë treguesit, tri nota nuk kishin lidhje me ndryshim të performancës por me një interpretim tepër optimist të kuadrit në 2011.

Përmirësimet kryesore janë vërejtur në fushat e mëposhtme:²

TP-3 - Të ardhurat agregate faktike në krahasim me buxhetin e aprovuar fillimisht: Gjatë periudhës së vlerësimit, parashikimi i të ardhurave është bërë më realist (me përjashtim të vitit 2015).

TP-4 - Stoku dhe monitorimi i detyrimeve të prapambetura për shpenzimet: Theksi më i fortë te menaxhimi dhe raportimi i angazhimeve dhe i detyrimeve të prapambetura në pagimin e shpenzimeve ka sjellë përmirësim të performancës.

TP-6 Gjithanshmëria e informacionit të përfshirë në dokumentacionin e buxhetit dhe TP-10 E drejta e publikut për të parë informacione kyçe fiskale: Jepen më shumë informacione kyçe në paketën e buxhetit, ndërsa informacionet kyçe fiskale i vihen në dispozicion publikut.

TP-19 Konkurrenca, maksimizimi i vlerës së fondeve dhe masat kontrolluese në prokurim: Ka pasur përmirësime sa i takon të drejtës së publikut për të parë informacione të plota, të besueshme dhe në kohë mbi prokurimin.

Rënie të performancës janë vërejtur në fushat e mëposhtme:

TP-7 Shkalla e operacioneve të paraportuara: Rënie për shkak të nivelit më të ulët të mbledhjes së të dhënave të gjithanshme në lidhje me njësitë jashtëbuxhetore.

TP-8 Transparenca e transfertave fiskale ndërqeveritare: Rënie për shkak të rritjes së përqindjes së buxhetit që shkon për grante të pakushtëzuara.

TP-11 Rregullsia dhe pjesëmarrja në procesin vjetor të buxhetit: Rënie e performancës për shkak të nxjerrjes së tavaneve buxhetore pas qarkores së buxhetit në 2016 dhe aprovimit me vonesë të buxhetit 2014.

TP-28 Shqyrtimi që u bën legjislativi raporteve të auditimit të jashtëm: Përkeqësim i performancës për shkak të masave të kufizuara që marrin ministritë e linjës në përgjigje të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit.

Efeki që kanë pasur këto lëvizje të performancës në rezultatet buxhetore mund të përmbliidhet si më poshtë:

Disiplina fiskale agregate është fuqizuar nëpërmjet përmirësimeve në parashikimin e të ardhurave dhe monitorimin e detyrimeve të prapambetura në pagimin e shpenzimeve.

Shpërndarja strategjike e burimeve është prekur negativisht nga devijimet nga kalendari i aprovuar i PBA-së. Efeki që kanë pasur ndryshimet e performancës të *përdorimi efikas i burimeve në funksion të realizimit të shërbimeve* ka qenë i përzier. Ka pasur efekt pozitiv nga përmirësimet e dimensioneve të ndryshme të treguesve të transparencës, përfshirë dokumentimin e buxhetit, të drejtën e publikut për informim dhe të drejtën për të pasur informacion prokurimi të besueshëm dhe në kohë. Ka pasur efekt negativ nga niveli më i ulët i mbledhjes së të dhënave të gjithanshme në lidhje me njësitë jashtëbuxhetore dhe përkeqësimi i transparencës së transfertave që u shpërndahen njësitë të qeverisjes vendore. Gjithashtu, mungesa e veprimit në përgjigje të dobësive të nënvizuara në raportet e auditimit mund të sjellë mosshfrytëzim të mundësive për t'i përdorur në mënyrë sa më efektive burimet brenda qeverisë.

Programi i reformës së MFP-së në zbatim

Autoritetet shqiptare kanë bërë përpjekje të gjerësishme për të zbatuar reforma të MFP-së nëpërmjet strategjisë së tanishme për MFP-në. Përpjekjet e para janë fokusuar te hedhja e themeleve për reformën, krijimi i kuadrit institucional dhe hartimi i legjislacionit. Kuadri i monitorimit dhe raportimit për zbatimin e reformave të MFP-së është tani plotësisht në funksionim. Zbatimi i një programi ambicioz reformash përbën sfidë për shkak të kufizimeve në kapacitet në të gjithë sektorin publik. Mund të lindin sfida të tjera për shkak të ndryshimeve organizative pas ristrukturimit të fundit të qeverisë të filluar në vjeshtën e vitit 2017.

2. Treguesit e performancës (TP) të përfshirë në listë janë numëruar sipas versionit të vitit 2011 të kuadrit PEFA

TABELA 1.1 Overview of the scores of the PEFA indicators

Treguesi i performancës së MFP-së	Metoda vlerësimit	Vlerësimet e dimensioneve				Vlerësimi gjithsej
		i.	ii.	iii.	iv.	
Shtylla I. Besueshmëria e buxhetit						
TP-1	Shpenzimet faktike agregate	M1	A			A
TP-2	Përbërja faktike e shpenzimeve	M1	D	A	A	D+
TP-3	Të ardhura faktike	M2	A	B		B+
II. Transparenca e financave publike						
TP-4	Klasifikimi I buxhetit	M1	A			A
TP-5	Dokumentimi i buxhetit	M1	A			A
TP-6	Operacionet e qeverisjes qendrore jashtë raporteve financiare	M2	D*	D*	D	D
TP-7	Transfertat drejt qeverisjes vendore	M2	C	B		C+
TP-8	Informacioni për performancën lidhur me realizimin e shërbimeve	M2	B	B	D	B
TP-9	E drejta e publikut për të parë informacione fiskale	M1	B			B
III. Menaxhimi i aktiveve dhe detyrimeve						
TP-10	Raportimi i risqeve fiskale	M2	C	C	C	C
TP-11	Menaxhimi i investimeve publike	M2	C	D*	C	B
TP-12	Menaxhimi i aktiveve publike	M2	C	D	C	D+
TP-13	Menaxhimi i borxhit	M2	B	A	A	A
IV. Strategjia fiskale dhe përgatitja e buxhetit në bazë të politikave						
TP-14	Parashikimi makroekonomik dhe fiskal	M2	A	B	A	A
TP-15	Strategjia fiskale	M2	B	A	A	A
TP-16	Perspektiva afatmesme në përgatitjen e buxhetit të shpenzimeve	M2	A	C	C	D
TP-17	Procesi i përgatitjes së buxhetit	M2	B	B	C	B
TP-18	Shqyrtimi i buxheteve nga legjislativi	M1	B	C	A	A
V. Parashikueshmëria dhe kontrolli në zbatimin e buxhetit						
TP-19	Administrimi i të ardhurave buxhetore	M2	A	C	C	D
TP-20	Kontabiliteti i të ardhurave	M1	A	A	A	A
TP-21	Parashikueshmëria e shpërndarjes së burimeve përgjatë vitit	M2	D	B	A	B
TP-22	Detyrimet e prapambetura në pagimin e shpenzimeve buxhetore	M1	B	C		C+
TP-23	Kontrolli i listë-pagesave	M1	B	B	C	B
TP-24	Menaxhimi i prokurimit	M2	A	B	A	B
TP-25	Sistemi i kontrollit të brendshëm për shpenzime jo paga	M2	C	C	A	B
TP-26	Auditimi i brendshëm	M1	A	C	A	B
VI. Kontabiliteti dhe raportimi						
TP-27	Integriteti i të dhënave financiare	M2	B	A	A	B
TP-28	Raportet buxhetore gjatë vitit	M1	D	B	C	D+
TP-29	Raportet financiare vjetore	M1	D	B	C	D+
VII. Shqyrtimi dhe auditimi i jashtëm						
TP-30	Auditimi i jashtëm	M1	B	B	C	B
TP-31	Shqyrtimi legjislativ i raporteve të auditimit	M2	A	C	C	B

1. HYRJE

1.1 Arsyeja dhe qëllimi

Shqipëria ka qenë objekt i dy vlerësimeve të mëparshme PEFA, në 2011 dhe në 2006³. Qëllimi kryesor i këtij vlerësimi PEFA është t'i sigurojë Qeverisë së Shqipërisë një diagnozë objektive të përditësuar të performancës së menaxhimit të financave publike në nivel qendror në bazë të metodikës më të fundit PEFA të njohur në nivel ndërkombëtar. Ky vlerësim vendos një pikënisje të re PEFA duke përdorur metodikën PEFA 2016 dhe jep një përditësim të progresit të MFP-së pas vlerësimit të bërë më 2011. Procesi i vlerësimit është përpjekur të mbështetet te njohuri të përbashkëta të performancës së MFP-së dhe te ato dimensione që kanë nevojë për përmirësim. Pritet që rezultatet e këtij vlerësimi ta ndihmojnë qeverinë në monitorimin e zbatimit dhe përditësimin e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2014 – 2020. Vlerësimi është financuar me një grant që KE e ka vënë në dispozicion nëpërmjet programit SAFE (Fuqizimi i Mjedisit të Llogaridhënies dhe Funksioneve të Besuara).

1.2 Menaxhimi dhe kontrolli i cilësisë së vlerësimit

Palët e interesit të vlerësimit PEFA janë autoritetet kombëtare dhe partnerët kryesorë për zhvillim të përfshira në MFP në Shqipëri. Ky vlerësim është ndërmarrë bashkërisht nga Qeveria e Shqipërisë dhe Banka Botërore. Ministria e Financave e Shqipërisë ka luajtur rolin udhëheqës nga ana e qeverisë, ndërsa Banka Botërore ka luajtur rolin udhëheqës nga ana e partnerëve për zhvillim. Këshilli për mbikëqyrjen e zbatimit të reformës së qeverisë për MFP-në ka qenë qendra e ekipit të mbikëqyrjes së vlerësimit. Në të ka përfaqësues nga Ministria e Financave, Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganës, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Komisioni i Prokurimit Publik. Në ekipin mbikëqyrës kishte edhe përfaqësues nga Banka Botërore dhe nga partnerët donatorë të interesuar, siç përshkruhet në kutinë më poshtë.

Konspekti është qarkulluar te shqyrtimi i kolegëve gjatë muajit mars 2017 për një shqyrtim virtual. Shqyrtuesit e konspektit përfshinin përfaqësues nga Ministria e Financave e Shqipërisë, FMN, Bashkimi Evropian, Qeveria Zvicerane, Banka Botërore dhe Sekretariati i PEFA-s. Të gjithë shqyrtuesit dhanë komente dhe konspekti u finalizua dhe aprovua më 22 prill 2017. Konspekti i aprovuar është qarkulluar më 24 prill 2017.

Vizita kryesore e vlerësimit u zhvillua në muajin prill. Rezultatet fillestare u diskutuan gjatë vizitës verifikuese që ka bërë ekipi i vlerësimit në Tiranë në muajin korrik. Projektraporti fillestar është shqyrtuar nga Ministria e Financave dhe institucionet e tjera shtetërore të përfaqësuara në ekipin e mbikëqyrjes së vlerësimit, në dy raunde në korrik-gusht.

Projektraporti i vlerësimit u qarkullua te shqyrtuesit gjatë periudhës 6-27 tetor 2017. Komentet e shqyrtimi të kolegëve u diskutuan në mbledhjen vendimmarrëse të zhvilluar më 2 nëntor 2017. Në raport u bënë pastaj ndryshime për të pasqyruar komentet e shqyrtimit të kolegëve.

3. Janë kryer edhe vlerësime PEFA të njëjësive të qeverisjes vendore (Tiranë, Berat, Tropojë, Kuçovë dhe Fier) në 2015-2016

KUTIA 1.1: Menaxhimi dhe kontrolli i cilësisë së vlerësimit

Organizimi i menaxhimit të vlerësimit PEFA

- Ekipi mbikëqyrës

Ministria e Financave	Erjon Luçi, Zëvendësministër i Financave (kryetar i Ekipit të Mbikëqyrjes)
Banka Botërore Banka Botërore	Bogdan Constantinescu, bashkëdrejtues i Ekipit të Projektit Elena Nikulina, bashkëdrejtuese e Ekipit të Projektit
Ministria e Financave Ministria e Financave Këshilli i Ministrave Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Kontrolli i Lartë i Shtetit Agjencia e Prokurimit Publik Komisioni i Prokurimit Publik	Gelardina Prodani, Sekretare e Përgjithshme Vanina Jakupi, Drejtoreshë, Drejtoria e Menaxhimit të Reformave në Fushën e Menaxhimit Financiar Publik Majlinda Duka, Zëvendëssekretare e Përgjithshme dhe Drejtore e Departamentit për Programimin, Financimin dhe Ndhmën e Huaj Vasilika Vjero, Drejtore e Përgjithshme Belinda Ikonomi, Drejtore e Përgjithshme Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme Xhoana Ristani, Shefe e Sektorit të Integritimit Evropian Evis Shurdha, Kryetar
Delegacioni i Komisionit Evropian	Edina Halapi, Menaxhere Programi, Financat Publike, Qeverisja Ekonomike
Ambasada Zvicerane / Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike Fondi Monetar Ndërkombëtar.	Philipp Keller, Zëvendës Ambasador Jens Reinke, Përfaqësues Vendor i FMN-së në Shqipëri
Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-ve	Dennis Wesner, Përgjegjës për Zhvillimin e Përgjithshëm

- Menaxher i vlerësimit: Erjon Luçi, Zëvendësministër, Ministria e Financave, Shqipëri
- Ekipi i Vlerësimit (Banka Botërore): Bogdan Constantinescu, Specialist i Lartë për Menaxhimin Financiar - Bashkëdrejtues Ekipi; Elena Nikulina, Specialiste e Lartë për Sektorin Publik - Bashkëdrejtuese ekipi; Julia Dhimitri, Specialiste për Sektorin Publik, atashuar nga Sekretariati i PEFA-s; Philip Sinnett, Konsulent, ish-Kryetar i Sekretariatit të PEFA-s; Andrew Mackie, Konsulent; Jonida Myftiu, Specialiste për Menaxhimin Financiar në Shqipëri (Zyra e BB-së në Tiranë); Hilda Shijaku, Ekonomiste për Vendin (Zyra e BB-së në Tiranë); Manjola Malo, Specialiste për Prokurimin (Zyra e BB-së në Tiranë); Donika Qesja, Konsulente (Zyra e BB-së në Tiranë).

Shqyrtimi i konspektit dhe/ose termave të referencës

- Data e projekt-konspektit të shqyrtuar: 07 mars 2017
- Recensuesit të cilëve u është kërkuar mendimi: Ministria e Financave e Shqipërisë; Sekretariati i PEFA-s; Fondi Monetar Ndërkombëtar; Ambasada Zvicerane në Tiranë; Antonio Blasco, Banka Botërore; Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
- Recensuesit që dhanë mendim: Ministria e Financave e Shqipërisë; Holy-Tiana Rame, Sekretariati i PEFA-s; Suzanne Flynn, Fondi Monetar Ndërkombëtar; Sigita Stafa, Ambasada Zvicerane në Tiranë; Antonio Blasco, Banka Botërore; Sybille Schmidt, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri; shqyrtimi është kryer midis datave 7 mars 2017 dhe 17 mars 2017. dhe datës së shqyrtimit
- Data a konspektit përfundimtar: 22 prill 2017 (qarkulluar më 24 prill 2017)

Shqyrtimi i raportit të vlerësimit

- Data e projekt-raportit të shqyrtuar: 1 tetor 2017;
- Recensuesit të cilëve u është kërkuar mendimi: Ministria e Financave e Shqipërisë; Sekretariati i PEFA-s; Fondi Monetar Ndërkombëtar; Ambasada Zvicerane në Tiranë; Antonio Blasco, Banka Botërore; Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri; raporti u është qarkulluar recensuesve të jashtëm më 6 tetor; raporti është qarkulluar për shqyrtim të brendshëm brenda Bankës Botërore më 14 tetor; takimi i shqyrtimit është zhvilluar më 2 nëntor 2017
- Recensuesit që dhanë mendim: Holy-Tiana Rame, Sekretariati i PEFA-s; Suzanne Flynn, Fondi Monetar Ndërkombëtar; Sigita Stafa, Ambasada Zvicerane në Tiranë; Antonio Blasco, Banka Botërore; Sybille Schmidt, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

1.3 Metodika e vlerësimit

Mbulimi i vlerësimit

Vlerësimi mbulon qeverisjen qendrore dhe pasqyron statusin e sistemit të MFP-së më datën e vlerësimit në prill 2017. Në përgjithësi, të dhënat e përdorura për vlerësimin e treguesve mbulojnë vitet 2014-2016. Periudha e veçantë e mbuluar për secilin tregues ndjek nga afër Udhëzuesin e Terrenit të PEFA-s⁴. Vlerësimi trajton ministritë, departamentet dhe agjencitë kryesore të qeverisjes qendrore, përfshirë edhe fondin e sigurimeve të kujdesit shëndetësor dhe atë të sigurimeve shoqërore. Njësitë jashtëbuxhetore (NJJB) mbulohen për ata tregues të cilët duhet t'i përfshijnë. Mbulimi i veçantë për secilin tregues ndjek nga afër Udhëzuesin e Terrenit të PEFA-s.

Metodika

Vlerësimi sheh performancën e Shqipërisë në përputhje me 31 treguesit e Kuadrit të Matjes së Performancës së PFM-së (PEFA 2016). Metodika e vitit 2016 identifikon shtatë shtyllat e performancës që janë thelbësore për një sistem transparent dhe të rregullt të MFP-së. Këto janë besueshmëria e buxhetit, transparenca e financave publike, menaxhimi i aktiveve dhe pasiveve, strategjia fiskale dhe përgatitja e buxhetit në bazë të politikave, parashikueshmëria dhe kontrolli në zbatimin e buxhetit, kontabiliteti dhe raportimi dhe shqyrtimi dhe auditimi i jashtëm.

Çdo dimension dhe çdo tregues është vlerësuar me notë kundrejt kriterëve të përcaktuara në Udhëzuesin e Terrenit të PEFA-s. Më parë është kryer një vlerësim PEFA në vitin 2011, në bazë të metodikës së mëparshme PEFA. Krahas përdorimit të Udhëzimeve për Kryerjen e një Vlerësimi të Përsëritur, është ndjekur ndryshimi i performancës në kohë, duke përdorur kuadrin PEFA 2011⁵.

Projektraporti i vlerësimit është përgatitur nga ekipi i Bankës Botërore dhe i është dërguar për komente dhe sugjerime për shtesa dhe ndryshime ekipit të qeverisë. Më pas, një projektraport përfundimtar u është dërguar recensuesve. Këta përfshinin përfaqësues nga Ministria e Financave e Shqipërisë, FMN, Bashkimi Evropian, Qeveria Zvicerane, Banka Botërore dhe Sekretariati i PEFA-s.

Në korrik 2017 është zhvilluar një prezantim paraprak ku janë shpjeguar konstatimet paraprake, ndërsa prezantimi përfundimtar është planifikuar me t'u finalizuar dhe aprovuar raport i PEFA-s. Pritet që raporti përfundimtar i PEFA-së të përdoret nga Qeveria në monitorimin e zbatimit dhe përditësimin e Strategjisë për Reformën e MFP-së.

Mbledhja e të dhënave

The sources of information for the assessment included relevant legislation, budget documentation and reports, methodology and other documentation and data provided by the MoF and other institutions involved in the assessment, information collected by the assessment team during the interviews, 2006 and 2011 PEFA reports, assessment reports for the 2016 local PEFA assessments, relevant reports produced by the World Bank, IMF, and other development partners (see Annexes 3A, 3B).

4. (https://pefa.org/sites/default/files/16_08_30%20Fieldguide_9.pdf)

5. Shih Shtojcën shtesë (Shtojca 4)

Ekipi mbikëqyrës dhe ekipi i vlerësimit në MF kanë luajtur një rol kyç në bashkërendimin e mbledhjes së të dhënave. Anëtarët kyç të ekipit të vlerësimit të MF-së njiheshin edhe më parë me metodikën PEFA nga pjesëmarrja në vlerësime të mëparshme dhe trajnimet përkatëse, përfshirë edhe një seminar të zhvilluar kohët e fundit në Qendrën e Përqendrimit të Njohurive në Financa (Center for Excellence in Finance–CEF) në Slloveni. Më 13-14 shkurt 2017 u zhvillua në Tiranë një trajnim i hollësishëm për metodikën PEFA 2016, ku morën pjesë afro 45 pjesëmarrës nga institucione shqiptare.

Në intervista u angazhuan të gjitha institucionet kyçe për MFP-në, si Kontrolli i Lartë i Shtetit, Kuvendi, Banka e Shqipërisë, Komisioni i Prokurimit Publik, Agjencia e Prokurimit Publik, Instituti i Statistikave, Dhoma e Tregtisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, shoqëria civile dhe të tjerë. Krahas këtyre, qenë edhe institucionet shtetërore të përfshira në përgatitjen e buxhetit, realizimin e buxhetit, prokurimin, auditimin dhe kontrollin e brendshëm dhe kontabilitetin dhe raportimin. Krahas kësaj, janë bërë takime me ministri si njësi kryesore shpenzuese (si shëndetësia, arsimit dhe transporti) për të bërë verifikim të informacioneve të marra nga Ministria e Financave. Lista e plotë e personave të intervistuar për këtë vlerësim jepet në Shtojcën 3C.

2. INFORMACION PËR KONTEKSTIN E VENDIT

2.1 Situata ekonomike e vendit

Shqipëria doli pas rënies së regjimit vetizolues komunist në fillim të viteve '90 të shekullit XX si një prej vendeve më të varfra të Evropës. Pas kësaj erdhi një rritje e vullshme ekonomike prej afro 6 për qind në vit, çka e futi Shqipërinë mes vendeve më të ardhura të mesme brenda vitit 2008. Gjatë kësaj periudhe, rritja vinte më së shumti nga rritja e konsumit të brendshëm, ku faktorët qenë bumi i ndërtimeve në bregdet dhe dërgesat private nga jashtë të cilat arrinin 10,8 për qind të PBB-së, si pasojë e niveleve të larta të emigrimit. Kjo rritje u shoqërua me rënie të varfërisë, ku shkallët e varfërisë (e matur me kufirin 5 USD/ditë) ranë nga 62,3 për qind në 2002 në 43,9 për qind në 2008. Edhe varfëria e skajshme (e matur me 2,5 USD/ditë) ra në të njëjtën periudhë nga 12 për qind në 5,2 për qind.

Ecuria e fuqishme ekonomike gjatë dekadës së parë të shekullit XXI solli përfitime të rëndësishme në fushën sociale, mirëpo kriza financiare botërore dhe kriza e mëpasshme e eurozonës e ndërpreu këtë rrugë drejt prosperitetit të përbashkët. Menjëherë pas krizës financiare botërore, rritja e Shqipërisë mbeti relativisht e fortë, me shkallë mesatare 3,2 për qind në 2009-2011, mbështetur nga konsumi i nxitur nga dërgesat private nga jashtë. Por kjo rritje u ngadalësua në 2012 dhe 2013, nën ndikimin e përkeqësimit të situatës së Italisë dhe Greqisë fqinje.

Aktiviteti ekonomik ka përmirësim prej vitit 2014, nën nxitjen e investimeve të fuqishme private. Pasi u rrit me 1 për qind në 2014 dhe 2,2 për qind në 2015, Shqipëria pati një rritje prej 3,5 për qind në 2016 sepse investimet private vijuan të jenë të fuqishme, ndërsa konsumi vijoi të rritej me mbështetjen e rritjes së punësimit. PBB reale pritet të fuqizohet në 3,6 për qind në 2017, kryesisht me shtytjen e kërkesës së brendshme, përfshirë edhe investimet private (sidomos në fushën e ndërtimit të ndërtesave jo rezidenciale) dhe konsumin privat, me një rimëkëmbje graduale të pozicionit të jashtëm neto. Zhvillimet pozitive në tregun e punës dhe lehtësimi i standardeve të kreditimit pritet të vijojnë ta mbështesin konsumin privat gjatë pjesës tjetër të vitit.

Rimëkëmbja ekonomike është shoqëruar me lehtësimin e pozitave të cenueshme nga jashtë. Shqipëria ka një deficit strukturor të llogarisë korrente i cili financohet kryesisht nga dërgesat private nga jashtë. Gjithashtu, deficitin e llogarisë korrente luhatet në varësi të çmimeve të mallrave bazë. Importet (sidomos të makinerive dhe pajisjeve) të cilat janë zgjeruar si pasojë e rritjes së investimeve dhe aktivitetit ekonomik duke filluar nga viti 2014, ranë në vitin 2015 për shkak të çmimeve më të ulëta të naftës. Importet janë rritur përsëri në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017 si pasojë e investimeve të mëdha që nevojiten në sektorin energjetik. Eksportet e shërbimeve, ku kryeson turizmi, i kanë kompensuar rezultatet e dobëta në fushën e industrisë së shfrytëzimit mineral, duke çuar në zvogëlim të deficitit të përgjithshëm tregtar. Meqë rreth 40 për qind e popullsisë jeton jashtë vendit (kryesisht në Greqi dhe Itali), Shqipëria historikisht është ndër vendet që marrin më shumë dërgesa private nga jashtë. Dërgesat korrente, përfshirë edhe dërgesat private, kanë rënë ndjeshëm nga 10,8 për qind të PBB-së në 2009 në 6,9 për qind në 2015, dhe pritet të arrijnë nivelin 6,7 për qind të PBB-së në vitin 2017. Deficiti i llogarisë korrente është financuar kryesisht nëpërmjet IHD-ve, të cilat kanë ruajtur nivelin rreth 8 për qind të PBB-së në vitin 2016, dhe nëpërmjet financimit të jashtëm të qeverisë.

Edhe pse sektori financiar më së shumti i ka bërë ballë krizës botërore, cilësia e portofolit të kredive është e ulët dhe e kufizon zgjerimin e mëtejshëm të kreditimit. Rritja e vrullshme e kreditimit përpara krizës, shoqëruar me lehtësimin e standardeve të kreditimit, huamarrjen e tepërt në valutë të huaj pa instrumente mbrojtëse dhe ekspozimin e tepërt në disa sektorë të tillë si ndërtimi krijuan pozita të pambrojtura në bilancet e bankave të nivelit të dytë. Me ardhjen e krizës financiare botërore, raporti i kredive nën standard u rrit nga 6,5 për qind në 2008 në 25 për qind në shtator 2014, që ka qenë edhe niveli maksimal, pas së cilës ra në 17 për qind në tremujorin e parë të vitit 2017. Në nivelin e kredive nën standard kanë ndikuar edhe proceset e stërzgjatura gjyqësore dhe vështirësitë në ekzekutimin e kolateralit, çka vijon ta mbajë të ulët ofertën e kreditimit. Pavarësisht nga niveli i lartë i kredive nën standard, bankat vijojnë të jenë rentabël dhe të kapitalizuara mirë. Me gjithë pjesëmarrjen relativisht të lartë të bankave me kapital grek, sistemi financiar shqiptar i ka bërë ballë situatës në Greqi, pa pasoja madhore.

TABELA 2.1 Disa tregues ekonomikë të përzgjedhur

	2014	2015	2016
PBB (milion lekë)	1.395.304	1.427.799	1.472.791
PBB për frymë (euro)	3.450	3.550	3.726
Rritja reale e PBB-së (%)	1,8%	2,2%	3,4%
IÇK (ndryshimi vjetor mesatar) (%)	1,6%	1,9%	1,3%
Borxhi shtetëror bruto (% e PBB-së)	70%	73%	71,6%
Kushtet e jashtme të tregtisë (ndryshimi për qind vjetore)	-1,8%	-5,6%	-2,2%
Bilanci i llogarisë korrente (% e PBB-së)	12,9%	10,8%	9,6%
Borxhi i jashtëm gjithsej (% e PBB-së)	69,5%	74,6%	72,9%
Rezervat zyrtare bruto (muaj vlerë importi)	5	6,2	5,7

Burimi : INSTAT, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, llogaritje të stafit të BB-së.

2.2 Trendët fiskalë dhe buxhetorë

Pozita fiskale e Shqipërisë u përkeqësua pas krizës financiare botërore dhe qeveria akumuloi një shumë të konsiderueshme detyrimesh të prapambetura kundrejt sektorit privat. Deficiti i përgjithshëm fiskal shtetëror, i cili pat qenë mesatarisht 3,4 për qind në periudhën 2005-2012, u rrit ndjeshëm në 5,2 për qind të PBB-së në vitin 2013. Të ardhurat buxhetore, si përqindje e PBB-së, të cilat qenë rritur në 26,7 për qind në 2008, ranë përsëri në nivelin 23,7 për qind në 2013 për shkak të zvogëlimit të shkallës së tatimit mbi fitimin, rritjes së përjashtimeve nga TVSH-ja dhe rënies së mbledhjes së ardhurave. Borxhi publik u rrit ndjeshëm nga 55 për qind e PBB-së në 2008 në rreth 71 për qind deri në vitin 2013. Kjo qe pasojë e politikës fiskale ekspansioniste që u ndoq menjëherë përpara zgjedhjeve të vitit 2013, si edhe e shkallëve më të ulëta të rritjes ekonomike, rënies së mbledhjes së të ardhurave fiskale, rritjes së trysnive fiskale në lidhje me mungesat energjetike, si edhe stokun e akumuluar të detyrimeve të prapambetura që kishte qeveria kundrejt sektorit privat, në rreth 70,7 miliard (rreth 5,2 për qind e PBB-së në 2013).

Në vitet e fundit stabilizimi fiskal është mbështetur me politika të kujdesshme fiskale. Në vitin 2014, Shqipëria filloi një program të konsolidimit fiskal me mbështetjen e partnerëve të jashtëm, në të cilin përfshiheshin masa në të dyja anët e buxhetit—të ardhura dhe shpenzime—dhe reforma për t'u dhënë zgjidhje dobësive strukturore siç janë ato në sektorin energjetik dhe në pensione, krahas shlyerjes së detyrimeve të prapambetura kundrejt sektorit privat. Në masat për të ardhurat buxhetore përfshihej rritja e shkallës së tatimit mbi fitimin (TF), shkallëve të akcizës mbi produktet e duhanit, pijet alkoolike dhe kafënë dhe taksës së qarkullimit, si edhe puna kundër evazionit. Masat nga ana e

shpenzimeve përfshijnë vendosjen e një limiti maksimal mbi fondin e pagave, disa kursime të krijuara nga ana e shpenzimeve mbi interesat dhe një ulje graduale të mbështetjes buxhetore për sektorin energjetik. Deficiti i përgjithshëm fiskal shtetëror ra në 1,8 për qind të PBB-së në 2016 (në krahasim me 4,9 për qind në 2015) në përputhje me përpjekjet për konsolidim fiskal në vend. Janë vënë re trendë të ngjashëm për qeverisjen qendrore, sikurse ilustron nga tabela 2.2.

TABELA 2.2 Të dhënat fiskale agregate (qeverisja qendrore buxhetore)

Faktike (në përqindje të PBB-së)			
	VF 2014	VF 2015	VF 2016
Të ardhura gjithsej	25,39	25,88	26,65
–Të ardhura të veta	24,66	25,17	25,66
–Grante	0,73	0,70	0,99
Shpenzime gjithsej	30,56	30,38	28,43
–Shpenzime jo mbi interesa	27,69	27,68	25,97
–Shpenzime mbi interesa	2,87	2,71	2,46
Deficit agregat (përf. grantet)	-5,17	-4,51	-1,78
Deficiti primar	-2,30	-1,80	0,68
Financimi neto**	5,56	3,79	1,81
–I jashtëm	2,14	4,52	1,19
–I brendshëm	3,41	-0,74	0,62

Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të stafit të BB-së.

Shënim: ** Financimi neto ka të bëjë me financimin neto të qeverisjes së përgjithshme, ku përfshihet pozicioni neto i qeverisjes neto.

Sa i takon zbrëthimit funksional të shpenzimeve të qeverisjes qendrore midis vitit 2014 dhe 2016, konsolidimi është shoqëruar gjithmonë me ulje të shpenzimeve publike për çështje ekonomike, shërbime të përgjithshme publike, mbrojtjen, ndërsa përqindja që zënë mbrojtja sociale dhe shëndetësia janë rritur, siç janë rritur edhe shpenzimet publike për sigurinë dhe rendin publik. Janë miratuar fonde të posaçme për të pastruar stokun historik të detyrimeve të prapambetura, çka shpjegon rritjen e madhe të shpenzimeve të tjera në vitin 2015.

TABELA 2.3 Shpërndarjet buxhetore sipas funksionit (qeverisja qendrore buxhetore)

Shpërndarjet buxhetore faktike, sipas sektorëve (si përqindje e shpenzimeve gjithsej)			
	VF 2014	VF 2015	VF 2016
Shërbimet e përgjithshme publike	6,34	0,94	5,87
Mbrojtja	3,31	2,69	2,70
Rendi dhe siguria publike	6,29	6,37	6,65
Çështjet ekonomike	13,22	14,68	11,71
Mbrojtja e mjedisit	0,24	0,35	0,71
Strehimi dhe shërbime për komunitetin	7,95	7,07	7,29
Shëndetësia	10,88	9,76	10,93
Koha e lirë, kultura dhe feja	1,57	1,65	1,66
Arsimi	12,16	11,31	12,05
Mbrojtja sociale	34,13	33,51	36,40
Shpenzime të tjera	3,91	11,67	4,02

Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të stafit të BB-së.

Shënim: Nuk përfshin shpenzimet mbi interesat dhe fondin rezervë.

Sa i takon zbërthimit ekonomik të shpenzimeve të qeverisjes qendrore, një ngrirje nominale e pagave dhe pensione ve të sektorin publik solli rënie të shpenzimeve për pagat, ndërsa kalimi drejt huamarrjes së jashtme afatgjatë solli rënie të shpenzimeve mbi interesat⁶.

TABELA 2.4 Shpërndarjet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik (qeverisja qendrore buxhetore)

Shpërndarjet buxhetore faktike, sipas klasifikimit ekonomik (si përqindje e shpenzimeve gjithsej)			
	VF 2014	VF 2015	VF 2016
Shpenzimet korrente			
–Paga dhe shpërblime	16,80	16,71	16,13
–Mallra dhe shërbime	7,79	9,78	10,59
–Interesa	9,43	8,91	8,66
–Transferta	43,30	44,96	49,11
–Të tjera	8,37	5,44	1,31
Shpenzime kapitale	14,31	14,21	14,20

Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të stafit të BB-së.

2.3 Kuadri ligjor dhe rregullator për MFP-në

Kuadri ligjor dhe rregullator për MFP-në në Shqipëri mbështetet te Kushtetuta (1998). Shumica e ligjeve që rregullojnë MFP-në janë rishikuar vitet e fundit për të mbështetur përpjekjet për konsolidim fiskal. Ligji kryesor i MFP-së është Ligji "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë" (2008, i ndryshuar në 2016), ku përcaktohen elementet e sistemit buxhetor dhe proceset kryesore të MFP-së dhe rregullohet menaxhimi i financave publike për të gjitha nivelet e qeverisjes. Procedurat e hollësishme për përgatitjen e buxhetit dhe zbatimin e buxhetit dokumentohen në udhëzimet standarde për këto procese të miratuara në 2012 dhe të ndryshuara në 2016. Në dy vitet e fundit është miratuar një legjislacion i ri që rregullon masat kontrolluese për shpenzimet dhe auditimin e brendshëm, ku janë bërë përshtatje ose përmirësime në ligjet e mëparshme për menaxhimin dhe kontrollin financiar, prokurimin, auditimin e brendshëm dhe të jashtëm. Ligji kuadër në menaxhimin fiskal është Ligji "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i miratuar në 2008 dhe i ndryshuar në nëntor 2016. Ka ligje të veçanta që rregullojnë llojet kryesore të tatimeve, siç është Ligji për TVSH-në, ligji për tatimin mbi të ardhurat, ligji për akcizat dhe ligji për taksat kombëtare dhe vendore, në të cilët janë bërë shtesa dhe ndryshime këto tre vitet e fundit. Qeveria e ka vënë edhe një herë theksin te sigurimi i stabilitetit dhe parashikueshmërisë së financave vendore, nëpërmjet ndryshimeve të bëra në ligjin për financat vendore, të miratuara në fund të vitit 2015.

Në Tabelën 2.5 jepet një përmbledhje e akteve ligjore dhe nënligjore kryesore që rregullojnë sistemet e MFP-së në Shqipëri. Elementet kryesore të kuadrit ligjor në lidhje me fusha të veçanta trajtohen më me hollësi në tekstin që përshkruan treguesit përkatës të performancës.

6. Në 2016, disa transferta të kushtëzuara për qeverisjes vendore për projekte kapitale janë riklasifikuar nga shpenzime kapitale në transferta

TABELA 2.5 Përmbledhje e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë MFP-në në Shqipëri

Fusha	Përshkrimi
Të përgjithshme	<ul style="list-style-type: none"> • Kushtetuta (1998) vendos bazën për MFP-në. • Ligji nr.9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në qershor 2016, ku përcaktohen elementet kryesore të sistemit buxhetor dhe proceset kryesore të MFP-së
Përgatitja dhe zbatimi i Buxhetit	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (2012, ndryshuar në 2016); • Udhëzimi për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit (2012, ndryshuar në 2016)
Borxhi	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr.9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë" (ndryshuar me Ligjin nr.181/2014); përcakton organet dhe procedurat për administrimin e borxhit
Administrimi tatimor	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr.112/2016, datë 03.11.2016, ndryshime të cilat kanë hyrë në fuqi më 2017 • Akte ligjore të përgjithshme për tatimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta: <ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr.156/2014, datë 27.11.2014, që ka hyrë në fuqi më 2015 - Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr.71/2017, datë 27.04.2017 - Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016 - Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr.142/2015, datë 17.12.2015 - Ligji nr.61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar për herë të fundit në 2016
Financat vendore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr.68/2016 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
Prokurimi	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar për herë të fundit në prill 2017
Kontrolli i menaxhimit financiar dhe auditimi i brendshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 10 296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", parashikon përgjegjësitë e menaxhimit për realizimin dhe kontrollin e buxhetit. • Ligji "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik" (2015)
Auditimi i jashtëm	<ul style="list-style-type: none"> • Kushtetuta (1998) nenet 162-165 Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" (2015)
Kontrolli mbikëqyrës legjislativ	<ul style="list-style-type: none"> • Kushtetuta (1998) nenet 155-160. • Rregullorja e Brendshme e Kuvendit • Ligji nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"

2.4 Kuadri institucional për MFP-në

Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm. Parlamenti me një dhomë (Kuvendi) përfaqëson legjislativin. Ekzekutivi përfaqësohet nga Presidenti si kreu i shtetit, Kryeministri si kreu i qeverisë dhe nga Këshilli i Ministrave. Gjyqësori përbëhet nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë dhe disa gjykata apeli dhe gjykata të rretheve gjyqësore. Kushtetuta e tanishme është miratuar me referendum më 1998. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë të zgjedhur në mënyrë proporcionale nga 12 lista në qarqe. Deputetët zgjidhen me mandat katërvjeçar.

Sistemi gjyqësor përfshin gjykata të rretheve gjyqësore, gjashtë gjykata apeli dhe një Gjykatë të Lartë (që njihet edhe si Gjykata e Kasacionit). Gjykatat e rretheve gjyqësore janë gjykata të shkallës së parë, pas të cilave mund të bëhet apelim i vendimit në gjykatat e apelit dhe më pas te Gjykata e Kasacionit. Gjykata e Kasacionit përbëhet nga 14 anëtarë, përfshirë edhe kryetarin e gjykatës. Ka edhe një Gjykatë Kushtetuese me kompetencë për zgjidhjen e çështjeve të interpretimit kushtetues që lindin gjatë çdo çështjeje në apelim. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, përfshirë edhe kryetarin. Kuvendi emëron shtatë anëtarë të Gjykatës së Kasacionit dhe pesë nga nëntë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, ndërsa të tjerët emërohen nga Presidenti. Të gjithë gjyqtarët e tjerë emërohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Funksioni i auditimit të jashtëm publik kryhet nga Këshilli i Lartë i Shtetit. Ligji nr.154/2014, datë 27 nëntor 2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" jep bazën ligjore për të siguruar që Kontrolli i Lartë i Shtetit të funksionojë si një institucion modern auditimi. Ligji nr.154/2014 parashikon llojet e auditimit që mund të kryhen nga KLSH, siç janë auditimet financiare, auditimet e përputhshmërisë, auditimet e performancës dhe auditimet e TI-së. Në praktikë, shumica e kontrolleve të KLSH-së janë auditime përputhshmërie me fokusin te gjetja e parregullsive si edhe te nënvijëzimi i problemeve me rëndësi materiale dhe i risqeve të sistemit dhe kontrollit. Kontrollat e viteve fiskale 2013-2105 të njërive të qeverisjes qendrore janë kryer më së shumti si auditime të përputhshmërisë.

Politika sektoriale shtetërore dhe rregullimi në nivel kombëtar është përgjegjësi e 16 ministrive që janë në varësi të Kryeministrit⁷. Politikat zbatohen dhe shërbimet publike realizohen nga institucione, shërbime dhe inspektive që japin llogari te ministritë e linjës.

Roli udhëheqës në menaxhimin e financave publike i është ngarkuar Ministrisë së Financave⁸. Kjo përfshin formulimin dhe monitorimin e politikës fiskale, përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, kontrollin financiar të brendshëm publik, menaxhimin e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm publik, integrimin e politikave fiskale dhe monetare në ekonominë kombëtare në bashkëpunim dhe bashkërendim me bankën qendrore dhe institucionet përkatëse. Ministria përbëhet nga disa drejtori të përgjithshme – thesari, buxheti, borxhi publik, politika fiskale dhe njësitë e harmonizimit qendror për menaxhimin financiar publik dhe kontrollin dhe për auditimin e brendshëm. Institucionet në varësi të MF-së përfshijnë drejtoritë e përgjithshme të tatimeve, të doganave dhe të pastrimit të parave.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka detyrën e administrimit të fondit të sigurimeve shoqërore, ndërsa Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor administron fondin e sigurimeve shëndetësore. Të dy fondet e sigurimeve shoqërore kanë statusin e fondeve buxhetore.

7. Të dhënat për numrin e ministrive reflektojnë situatën në kohën kur është kryer vlerësimi. Qeveria kaloi nëpër një riorganizim madhor në vjeshtën e vitit 2017, si pasojë e të cilit kanë ndryshuar funksionet e shumë ministrive, si edhe numri gjithsej i tyre

8. Informacionet për emrat dhe funksionet e ministrive reflektojnë situatën në kohën kur është kryer vlerësimi. Si rezultat e riorganizimit të qeverisë në vjeshtën e vitit 2017 Ministria e Financave u bashkua me Ministrinë e Ekonomisë duke e riemërtuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ministrisë së Financave iu kaluan edhe disa funksione të Ministrisë së Punës

TABELA 2.6 Struktura e sektorit publik (numri i subjekteve dhe qarkullimi financiar)

Sektori publik													
Viti 2016	Nësektori i qeverisjes						Nësektori i shoqërive publike						
	Njësitë buxhetore			Njësitë jashtëbuxhetore			Shoqëritë publike jofinanciare			Shoqëritë publike financiare			
	Numri i njëjësive	Qarkullimi (milion lekë)	Numri i njëjësive	për të cilat ka informacion	Qarkullimi (milion lekë)	Numri i njëjësive	për të cilat ka informacion	Qarkullimi (milion lekë)	Numri i njëjësive	për të cilat ka informacion	Qarkullimi (milion lekë)	Numri i njëjësive	Qarkullimi (milion lekë)
Qeverisja qendrore	53 njësi institucionale	295.490	63	28	9.926								
(përfshirë 16 ministri, 12 prefektura), 1469 njësi shpenzimi	12 regions and 61 municipality	16.954	90	67	6.263								
Njësitë e qeverisjes vendore	12 qarqe dhe 61 bashki	77.090											
Fondet e sigurimeve shoqërore	2 (fondi i sigurimeve shoqërore, fondi i sigurimeve shëndetësore)												
Shoqëri publike						16			11		n/a	2	n/a

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT.

Autoriteti kryesor i administrimit të ardhurave është administrata tatimore, së cilës i është ngarkuar mbledhja e tatimit mbi të ardhurat personale, TVSH-së, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe taksave të tjera në nivel kombëtar (taksa e lojërave të fatit etj.). Administrata doganore administron taksat doganore dhe të akcizës.

Ministritë e linjës kanë përgjegjësi funksionale dhe janë përgjegjëse për mbajtjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm brenda ministrive. Ato çelin propozimet për buxhetin e ministrisë, realizojnë buxhetin e aprovuar, bëjnë shpenzimet, prokurojnë mallrat dhe shërbimet dhe raportojnë për performancën të MF-jë dhe palët e tjera të interesuara në mënyrë të rregullt.

Pas ndryshimeve të bëra në vitin 2012 në Ligjin e Prokurimit Publik (LPP), ka dy subjekte kryesore që rregullojnë prokurimin publik. Organi qendror përgjegjës për politikën e prokurimit publik është Agjencia e Prokurimit Publik (APP), së cilës i është ngarkuar zyrtarisht edhe përgjegjësia për koncesionet. Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është përgjegjës për sigurimin e një mekanizmi të shqyrtimit të ankesave.

Njësitë e qeverisjes vendore përbëjnë nivelin e dytë të qeverisjes dhe përfshijnë 12 qarqe dhe 61 bashki. Organizimi i njësive të qeverisjes vendore ka ndryshuar kohët e fundit në kuadër të reformës së re territoriale dhe administrative. Bashkitë janë njësitë bazë të qeverisjes vendore, duke kryer menaxhimin financiar dhe të gjitha detyrimet e tjera të vetëqeverisjes që nuk janë të caktuara në njësi të tjera nga aktet ligjore dhe nënligjore të qeverisjes kombëtare. Ato përgatisin buxhetet, realizojnë buxhetet e miratuara, lidhin kontrata dhe bëjnë prokurime dhe të gjitha aspektet e tjera të administrimit shtetëror. Këshillat e pushtetit vendor zgjidhen me mandat katërvjeçar, sikurse edhe kryetari i tyre. Aty ku ka disa njësi të qeverisjes vendore me interesa dhe tradita të përbashkëta dhe me lidhje ekonomike, këto mund të përfaqësohen nga një qeverisje qarku, e administruar nga një këshill qarku i zgjedhur. Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore konsolidohen në pasqyrat financiare të qeverisjes së përgjithshme në përfundim të vitit.

TABELA 2.7 Struktura financiare e qeverisjes qendrore⁹ (milion lekë)

Viti 2016	Qeveria qendrore			
	Buxheti i shtetit		Fondet e sigurimeve shoqërore	
	Buxheti	Fakti	Buxheti	Fakti
Të ardhura	323.891	312.917	78.501	79.153
Shpenzime	251.163	237.526	152.593	152.591
Transferimet te (-) dhe nga (+) nivele te tjera të qeverisë së përgjithshme	29.917	1.886	74.092	73.438

Burimi: Ministria e Financave.

9. Të dhënat e plota që nevojiten për formatin e rekomanduar të Tabelës 2.7. nuk janë të disponueshme, prandaj formati është modifikuar

2.5 Karakteristika të tjera të MFP-së dhe mjedisi në të cilin funksionon

Kuadri institucional në Shqipëri për menaxhimin e burimeve buxhetore mund të përshkruhet si i centralizuar në mënyrë të moderuar, me njëfarë shkalle devolgimi të masave kontrolluese operative te ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes poshtë nivelit qendror. Kuadri rregullator i përgjithshëm është vendosur në nivel qendror. Procedurat e MFP-së që përdoren në nivel qendror dhe vendor janë në përgjithësi të njëtrajtshme dhe përcaktohen nga autoritetet qendrore. Planifikimi buxhetor ndërthur elemente nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart, ku ministritë e linjës shprehin objektivat dhe prioritetet e tyre sektoriale brenda një limiti burimesh të caktuar nga qendra. Ministritë dhe njësitë e tjera shpenzuese kanë njëfarë lirshmërie në përcaktimin e planeve të hollësishme të shpenzimeve, por me t'u vendosur këto kthehen në masa kontrolluese të palëvizshme të zbatimit të buxhetit brenda sistemit të centralizuar të thesarit, dhe mund të ndryshohen vetëm me miratim të Ministrisë së Financave. Njësitë shpenzuese janë përgjegjëse edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm të menaxhimit financiar.

Sistemi kryesor informatik që shfrytëzohet nga Ministria e Financave tani për tani është sistemi informatik i thesarit (zyrtarisht i quajtur sistemi informatik financiar i Qeverisë, SIQF¹⁰). Funksionet e automatizuara nëpërmjet këtij sistemi përfshijnë zbatimin e buxhetit, menaxhimin e angazhimeve, menaxhimin e likuiditetit, kontabilitetin dhe raportimin. Vënë në zbatim në 2010, ky sistem është përdorur fillimisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, degët e thesarit dhe Drejtoria e Përgjithshme Buxhetit. Por u pa se ky sistem do të ishte edhe më efektiv nëse edhe njësitë shpenzuese u jepeshin të drejta në të. Testimi pilot i dhënies së të drejtave të drejtpërdrejta në këtë sistem ka nxjerrë në pah kufizime teknike dhe financiare madhore mbi zbatimin e tij (për shkak të nevojave për të bërë ndryshime në softuer dhe të kostove të larta të licencimit). Më pas u vendos të krijohet një portal në rrjet për t'u dhënë njësitë shpenzuese të drejta (pa pagesë ose me kosto të ulët) në atë funksionalitet të sistemit që nevojitet në nivelin e tyre. Aktualisht, MF po zhvillon në bazë të SIFQ-së, zgjidhje TIK për një sistem informatik të integruar të menaxhimit financiar (SIIMF) dhe dy module të ndërlidhura të sistemit informatik që do të administrohen nga Kryeministria (Kryeministria do të administrojë modulën e planifikimit të integruar, SISPI, dhe modulën e asistencës së jashtme, EAMIS).

Kuadri institucional për MFP-në u është nënshtruar ndryshimeve të konsiderueshme pas ardhjes së qeverisë së re në 2013. Përgjegjësitë për menaxhimin e investimeve publike iu kaluan Ministrisë së Ekonomisë por pastaj iu rikthyen Ministrisë së Financave në 2016. Kapaciteti i MF-së u prek ndjeshëm nga shkurtime të mëdha në personel në vitin 2015. Në vitin 2016, kësaj ministrie iu dha mundësia ta rivendoste numrin e vendeve të punës, por plotësimi i vendeve të lira me punonjës që i vështirë dhe zgjati shumë në kohë, prandaj në momentin e vlerësimit ministria vijonte të punonte me shumë vende pune ende të paplotësuara.

Struktura e Qeverisë i është nënshtruar një ndryshimi tjetër radikal në vjeshtën e vitit 2017, pas zgjedhjeve të fundit parlamentare. Si rezultat i këtij riorganizimi të fundit, Ministria e Financave u bashkua me Ministrinë e Ekonomisë duke marrë edhe disa funksione të Ministrisë së Punës. Kjo u shoqërua me një tjetër raund të riorganizimit të personelit, me një numër gjithsej punonjësish në organikën e re të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që është ndjeshëm më i vogël se numri i punonjësve gjithsej në ministritë e mëparshme.

Përpjekjet e Qeverisë për konsolidim fiskal, si edhe reformat e MFP-së, kanë përfituar nga mbështetja e fortë e partnerëve për zhvillim të Shqipërisë. Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, Shqipëria kishte një program aktiv me FMN-në dhe ka përfituar mbështetje buxhetore dhe asistencë teknike nga disa partnerë për zhvillim, përfshirë FMN-në, Bankën Botërore, BE-në, SECO-n, SIDA-n.

10. Regjistruar në listën e bazës së të dhënave shtetërore me VKM nr. 352 datë 11.05.2016 ku përcaktohen të dhënat, institucionet përgjegjëse, nivelet e të drejtave në sistem dhe përgjegjësitë administrative për çdo institucion

3. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË MFP-SË



3.1 SHTYLLA I : Besueshmëria e buxhetit

TP-1. Shpenzimet faktike agregate

Ky tregues mat shkallën me të cilën shpenzimet agregate faktike të buxhetit reflektojnë shumat e miratuara fillimisht, siç janë përcaktuar në dokumentacionin e buxhetit të shtetit dhe në raportet fiskale. Ka një dimension për këtë tregues - Dimensionin 1.1. Shpenzimet faktike agregate (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015 dhe 2016, mbulimi - QQB).

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-1. Shpenzimet faktike agregate	Vlerësimi i përgjithshëm A	
1.1. Shpenzimet faktike agregate	Vlerësimi i dimensionit A	Shpenzimet faktike agregate qenë midis 95% dhe 105% të shpenzimeve agregate të miratuara në buxhet në 2016 dhe 2014 dhe 94,5% në 2015.

TABELA 3.1 Shpenzimet faktike agregate

Shpenzimet gjithsej të parashikuara në buxhet dhe faktike (milion lekë)			
	2014	2015	2016
Buxheti	445,731	459,134	436,822
Fakti	426,447	433,790	418,746
Deviacioni (%)	4.3%	5.5 %	4.1%

Të dhënat e përdorura janë parashikime të buxhetit siç janë miratuar nga Kuvendi dhe publikuar nga Ministria e Financave, dhe të dhënat përfundimtare të audituara për vitin 2014 dhe 2015¹¹. Llogaritjet për këtë dimension janë bërë në përputhje me metodikën e siguruar në një tabelë në Excel në faqen në internet të PEFA-s, www.pefa.org, dhe jepen në Shtojcën 5 të raportit të vlerësimit.

Shpenzimet faktike gjithsej kanë qenë mes 95 për qind dhe 105 për qind të buxhetit në vitin 2014 dhe 2016. Ky rezultat ka përmirësim të konsiderueshëm në krahasim me vitet e shkuara dhe vlerësimin e mëparshëm. Në 2015 fakti qe 94,5 për qind i shpenzimeve të parashikuara në buxhet. Ky dimension është llogaritur sipas kontabilitetit me bazë të modifikuar monetare. Shpenzimet përfshijnë transfertat

11. Viti 2016 qe në proces auditimi në kohën e këtij vlerësimi

dhe subvencionet e çdo lloji, përfshirë edhe ato për qeverisjen vendore, dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Janë përfshirë edhe transfertat për njësitë jashtë QQB-së, por që gjithsesi kanë qenë pjesë e buxhetit të miratuar fillimisht.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

TP-2. Përbërja faktike e shpenzimeve

Ky tregues mat shkallën me të cilën rishpërndarjet midis kategorive kryesore të buxhetit gjatë zbatimit të tij kanë kontribuar në ndryshimin e përbërjes së shpenzimeve. Përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën M1 (WL) për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- *Dimensioni 2.1: Përbërja faktike e shpenzimeve sipas funksionit (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015 dhe 2016, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 2.2: Përbërja faktike e shpenzimeve sipas llojit ekonomik (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015 dhe 2016, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 2.3: Shpenzimet nga fondet rezervë (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015 dhe 2016, mbulimi - QQB).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-2. Përbërja faktike e shpenzimeve	D+	Metoda vlerësimit M1 (WL)
2.1 Përbërja faktike e shpenzimeve sipas funksionit	Vlerësimi i dimensionit D	Varianca e përbërjes midis shpenzimeve faktike sipas funksionit dhe shpenzimeve të parashikuara në buxhet është më shumë se 20 për qind në të tre vitet e vlerësimit.
2.2 Përbërja faktike e shpenzimeve sipas llojit ekonomik	Vlerësimi i dimensionit A	Varianca në përbërjen e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik ka qenë më pak se 5% në vitin 2014 dhe 2016. Varianca e përbërjes së shpenzimeve është më shumë se 5% në vitin 2015.
2.3 Shpenzimet nga fondet rezervë	Vlerësimi i dimensionit A	Shpenzimet faktike të bëra nga fondi rezervë qenë mesatarisht sa 0,1% e buxhetit fillestar.

2.1 Përbërja faktike e shpenzimeve sipas funksionit

Ky dimension mat diferencën midis buxhetit të miratuar fillimisht dhe faktit në fund të vitit sa i takon përbërjes së shpenzimeve, sipas klasifikimit funksional, gjatë tre viteve të fundit, pa përfshirë zërat e rezervës dhe interesat mbi borxhin.

Llogaritjet për këtë dimension janë bërë në përputhje me metodikën e siguruar në një tabelë në Excel në faqen në internet të PEFA-s dhe jepen në Shtojcën 5 të raportit të vlerësimit.

Përbërja faktike e shpenzimeve sipas funksionit paraqet një variancë të madhe, midis 26,7 për qind në 2014 dhe 21 për qind në 2015. Një pjesë e kësaj variance të madhe shpjegohet nga procesi i shlyerjes së stokut të detyrimeve të prapambetura në krahun e shpenzimeve. Gjatë viteve 2014 dhe 2015, qeveria shleu detyrimet e prapambetura të qeverisjes qendrore të cilat qenë akumuluar përpara vitit 2013 në shumën gjithsej prej 51.516 milion lekë dhe qenë planifikuar fillimisht me shumën prej 55.000 milion lekë. Një pjesë e detyrimeve të prapambetura janë shlyer me kompensim, duke qenë se institucionet buxhetore kishin detyrime reciproke kundrejt njëra-tjetrës. Pjesa tjetër e stokut historik të detyrimeve të prapambetura u shlye nëpërmjet procesit normal të buxhetit.

Llogaritja e variancës së përbërjes së shpenzimeve kërkonte bërjen e disa korigjimeve (për përshtatje) të shifrave të miratuara dhe faktike të publikuara në buxhet. Problemi në këtë rast që se klasifikimi funksional i përdorur në dokumentet e buxhetit nuk përputhej plotësisht me atë që përdorej në llogaritë e publikuara në pjesën që kishte të bënte me shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Këto shpenzime në të dhënat e realizimit faktik të buxhetit janë raportuar si pjesë e shërbimeve të përgjithshme publike, ndërsa parashikimet e buxhetit qenë paraqitur si pjesë e shpenzimeve të tjera. U bënë rregullime në të dhënat faktike për të qenë në përputhje me klasifikimin e përdorur nga parashikimet buxhetore në fillim të çdo viti.

TABELA 3.2 Matrica e rezultateve - varianca e përbërjes

Viti	Për TP-2.1 Varianca e përbërjes
2014	26.7%
2015	21.0%
2016	22.7%

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D.

2.2 Përbërja faktike e shpenzimeve sipas llojit ekonomik

Ky dimension mat diferencën midis buxhetit të miratuar fillimisht dhe faktit në fund të vitit sa i takon përbërjes së shpenzimeve, sipas klasifikimit ekonomik, gjatë tre viteve të fundit, duke përfshirë interesat mbi borxhin por pa përfshirë zërat e rezervës.

Përbërja e buxhetit sipas klasifikimit ekonomik ka rëndësi për të treguar lëvizjet midis kategorive të ndryshme të faktorëve—për shembull, shpenzimet kapitale dhe ato të përvitshme. Llogaritja për këtë dimension është bërë në përputhje me metodikën e siguruar në një tabelë në Excel në faqen në internet të PEFA-s, www.pefa.org, dhe jepet në Shtojcën 5 të raportit të vlerësimit.

Varianca e llogaritur e përbërjes së shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik ka qenë më pak se 5 për qind në vitin 2014 dhe 2016. Varianca e përbërjes së shpenzimeve është më shumë se 5 për qind në vitin 2015 dhe ka ardhur më së shumti si pasojë e variancës së granteve për njësitë e qeverisjes vendore. Në qershor 2015, Shqipëria mbajti zgjedhjet vendore, gjithë duke vënë në zbatim një reformë territoriale; 61 njësi të qeverisjes vendore zunë vendin e 373 komunave dhe bashkive që kishte më parë. Në vitin 2015 Shqipëria filloi zbatimin e një strategjie ambicioze për decentralizimin fiskal, përfshirë edhe devolgimin e disa funksioneve të caktuara, transferimin e personelit dhe vënien në dispozicion të burimeve të reja të financimit për njësitë e qeverisjes vendore. Pas zgjedhjeve, autoritetet filluan procesin e auditimit të njërive të reja dhe të përgatitjes së vrojtimit vjetor të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes vendore. Këto aktiviteteve e kanë vendosur nën trysni të konsiderueshme realizimin e shpenzimeve publike në nivel vendor.

TABELA 3.3 Varianca e përbërjes së shpenzimeve

Viti	Varianca e përbërjes
2016	4.7%
2015	5.6%
2014	5.0%

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

2.3 Shpenzimet nga fondet rezervë

Ky dimension mat shumën mesatare të shpenzimeve të miratuar me votë nga fondi i rezervave gjatë tre viteve të fundit.

Qeveria ka një fond rezervë dhe një fond të kontigjencës. Shumat e caktuara për këto fonde miratohen si zëra buxheti pa nënzëra të tjerë. Shpenzimet nga këto fonde bëhen në bazë të vendimeve të posaçme të Këshillit të Ministrave, të miratuara gjatë vitit buxhetor përkatës. Për periudhën 2014-2016 shpenzimet nga fondet e rezervës dhe kontigjencës kanë shkuar mesatarisht deri në 0,6 për qind të shpenzimeve gjithsej, siç tregohet në Tabelën 3.4 më poshtë. Është përdorur tabela në Excel që vihet në dispozicion në faqen në internet të PEFA-s për dimensionin 2.1 për të bërë llogaritjet për këtë dimension (shih Shtojcën 5).

TABELA 3.4 Përqindja që zënë shpenzimet nga rezervat në shpenzimet faktike

Viti	Përqindja e rezervave	Përqindja mesatare e rezervave
2014	0.3%	0.6%
2015	0.6%	
2016	0.9%	

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

TP-3. Të ardhurat faktike

*Ky tregues mat ndryshimin e të ardhurave midis buxhetit të miratuar fillimisht dhe faktit në fund të vitit. Përmban dy dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.*

- *Dimensioni 3.1: Të ardhurat faktike agregate (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015 dhe 2016, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 3.2: Përbërja faktike e të ardhurave (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015 dhe 2016, mbulimi - QQB).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-3. Të ardhurat faktike	B+	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
3.1 Të ardhurat faktike agregate	Vlerësimi i dimensionit A	Të ardhurat faktike qenë midis 97% dhe 106% të të ardhurave të parashikuara në buxhet në 2014 dhe 2016.
3.1 Përbërja faktike e të ardhurave	Vlerësimi i dimensionit B	Varianca e përbërjes së të ardhurave ka qenë më pak se 10% në vitin 2014 dhe 2016.

3.1 Të ardhurat faktike agregate

Ky dimension mat shkallën me të cilën të ardhurat faktike kanë shmangie (deviacion) nga buxheti i miratuar fillimisht.

Llogaritjet për këtë dimension janë bërë në përputhje me metodikën e siguar në një tabelë në Excel në faqen në internet të PEFA-s dhe jepen në Shtojcën 5 të raportit të vlerësimit.

Për periudhën që vlerësohet, të ardhurat faktike kanë qenë midis 97 për qind dhe 106 për qind të të ardhurave të parashikuara në buxhet në dy prej të tre viteve, me 97,5 për qind të të ardhurave të parashikuara në buxhet në 2016 dhe 100,1 për qind të të ardhurave të parashikuara në buxhet në 2014.

Mosrealizimi i planit të të ardhurave tatimore në 2015 i preku të gjithë zërat, përfshirë akcizat, TAP dhe taksat e lidhura me naftën. Ky mosrealizim plani tatimor pasqyron disa faktorë, përfshirë problemet në administrimin tatimor dhe bashkërendimin midis institucioneve përgjegjëse. Një rol kanë luajtur edhe problemet me parashikimin në buxhetin e vitit 2015, ku pati një nënvlerësim të stokut të tepërive kreditore në sistem dhe shkallë më të ulëta nga sa pritej në lidhje me rritjen e PBB-së, normat e interesit dhe çmimet e naftës. Me gjasë ky problem mund të jetë përkeqësuar edhe nga reagimi negativ ndaj rritjes së tatimeve që hynë në fuqi në janar 2015, përfshirë kalimin e veprimtarisë tregtare në fund të vitit 2014, si edhe rritjen e evazionit fiskal dhe prodhimit të brendshëm informal.

TABELA 3.5 Të ardhurat faktike gjithsej

Viti	Deviacioni i të ardhurave gjithsej
2016	97.5%
2015	92.2%
2014	100.1%

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

3.2 Përbërja faktike e të ardhurave

Ky dimension mat variancën e përbërjes së të ardhurave gjatë tre viteve të fundit. Ky dimension përpiqet të kapë saktësinë e parashikimeve të strukturës së të ardhurave dhe aftësinë e qeverisë për të mbledhur shumat e planifikuara për secilën kategori të ardhurash.

- Një tabelë për "Treguesit fiskalë" me çmuarje të të ardhurave dhe shpenzimeve, të hartuar nga Ministria e Financave në kuadër të paketës së projektbuxhetit që i paraqitet për miratim Kuvendit;
- Një tabelë e ngjashme me shifrat faktike, të hartuar çdo muaj nga Drejtoria e Thesarit në Ministrinë e Financave, dhe të publikuar në faqen në internet të Ministrisë së Financave. Këto tabela përfshijnë edhe të dhënat më të fundit për buxhetin, pas ndryshime dhe rishpërndarjeve të bëra gjatë vitit.

Për periudhën që vlerësohet, varianca e përbërjes së të ardhurave që më pak se 10 për qind në 2014 dhe 2016, ndërsa në 2015 arkëtimet e TVSH-së që qenë më të ulëta se plani sollën një variancë më të madhe në përbërjen e të ardhurave.

TABELA 3.6 Varianca e përbërjes së të ardhurave

Viti	Varianca e përbërjes
2016	5.8%
2015	10.3%
2014	9.3%

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.



3.2 SHTYLLA II: Transparenca e financave publike

TP-4. Klasifikimi i buxhetit

Ky tregues vlerëson shkallën me të cilën klasifikimi i buxhetit dhe llogarive të qeverisë është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ka një dimension për këtë tregues - Dimensioni 4.1. klasifikimi i buxhetit (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQB).

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-4. Klasifikimi i buxhetit	Vlerësimi i përgjithshëm A	
4.1 Klasifikimi i buxhetit	Vlerësimi i dimensionit A	Klasifikimi i buxhetit dhe plani kontabël bazohen në çdo nivel të klasifikimit ekonomik, administrativ dhe funksional (dhe nënfunksional) duke përdorur standardet GFS/COFOG dhe mund të japin informacione që janë në përputhje me standardet GFS 2011.

4.1 Klasifikimi i buxhetit

Plani kontabël që përdoret për përgatitjen, zbatimin dhe raportimin (përfshirë edhe kontabilitetin) e buxhetit të vitit 2016 nëpërmjet sistemit të Thesarit bazohet në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i cili është në përputhje me GFS 2011 dhe bazohet në klasifikimet e mëposhtme:

- Klasifikimi administrativ, i cili pasqyron njësitë e qeverisjes së përgjithshme sipas llojit (njësi e qeverisjes qendrore, njësi e qeverisjes vendore, fonde jashtëbuxhetore); si edhe nënklasifikime në nivel të njësisocial të shpenzuesve. Dimensionet e ministrive të linjës dhe institucioneve përbëjnë së bashku klasifikimin institucional (administrativ);
- Klasifikimi ekonomik, i cili klasifikon veprimet sipas natyrës ekonomike (përfshirë kodet për shpenzimet korrente, shpenzimet kapitale, si edhe të ardhurat, në nivel 7-shifror);
- Klasifikimi funksional (dhe nënfunksional), i cili pasqyron shpenzimet sipas funksioneve ose objektivave që synon të arrijë. Ky sistem bazohet në 10 funksione kryesore, në përputhje me klasifikimin COFOG;
- Klasifikimi sipas programeve identifikon programet, nënprogramet dhe projektet buxhetore. Klasifikimi funksional është në nivel 5-shifror, ku 2 shifrat e fundit përdoren për të identifikuar programet brenda funksioneve dhe nënfunksioneve. Në fund, dimensionin "Projekt" përdoret për të dhënë informacion kontabël për projektet me afate kohore. Kodet përfshijnë informacion për natyrën e financimit, grant ose kredi, dhe njësinë përgjegjëse.

Dimensionet e mësipërme zbatohen në sistemin informatik të thesarit (SIQF) që bazohet në Oracle Financials. Plani kontabël i miratuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001, që përdoret për klasifikimin, mund të transferohet përmes një table në klasifikimin GFS dhe përdoret në mënyrë të njëtrajtshme në hartimin, menaxhimin dhe raportimin e buxhetit. Shqipëria i raporton FMN-së të dhëna duke përdorur GFS2014 dhe po planifikon të kalojë plotësisht në GFS 2014.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

TP-5. Dokumentimi i buxhetit

Ky tregues vlerëson plotësinë e informacioneve që jepen në dokumentacionin e buxhetit vjetor, të matur kundrejt një liste të përcaktuar të elementeve bazë dhe elementeve shtesë. Ka vetëm një dimension për këtë tregues. Vlerësimi i performancës së këtij treguesi mbështetet në përmbajtjen e buxhetit të qeverisjes qendrore buxhetore (QQB) që i është paraqitur Kuvendit për vitin 2017.

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensio	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-5. Dokumentimi i buxhetit	Vlerësimi i përgjithshëm A	
5.1 Dokumentimi i buxhetit	Vlerësimi i dimensionit A	Për QQB-në, Shqipëria përmbush 10 elemente, përfshirë çdo element bazë (1-4) të dokumentacionit të buxhetit.

5.1 Dokumentimi i buxhetit

Në Shqipëri, qeveria harton dhe miraton buxhetin e saj dhe monitoron kuadrin fiskal nëpërmjet buxhetit të përgjithshëm në të cilin përfshihen qeverisja e përgjithshme (ministritë e linjës dhe institucionet e qeverisjes qendrore), fondet e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor dhe njësitë e qeverisjes vendore. Planet e hollësishme të cilat jepen sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik në tabelat e buxhetit i dërgohen fillimisht legjislativit në nivel të qeverisjes së përgjithshme në fund të çdo viti (për vitin e ardhshëm dhe 2 vite më pas), i njëjti klasifikim përdoret për zbatimin e buxhetit mujor; buxheti rezultues lidhet me rregullën e përgjithshme fiskale të miratuar në Ligjin Organik të Buxhetit. Në tabelat e mësipërme të ardhurat nga qeverisja vendore dhe fondet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe shpenzimet e lidhura me qeverisjen vendore dhe fondet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë të identifikueshme sepse klasifikohen në kategori më vete. Për shpenzimet, të gjitha grantet e qeverisjes qendrore dhe shpenzimet që qeverisja vendore i bën me fondet e veta klasifikohen së bashku të shpenzimet korrente, pavarësisht nëse kanë ose jo lidhje me projekte kapitale. Pra, llogaritë e QQB-së mund të identifikohen me lehtësi nga këto tabela.

Krahas kësaj, legjislativi merr informacion për të mëposhtmet:

- Financimi i deficitit, me përshkrim të përbërjes së parashikuar të tij;
- Supozimet makroekonomike, përfshirë çmuarjet për rritjen e PBB-së, inflacionin, normat e interesit dhe kursin e këmbimit valutor;
- Stoku i borxhit publik dhe i borxhit me dorëzani publike;
- Informacion përmbledhës për risqet fiskale, përfshirë pasivet e kushtëzuara, siç janë dorëzanitë;
- Një shpjegim i rrjedhëve që kanë për buxhetin nismat e reja për politikën dhe investimet e reja madhore publike, me çmuarje të efektit buxhetor të çdo ndryshimi madhor të politikave dhe/ose ndryshimi madhor të programeve të shpenzimeve.

Në paketën e buxhetit vjetor që i paraqitet legjislativit, informacioni për qeverisjen qendrore buxhetore përfshin i. Informacion agregat për shpenzimet, të ardhurat për vitin e propozuar, ii. parashikim të deficitit ose suficitit fiskal për vitin e propozuar dhe dy vitet e ardhshme, iii. çmuarjen për kategoritë kryesore të shpenzimeve, të ardhurave dhe tepricën e përgjithshme për vitin ushtrimor dhe iv. kategoritë kryesore të shpenzimeve, të ardhurave dhe tepricën kryesore për dy vitet e fundit

përpara vitit ushtrimor. Prezantohen edhe të dhëna agregate për buxhetin për të ardhurat dhe për shpenzimet sipas titujve kryesorë të klasifikimeve të përdorura, me të dhëna për vitin e fundit me zberthim të çmuarjeve për të ardhurat dhe shpenzimet, në tabela në përputhje me GFS 2014, të cilat publikohen në faqen në internet të Ministrisë së Financave dhe i raportohen FMN-së. Së bashku me paketën e buxhetit vjetor, legjislativit i paraqitet edhe buxheti i vitit fiskal ushtrimor me të njëjtin format me projektbuxhetin.

Tabela përmbledhëse në vijim jep informacionet e përdorura dhe rezultatet e vlerësimit për TP-5.

TABELA 3.7 Përmbledhje e dëshmive dhe rezultateve të vlerësimit për TP-5

Elementi / Kërkesat	Përmbushur (Po/Jo)	Dëshmitë e përdorura / Komente
Parashikim i deficitit ose suficitit fiskal ose rezultati ushtrimor me të drejta dhe detyrime të konstatuara	Po	Parashikimi i deficitit ose suficitit fiskal për QQB-në jepet në ligjin e buxhetit vjetor për vitin 2017.
Vlerat faktike të buxhetit të vitit të fundit, të paraqitura me të njëjtin format me projektbuxhetin.	Po	Buxheti faktik i QQB-së për vitin 2015 qe pjesë e paketës së buxhetit vjetor dhe iu paraqit legjislativit me të njëjtin format me projektbuxhetin.
Buxheti i vitit fiskal ushtrimor paraqitet me të njëjtin format me projektbuxhetin.	Po	Vlerësimet e vlerave faktike për vitin fiskal ushtrimor për QQB-në paraqiten me të njëjtin format me projektbuxhetin.
Të dhëna agregate për buxhetin për të ardhurat dhe për shpenzimet sipas titujve kryesorë të klasifikimeve të përdorura, përfshirë të dhëna për vitin ushtrimor dhe vitin e fundit me zberthim të çmuarjeve për të ardhurat dhe shpenzimet. (Klasifikimi i buxhetit mbulohet në TP-4).	Po	Lidhjet e Ligjit të Buxhetit përfshijnë informacion për vitin 2015 dhe 2016 për qeverisjen e konsoliduar ku identifikohen më vete shpenzimet dhe të ardhurat e QQB-së. Relacioni shoqëruar i projektbuxhetit përmban informacion dhe shpjegim për titujt kryesorë të klasifikimit për të ardhurat dhe shpenzimet e vlerësuar të QQB-së.
Financimi i deficitit, me përshkrim të përbërjes së parashikuar të tij.	Po	Financimi i deficitit dhe përbërja e parashikuar sipas Strategjisë Afatmesme për Borxhin jepet si lidhje e Ligjit të Buxhetit.
Supozimet makroekonomike, përfshirë të paktën çmuarjet për rritjen e PBB-së, inflacionin, normat e interesit dhe kursin e këmbimit valutor	Po	Supozimet makroekonomike që mbulojnë një periudhë trevjeçare jepen si lidhje e Ligjit të Buxhetit dhe diskutohen në relacionin e projektbuxhetit që i paraqitet legjislativit.
Stoku i borxhit, përfshirë të dhëna për të paktën çeljen e vitit fiskal ushtrimor të paraqitura në përputhje me GFS-në ose me një standard tjetër të krahasueshëm.	Po	Stoku i borxhit i krahasueshëm me GFS-në, përfshirë të dhëna për çeljen e vitit fiskal ushtrimor jepet në relacionin e projektbuxhetit që i paraqitet legjislativit.
Aktivet financiare, përfshirë të dhëna për të paktën çeljen e vitit fiskal ushtrimor të paraqitura në përputhje me GFS-në ose me një standard tjetër të krahasueshëm.	Jo	Ky informacion nuk paraqitet apo publikohet përpara paraqitjes së projektbuxhetit në legjislativ.
Informacion përmbledhës për risqet fiskale, përfshirë pasivet e kushtëzuara siç janë dorëzanitë dhe detyrimet e kushtëzuara të integruara në instrumentet e financimit siç janë kontratat e partneritetit publik privat (PPP), e të tjera si këto.	Jo	Informacionet përmbledhëse për risqet fiskale (përfshirë pasivet e kushtëzuara siç janë dorëzanitë dhe detyrimet e kushtëzuara të integruara në instrumentet e financimit siç janë kontratat e partneritetit publik privat (PPP)) me rrjedhoja të drejtpërdrejta për buxhetin paraqiten në relacionin e projektbuxhetit që i paraqitet legjislativit për çdo sektor. Risqet fiskale për PPP-të pa rrjedhje eksplicite të drejtpërdrejta për buxhetin nuk i paraqiten legjislativit.
Një shpjegim i rrjedhojave që kanë për buxhetin nismat e reja për politikën dhe investimet e reja madhore publike, me çmuarje të efektit buxhetor të çdo ndryshimi madhor të politikave dhe/ose ndryshimi madhor të programeve të shpenzimeve.	Po	Shpjegimi për rrjedhojat që kanë për buxhetin nismat e reja për politikën jepet në relacionin e projektbuxhetit që i paraqitet legjislativit për çdo politikë madhore mbi të ardhurat dhe shpenzimet veçmas.
Dokumentacioni për parashikimet fiskale afatmesme.	Po	Dokumentacioni për parashikimet fiskale afatmesme me klasifikime të hollësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve paraqitet për çdo nivel të qeverisjes.
Vlerësimi sasior i lehtësive tatimore.	Po	Vlerësimi sasior i lehtësirave fiskale jepet në relacionin e projektbuxhetit që i paraqitet legjislativit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

TP-6. Operacionet e qeverisjes qendrore jashtë raporteve financiare

Ky tregues mat shkallën me të cilën të ardhurat dhe shpenzimeve e qeverisë raportohen jashtë raporteve financiare të qeverisjes qendrore. Përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve:

- *Dimensioni 6.1: Shpenzimet jashtë raporteve financiare (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 6.2: Të ardhurat jashtë raporteve financiare (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 6.3: Raportet financiare të njërive jashtëbuxhetore (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-6. Operacionet e qeverisjes qendrore jashtë raporteve financiare	D	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
6.1 Shpenzimet jashtë raporteve financiare	Vlerësimi i dimensionit D*	Informacioni për shpenzimet jashtë raporteve financiare është i paplotë sepse mbulon vetëm 17 nga 63 njësitë jashtëbuxhetore sipas listës së INSTAT-it; megjithëse dëshmitë në dispozicion sugjerojnë se shumica gjithsej jo e raportuar është më pak se 5% e shpenzimeve të QQB-së, kjo nuk mund të konfirmohet.
6.2 Të ardhurat jashtë raporteve financiare	Vlerësimi i dimensionit D*	Të ardhurat e njërive jashtëbuxhetore aktive jo të raportuara nuk mund të konfirmohen.
6.3 Raportet financiare të njërive jashtë buxhetore	Vlerësimi i dimensionit D	Njësitë jashtëbuxhetore aktive nuk i japin Qeverisë së Shqipërisë raporte të rregullta financiare.

Parimisht, të gjitha operacionet që përdorin të ardhura të qeverisë (në dallim nga të ardhurat nga shfrytëzimi që fitojnë ndërmarrjet shtetërore) do të duhej të përfshiheshin në raportet e buxhetit për të siguruar transparencë, dhënie të informacioneve shpjeguese publikut, shpërndarje dhe përdorim më efikas të burimeve dhe qëndrueshmëri në kohë të buxhetit. Një pamje e plotë e të ardhurave dhe shpenzimeve të qeverisë kërkon që edhe njësitë jashtëbuxhetore dhe shpenzimet dhe të ardhurat e lidhura me aktivitetet jashtëbuxhetore të njërive buxhetore të përfshihen në raportet financiare *ex post* të qeverisjes qendrore (nëse nuk janë të papërfillshme): kjo është thelbësore për disiplinën fiskale agregate.

Ky tregues përdor tri dimensionet për të matur shkallën me të cilën të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë raportohen jashtë raporteve financiare të qeverisjes qendrore.

6.1 Shpenzimet jashtë raporteve financiare

Ky dimension vlerëson shpenzimet e bëra nga njësitë buxhetore dhe jashtëbuxhetore por që nuk janë përfshirë në raportet financiare të qeverisjes qendrore; për shembull, shpenzimet e përballuara nga tarifat dhe pagesat e arkëtuara dhe mbajtura nga njësitë buxhetore dhe jashtëbuxhetore jashtë buxhetit të miratuar.

Ligji organik i buxhetit kërkon që të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e qeverisjes qendrore dhe asaj vendore të përfshihen në Buxhetin e Shtetit që i paraqitet Kuvendit. Ligji lejon pasjen e një fondi rezervë (që nuk mund të jetë më shumë se 3 për qind i fondeve të miratuara gjithsej) dhe "Fonde të posaçme" të propozuara nga Ministri i Financave: të gjitha përfshihen në buxhetin e shtetit dhe raportohen.

Krahas kësaj, buxhetet e njësive të qeverisjes vendore duhet të jenë të rakorduar, me përjashtim të rasteve kur miratohet huamarrje për projekte investimesh. Çdo "fond i posaçëm" i njësive të qeverisjes vendore i paraqitet këshillit vendor në kuadër të buxhetit vendor.

Një shqyrtim i kryer nga FMN¹² në vitin 2016 identifikonte 64 njësi jashtëbuxhetore të qeverisjes qendrore, një numër i konsiderueshëm i të cilave nuk kanë aktivitet dhe janë në proces likuidimi. Në momentin e këtij vlerësimi, INSTAT raportonte 63 njësi jashtëbuxhetore. Qeveria e Shqipërisë ushtron një shkallë të konsiderueshme kontrolli mbi ato njësi të cilat vijojnë të jenë aktive, për shembull përmes emërimit të këshillit të administrimit (shpesh i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit); përmes vendosjes së shkallës së pagave të punonjësve etj.; ose përmes dhënies së granteve për të financuar operacionet.

Nga të 64 njësitë:

- 8 janë universitete;
- 7 janë "ndërmarrje studentore" të lidhura me universitetet;
- Disa janë jo pjesëmarrës të tregut, të cilat kryejnë funksione rregullatore dhe financohen me tarifa dhe gjoha të përcaktuara;
- Të tjera ngjajnë me shoqëri tregtare tipike, siç është Ndërmarrja Industriale Nr. 1, por të ardhurat u vijnë kryesisht nga grante shtetërore;
- 33 njësi janë aktive, megjithëse jo të gjitha i japin të dhëna INSTAT-it dhe/ose Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Me kërkesë të misionit të PEFA-s, INSTAT shqyrtoi informacionin e dhënë në raportin e FMN-së dhe identifikoi 17 njësi që janë aktive dhe janë pjesë e raportimit në SIQF, megjithëse kanë njëfarë shkalle pavarësie dhe janë të klasifikuara si njësi jashtëbuxhetore.

Duke qenë se nuk mund të konstatohet shkalla e shpenzimeve të njësive aktive - megjithëse jo të gjitha këto shpenzime mbahen jashtë raporteve financiare shtetërore - ky dimension merr vlerësimin D*.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D*.

12. Raporti i Misionit të GFS-së, qershor 2016

6.2 Të ardhurat jashtë raporteve financiare

Ky dimension vlerëson shkallën e të ardhurave që marrin njësitë buxhetore dhe jashtëbuxhetore (përfshirë edhe fondet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) të cilat nuk raportohen në raportet financiare të qeverisë (p.sh., të ardhurat që merren nga projektet me fonde të donatorëve; tarifatat dhe pagesat e marra jashtë llojeve ose vlerave të buxhetit).

Neni 8 i Ligjit Organik të Buxhetit kërkon që të gjitha arkëtimet nga tatimet dhe burimet e tjera të qeverisjes së përgjithshme të kalojnë në llogarinë e unifikuar të thesarit. Ky ligj duket se zbatohet, duke qenë se nuk përmenden përjashtime në raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Por, për arsyet e parashtruara në pikën 6.1 më lart, shkalla e e të ardhurave jo të raportuara nuk mund të konstatohet dhe prandaj ky dimension ka marrë vlerësimin D*.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D*.

6.3 Raportet financiare të njësive jashtëbuxhetore

Ky dimension vlerëson shkallën me të cilën raportet financiare ex post të njësive jashtëbuxhetore i vihen në dispozicion qeverisjes qendrore dhe nëse janë të hollësishme dhe në afat mjaftueshëm për të dhënë një pamje të plotë të operacioneve financiare të qeverisë pasi të bashkohen me raportet financiare të qeverisjes qendrore buxhetore.

Për të pasur një pamje të plotë të operacioneve të qeverisjes qendrore, pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara do të duhej të përfshinin të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet, si të njësive buxhetore, ashtu edhe të njësive jashtëbuxhetore, siç përkufizohen në GFS 2014.

Nga të 33 njësive jashtëbuxhetore që janë konstatuar si "aktive" nga të dhënat e INSTAT-it, nuk ka dëshmi që të tregojnë se i dorëzojnë rregullisht raporte financiare qeverisë brenda 9 muajve pas përfundimit të vitit fiskal.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D.

TP-7. Transfertat drejt qeverisjes vendore

Ky tregues vlerëson transparencën dhe kryerjen brenda afateve të transfertave nga qeverisja qendrore drejt njësisive të qeverisjes vendore me të cilat ka marrëdhënie financiare të drejtpërdrejta. Treguesi shikon bazën e transfertave nga qeverisja qendrore dhe nëse njësitë e qeverisjes vendore marrin ose jo informacion për fondet që u janë caktuar brenda afateve për të ndihmuar në planifikimin e buxhetit. Përmban dy dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve:

- *Dimensioni 7.1: Sistemi që përdoret për caktimin e transfertave (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - qeverisja qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore me marrëdhënie të drejtpërdrejta me qeverisjes qendrore);*
- *Dimensioni 7.2: Dhënia në kohë e informacioneve për transfertat (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - qeverisja qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore me marrëdhënie të drejtpërdrejta me qeverisjes qendrore).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-7. Transfertat drejt qeverisjes vendore	C+	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
7.1 Sistemi që përdoret për caktimin e transfertave	Vlerësimi i dimensionit C	Shpërndarja horizontale e granteve të pakushtëzuara dhe specifike për njësitë e qeverisjes vendore nga qeverisja qendrore bëhet me sisteme transparente të mbështetura në rregulla. Këto përbëjnë 60,8 për qind të transfertave gjithsej për NJQV-të. Ka kritere për shpërndarjen e transfertave të kushtëzuara, por nuk janë transparente dhe të verifikueshme.
7.2 Dhënia në kohë e informacioneve për transfertat	Vlerësimi i dimensionit B	Deri në fillim të muajit dhjetor çdo vit, NJQV-të i dinë shumat e transfertave të pakushtëzuara dhe specifike që do të marrin.

Shqipëria është e ndarë në 12 qarqe. Prej vitit 2015, këto qarqe kanë 61 bashki. Shqipëria ka kaluar nëpër një reformë territoriale dhe administrative në kuadër të së cilës 373 bashki dhe komuna u përqendruan në 61 bashki më të mëdha, të cilat funksionojnë sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligjit nr.68, datë 21.05.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Viti i parë kur është zbatuar reforma me organizimin e ri strukturor që viti 2016.

Bashkitë janë niveli i parë qeverisjes vendore, përgjegjëse për shërbimet dhe policinë vendore. Çdo qark ka një këshill të përbërë nga përfaqësues të bashkive përbërëse. Prefektët emërohen nga qeverisja qendrore për të mbikëqyrur ligjshmërinë, efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve të qarqeve, por nuk luajnë asnjë rol në realizimin e shërbimeve. Njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) kryejnë a. funksione ekskluzive ("të veta"), si furnizimi me ujë, transporti publik, ndriçimi publik dhe mbledhja e mbetjes; b. funksione të përbashkëta, si arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kujdesi shëndetësor, rendi publik dhe mbrojtja civile; dhe c. funksione të deleguara. Këto të fundit zbërthehen në funksione të detyrueshme dhe jo të detyrueshme, si administrimi i tokës dhe kryerja e regjistrimit të popullsisë.

7.1 Sistemi që përdoret për caktimin e transfertave

Ky sistem vlerëson shkallën me të cilën përdoren sisteme transparente të mbështetura në rregulla për përgatitjen e buxhetit dhe shpërndarjen faktike të transfertave të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara.

Transferimi i fondeve të njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) bëhet nëpërmjet një sërë mekanizmesh që kanë ndryshuar me kalimin e viteve. Disa prej këtyre mekanizmave kanë të bëjnë me transfertat për bashkitë, të tjerat me transfertat për qarqet.

Vëllimi dhe rëndësia relative e transfertave nga qeverisja qendrore të NJQV-të tregohet në tabelën në vijim.

TABELA 3.8 Transfertat nga qeverisja qendrore të NJQV-të

Transfertat për njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2016 (në përqindje të transfertave gjithsej)	Transfertat e parashikuara në buxhet kur buxheti i paraqitet Kuvendit	Fakti
Transfertat e pakushtëzuara	43,5	41,8
Transfertat specifike	26,4	19,0
Transfertat e kushtëzuara	30	39,2

Burimi: Ministria e Financave.

Qeverisja qendrore u jep burime financiare bashkive nëpërmjet dy llojesh transfertash: grante të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara. Grantet e kushtëzuara janë, ose grante konkurruese, ose lidhen me burime financiare të paracaktuara që mund të përdoren vetëm për një qëllim specifik. Gjatë përgatitjes së buxhetit për vitin 2016, fondet gjithsej për t'iu shpërndarë njësitë të qeverisjes vendore qenë përcaktuar për secilën kategori. Shpërndarja për secilën njësi të qeverisjes vendore është bërë përmes një formule për grantin e pakushtëzuar (shih më poshtë), përmes specifikimit transparent në dokumentet e buxhetit për transfertat specifike dhe përmes një procesi konkurrues për grantet konkurruese. Kriteret për përzgjedhjen e fituesve të granteve konkurruese nuk qenë transparente ngaqë nuk qenë të publikuara apo nuk dihehin paraprakisht nga pjesëmarrësit në konkurrim. Për këtë arsye, në llogaritjen e përqindjes së granteve të marra me kritere transparente janë përfshirë transfertat e pakushtëzuara dhe transfertat specifike.

Transfertat e pakushtëzuara

The unconditional grants are allocated as per the new formula that was applied for the first time in 2016. This formula is based on relative population, population density for every LG unit and number of pupils in elementary and secondary education in each LGU. Besides the equalization of costs which is done through the density component, the new formula of allocation of unconditional transfer also introduces fiscal capacity equalization which is captured by shared taxes between central government and local government including factual revenues from the small business tax, annual tax on used cars and juridical persons' property transfer tax.

The allocation of these funds to the municipalities and districts is determined in three steps. Firstly, the total fund of unconditional grants to be transferred to the districts is determined. In 2016 the amount of unconditional transfer was set at 4.67 percent of the tax and customs revenue in 2014. Through the second step the shares of unconditional grants to be allocated to municipalities and the districts are determined. In 2016, these shares were 96.3 percent and 3.7 percent respectively.

Në hapin e tretë, përcaktohet shpërndarja për secilën bashki. 80 për qind e transfertës për bashkitë shpërndahet mbi bazën e popullsisë relative. Meqë Censusi Kombëtar Shqiptar i vitit 2011 konstatoi mospërputhje të mëdha të numrit të popullsisë kundrejt të dhënave të Gjendjes Civile, të dhënat e numrit të popullsisë janë ato të Censurit duke i shtuar atij edhe 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe të dhënave të Censurit për çdo bashki. Pas kësaj, 15 për qind e transfertës gjithsej u shpërndahet bashkive mbi bazën e densitetit të popullsisë; bashkitë që mund të përfitojnë janë ato që kanë densitet popullsie nën 110 për qind të mesatares kombëtare, prej 118 banorë për km². Kriteri i tretë që përdoret për caktimin e transfertës së pakushtëzuar midis bashkive është numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm publik.

Përmes një mekanizmi relativisht kompleks, fondet rishpërndahen nga bashki më të pasura në bashki më të varfra. Kjo rishpërndarje mbështetet në të dhënat për arkëtimin e dy llojeve të taksave vendore nga bashkitë: tatimi mbi biznesin e vogël dhe taksë e regjistrimit të automjeteve. Bashkitë me arkëtime më të larta se mesatarja për frymë të këtyre dy taksave kontribuojnë 35 për qind të diferencës për ato bashki që kanë arkëtime më të ulëta se mesatarja.

Bashkive përfituese u garantohej një transfertë minimale. Pjesa tjetër e fondeve të rishpërndara caktohet në atë mënyrë që bashkitë përfituese të marrin 35 për qind të diferencës midis arkëtimeve të tyre dhe arkëtimin mesatar për frymë të këtyre dy taksave.

NJQV-të e dinë që në dhjetor se sa do të marrin si grante të pakushtëzuara vitin e ardhshëm.

Transfertat specifike

Këto transferta u caktohen njësisë të qeverisjes vendore për të mbuluar funksione të reja specifike të caktuara me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë", përfshirë:

- Konviktet e arsimit parauniversitar (fondet që mbulojnë pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime);
- Qendrat e shërbimeve sociale për 5 bashki në të cilat ndodhen këto qendra (fondet që mbulojnë pagat e personelit dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shpenzimet operative);
- Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri (fondet që mbulojnë pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes);

- Pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për personelin mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personelin jomësimor në arsimin parauniversitar;
- Rugët rurale (fondet që mbulojnë pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime);
- Administrimi i pyjeve (fondet që mbulojnë pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të punonjësve dhe shpenzimet operative);
- Ujitja dhe kullimi (fondet që mbulojnë pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shpenzimet operative).

Duke qenë se këto funksione janë kryer fillimisht nga qeverisja qendrore (ministritë e linjës), parashikimet e këtyre shpenzimeve në buxhet është përdorur kuadri ekzistues ligjor dhe rregullator i përdorur nga ministritë përkatëse për të përcaktuar pagat dhe shpenzimet e tjera.

Grantet konkurruese

Granti konkurrues mund të financojë projekte mbi baza konkurruese në tri shtylla kryesore: Infrastruktura vendore, zhvillimi ekonomik dhe "Shqipëria dixhitale". Shtylla i konsiston në zhvillimin e infrastrukturës vendore, arsimin fillor, arsimin e mesëm dhe arsimin universitar, shëndetësinë, objektet kulturore dhe trashëgiminë kulturore, objektet e ujësjellës-kanalizimeve, tregjet e produkteve bujqësore dhe thertoret, ujitjen dhe kullimin dhe pyllëzimin. Shtylla e dytë konsiston në financim për zhvillimin ekonomik vendor përmes ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Objektivat që përpiqet të arrijë ky fond janë objektiva të qeverisjes qendrore. Pavarësisht nga përmendja shprehimisht e sektorëve, ideja e këtij granti është që përzgjedhja e projekteve për t'u financuar të orientohet nga një perspektivë e bashkërenduar territoriale.

Qarqet u paraqesin kërkesë për fonde ministrive të ndryshme të linjës në varësi të natyrës sektoriale të propozimit. Këto kërkesa vlerësohen nga ministria përkatëse e linjës dhe pastaj i përcillen sekretariatit teknik pranë Kryeministrit, i cili pastaj përgatit dosjen për t'u shqyrtuar nga Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Krahas miratimit ose refuzimit të kërkesave të veçanta, ky Komitet vendos edhe për kriteret për shpërndarjen e fondeve mes rajoneve dhe shpërndarjen faktike të fondeve mes rajoneve të ndryshme. Pra ka një paketë kriteresh për shpërndarjen e fondeve, por këto mbështeten më pak në rregulla në krahasim me grante e pakushtëzuara.

Për ta përmbledhur, shpërndarja horizontale e granteve të pakushtëzuara dhe specifike për njësitë e qeverisjes vendore nga qeverisja qendrore bëhet me sisteme transparente të mbështetura në rregulla. Këto përbëjnë 60,8 për qind të transfertave gjithsej për NJQV-të..

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

7.2 Dhënia në kohë e informacioneve për transfertat

Ky dimension vlerëson kohën se kur u jepet informacion i besueshëm njësisive të qeverisjes vendore lidhur me fondet që u ka miratuar qeverisja qendrore për vitin e ardhshëm.

Në kuadër të procesit të rregullt të buxhetit, NJQV-të marrin informacion të qartë dhe mjaftueshëm të hollësishëm në fillim të muajit dhjetor të çdo viti (4 javë përpara fillimit të vitit) se sa fonde do të marrin si grante të pakushtëzuara vitin e ardhshëm. Gjithashtu, duke qenë se këto grante që i jepen pushtetit vendor janë pjesë e procesit të PBA-së trevjeçare dhe duke pasur parasysh faktin se kriteret e shpërndarjes nuk para ndryshohen, NJQV-të kanë një ide që në fillim të procesit të përgatitjes së buxhetit vjetor se sa fonde mund të marrin vitin e ardhshëm.

NJQV-të dinë që katër javë përpara edhe se sa fonde do të marrin si transfertat specifike, duke qenë se këto janë pjesë e paketës së buxhetit vjetor që miratohet në Kuvend. Në rastin e granteve konkurruese NJQV-të dinë me siguri vetëm atë pjesë të grantit konkurrues që ka qenë pjesë e një projekti të miratuar më parë (pra projektet e vjetra, meqë këto projekte mund të zgjasin dy vjet).

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

TP-8. Informacioni për performancën lidhur me realizimin e shërbimeve

*Praktika e mirë na tregon se treguesit e performancës për produktet dhe rezultatet e planifikuara të programeve dhe shërbimeve të financuara nëpërmjet buxhetit është mirë të përfshihen në projektbuxhetin e propozuar nga ekzekutivi, si edhe në raportin e përfundimit të vitit, raportet e auditimit dhe raportet e vlerësimit të ecurisë, për të nxitur një efikasitet më të lartë operativ në realizimin e shërbimeve. Njësitë që realizojnë shërbime gjithashtu do të duhej të dinin se sa burime mund të presin, për të pasur mundësi t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre dhe të arrijnë planin vjetor dhe afatmesëm të punës, si edhe objektivat strategjike sektoriale. Prandaj ky tregues përmban katër dimensione për të këqyru informacionet mbi realizimin e shërbimeve në projektbuxhetin e ekzekutivit ose në dokumentacionet mbështetëse dhe në raportet e përfundimit të vitit apo auditimet apo vlerësimet e ecurisë, si edhe se deri ku mblidhen dhe evidentohen informacione për burimet e marra nga njësitë që realizojnë shërbime. Përmban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve:*

- *Dimensioni 8.1: Planet e performancës për realizimin e shërbimeve (Periudha kohore: treguesit e performancës dhe produktet dhe rezultatet e planifikuara për vitin e ardhshëm fiskal; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 8.2: Performanca e arritur për realizimin e shërbimeve (Periudha kohore: produktet dhe rezultatet e vitit të fundit fiskal të përfunduar; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 8.3: Burimet që marrin njësitë e realizimit të shërbimeve (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 8.4: Vlerësimi i performancës për realizimin e shërbimeve (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensionimi	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-8. Informacioni për performancën lidhur me realizimin e shërbimeve	C+	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
8.1 Planet e performancës për realizimin e shërbimeve	Vlerësimi i dimensionit B	Çdo program i Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Shëndetësisë ka të përcaktuar objektivat, produktet e synuara dhe fondet e miratuara për shpenzimet për periudhën afatmesme dhe këto raportohen në mënyrë tremujore dhe vjetore.
8.2 Performanca e arritur për realizimin e shërbimeve	Vlerësimi i dimensionit B	Informacionet për produktet e realizuara publikohen çdo vit për shumicën e ministrive.
8.3 Burimet që marrin njësitë e realizimit të shërbimeve	Vlerësimi i dimensionit D	Një ministri e madhe (Arsimi) ka informacione për burimet e qeverisjes qendrore që marrin njësitë e realizimit të shërbimeve në bazë (shkollat), për pagat dhe shpenzimet e tjera të investimeve: por, shpenzimet e tjera të shkollave mbulojnë nga njësitë e qeverisjes vendore, pra nuk ka një raport të plotë.
8.4 Vlerësimi i performancës për realizimin e shërbimeve	Vlerësimi i dimensionit B	KLSH ka kryer "auditime të performancës" si vijon: VF 2014-7; VF 2015-11; VF 2016-13, dhe raportet gjenden në faqen në internet të KLSH-së.

Për vlerësimin e këtij treguesi janë përdorur Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë, meqë shërbimet që realizojnë këto ministri lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës së popullsisë dhe zënë një përqindje të konsiderueshme të buxhetit vjetor. Në çdo rast, ka një numër shumë të madh objektivash të performancës; për rezultatet dhe produktet që duhen arritur, ndërsa ecuria monitorohet çdo 3-mujor.

8.1 Planet e performancës për realizimin e shërbimeve

Ky dimension vlerëson se deri ku treguesit kyç të performancës për produktet dhe rezultatet e planifikuara të programeve ose shërbimeve që financohen nëpërmjet buxhetit janë të përfshira në projektbuxhetin e ekzekutivit ose dokumentacionin e lidhur me të, në nivel funksioni, programi ose njësie.

Sikurse thuhet në "Vlerësimin e transparencës fiskale" të kryer nga FMN-ja, objektivat e hollësishëm për rezultatet dhe produktet e planifikuara në thuajse të gjitha programet e politikave përgatiten në nivel ministrie, programi dhe produkti.

Ekipi i vlerësimit ndërmori një analizë të hollësishme të të dhënave që ka Ministria e Arsimit, nga e cila doli se për secilin prej të gjashtë programeve, ka një sërë objektivash vjetorë, të cilët zërthehen më pas në disa produkte: çdo produkt ka të përcaktuar objektivat, produktet e synuara dhe fondet e miratuara për shpenzimet për periudhën afatmesme. Diskutimet në nivele të ndryshme në Ministrinë e Shëndetësisë (në ministri, në një drejtori rrethi dhe në Spitalin Universitar të Tiranës) nxorën në pah një nivel të ngjashëm planifikimi të hollësishëm dhe të gjitha të dhënat publikohen në faqen në internet të Qeverisë së Shqipërisë. Në të dyja këto raste - si edhe për ministrinë e tjera - zbatimi i shpenzimeve të parashikuara në buxhet dhe diskutimi i performancës kundrejt këtyre objektivave raportohet në raportet tremujore të monitorimit të publikuara në faqen në internet të Ministrisë së Financave dhe pastaj në Raportin e Zbatimit të Buxhetit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

8.2 Performanca e arritur për realizimin e shërbimeve

Ky dimension shikon se deri ku prezantohen rezultatet e performancës për produktet dhe rezultatet në projektbuxhetin e ekzekutivit apo në një raport vjetor apo dokument tjetër publik, në një format dhe nivel që lejon krahasimin me planet e miratuara më parë në buxhetin vjetor ose buxhetin afatmesëm më vete nga çdo ministri.

Secila ministri ka një drejtori monitorim-vlerësimi që mbledh dhe analizon të dhëna statistikore, në bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Statistikave (INSTAT). INSTAT-i u dërgon ministrive të linjës modelet tip të raportimit për mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe, pas plotësimit, të dhënat publikohen vazhdimisht në faqen në internet të INSTAT-it; të dhënat mundësojnë krahasimin me planet e hollësishme të përmendura në pikën 8.1 më lart. Gjithashtu, raporti i buxhetit vjetor në përfundim të vitit përfshin informacione për rezultatet e performancës të arritura nga ministrinë; ka disa vjet që praktika është kjo. Sasia e informacioneve shpjeguese është e mjaftueshme për të kuptuar se çfarë është realizuar.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

8.3 Burimet që marrin njësitë e realizimit të shërbimeve

Ky dimension mat se sa ka një sistem të ngritur për të monitoruar nëse njësitë e realizimit të shërbimeve i marrin apo jo fondet e miratuara për sektorin/shërbimet sipas planit dhe mbulon tre vitet e fundit fiskale.

Ministria e Financave vendos buxhetin e investimeve, në bazë të vendimeve të Komitetit të Fondit Rajonal. Për shpenzimet e përvitshme, pagat e të gjithë personelit shëndetësor dhe arsimor në bazë janë në dorë të ministrisë përgjegjëse, për shembull Ministria e Arsimit menaxhon fondin e pagave për arsimtarët. Në shëndetësi, fondi i pagave për mjekët dhe infermierët administrohet nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, megjithëse pagat e personelit tjetër administrohen nga drejtoritë shëndetësore rajonale, dhe këto drejtori rajonale administrojnë edhe raportet mbi konsumin e të mirave jo financiare (siç janë materialet mjekësore).

Bashkitë parashikojnë në buxhetin e tyre shpenzime të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të objekteve në territorin e tyre, nëpërmjet proceseve të tyre vjetore.

Ndërkohë që Ministria e Arsimit ka të dhëna për shpenzimet e qeverisjes qendrore në nivel të tre mijë e ca shkollave publike, Ministria e Shëndetësisë nuk ka të dhëna të tilla në këtë nivel zberthimi. Në përgjithësi, nuk ka prurje të njëtrajtshme dhe të rregullt nga poshtë lart të informacioneve për shfrytëzimin e burimeve, në drejtim të ministrive përgjegjëse.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D.

8.4 Vlerësimi i performancës për realizimin e shërbimeve

Ky dimension vlerëson se deri ku vlerësohen në mënyrë sistematike përmes vlerësimeve të pavarura të performancës hartimi i programeve të realizimit të shërbimeve dhe efikasiteti dhe efektiviteti i këtyre programeve.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) është ende në fazat e para të kryerjes së auditimeve të performancës dhe vijon të marrë mbështetje në këtë fushë nga institucionet homologe në Suedi dhe Vendet e Ulëta. Megjithatë, në tre vitet e fundit, janë kryer më shumë se tridhjetë auditime të performancës, me të cilat janë mbuluar shumica e ministrive të linjës. Megjithëse jo të gjitha këto auditime janë shoqëruar me raporte (dhe siç përmendet gjetkë, nuk ka një komision për llogaritë publike) raportet e hartuara janë publikuar në faqen në internet të KLSH-së.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

TP-9. E drejta e publikut për informacione fiskale

Ky tregues vlerëson gjithanshmërinë e informacioneve fiskale që vihen në dispozicion të publikut në bazë të elementeve të përcaktuara të informacioneve për të cilat qasja e publikut konsiderohet me rëndësi kritike. Ka një dimension për këtë tregues:

- *Dimensioni 9.1: E drejta e publikut për të parë informacione fiskale (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, mbulimi - QQB).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-9. E drejta e publikut për të parë informacione fiskale	Vlerësimi i përgjithshëm B	
9.1 E drejta e publikut për të parë informacione fiskale	Vlerësimi i dimensionit B	Qeveria vë në dispozicion të publikut shtatë elemente, përfshirë pesë elemente bazë, në afatet e përcaktuara.

9.1 E drejta e publikut për të parë informacione fiskale

TABELA 3.9 Përmbledhje e dëshmive dhe rezultateve të vlerësimit për TP-9

Elementi / Kërkesat	Dëshmitë e përdorura / Komente	Evidence used/ Comments
Elementet bazë		
Dokumentacioni i projektbuxhetit vjetor të ekzekutivit. Një paketë e plotë dokumentesh të projektbuxhetit të ekzekutivit (të prezantuar nga vendi në TP-5) i vihet në dispozicion publikut brenda një jave pas paraqitjes së këtyre nga ekzekutivi të legjislativi.	Po	Dokumentacioni i projektbuxhetit të ekzekutivit për vitin financiar 2017, përfshirë projektligjin për buxhetin, është miratuar nga Këshilli i Ministrave më 4 nëntor 2016 dhe më pas i është paraqitur legjislativit. Kjo paketë është publikuar më 9 nëntor 2016 në faqen në internet të Ministrisë së Financave: http://www.financa.gov.al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/projektbuxhet/projektbuxheti-2017
Buxheti i miratuar. Ligji për buxhetin vjetor i miratuar nga legjislativi bëhet publik brenda dy javësh pas miratimit të ligjit.	Po	Ligji Nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017", është publikuar në faqen në internet të Ministrisë së Financave më 28 dhjetor 2016. http://www.financa.gov.al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite
Raportet të zbatimit të buxhetit gjatë vitit. Raportet vihen rregullisht në dispozicion të publikut brenda një muaji pas daljes së tyre, siç vlerësohet në TP-27.	Po	Përgatiten gjatë vitit raporte mujore dhe tremujore për zbatimin e buxhetit, të cilët publikohen në faqen në internet të Ministrisë së Financave. Publikimi i raporteve të konsoliduara mujore bëhet brenda katër javësh. Përgatitja e raporteve tremujore më të zgjeruara përgjithësisht kërkon më shumë kohë dhe këto publikohen jo më vonë se 3 muaj pas përfundimit të periudhës së raportimit. Mujore: http://www.financa.gov.al/raportime/thesari/treguesit-fiskal-sipas-buxhetit-te-konsoliduar Tremujore: http://www.financa.gov.al/raportime/thesari/buletini-fiskal
Raporti vjetor për zbatimin e buxhetit. Raporti i vihet në dispozicion publikut brenda gjashtë muajve pas përfundimit të vitit fiskal.	Po	Ligji i ndryshuar për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor kërkon që raporti vjetor i konsoliduar të zbatimit të buxhetit të përgatitet dhe t'i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave jo më vonë se 5 muaj pas përfundimit të vitit fiskal ¹³ . Raporti përmban: a) pasqyrat e konsoliduara vjetore financiare, b) raportin për zbatimin e buxhetit vjetor dhe analizën përshkruese, c) raportin për borxhin publik, ç) raportin për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës; d) raportin për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik. dh) çdo raportim tjetër financiar, të kërkuar nga Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, publikohet në faqen në internet të Ministrisë së Financave ¹⁴ . Raporti vjetor i konsoliduar të zbatimit të buxhetit është një kërkesë e re e futur me shtesat dhe ndryshimet e vitit 2016, prandaj do të përdorej për herë të parë për vitin fiskal 2016. Në momentin e vlerësimit, raporti, siç përshkruhet më lart, nuk qe përgatitur, por vërehet se janë përgatitur dhe publikuar elemente të veçanta të tij. Hë për hë, raporti për zbatimin e buxhetit në përfundim të vitit përqendrohet vetëm te shmangia nga shumata e miratuara në buxhetin e vitit kundrejt zërave sipas klasifikimit ekonomik; atij i mungon harmonizimi me raportet e monitorimit të ministrive të linjës. Raporti për zbatimin e buxhetit për vitin 2016 është publikuar në faqen në internet të Ministrisë së Financave brenda 3 muajve pas përfundimit të vitit fiskal. http://www.financa.gov.al/raportime/thesari/buletini-fiskal .
Raporti financiar vjetor i audituar, i cili të përfshijë ose të shoqërohet me raportin e audituesit të jashtëm. Raportet të vihen në dispozicion publikut brenda 12 muajve pas përfundimit të vitit fiskal.	Po	Raporti i plotë vjetor me konstatimet e kontrollit afishohet në faqen në internet të KLSH-së. Raporti për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2015 është publikuar si raport i miratuar nga legjislativi më 20 tetor 2016. (http://www.klsh.org.al/web/RAPORT_P_R_ZBATIMINEBUXHETIT_T_SHTETIT_T_VITIT_2015_2367_1.php). Raporti bën të ditur se nuk janë hartuar pasqyra financiare vjetore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe si rezultat audituesi ka dhënë opinion negativ për pasqyrat financiare vjetore.

13. Neni 62 i Ligjit nr. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr.114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr.57/2016, datë 02.06.2016.

14. Neni 63 i Ligjit nr. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr.114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr.57/2016, datë 02.06.2016.

Elemente shtesë

Dokumenti parabuxhetor. Parametrat e përgjithshëm për projektbuxhetin e ekzekutivit lidhur me shpenzimet, planin e të ardhurave dhe borxhin i vihen në dispozicion publikut të paktën katër muaj përpara fillimit të vitit fiskal.	Po	Udhëzimi i Ministrisë së Financave për përgatitjen e PBA-së 2017-2019 (dhe të buxhetit të vitit 2017) mban datën 29 shkurt 2016 dhe përmban kalendarin e hollësishëm. Në vitin 2016, Këshilli i Ministrave i miratoi tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2017-2019 më 13 korrik. PBA 2017-2019 përfundimtar u miratua dhe publikua në shkurt 2017. PBA 2016-2018 përfundimtar u miratua dhe publikua në shkurt 2016. Parametrat për projektbuxhetin e ekzekutivit lidhur me shpenzimet, planin e të ardhurave dhe borxhin i vihen në dispozicion publikut kohë përpara afatit që kërkon ky element.
Përmbledhje e projektbuxhetit. Një përmbledhje e qartë dhe e thjeshtë e projektbuxhetit të ekzekutivit ose e buxhetit të miratuar që të jetë i kuptueshëm për ata që nuk janë ekspertë të buxhetit, shpesh i quajtur ndryshe edhe "buxheti i qytetarit", dhe, sipas nevojës, i përkthyer në gjuhët më të përhapura lokale, i vihet në dispozicion publikut brenda dy javësh pasi projektbuxheti i ekzekutivit i paraqitet legjislativit dhe brenda një muaji pas miratimit të buxhetit.	Jo	"Buxheti i qytetarit" për vitin 2017 është publikuar në faqen në internet të Ministrisë së Financave më 28 dhjetor 2016, pra brenda dy javësh pas miratimit të buxhetit nga Kuvendi. Nuk ka dëshmi të publikimit të buxhetit të qytetarit kur i është paraqitur projektbuxheti legjislativit, siç e kërkon Kuadri PEFA. (http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti-i-qytetarit)
Parashikimet makroekonomike Parashikimet, siç vlerësohen në TP-14.1, vihen në dispozicion brenda një jave pasi marrin miratimin.	Po	Këto parashikime përditësohen çdo vit dhe marrin formë zyrtare me VKM dhe publikohen në faqen në internet të Ministrisë së Financave. http://www.financa.gov.al/al/raportime/programimi-ekonomiko-fiskal/kuadri-makroekonomik-dhe-fiskal Parashikimi për VF 2018-2020 është miratuar me VKM nr.47, datë 25 janar 2017 dhe është publikuar brenda një jave në faqen në internet të MF-së dhe në Fletoren Zyrtare. Parashikimi për VF 2017-2019 është miratuar me VKM nr.80, datë 3 shkurt 2016 dhe është publikuar brenda një jave në faqen në internet të MF-së dhe në Fletoren Zyrtare.
Raporte të tjera të auditimit të jashtëm. Të gjitha raportet jo konfidenciale për operacionet e konsoliduara të qeverisjes vendore i vihen në dispozicion publikut brenda gjashtë muajve pas dorëzimit.	Jo	Raportet e kontrollit të rregullsisë që u bën KLSH-ja subjekteve të veçanta të sektorit publik bëhen publike në faqen në internet të KLSH-së. Raporti i kontrollit konsiston në një përmbledhje të rekomandimeve të dhëna.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.



3.3 SHTYLLA III: Menaxhimi i aktiveve dhe pasiveve

TP-10. Raportimi i risqeve fiskale

Ky tregues mat se sa raportohen risqet fiskale ndaj qeverisjes qendrore. Risqet fiskale mund të lindin nga situata makroekonomike të padëshiruara, pozicionet financiare të njësisve të qeverisjes nën nivelin qendror apo të shoqërive tregtare shtetërore dhe detyrimet e kushtëzuara që vijnë nga programet dhe aktivitetet e vetë qeverisjes qendrore, përfshirë edhe njësitë extra-buxhetore. Këto mund të lindin edhe nga risqe të tjera të nënkuptuara dhe të shprehura, siç janë mosfunksionimi i tregut dhe fatkeqësitë natyrore. Ky tregues përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- *Dimensioni 10.1: Monitorimi i shoqërive publike (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - shoqëritë publike nën kontrollin e qeverisjes qendrore);*
- *Dimensioni 10.2: Monitorimi i njësisve të qeverisjes vendore (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - subjektet e qeverisjes nën nivelin qendror që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta fiskale me qeverisjes qendrore);*
- *Dimensioni 10.3: Pasivet e kushtëzuara dhe risqet e tjera fiskale (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-10. Raportimi i risqeve fiskale	Vlerësimi i përgjithshëm C	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
10.1 Monitorimi i shoqërive publike	Vlerësimi i dimensionit C	Qeveria merr raportet financiare nga shumica e shoqërive publike brenda nëntë muajve pas përfundimit të vitit fiskal.
10.2 Monitorimi i njësisve të qeverisjes vendore	Vlerësimi i dimensionit C	Pasqyrat financiare për të gjitha njësitë e qeverisjes nën nivelin qendror publikohen çdo muaj në formë të konsoliduar për të gjitha NJQV-të dhe çdo tre muaj në nivel njësie. Auditimi i NJQV-ve bëhet një herë në dy vjet nga KLSH-ja.
10.3 Detyrimet e kushtëzuara dhe risqet e tjera fiskale	Vlerësimi i dimensionit C	Subjektet dhe institucionet e qeverisjes qendrore i shprehin në mënyrë sasiore disa detyrimeve të kushtëzuara të rëndësishme në raportet e tyre financiare, përfshirë statistikën për borxhin, programin e reformës ekonomike dhe relacionin e projektbuxhetit. Por nuk ka një raport të gjithanshëm në të cilin të përfshihen të gjitha PPP-të dhe koncesionet të cilat, tani për tani, mund të mos kenë rrjedhoja të drejtpërdrejta për buxhetin por që mund të përbëjnë një risk të kushtëzuar.

Risqet fiskale diskutohen në disa raporte, siç tregohet në tabelën 3.10 më poshtë:

TABELA 3.10 Shqipëria - disa raporte të përzgjedhura ku diskutohen risqet fiskale

Titulli	Risqet fiskale që diskutohen	Autori
Programi Kombëtar i Reformave Ekonomike 2015-2017	Risqet makroekonomike, përfshirë analizën e ndjeshmërisë, risqet specifike fiskale, riskqet e sektorit financiar	Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë
Raporti i buxhetit	Risqet specifike fiskale, përfshirë kontigjencat	Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë
Dokumenti mbi politikat për pensionet, 2014	Risqet afatgjata të skemës së pensioneve	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
Strategjia Afatmesme për Borxhin, 2015-2017	Risqet e borxhit të lidhura me refinancimin, normat e interesit, kurset e këmbimit dhe operacionet e borxhit.	Drejtorja e Borxhit Publik, Ministria e financave
Treguesit e borxhit	Borxhi dhe garancitë	Drejtorja e Borxhit Publik, Ministria e financave
Raporti për qëndrueshmërinë financiare	Risqet e sektorit financiar	Banka e Shqipërisë
Raporti vjetor	Depozitat bankare të garantuara	Agjencia e Sigurimit të Depozitave

Burimi: Të gjitha dokumentet gjenden në faqet në internet të institucioneve përkatëse.

10.1 Monitorimi i shoqërive publike

Ky dimension vlerëson sa vihet në dispozicion përmes pasqyrave financiare vjetore të audituara informacioni për performancën financiare dhe risqet fiskale të lidhura të shoqërive publike të qeverisjes vendore. Gjithashtu vlerëson se sa publikon qeverisja qendrore një raport të konsoliduar për performancën financiare të sektorit të shoqërive publike në mënyrë të përvitshme.

Për përkufizimin e shoqërive publike sipas GFS 2001, vlerësimi ka përdorur listën e subjekteve të përfshira në Raportin e FMN-së për statistikat financiare shtetërore (qershor 2016) dhe të klasifikuara si shoqëri publike dhe ka ndjekur publikimin e raporteve financiare në faqet e tyre në internet, ose në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Dokumentet e buxhetit tregojnë transfertat që bëhen drejt shoqërive publike dhe llogaritë e çdo shoqërie madhore gjenden publikisht, por qeveria nuk publikon një raport të pasiveve apo të performancës financiare të këtij sektori, megjithëse i është dashur shpesh të subvencionojë shumë prej shoqërive, përfshirë edhe në sektorin e energjisë elektrike dhe të ujësjellës-kanalizimeve. Nuk ka asnjë raport për financat e sektorit të shoqërive publike. Pasqyrat financiare të audituara të shoqërive publike të veçanta, njësoj si të çdo shoqërie tjetër aksionare, publikohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Për vitin 2015, deri më 30 qershor 2016 nuk janë publikuar pasqyra financiare të audituara për shumicën e shoqërive publike.

Ministria e Ekonomisë mbikëqyr administrimin e pasurive publike, por nuk përgatit pasqyra financiare të konsoliduara për portofolin e qeverisë në shoqëritë tregtare dhe as nuk raporton aktivitetet thuajse fiskale. Transfertat midis qeverisë dhe shoqërive publike publikohen në buxhet. Shoqëritë publike krijojnë risqe të konsiderueshme fiskale. Drejtimi i brendshëm dhe performanca financiare e këtyre shoqërive është e dobët. Ato ushtrojnë aktivitet sipas ligjit për shoqëritë tregtare, por disa prej tyre dalin me humbje, duke marrë nga buxheti mbështetje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

TABELA 3.11 Raportet financiare të shoqërive publike

Shoqëritë publike	Data e pasqyrave financiare të audituara	Shpenzime gjithsej	Si % e shpenzimeve gjithsej të shoqërive publike	A jepen informacione për Detyrimet e kushtëzuara të shoqërive publike në raportin financiar? (po/jo)
Shoqëria publike	Data e pasqyrës financiare të audituar	Shpenzime gjithsej	Shpenzime gjithsej si % e shpenzimeve gjithsej të shoqërive publike	A përfshihen pasivet e kushtëzuara të shoqërive publike në raportin financiar? (po/jo)
OSHE	21,07,2016	40,829,083	54%	Jo
Kesh	30,07,2016	18,688,703	25%	Jo
Albanian Post	30,06,2016	5,348,319	7%	Jo
OST	30,07,2016	5,146,870	7%	Jo
Albpetrol	11,01,2017	3,361,071	4%	Jo
First Investment Company FAF	14,12,2016	177,193	0%	Jo
Porti Vlore	27,12,2016	141,299	0%	Jo
Porti Shengjini	-	95,696	0%	Jo
Porti Sarandë	30,07,2016	68,969	0%	Jo
Dinamo SHA, Tirane	28,07,2016	34,032	0%	Jo
Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime Lushnje	2014	29,446	0%	Jo
Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime Shkodër	2008	11,074	0%	Jo
Autoriteti Portual Durrës	2016	1,781,827	2%	Jo
Federata Shqiptare e Futbollit	na	340,000	0%	Jo
Tregu i shitjes me shumicë dhe pakicë, fruta perime-Kukës***	na	na	0%	Jo
Tregu i shitjes me Shumicë, Fruta-Perime Berat	na	na	0%	Jo
Tregu i shitjes me Shumicë Fruta-Perime Vlorë***	na	na	0%	Jo
Qendra Kombëtare e Panairëve	na	na	0%	Jo

Shënim: *Të dhënat janë parashikime të projekt-buxhetit të Autoritetit të Portit të Durrësit dhe përfshihen vetëm për krahasim të madhësisë në shumën gjithsej të shoqërive publike jofinanciare.

**Kjo shifër është çmuarje e mbështetur në raporte në media.

***Këto janë ndërmarrje të vogla, kapitali i të cilave është më pak se 20.000 dollarë dhe konsiderohen si të papërfillshme për këtë llogaritje..

Për shumicën e shoqërive publike (rëndësia materiale sipas vlerës siç përkufizohet në kuadrin PEFA 2016 dhe shoqëria publike siç përkufizohet në kuadrin PEFA f.36), qeveria merr raporte financiare brenda nëntë muajve pas përfundimit të vitit fiskal.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

10.2 Monitorimi i njësive të qeverisjes nën nivelin qendror

Ky dimension vlerëson sa vihet në dispozicion përmes pasqyrave financiare vjetore të audituara të njësive të qeverisjes nën nivelin qendror informacioni për performancën financiare, përfshirë ekspozimin e mundshëm të qeverisjes qendrore ndaj risqeve fiskale.

Raportet për të ardhurat dhe shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore publikohen çdo muaj në formë të konsoliduar dhe çdo tremujor në nivel njësie, përfshirë edhe shpenzimet sipas funksionit, në statistikave fiskale tremujore të Ministrisë së Financave. Të dhënat për aktivet dhe detyrimet jo borxh të njësive të qeverisjes vendore nuk publikohen sistematikisht, megjithëse qeveria po bën një inventarizim të detyrimeve të prapambetura nëpërmjet anketave tremujore dhe i publikon këto detyrime të prapambetura në faqen në internet të Ministrisë së Financave.

Tani për tani, aktivitetet financiare dhe zbatimin e buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore janë objekt auditimi të jashtëm çdo dy vjet, i cili kryhet ose nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga auditues të tjerë ligjorë¹⁵.

Ministri i Financave dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit përcaktojnë me udhëzim të përbashkët rastet kur auditimi realizohet nga auditues të tjerë ligjorë si dhe procedurat, afatet dhe standardet e auditimit të jashtëm që ndiqen nga këta auditues. Kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore e dërgon raportin e auditimit të jashtëm në këshillin e njësive të vetëqeverisjes vendore si pjesë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit vendor. Një kopje e këtij raporti i dërgohet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Ministrisë së Financave. Kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të të gjitha raporteve të auditimit të jashtëm dhe raporton rregullisht në këshillin e njësive për progresin në zbatimin e tij.

Raportet jo të audituara për të ardhurat dhe pasivet dhe performancën e shumicës (rëndësia materiale sipas vlerës të përkufizuar në Kuadrin PEFA 2016) të njësive të qeverisjes nën nivelin qendror publikohen çdo muaj në formë të konsoliduar dhe çdo tremujor në nivel njësie, përfshirë edhe shpenzimet sipas funksionit, në statistikave fiskale tremujore të Ministrisë së Financave në lidhjen e mëposhtme:
<http://www.financa.gov.al/al/raportime/thesari/treguesit-fiskal-sipas-buxhetit-te-konsoliduar>.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

10.3 Detyrimet e kushtëzuara dhe risqet e tjera fiskale

Ky dimension vlerëson monitorimin dhe raportimin e detyrimeve të kushtëzuara eksplicite të qeverisjes qendrore që rrjedhin nga programet dhe projektet e saj, përfshirë edhe ato të njësive ekstra-buxhetore.

Detyrimet e kushtëzuara eksplicite në formën e garancive shtetërore për lloje të ndryshme kredish monitorohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Borxhit Publik pranë MF-së dhe publikohen çdo tremujor në faqen në internet të MF-së si pjesë e statistikave të borxhit. Në fund të vitit 2016, borxhi i garantuar publikisht për QQB-në qe 53,468 milion lekë, ose 3,6 për qind e PBB-së. Dorëzanitë në tregun e brendshëm përbëjnë 56,8 për qind të stokut të borxhit të garantuar gjithsej, ndërsa dorëzanitë e dhëna nga kreditorët e jashtëm përbëjnë 43,2 për qind të stokut të borxhit të garantuar. Shumica e garancive janë lëshuar në favor të sektorit energjetik.

Programi i Reformës Ekonomike 2017-2019 përmban informacion për pasivet e tjera të kushtëzuara, si partneritetet publike-private (PPP) të cilat krijojnë detyrime të drejtpërdrejta për buxhetin. Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik

15. Sipas ligjit të ri, auditimi i NJQV-ve do të bëhet çdo vit

privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente të mundshme. Ndryshimet e fundit të ligjit organik të buxhetit, me synim menaxhimin e risqeve të mundshme ekstrabuxhetore, kanë përcaktuar ndër të tjera që "Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor." Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore". Aktualisht, janë në fuqi 6 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP) të cilat marrin mbështetje buxhetore si dhe pritet që gjatë vitit 2017 të startojnë dhe 2 kontrata të reja të lidhura nga Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të detajuara këto kontrata dhe pagesa vjetore përkatëse, siç janë të publikuara në Programin e Reformave Ekonomike:

TABELA 3.12 Përmbledhje e kontratave PPP aktive dhe pagesat përkatëse vjetore

Ministria e Linjës	Emërtimi i Koncesionit/PPP	Kohëzgjatja	Kostoja totale (000/lek)	Kosto mesatare vjetore (000/lek)
Ministria e Shëndetësisë	Ofrimi i Shërbimit të Kontrollit Bazë (Check-Up)	10 vjet (2015-2024)	7.872.000	787.200
	Ofrimi i shërbimeve të Integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale	10 vjet (2015-2025)	12.300.000	1.230.000
	Ofrimi i Shërbimit të Dializës	10 vjet (2016-2025)	9.471.000	947.100
	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore*	10 vjet (2017-2026)	8.863.000	886.300
Ministria e Mjedisit	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	7 vjet (2015-2022)	3.338.220	476.186
	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier*	6 vjet (2017-2022)	4.059.000	676.500
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	5 vjet (2015 - 2019)	6.765.000	1.291.500
Ministria e Financave	Shërbimi i Skanimit në Dogana	15 vjet (2014-2029)	13.530.000	897.900
TOTALI			66.198.220	7.192.686

*Kërkesa për mbështetjen financiare për këto projekte të Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetit është miratuar nga Ministria e Financave dhe kontratat pritet të lidhen në 2017. - Burimi: Programi i Reformave Ekonomike.

Përveç PRE-së, nuk ka asnjë raport të rregullt e të plotë për PPP-të përfshirë arkëtimet dhe pagesat e parashikuara gjatë kohëzgjatjes së kontratave. Raporti i FMN-së i vitit 2015 për transparencën fiskale vlerësoi se kontratat e nënshkruara krijojnë kosto fiskale gjithsej prej të paktën 7 për qind të PBB-së në 2013, ndërkohë që pas vitit 2013 janë nënshkruar edhe kontrata të tjera. Të gjitha kontratat individuale publikohen nga ATRAKO, agjencia shtetërore qendrore së cilës i është ngarkuar detyra e mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit. Detyrimet e kushtëzuara eksplicite në formën e sigurimit të depozitave, fatkeqësive, sigurimit të bimëve bujqësore, proceseve gjyqësore të papërfunduara dhe çështjeve gjyqësore nuk jepen në formë sasiore, megjithëse këto diskutohen në PRE së bashku me masat që ka marrë qeveria në formën e fondeve rezervë në buxhet. Në përgjithësi, subjektet dhe institucionet e qeverisjes qendrore i shprehin në mënyrë sasiore (rëndësia materiale sipas vlerës siç përkufizohet nga Kuadri PEFA 2016) disa pasive të kushtëzuara të rëndësishme në raportet e tyre financiare.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

TP-11. Menaxhimi i investimeve publike

Ky tregues vlerëson vlerësimin ekonomik, përzgjedhjen, llogaritjen e kostove dhe monitorimin e projekteve të investimeve publike nga qeveria, me theksin te projektet më të mëdha dhe më të rëndësishme. Ky tregues përmban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- *Dimensioni 11.1: Analiza ekonomike e projekteve të investimeve (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 11.2: Përzgjedhja e projekteve të investimeve (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 11.3: Llogaritja e kostove të projekteve të investimeve (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 11.4: Monitorimi i projekteve të investimeve (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-11. Menaxhimi i investimeve publike	C+	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
11.1 Analiza ekonomike e projekteve të investimeve	Vlerësimi i dimensionit C	Kryhen analiza ekonomike për të vlerësuar të gjitha projektet madhore të investimeve. Por ekipit të vlerësimit nuk iu vu në dispozicion asnjë publikim i dokumentuar i rezultateve të analizës ekonomike të këtyre projekteve madhore të investimeve.
11.2 Përzgjedhja e projekteve të investimeve	Vlerësimi i dimensionit D*	Përpara përfshirjes në buxhet, disa prej projekteve madhore të investimeve prioritetizohen nga një subjekt qendror, megjithëse për qindja nuk mund të konstatohet.
11.3 Llogaritja e kostove të projekteve të investimeve	Vlerësimi i dimensionit C	Parashikimet e kostos kapitale gjithsej të projekteve madhore të investimeve, së bashku me kostot kapitale për periudhën trevjeçare, përfshihen në dokumentet e buxhetit.
11.4 Monitorimi i projekteve të investimeve	Vlerësimi i dimensionit B	Kostoja gjithsej dhe ecuria fizike e projekteve madhore të investimeve monitorohet nga njësi zbatuese. Ka procedura dhe rregulla standarde për zbatimin e projekteve, ndërsa informacioni për projektet madhore të investimeve publikohet çdo vit.

Konteksti

Për këtë tregues, projektet madhore të investimeve janë ato projekte që përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Kostoja gjithsej e projektit arrin në 1 për qind ose më shumë të shpenzimeve gjithsej të buxhetit vjetor;
- Projekti është ndër 10 projektet më të mëdha (sipas koston së investimit) për secilën prej 5 njësisive më të mëdha të qeverisjes qendrore, e matur sipas shpenzimeve të njësisive për projektet e investimeve.

Projektet që i përmbushin të dy këto kriteret të PEFA-s i përkasin Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (MTI). Ka rreth 102 projekte madhore investimesh (49 me fonde të brendshme dhe 52 me fonde të jashtme) për të cilat kostoja e investimit gjithsej e projektit arrin 1 për qind ose më shumë të shpenzimeve gjithsej të buxhetit vjetor. 10 projektet më të mëdha madhore të investimeve i përkasin MTI-së në fushën e ndërtimit, përmirësimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të rrugëve kombëtare. MTI është ministria

e linjës me programin më të madh të investimeve publike, me rreth 60 për qind të buxhetit të shtetit në investime. Pas saj vjen sektori social me rreth 34,6 për qind të buxhetit të shtetit në investime, me një investim të konsiderueshëm në ujësjellës kanalizime dhe zhvillim të komunitetit.

Projektet e investimeve me financim të jashtëm përfshihen në dokumentacionin e buxhetit, ndërsa PPP-të përfshihen vetëm në rastet kur kërkojnë shprehimisht pagesa buxhetore. Nuk është krijuar ende një regjistër qendror për të ndjekur të gjitha projektet ekzistuese të PPP-ve, por sipas çmuarjeve të autoriteteve janë nënshkruar rreth 170 PPP dhe deri tani buxheti subvencionon vetëm gjashtë PPP¹⁶.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI-II) e përcakton vizionin afatgjatë për sektorin e transportit në Shqipëri si "zhvillimi i një sistemi efikas të transportit, të integruar në rajon dhe në rrjetin e BE-së, që nxit zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetesës së qytetarit". Në përputhje me këtë plan dhe objektivat kryesorë, Strategjia e re kombëtare e transportit dhe plani i veprimit 2016-2020 përcaktojnë prioritetet strategjike të sistemit të transportit të Shqipërisë.

11.1 Analiza ekonomike e projekteve të investimeve

Ky dimension vlerëson se sa përdoren metodat solide të vlerësimit mbështetur në analizë ekonomike për të kryer studime para-realizueshmërie ose realizueshmërie për projektet madhore të investimeve me një analizë të pasojave ekonomike, financiare dhe të tjera; nëse rezultatet e analizave publikohen dhe nëse analizat shqyrtohen nga një subjekt tjetër nga subjekti kërkues.

Analizat ekonomike të investimeve madhore publike kryhen siç parashikohet në dokumentin e procedurave për menaxhimin e investimeve publike. Procedurat zbatohen njësoj për të gjitha projektet, pavarësisht nëse janë me financim të jashtëm ose të brendshëm. Sipas procedurave të MIP-së, ka tri nivele vlerësimi: i. vlerësim bazë (projektet e kategorisë I me kosto investimi gjithsej deri në 100 milion lekë për sektorin e infrastrukturës dhe deri në 50 milion lekë për sektorët e tjerë); ii. vlerësim standard (projektet e kategorisë II me kosto investimi gjithsej më shumë se 100 milion lekë për sektorin e infrastrukturës dhe më shumë se 50 milion lekë për sektorët e tjerë); dhe iii. vlerësim i plotë (projektet e kategorisë III¹⁷ - këtu pragu varet nga sektori; niveli i kërkesave dhe vlerësimit specifikohen sipas çdo rasti të veçantë).

Dokumenti për procedurat e MIP-së jep udhëzime të qarta për kërkesat dhe informacionet e hollësishme që duhen përfshirë në formularin e projektit të investimit. Për shembull, për vlerësimin standard, analiza kosto-përfitim duhet të plotësohet për të paktën 2 alternativa (opsione) të investimit, në bazë të identifikimit të paktën të tri alternativave ekuivalente "nuk investohet" - "investim minimal" - "investim i konsiderueshëm". Projektet e mëdha të investimeve publike që i përkasin kategorisë III do të kërkonin një analizë më rigorozë kosto-përfitim. Krahas një analize të plotë kosto-përfitim, procedurat kërkojnë një studim të plotë ose të pjesshëm realizueshmërie, skenarët e flukseve monetare dhe financimit, alternativat e dizenjimit të projektit, planin e prokurimit, vlerësimet e ndikimeve mjedisore, sociale dhe analiza të tjera që nevojiten¹⁸. Por kërkesat për analizën kosto-përfitim mund të anashkalojnë me praktikën e vazhdueshme të zhvillimit në masë të projekteve më të vogla, shumë prej të cilëve do të duhej të ishin pjesë e projekteve më të mëdha.

Analizat ekonomike nuk shqyrtohen nga një subjekt që nuk është subjekti kërkues dhe as nga Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike (DMIP) në MF. Vlerësimi i projekteve përpara miratimit të tyre është përgjegjësi e ministrive përkatëse të linjës (institucionet buxhetore), ndërsa në rastin e projekteve me

16. PPP kanë rezultuar në një nivel relativisht të lartë stoku të kapitalit prej 6,1 për qind të PBB-së. Projektet PPP janë përqendruar kryesisht në rrugë, porte dhe energjetikë

17. Në këtë kategori zakonisht bien projektet me kosto investimi gjithsej më shumë 700 milion lekë, të cilët përkufizohen si projekte prioritare

18. Dokumenti për procedurat për menaxhimin e investimeve publike, faqe 5-8

fonde donatori, kjo detyrë shpesh kryhet nga konsulentë të jashtëm të marrë nga projekti. DMIP në MF nuk bën shqyrtim të analizës ekonomike të propozimeve për projekte madhore investimesh. Shqyrtimi zakonisht përqendrohet te shkalla deri ku propozimi për projekt investimi është brenda tavaneve të miratuara në PBA. Kalimi i përgjegjësisë për MIP-në në MF nuk u shoqërua me transferim personeli¹⁹. Pra ka një mungesë të përgjithshme personeli me shprehitë e nevojshme për vlerësimin paraprak të projekteve në DMIP të MF-së. Për shembull, mesatarisht një ministri dorëzon rreth 20 projekte të reja, të cilat do të duhej të shqyrtoheshin brenda dy javësh nga një sektor me më pak se 10 specialistë.

KLSH ka theksuar në raportin e tij²⁰ se edhe projektet me fonde nga burime të jashtme nuk kanë qenë gati për zbatim, siç pasqyrohet edhe nga tërheqja e fondeve deri në katër vjet. Arsyeja për këtë është mungesa e përgjithshme e personelit me shprehitë e nevojshme të vlerësimit paraprak të projekteve në ministrinë e linjës dhe mungesa e një interesi të qenësishëm në nivelet politike dhe të larta drejtuese për të maksimizuar vlerën e fondeve të investuara. Gjithashtu, vonesat e konsiderueshme në zbatimin e projekteve ngrenë çështjen e vlefshmërisë në kohë të analizës fillestare kosto-përfitim, kur ka pasur të tillë.

Për **të gjitha projektet madhore të investimeve** (rëndësia materiale sipas vlerës siç përkufizohet nga Kuadri PEFA 2016) që i përkasin MTI-së (sipas kriterëve PEFA për këtë tregues) janë kryer vlerësimet teknike dhe analizat kosto-përfitim. Por ekipit të vlerësimit nuk iu vu në dispozicion asnjë dëshmi e dokumentuar për publikimin e rezultateve të analizës ekonomike të këtyre projekteve madhore të investimeve.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

11.2 Përzgjedhja e projekteve të investimeve

Ky dimension vlerëson shkallën e vendosjes së prioriteteve mes projekteve të investimeve në procesin e përzgjedhjes së projekteve, në bazë të kriterëve të përcaktuara qartë për të siguruar që projektet e përzgjedhura janë në përputhje me prioritetet e qeverisë.

Procedurat e vendosura për MIP-në përfshijnë një proces të strukturuar shqyrtimi dhe miratimi për vlerësimin paraprak të projekteve. Dokumenti për procedurat e menaxhimit të investimeve publike vendos procedura të cilat zbatohen njësoj për të gjitha projektet, pavarësisht nëse janë me financim të jashtëm ose të brendshëm. Sikurse ilustron në diagramin më poshtë, këto procedura përfshijnë identifikimin dhe vlerësimin paraprak, ku bëhet një vlerësim i parë i përputhjes me objektivat e politikave dhe i logjikës së projektit dhe merret një vendim nëse ia vlen të vijohet më tej. Nëse projektet e kalojnë këtë shoshitje të parë, atëherë procedurat parashikojnë edhe kryerjen e një vlerësimi nëse projekti ka të ngjarë të ketë leverdi ekonomike, krahas kërkesës për të ekzaminuar alternativa të projektit.

Procesi i shqyrtimit të projekteve madhore të investimeve publike përfshin hapat e mëposhtëm: i. institucionet buxhetore prezantojnë projekt-idetë që të shqyrtohen nga DMIP në MF; ii. Shqyrtimi i projekt-idesë për projektet e mëdha nga Grupi i Menaxhimit të Buxhetit (GMB); iii. shqyrtimi i projekteve të përzgjedhura me kosto dhe ndikim të lartë nga Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) i cili kryesohet nga Kryeministri; iv. shqyrtimi i propozimeve për investim nëpërmjet procesit të rishikimit të PBA-së nga Drejtoria e Analizës së Buxhetit dhe Grupi i Menaxhimit të Buxhetit (projektet e vogla); dhe v. miratimi dhe përfshirja për financim në PBA dhe në buxhet.


Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI) përcakton përgjegjësinë qendrore për shqyrtimin e projekteve që duhet të përfshihen në PBA. DMIP ka përgjegjësinë e rishikimit të projekteve madhore të investimeve përpara se të përfshihen në buxhet. Procedurat e vendosura japin edhe kriteret e përzgjedhjes së

19. Funkcioni i menaxhimit të investimeve publike (MIP) është kaluar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) te Ministria e Financave në bazë të VKM nr.171, datë 03.03.2016

20. Kontrolli i Lartë i Shtetit, Raporti për zbatimin e buxhetit të shtetit 2014

projekteve që duhet të zbatohen nga njësi qendrore, por këto nuk zbatohen sistematikisht dhe shpesh hiqet dorë prej tyre për shkak të trysnisë për të ruajtur nivelin e shpenzimeve kapitale. Zyrtarë të qeverisë kanë komentuar në disa raste se procesi i përzgjedhjes së projekteve të investimeve është disi i politizuar. Në praktikë, kjo do të thotë se përzgjedhja e projekteve bëhet në fakt në nivel të ministrive të linjës të cilat vendosin prioritetet midis projekteve konkurruese të propozuara nga njësitë e varësisë. Kriteret e përzgjedhjes së projekteve nuk janë të publikuara.

DIAGRAMI 3.1: Procesi i shqyrtimit dhe miratimit për projektet e investimeve publike



Përpara përfshirjes në buxhet, disa prej projekteve madhore të investimeve prioritizohen nga një subjekt qendror, megjithëse përqindja nuk mund të konstatohet.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D*.

11.3 Llogaritja e kostove të projekteve të investimeve

Ky dimension vlerëson nëse dokumentacioni i buxhetit përfshin parashikime afatmesme të projekteve të investimeve në bazë të kostove të plota dhe nëse procesi i buxhetit për shpenzimet kapitale dhe të përvitshme është plotësisht i integruar.

Buxheti përfshin informacion për shpenzimet korrente dhe ato kapitale të klasifikuara sipas programeve, por nuk përfshin informacion për kostot gjithsej të projekteve dhe as një zbërthim sipas nënprogrameve apo projekteve. Megjithëse neni 29 i Ligjit Organik të Buxhetit (LOB) parashikon që buxheti të japë të dhëna të hollësishme për projektet kapitale, përfshirë: vlerën e plotë të kontratës, shumën e shpenzuar për projektin deri këtë vit buxhetor, fondin e miratuar për vitin buxhetor, vlerësimet për dy vitet e tjera dhe burimet e financimit, ky informacion nuk jepet në dokumentacionin e buxhetit. Mungesa e transparencës për kostot e projekteve gjithsej cenohet më tej nga moria e projekteve, shumë prej të cilëve praktikisht janë komponentë të atyre që duhej të kishin qenë projekte më të mëdha – për shembull mbikëqyrja e projektit dhe shpronësimet shpesh identifikohen si projekte më vete nga komponenti kryesor i ndërtimit, çka e bën të vështirë llogaritjen e kostos së plotë të projektit.

Pas miratimit të buxhetit nga Kuvendi, të gjitha institucionet buxhetore sigurojnë një zberthim të fondeve të miratuara kapitale sipas projekteve që janë miratuar nga MF dhe regjistruar si tavane të projekteve në SIQF. Kështu, shpenzimet kapitale realizohen dhe kontrollohen në nivel projekti. PBA përfshin parashikime për shpenzimet kapitale të zberthyer sipas ministrive dhe programeve për periudhën trevjeçare. Por PBA nuk jep informacion për projektet e reja më vete dhe projektet me fond buxheti, kredie dhe granti përfshihen brenda të njëjtit tavan, duke mundësuar rishpërndarje nga projektet me fonde donatori te projektet me fonde të brendshme.

Si përfundim, parashikimet e kostos kapitale gjithsej të projekteve madhore të investimeve, së bashku me kostot kapitale për periudhën trevjeçare, përfshihen në dokumentet e buxhetit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

11.4 Monitorimi i projekteve të investimeve

Ky dimension vlerëson se deri ku ka masa për monitorim dhe raportim qendror të projekteve për të siguruar vlerën për para dhe pacenueshmërinë e funksioneve të besuara.

Rregullorja për raportimin, monitorimin dhe vlerësimin e investimeve publike parashikon një sistem raportimi dhe monitorimi të projekteve kapitale gjatë zbatimit të projektit. Sipas saj, kostot gjithsej të projektit si edhe ecuria fizike monitorohen në nivel qendror gjatë zbatimit të projektit. Kjo rregullore synon parashikimin e një forme të standardizuar të raportimit nga ministrinë e linjës, ku të përfshihet ky informacion: informacion bazë për projektet, kostot gjithsej, afatet kohore, ecurinë financiare dhe fizike, problemet në zbatim, si edhe sa kanë arritur këto projekte të kontribuojnë në arritjen e objektivave sektoriale.

Të gjitha ministrinë e linjës janë të detyruara t'i raportojnë Ministrisë së Financave për zbatimin e projekteve kapitale, çdo muaj për projektet me fonde buxheti dhe çdo javë për projektet me fonde të huaja. Më konkretisht, projektet e investimeve me vlerë totale mbi 700 milion lekë (ekuivalent i 5 milion Euro), të cilat përkufizohen si prioritare, janë objekt i monitorimit në kohë reale. Të gjitha ministrinë e linjës dhe institucionet buxhetore që i zbatojnë këto projekte raportojnë në mënyrë të përjavshme. Projektet me kosto investimi gjithsej më pak se 100 milion lekë janë objekt monitorimi dhe raportimi në bllok dhe sipas programeve. Njësitë shpenzuese të varësisë u raportojnë ministrive të linjës dhe më pas ministrinë e linjës i raportojnë Ministrisë së Financave. Më pas, MF harton një raport për zbatimin e projekteve të cilin ia paraqet Këshillit të Investimeve, organ i kryesuar nga Kryeministri, të cilit i është ngarkuar detyra e monitorimit të ecurisë dhe trajtimit të problemeve që pengojnë zbatimin e projekteve. Një herë në vit, ministria harton një raport vjetor për zbatimin e projekteve kapitale i cili publikohet në faqen e saj në internet.

Megjithëse ekzistojnë rregulloret për monitorim dhe raportim, sistemi për monitorimin nuk është plotësisht i gjithanshëm dhe cilësia e të dhënave nuk ka qenë gjithmonë adekuate. Ekipi i vlerësimit u takua me përfaqësues të Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), i cili është administratori kryesor i veprave të rrjetit të rrugëve kombëtare dhe është përgjegjës për ndërtimin, përmirësimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e këtij rrjeti²¹. Në disa nga sfidat kryesore që has ARRSH janë: burimet për mbikëqyrjen e projektit janë të tejpërdorura - një mbikëqyrës mund të monitorojë 5-10 kontrata (në rastin e kontratave me fonde të brendshme) për shkak të numrit të lartë të kontratave; përvojë e pamjaftueshme në prokurimin dhe

21. ARRSH është krijuar me Ligjin nr. 10164 datë 15.10.2009. ARRSH përgjigjet përpara MTI-së dhe mbikëqyrret nga Bordi i Menaxhimit i ARRSH-së, i cili përbëhet nga shtatë anëtarë: katër përfaqësues të qeverisë nga Ministria e Transportit, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Pushtetit Vendor, dhe tre përfaqësues të organizatave të sektorit privat

zbatimin e kontratave me bazë performance (PBS); kapacitete të pamjaftueshme të ekipeve të menaxhimit të projekteve dhe po ashtu njohuri të pamjaftueshme të tyre mbi udhëzimet shumëpalëshe të prokurimit; vonesa në zbatimin dhe përvojë e pamjaftueshme në kontratat me bazë performancën në sektorin e ndërtimit²². Një sfidë tjetër e rëndësishme është mungesa e fondeve të mjaftueshme dhe pamundësia për të financuar në kohë. Prandaj, është e rëndësishme të sigurohet që shpenzimet në të ardhmen të jenë në përputhje me të ardhurat në mënyrë që të parandalohet akumulimi i detyrimeve të prapambetura ndaj sipërmarrësve. Kjo kërkon një angazhim për të mos i filluar punimet e rehabilitimit dhe ndërtimit nëse nuk është siguruar angazhimi për fonde të mjaftueshme. Sa më lart, nuk mund të thuhet me besim se ka një nivel të lartë përputhshmërie me procedurat dhe rregullat standarde për zbatimin e projekteve që janë në fuqi.

Pra rrjedhojë, kostoja gjithsej dhe ecuria fizike e projekteve madhore të investimeve monitorohet nga njësia zbatuese e qeverisjes. Ka procedura dhe rregulla standarde për zbatimin e projekteve, ndërsa informacioni për projektet madhore të investimeve publikohet çdo vit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

TP-12. Menaxhimi i aktiveve publike

Ky tregues vlerëson administrimin dhe monitorimin e aktiveve shtetërore dhe transparencën e heqjes së aktiveve. Përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve:

- *Dimensioni 12.1: Monitorimi i aktiveve financiare (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 12.2: Monitorimi i aktiveve jofinanciare (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQB).*
- *Dimensioni 12.3: Transparenca e heqjes së aktiveve (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ për aktivet financiare dhe QQB për aktivet jofinanciare)*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-12. Menaxhimi i aktiveve publike	D+	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
12.1 Monitorimi i aktiveve financiare	Vlerësimi i dimensionit C	Qeveria mban evidencë të të gjitha kategorive madhore të aktiveve financiare që zotëron.
12.2 Monitorimi i aktiveve jofinanciare	Vlerësimi i dimensionit D	Performanca është në nivel më të ulët nga sa e kërkon niveli i vlerësimit C.
12.3 Transparenca e heqjes së aktiveve	Vlerësimi i dimensionit C	Janë vendosur procedura dhe rregulla për kalimin ose heqjen e aktiveve jofinanciare. Informacionet për kalimin dhe heqjen e aktiveve përfshihen në dokumentet e buxhetit, raportet financiare ose raporte të tjera.

22. Raport Nr. 91351-Al për projektet e mirëmbajtjes dhe sigurisë rrugore bazuar në rezultate (RRMSP), Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim. Banka Botërore, mars 2015

12.1 Monitorimi i aktiveve financiare

Ky dimension vlerëson natyrën e monitorimit të aktiveve financiare, i cili është me rëndësi kritike për identifikimin dhe administrimin me efektivitet të ekspozimeve kryesore financiare dhe risqeve që i kanosen menaxhimit të përgjithshëm fiskal.

Qeveria ka evidencë të aktiveve kryesore financiare që ka qeverisja qendrore. QSH ka këto lloje të aktiveve financiare: i. depozita të menaxhuara nga Thesari dhe të raportuara në mënyrë të përmuajshme; ii. kreditë e regjistruara dhe menaxhuara nga Drejtoria e Borxhit në MF; iii. pjesëmarrjet në kapital, për të cilat Banka Qendrore ka bërë vlerësim kohët e fundit. Të gjitha aktivet financiare mbahen me vlerë të drejtë. Informacioni mbi performancën e portofolit të aktiveve financiare nuk është publikuar. Kështu, qeveria mban evidencë të pjesëmarrjes së saj në kategoritë kryesore të aktiveve financiare (rëndësia materiale sipas vlerës të përkufizuar në Kuadrin PEFA 2016).

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

12.2 Monitorimi i aktiveve jofinanciare

Ky dimension vlerëson karakteristikat e monitorimit të aktiveve jofinanciare për QQB-në.

Nuk ka një regjistër të plotë dhe aktual të aktiveve jofinanciare. Udhëzimi i MF-së për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik kërkon që të gjitha institucionet buxhetore të ngrenë një sistem për administrimin e duhur të aktiveve, ku përfshihet: caktimi qartë i përgjegjësive brenda institucionit për menaxhimin e aktiveve, ngritja dhe përditësimi rregullisht i regjistrit të aktiveve, dokumentimi i të gjitha shitblerjeve ose i heqjes së aktiveve dhe kryerja e një kontrolli të ekzistencës së aktiveve të paktën një herë në vit. Regjistri i aktiveve duhet të përfshijë informacion për aktivet financiare dhe jofinanciare, përfshirë: përshkrimin e aktiveve, datën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes.

Sipas nenit 62 të Ligjit Organik të buxhetit, ministritë e linjës janë përgjegjëse për hartimin e pasqyrave financiare, përfshirë edhe një bilanc ku përfshihen aktivet financiare dhe jofinanciare. Ministritë e linjës mbajnë të dhëna agregate por jo të hollësishme. Pasqyrat financiare i dorëzohen më pas Thesarit. Thesari harton bilancin e konsoliduar të qeverisë i cili për vitin 2016, as nuk është audituar, as nuk është publikuar. Pasqyra më e fundit financiare e publikuar në faqen në internet të MF-së i takon vitit 2014 <http://www.financa.gov.al/al/raportime/thesari/pasqyrat-financiare>. Bilancet nuk janë të plota, duke mos përfshirë njësitë për zbatimin e projekteve me financim të huaj dhe institucionet me vetëfinancim, si edhe disa njësi të mbajtura jashtë operacioneve të llogarisë unike të thesarit. Megjithatë amortizimi i aktiveve afatgjata materiale nuk përfshihet në pasqyrën e aktiviteteve të shfrytëzimit, ky amortizim përfshihet në bilancin e konsoliduar të qeverisë.

Strategjia e MF-së për menaxhimin e financave publike 2014-2020 përfshin një projekt për të zbatuar SEKSP-të/SNKSP-të për ta përmirësuar cilësinë e raportimit të aktiveve dhe një projekt për ngritjen e një regjistri të plotë dhe aktual të aktiveve.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D.²³

23. Sipas sqarimit 12.2:4 të Udhëzuesit të PEFA-s, nivelet e vlerësimit mbi D duhet të jepen vetëm kur regjistrat konsiderohen të gjithanshëm dhe aktualë për të gjitha aktivet me rëndësi materiale që mbulojnë këto kërkesa

12.3 Transparenca e heqjes së aktiveve

Ky dimension vlerëson nëse procedurat për kalimin dhe heqjen e aktiveve vendosen me legjislacion, rregullore ose procedura të miratuara.

Janë vendosur procedura dhe rregulla për kalimin ose heqjen e aktiveve jofinanciare. Kuadri ligjor dhe rregullator për kalimin dhe heqjen e aktiveve jofinanciare përbëhet nga: Ligji nr.7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve"; Ligji nr.10270, datë 22.4.2010 "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij", ndryshuar me Ligjin nr.24/2012, datë 15.03.2012; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 413, datë 25.6.2014, "Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme, dhe trojeve shtesë funksionale të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, të objekteve shtetërore të veçuara, të privatizuara, të objekteve apo ndërtesave të shitura të ish-kooperativave bujqësore, si dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit"; VKM nr.603, datë 31.08.2016 "Për disa shtesa në VKM nr.413, datë 25.06.2014; Udhëzim nr. 5, datë 20.01.2015 në bazë të Ligjit nr. 10270, datë 22.04.2010; Ligji nr.9967, datë 24.07.2008 "Për miratimin e aktit normativ Nr.4, datë 09.07.2008 "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve"; VKM nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet ose transformohet, dhe procedurën e shitjes"; dhe Udhëzimi nr.5222, datë 26.06.2015, për zbatimin e VKM nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet ose transformohet, dhe procedurën e shitjes".

Gjatë vitit fiskal 2016, në bazë të VKM nr. 413, datë 25.06.2014, janë mbyllur 129 procedura për objektet e privatizuara të ish-ndërmarrjeve shtetërore dhe troje funksionale në shumën gjithsej prej 64.400.000 lekë. Drejtoria e Pronave Publike bën rakordim periodik (çdo 3 muaj) me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me Drejtorinë e Privatizimit për arkëtimin e të ardhurave nga shitja e mjediseve dhe kryen rakordim periodik (çdo muaj) me Drejtorinë e Financës pranë Ministrisë së Financave për objektet dhe trojet e privatizuara. Informacioni për të ardhurat nga privatizimi gjenden në dokumentacionin e buxhetit²⁴.

Si përfundim, janë vendosur procedura dhe rregulla për kalimin ose heqjen e aktiveve jofinanciare. Informacionet për kalimin dhe heqjen e aktiveve përfshihen në dokumentet e buxhetit, raportet financiare ose raporte të tjera.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

24. <http://www.financa.gov.al/raportime/programimi-ekonomiko-fiskal/raporte-dhe-statistika-fiskale-mujore/statistika-fiskale-mujore>

TP-13. Menaxhimi i borxhit

Ky tregues vlerëson menaxhimin e garancive dhe borxhit të brendshëm dhe të jashtëm. Treguesi kërkon të identifikojë nëse ka praktika, evidenca dhe masa kontrolluese të kënaqshme të menaxhimit, për të siguruar rregullime efikase dhe efektive. Përmban tre dimensione dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve.

- *Dimensioni 13.1: Regjistrimi dhe raportimi i borxhit dhe i garancive (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 13.2: Miratimi i borxhit dhe i garancive (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 13.3: Strategjia e menaxhimit të borxhit (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit bazuar në tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-13. Menaxhimi i borxhit	Vlerësimi i përgjithshëm A	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
13.1 Regjistrimi dhe raportimi i borxhit dhe i garancive	Vlerësimi i dimensionit B	Evidencat e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm dhe borxhit të garantuar janë të plota, të sakta dhe përditësohen çdo tremujor. Shumica e informacionit rakordohet çdo tremujor. Çdo tremujor hartohen raporte të plota të menaxhimit dhe statistikave mbulojnë shërbimin, stokun dhe operacionet e borxhit.
13.2 Miratimi i borxhit dhe i garancive	Vlerësimi i dimensionit A	Legjislati parësor i jep autorizim për të marrë hua, për të emetuar borxh të ri dhe për të lëshuar garanci në emër të qeverisë qendrore një subjekti të vetëm përgjegjës për menaxhimin e borxhit. Politikën dhe procedurat e dokumentuara japin udhëzime për marrjen e huar, për emetimin e borxhit të ri dhe për ndërmarrjen e veprimeve të lidhura me borxhin, për lëshimin e garancive dhe për monitorimin e veprimeve të menaxhimit të borxhit nga një subjekt i vetëm i menaxhimit të borxhit. Huamarrja vjetore duhet të miratohet nga qeveria ose legjislativi.
13.3 Strategjia e menaxhimit të borxhit	Vlerësimi i dimensionit A	Raportohet publikisht një strategji aktuale afatmesme e menaxhimit të borxhit e cila mbulon borxhin ekzistues dhe të parashikuar të qeverisë, me një horizont prej të paktën tre vjetësh. Strategjia përfshin fasha objektive për tregues të tillë si normat e interesit, rifinancimi dhe risqet e monedhës së huaj. Legjislativi i vihen në dispozicion raporte vjetore kundrejt objektivave të menaxhimit të borxhit. Plani vjetor i qeverisë për huamarrjen është në përputhje me strategjinë e miratuar.

13.1 Regjistrimi dhe raportimi i borxhit dhe i garancive

Ky dimension vlerëson pacenueshmërinë dhe gjithanshmërinë e regjistrimit dhe raportimit të borxhit të brendshëm, të huaj dhe të garantuar. Një sistem i monitorimit dhe raportimit të rregullt për karakteristikat e portofolit të borxhit ka rëndësi kritike për të siguruar pacenueshmërinë e të dhënave dhe menaxhimin efektiv, siç është parashikimi i saktë në buxhet i shërbimit të borxhit, bërja e pagesave në afat të shërbimit të borxhit dhe sigurimi i rifinancimit të planifikuar mirë të borxhit.

Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit të Borxhit Publik (DPMBP) pranë Ministrisë së Financave kryen të gjitha aspektet e planifikimit, vlerësimin e riskut dhe operacionet me borxhin e brendshëm dhe të jashtëm dhe dorëzantë të qeverisë. Objektivi i këtij funksioni është arritja e kombinimit më të mirë të fondeve buxhetore, huamarrjes së brendshme dhe të jashtme dhe garantimit të kredive, për të minimizuar koston dhe riskun e borxhit të qeverisë.

Të dhënat për borxhin e brendshëm dhe të jashtëm dhe borxhin e garantuar regjistrohen, monitorohen dhe publikohen në buletinet tremujore dhe vjetore për borxhin, të cilat gjenden në faqen në internet të Ministrisë së Financave. Raportet e gjithanshme të menaxhimit dhe statistikave mbulojnë shërbimin, stokun dhe operacionet e borxhit lidhur me borxhin publik dhe të garantuar publikisht të qeverisjes së përgjithshme dhe qeverisjes qendrore. Borxhi i jashtëm zbërthehet sipas afatit (afatgjatë ose afatshkurtër), monedhës, llojit të kreditorëve dhe normave të interesit. Borxhi i brendshëm zbërthehet sipas afatit (kohëzgjatje mesatare e ponderuar dhe profili i kohëzgjatjes), llojeve të normave të interesit dhe mbajtësve të borxhit. Për dorëzantë, jepen vetëm stoqet agregate të jashtme dhe të brendshme.

Qeveria bën njoftime të rregullta për aktivitetet e borxhit. Në bazë të rregullave ekzistuese të kontabilitetit të qeverisë, pagesat e borxhit regjistrohen me të drejta dhe detyrime të konstatuara. Rakordimi i borxhit të brendshëm bëhet çdo muaj, ndërsa borxhi i jashtëm mund të kërkojë deri në dy muaj për t'u rakorduar. Kalimi kohor nga veprimi i livrimit deri në regjistrimin e tij në sistemin informatik të borxhit është deri në një muaj për borxhin e jashtëm dhe deri në dy ditë për borxhin e brendshëm. DPMBP përdor sistemin e analizës financiare të menaxhimit të borxhit për të gjithë borxhin e jashtëm dhe tabela më vete në Excel për menaxhimin e borxhit të brendshëm dhe dorëzantëve. Deri në fund të vitit 2016 borxhi i brendshëm regjistrohej edhe në DMFAS. Evidencat e borxhit janë të sakta dhe të plota.²⁵

Për ta përmbledhur, evidencat e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm dhe borxhit të garantuar janë të plota, të sakta dhe përditësohen çdo tremujor. Shumica (rëndësia materiale sipas vlerës të përkufizuar në Kuadrin PEFA 2016) e informacionit rakordohet çdo tremujor. Çdo tremujor hartohen dhe publikohen raporte të plota të menaxhimit dhe statistikave që mbulojnë shërbimin, stokun dhe operacionet e borxhit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

13.2 Miratimi i borxhit dhe i dorëzantëve

Ky dimension vlerëson masat organizuese për miratimin dhe mbajtjen në kontroll të kontratave që lidh qeveria për kredi dhe të lëshimit të dorëzantëve nga ana e saj, çka ka rëndësi kritike për një performancë të duhur të menaxhimit të borxhit.

Kuadri ligjor për menaxhimin e borxhit të qeverisjes qendrore përfshihet në Kushtetutë, në Ligjin për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë (2006) dhe Ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor (2016). Kushtetuta sqaron se qeverisja qendrore mund të marrë e

25. Kohët e fundit DPMBP e ka përmirësuar sistemin DMFAS 6 dhe ka përfshirë edhe të dhënat për borxhin e brendshëm.

të garantojë hua dhe kredi financiare, por vetëm "kur autorizohet me ligj" (neni 156). Gjithashtu, neni 158 i kërkon Këshillit të Ministrave t'i paraqesë raport Kuvendit lidhur me borxhin shtetëror për vitin e kaluar.

Ligji për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë i jep autorizim të qartë Ministrit të Financave të marrë hua dhe japë garanci në emër të qeverisë. Ministrit i lejohej edhe të riblejë borxhin dhe të lidhë kontrata derivative, me kusht që të jenë në përputhje me strategjinë për menaxhimin e borxhit. Neni 9 i ligjit e kufizon huamarrjen shtetërore brenda qëllimeve specifike, kërkon raportim vjetor në Kuvend (si pjesë e raportit të madh për zbatimin e buxhetit, ku të përfshihet një përshkrim i transaksioneve të menaxhimit të borxhit gjatë vitit dhe si kanë ndikuar këto te kostoja dhe risku i portofolit të borxhit gjithsej) dhe përgatitjen vjetore të një strategjie afatmesme të menaxhimit të borxhit e cila duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor thotë se huaja dhe garancia e huasë duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Kur projektbuxheti vjetor i paraqitet Kuvendit, ministri përfshin një pasqyrë për pasivet e kushtëzuara. Ligji vendos edhe një rregull të re fiskale, sipas së cilës çdo vit, raporti borxh/PBB nuk mund të jetë më i madh se raporti borxh/PBB i vitit të mëparshëm derisa raporti borxh/PBB të arrijë 45 për qind.

Huamarrja shtetërore dhe veprimet e lidhura me borxhin menaxhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Borxhit Publik pranë Ministrisë së Financave, drejtuar nga një drejtor i përgjithshëm i cili raporton te Zëvendësministri i Financave. DPMBP funksionon si subjekt parësor i menaxhimit të borxhit dhe si subjekt parësor i dorëzanive të Qeverisë së Shqipërisë. Ndër përgjegjësitë e saj janë menaxhimi i borxhit të brendshëm dhe të jashtëm të qeverisjes qendrore, përgatitja vjetore e strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit, përgatitja e raportit vjetor të menaxhimit të borxhit për Kuvendin, monitorimi dhe miratimi i huamarrjes së qeverisjes vendore, lëshimi i dorëzanive të kredisë dhe nëndhënia hua e fondeve të marra hua. Është e organizuar në dy drejtori, secila e drejtuar nga një drejtor. Këto janë Drejtoria e Huamarrjes dhe Drejtoria e Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit. Përgatitja e garancive të kredive dhe e huadhënies më tej të fondeve të marra hua dhe monitorimi dhe miratimi i huamarrjes së qeverisjes vendore menaxhohen nga sektori përkatës i Drejtorisë së Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit. Zyrtarisht, Ministri miraton të gjitha huamarrjet, të cilat orientohen nga strategjia afatmesme e menaxhimit të borxhit, e miratuar nga Këshilli i Ministrave. DPMBP harton një raport vjetor për borxhin publik dhe përbërjen e tij, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe i paraqitet Kuvendit si pjesë e raportit të zbatimit të buxhetit vjetor të konsoliduar.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

13.3 Strategjia e menaxhimit të borxhit

Ky dimension vlerëson nëse qeveria ka hartuar një strategji të menaxhimit të borxhit (SMB) me objektivin afatgjatë të marrjes së borxhit brenda ekuilibrave solid kosto-risk. Një strategji e tillë duhet të mbulojë të paktën periudhë afatmesme (tre deri në pesë vjet) dhe të përfshijë një përshkrim të përbërjes dhe zhvillimit në kohë të portofolit ekzistues të borxhit.

Vlerësimi mbulon strategjitë afatmesme të borxhit për periudhën 2016-2018.

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMMB) për Shqipërinë përditësohet dhe publikohet nga Ministria e Financave çdo vit. Për të tri strategjitë e njëpasnjëshme, ka pasur vijimësi të objektivave të njëjtë të përgjithshëm për menaxhimin e borxhit, që janë:

1. Sigurimi i realizimit të nevojave të Qeverisë për financim, si edhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët dhe duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj rrezikut;
2. Zhvillimi i tregut primar dhe tregut sekondar të titujve shtetërorë vendas.

SAMMB i merr supozimet nga kuadri makrofiskal i miratuar nga Kuvendi çdo vit për tre vitet e ardhshme, duke qenë në përputhje me këtë kuadër si edhe me politikën monetare të zbatuar nga Banka e Shqipërisë në periudhën afatmesme. SAMMB e fundit është miratuar nga Këshilli i Ministrave në prill 2016 dhe është pjesë e procesit vjetor të përgatitjes së buxhetit.

Objekti i SAMMB-së është borxhi i qeverisjes qendrore, i cili përfshin borxhin shtetëror dhe borxhin e garantuar shtetëror. Qëllimi i SAMMB-së është ta orientojë huamarrjen drejt instrumenteve me kosto të favorshme në varësi të niveleve të pranueshme të ekspozimit të riskut për nivele të caktuara të financimit. Nivelet e financimit përcaktohen në kuadrin makrofiskal dhe në PBA, që ndahet në plane vjetore të huamarrjes. Strategjia e financimit në SAMMB është në përputhje me planin e huamarrjes që përcakton financimin e brendshëm dhe të jashtëm në llogaritë fiskale të konsoliduara të cilat i paraqiten Kuvendit në kuadër të ligjit të buxhetit vjetor.

SAMMB përfshin një përshkrim të përbërjes dhe zhvillimit në pesë vitet e fundit të portofolit të borxhit ekzistues (2010-2015). SAMMB shqyrton risqet e tregut që menaxhohen—përfshirë riskun e normave të interesit, riskun e kursit të këmbimit, riskun e rirfinancimit, riskun e likuiditetit—dhe përdor supozimet e kuadrit të miratuar makrofiskal për parashikimet fiskale dhe të borxhit.

SAMMB jep objektivat strategjike lidhur me kuantifikimin e synimeve për treguesit kryesorë të riskut që duhen arritur në vitin 2018, sipas tabelës 3.13 më poshtë:

TABELA 3.13 Objektivat e treguesve kryesorë të riskut

Lloji i riskut	Treguesi i riskut	Treguesi 2015	Objektivi* (Fund 2018)
Risku i rirfinancimit	KMM Borxhi Brendshëm	2,0 vite	Min. 2,2 vite
	KMM Borxhi Total	4,9 vite	Min. 4,7 vite
	Borxhi brendshëm i maturuar në 1 vit (% të totalit)	55,9%	Maks. 46,0%
Risku i normave të interesit	KMR Borxhi Brendshëm	1,8	Min. 2,0
	KMR Borxhi Total	3,2	Min. 3,0
	Borxhi i brendshëm i rivlerësuar brenda 1 viti (% të totalit)	67,7%	Maks. 60,0%
	Borxhi total i rivlerësuar brenda 1 viti (% të totalit)	58,1%	Maks. 55,0%
Risku i kursit të këmbimit	Borxhi në monedhë të huaj (% të totalit)	48,5%	50,0%-55,0%

Burimi: Ministria e Financave

Raportimi vjetor për menaxhimin e borxhit kundrejt objektivave strategjike të vendosur në SAMMB është pjesë e paketës së buxhetit të vitit e cila i paraqitet Kuvendit në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm. Relacioni shoqëruar i projektbuxhetit të vitit 2017 përmbante një kapitull për menaxhimin e borxhit në 2016 dhe vlerësoi se qenë përmbushur të gjitha objektivat strategjike të SAMMB-së. Në të përshkruhej edhe strategjia e financimit për vitin 2017.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.



3.4 SHTYLLA IV: Strategjia fiskale dhe përgatitja e buxhetit në bazë të politikave

TP-14. Parashikimi makroekonomik dhe fiskal

Ky tregues mat aftësinë që ka vendi për të zhvilluar parashikime solide makroekonomike dhe fiskale, të cilat janë me rëndësi kritike për hartimin e një strategjie fiskale të qëndrueshme dhe për të siguruar një parashikueshmëri më të madhe të fondeve të miratuara në buxhet. Treguesi vlerëson edhe kapacitetin e qeverisë për të bërë çmuarje të efektit fiskal që kanë ndryshimet e mundshme të rrethanave ekonomike. Përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- *Dimensioi 14.1: Parashikimet makroekonomike (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015, 2016, mbulimi - e gjithë ekonomia);*
- *Dimensioi 14.2: Parashikimet fiskale (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015, 2016, mbulimi - QQ);*
- *Dimensioi 14.3: Analiza e ndjeshmërisë makrofiskale (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015, 2016, mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioi	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-14. Parashikimi makroekonomik dhe fiskal	Vlerësimi i përgjithshëm A	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
14.1 Parashikimet makroekonomike	Vlerësimi i dimensionit A	Qeveria përgatit parashikime të treguesve kyç makroekonomikë, të cilët, së bashku me supozimet bazë, përfshihen në dokumentacionin e buxhetit që i paraqitet legjislativit. Këto parashikime përditësohen të paktën një herë në vit zakonisht të formalizuara me një akt normativ të miratuar në mes të vitit. Parashikimet mbulojnë vitin e buxhetit dhe dy vitet e ardhshme fiskale. Parashikimet janë shqyrtuar nga FMN në kuadër të mbështetjes buxhetore që ka dhënë FMN për periudhën 2014-2017.
14.2 Parashikimet fiskale	Vlerësimi i dimensionit B	Qeveria përgatit parashikime të treguesve kryesorë fiskalë, përfshirë të ardhurat sipas llojit, shpenzimet sipas llojit dhe bilancin e buxhetit për vitin e buxhetit dhe dy vitet e ardhshme fiskale. Këto parashikime, së bashku me supozimet bazë përfshihen në kuadrin makrofiskal që miratohet me VKM dhe në shtojcat e projektbuxhetit që i paraqitet legjislativit dhe miratohen nga Kuvendi.
14.3 Analiza e ndjeshmërisë makrofiskale	Vlerësimi i dimensionit A	Qeveria përgatit një varg skenarësh të parashikimeve fiskale në bazë të supozimeve alternative makroekonomike dhe këta skenarë publikohen, së bashku me parashikimin qendror si pjesë e programit të qeverisë për reformat ekonomike.

14.1 Parashikimet makroekonomike

Ky dimension vlerëson se sa përgatiten parashikime të gjithanshme afatmesme makroekonomike dhe supozime mbi të cilat mbështeten këto, që të shërbejnë si bazë informimi për proceset e planifikimit fiskal dhe buxhetor, dhe sa i paraqiten legjislativit si pjesë e procesit të buxhetit vjetor.

Parashikimet makroekonomike për një periudhë trevjeçare që mbulojnë vitin buxhetor dhe dy vitet e ardhshme fiskale bëhen çdo vit dhe përditësohen të paktën një herë gjatë vitit. Njësia së cilës i është ngarkuar parashikimi makroekonomik është Drejtoria Makroekonomike pranë Ministrisë së Financave. Parashikimet makroekonomike përfshijnë treguesit kryesorë ekonomikë, siç paraqitet në tabelën 3.11 më poshtë, dhe i paraqiten Kuvendit së bashku me paketën e buxhetit vjetor. Krahas parashikimeve, shtojca e projektbuxhetit që i paraqitet Kuvendit përmban parametrat kryesorë ekonomikë dhe hipotozeta/supozimet bazë të përdorura në parashikime në një mënyrë të shprehur dhe përcaktuar qartë. Për vitet e periudhës së vlerësimit, 2014-2016, Shqipëria ka qenë objekt i një programi të FMN-së, që do të thotë se parashikimet makroekonomike janë shqyrtuar dhe miratuar me FMN-në. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", thotë që parashikimi i PBB-së nuk mund të jetë më i lartë se vlera e parashikuar në raportin "Perspektiva ekonomike botërore" të Fondit Monetar Ndërkombëtar, kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend.

Kuadri makroekonomik rishikohet nga MF në lidhje me paraqitjen e çmuarjeve shtesë në mes të vitit, të publikuara në faqen në internet të MF-së dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Ky proces siguron të dhënat mbi të cilat mbështetet paraqitja e projektaktit normativ të buxhetit në Kuvend në mes të vitit ose përpara mbylljes së vitit.

TABELA 3.14 Parashikimet makroekonomike për buxhetin e vitit 2016

Treguesit	Njësia	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
				vler.	vler.	para.	para.	para.
Popullsia	milion	2,90	2,90	2,89	2,89	2,89	2,90	2,91
Inflacioni (mesatar)	%	2,0	1,9	1,6	2,5	2,8	3,0	3,0
Deflatori i PBB-së	%	1,0	0,3	1,4	2,5	2,8	3,0	3,0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	108,2	105,7	105,5	119,5	119,5	119,5	119,5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	139,0	140,3	140,0	141,0	141,0	141,0	141,0
Faktori i konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP)	Lek / USD	44,4	44,8	45,5	45,5	45,5	45,5	45,5
Rritja reale e PBB-së	%	1,4	1,0	2,1	3,0	4,0	4,5	4,5
PBB	miliard lekë	1.332,8	1.350,1	1.413,9	1.492,0	1.596,0	1.717,9	1.848,9
PBB	miliard USD	12,3	12,8	13,4	12,5	13,4	14,4	15,5
PBB	miliard euro	9,6	9,6	10,1	10,6	11,3	12,2	13,1
PBB për frymë	mijë lekë	459,6	466,1	481,9	496,9	519,3	550,3	586,3
PBB për frymë	USD	4.247,9	4.410,1	4.568,6	3.945,2	4.122,8	4.369,1	4.654,4
PBB për frymë	euro	3.306,6	3.322,7	3.442,7	3.556,2	3.763,2	3.988,0	4.248,3
PBB për frymë	USD-PPP	10.361,4	10.357,4	10.740,9	11.277,5	12.003,4	12.856,5	13.767,4

Treguesit	Njësia	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
				vler.	vler.	para.	para.	para.
Papunësia	%	14,1	17,1	17,3	16,4	15,3	13,9	12,4
Të ardhurat totale	% e PBB-së	24,7	24	26	27,8	27,8	27,9	27,9
Shpenzimet totale	% e PBB-së	28,2	28,9	32,3	31,7	30,3	29,2	28,5
Deficiti i përgjithshëm	% e PBB-së	-3,4	-4,9	-6,3	-3,9	-2,6	-1,3	-1
Bilanci primar	% e PBB-së	-0,3	-1,7	-3,4	-0,6	0,6	1,7	2
Bilanci korrent fiskal	% e PBB-së	1,2	-0,1	0,9	2	3	4	4,6
Huamarrja neto	% e PBB-së	3,5	4,1	6,2	3,8	2,6	1,3	1
Borxhi publik total	% e PBB-së	62,1	70,1	72	71,8	68,9	65,7	62,1
Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme	% e PBB-së	58,1	61,1	65,2	65,6	63,8	60,6	57,3
Borxhi publik jashtë treguesve fiskalë	% e PBB-së	4	9	6,9	6,2	5,1	5,1	4,8
Bilanci i llogarisë korrente	% e PBB-së	-10,2	-10,6	-11,9	-11,8	-12,4	-12,5	-12,3
Bilanci tregtar (ma & shë)	% e PBB-së	-18,6	-17,8	-18,3	-18	-18	-17,5	-16,7
Mallra	% e PBB-së	-20,8	-17,7	-19,7	-20,2	-20,2	-19,8	-18,9
Eksporte	% e PBB-së	15,9	18	17,1	17,7	18	18,3	18,8
Importe	% e PBB-së	-36,7	-35,7	-36,7	-37,9	-38,2	-38,1	-37,7
Bilanci i pagesave	% e PBB-së	0,8	1,1	2,2	2,1	2,1	2,2	1,9

Burimi: Ministria e Financave: Kuadri makro-fiskal, miratuar me VKM nr.68, datë 28.01.2015.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

14.2 Parashikimi fiskal

Ky dimension vlerëson nëse qeveria ka përgatitur një parashikim fiskal për vitin e buxhetit dhe dy vitet e ardhshme fiskale në bazë të parashikimeve të përditësuara makroekonomike dhe që reflekton vendimet e politikave të miratuara nga qeveria për shpenzimet dhe të ardhurat.

Në bazë të kuadrit të miratuar makro-fiskal, Drejtoria e Politikave Fiskale pranë Ministrisë së Financave përgatit parashikimet për të ardhurat. Përdoren dy qasje kryesore: i. qasja nga lart-poshtë, e cila shikon parametrat makroekonomikë, si rritja, inflacioni, elasticitetet e ndryshme tatimore, importet etj., dhe ii. qasja nga poshtë-lart, e cila parashikon çdo lloj të ardhurash nëpërmjet modeleve të thjeshta të serive kohore. Këtyre parashikimeve u shtohen efektet e politikave të reja, të cilat identifikohen qartë vetëm në relacionin e projektbuxhetit e vitit të ardhshëm (efektet për dy vitet e tjera supozohen si të pandryshueshme por nuk shpjegohen). Relacioni i projektbuxhetit që i paraqitet legjislativit përmban informacion edhe për realizimin e të ardhurave të vitit ushtrimor dhe pritjet për ecurinë në të ardhmen. Parashikimet e përditësuara për të ardhurat paraqiten sipas llojit të të ardhurave dhe identifikojnë qartë supozimet ku bazohen, si normat, mbulimi dhe rritja e parashikuar.

Çmuarjet e përditësuara për shpenzimet përgatiten nga Drejtoria e Buxhetit e Ministrisë së Financave. Këto çmuarje të shpenzimeve mbështeten në kuadrin e përditësuar makro-fiskal të miratuar me VKM dhe marrin në konsideratë çmuarjet e pas-vitit të buxhetit për buxhetin e miratuar të fundit, të

korrigjuara me efektin buxhetor dhe afatmesëm fiskal të çdo vendimi për politikat e shpenzimeve pas buxhetit. Dallimet midis parashikimit përfundimtar fiskal të miratuar dhe parashikimeve të përfshira në buxhetin e miratuar të vitit të mëparshëm nuk identifikohen, shpjegohen dhe publikohen më vete si pjesë e procesit të buxhetit vjetor.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

14.3 Analiza e ndjeshmërisë makrofiskale

Ky dimension vlerëson kapacitetin e qeverive për të hartuar dhe publikuar skenarë fiskalë alternativë në bazë të ndryshimeve të papritura por realiste të kushteve makroekonomike apo faktorëve të tjerë të jashtëm të riskut që kanë efekt te të ardhurat, shpenzimet dhe borxhi.

Aktualisht, Ministria e Financave nuk paraqet një analizë të ndjeshmërisë makrofiskale apo analizë të qëndrueshmërisë së borxhit kur paketa e buxhetit vjetor i paraqitet Kuvendit. Kjo analizë nuk paraqitet si pjesë e miratimit të kuadrit makrofiskal (KFAM).

Programi i Reformave Ekonomike (PRE) 2017-2019 përmban një kapitull më vete (Kapitulli 3.6) ku diskutohen dy skenarë alternativë për analizën e ndjeshmërisë dhe rrjedhojat e pritura për kuadrin fiskal si edhe rregullimet e mundshme të politikave fiskale. Secili prej skenarëve alternativë supozon që realizohen një grup rreziqesh negativë (në rast të një skenari "pesimist") ose pozitivë (në rastin "optimist"). Ky grup i rreziqeve supozon devijime nga parashikimet përkatëse të skenarit bazë për disa tregues bazë makroekonomikë, duke përfshirë kreditimin në ekonomi, performancën e ekonomisë së eurozonës me efekte të njëpasnjëshme mbi eksportet e mallrave dhe shërbimeve, për dërgesat private nga jashtë, në qarkullimin e kapitalit të huaj si dhe kursit të këmbimit, masat e ndikimeve gjithëpërfshirëse dhe ritmin e politikave të planifikuara të reformave strukturore për periudhën afatmesme dhe në vazhdim. Efekti i përgjithshëm neto i të gjitha rreziqeve të supozuara, negative ose pozitive, përcaktohet dhe prezantohet në termat e një ndryshoreje të vetme të rritjes reale ekonomike. Pra, skenarët alternativë bazohen në supozime të ndryshme të rritjes ekonomike nga skenari bazë për secilin vit të PRE-së.


Këta dy skenarë makroekonomikë alternativë nënkuptojnë rezultate të ndryshme për të ardhurat fiskale për shkak të një norme nominale më të ulët të PBB-së dhe elasticiteti më të ulët tatimor në skenarin bazë, në rastin e skenarit pesimist. Në bazë të këtyre hartohen dhe paraqiten trajektore (rezultate) për të ardhurat, deficitin publik dhe borxhin. Zërat kryesorë të shpenzimeve që planifikohen të absorbojnë shumicën e pasojave fiskale në rast të çdo skenari alternativ janë "kontigjencat" e përfshira në skenarin bazë dhe "shpenzimet kapitale me financim të brendshëm". Nevojat më të larta për financim të deficitit në rastin e një skenari "pesimist" pritet të mbulohen me rritje të huamarrjes së brendshme. Një analizë e ngjashme është bërë në dy PRE-të e mëparshme.

TABELA 3.15 Skenarët makroekonomikë dhe fiskalë alternativë në PRE

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
						Par.	Par.	Par.	Par.	Par.
Rritja reale e PBB (%)										
Bazë	3,7	2,5	1,4	1,0	1,8	2,6	3,4	3,8	4,1	4,2
Pesimist								2,3	2,6	2,7
Optimist								4,8	5,1	5,2
PBB nominal (në miliard Lek)										
Bazë	1.240	1.301	1.333	1.350	1.394	1.435	1.502	1.596	1.707	1.833
Pesimist							0	1.573	1.659	1.755
Optimist							0	1.612	1.740	1.886
Të ardhurat (% të PBB)										
Bazë	26,2	25,4	24,8	24,2	26,3	26,4	27,6	27,3	27,3	27,3
Pesimist						26,4	27,1	26,8	26,8	26,8
Optimist						26,4	27,6	27,3	27,3	27,3
Defiçiti fiskal (në miliard Lek)										
Shënim: Deficiti i përgjithshëm fiskal në terma nominale për çdo skenar alternativ targetohet të jetë më tepër (më pak) në rastin e skenarit pesimist (optimist) se deficiti nominal i skenarit bazë me diferencë në 50% të të ardhurave totale ndërmjet skenarit bazë dhe skenarëve të tjerë alternativ										
Bazë	-38,0	-45,8	-45,9	-66,9	-72,1	-58,2	-35,7	-31,2	-30,9	-17,5
Pesimist							-35,7	-38,3	-41,7	-32,6
Optimist							-35,7	-29,1	-26,4	-10,3

Burimi: PRE i Shqipërisë 2017-2019.

FIGURA 3.1 Parashikimet e rezultateve fiskale sipas skenarëve alternativë



Burimi: PRE i Shqipërisë 2017-2019.

Krahas parashikimeve fiskale në skenarët makroekonomikë alternativë, PRE përmban një analizë të qëndrueshmërisë së borxhit me parashikime për borxhin në skenarin bazë dhe në skenarë negativë të kursit të këmbimit dhe normave të interesit që paraqiten sipas të njëjtit format me skenarin bazë. Këto dokumente përgatiten çdo vit për periudhën afatmesme në vijim, gjenden publikisht dhe kanë përputhshmëri të plotë me kuadrin makrofiskal.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

TP-15. Strategjia fiskale

Ky tregues bën një analizë të kapacitetit për të hartuar dhe zbatuar një strategji të qartë fiskale. Treguesi mat edhe aftësinë për të përgatitur dhe analizuar efektin fiskal të propozimeve për politikat e të ardhurave dhe shpenzimeve në mbështetje të objektivave fiskalë të qeverisë. Përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve:

- Dimensioni 15.1: Efekti fiskal i propozimeve për politika (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015, 2016, mbulimi - QQ);
- Dimensioni 15.2: Miratimi i strategjisë fiskale (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ);
- Dimensioni 15.3: Raportimi për rezultatet fiskale (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ).

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-15. Strategjia fiskale	Vlerësimi i përgjithshëm A	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
15.1 Efekti fiskal i propozimeve për politika	Vlerësimi i dimensionit B	Qeveria ka përgatitur çmuarje të ndikimit fiskal të çdo ndryshimi të propozuar në politikën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin buxhetor dhe dy vitet e ardhshme gjatë periudhës së vlerësimit 2014-2016. Por efekti i ndryshimeve të politikave lidhur me shpenzimet dhe disa prej të ardhurave nuk është shprehur qartë në projektbuxhetet e paraqitura në Kuvend. Ndryshimet e politikave që janë miratuar pas procesit të buxhetit nuk vlerësohen dhe publikohen me njëtrajtshmëri.
15.2 Miratimi i strategjisë fiskale	Vlerësimi i dimensionit A	Qeveria ka miratuar, ka paraqitur në legjislativ dhe ka publikuar një strategji fiskale korrente e cila përfshin objektiva eksplicitë fiskalë të shprehur me terma sasiorë dhe kohorë së bashku me objektiva cilësorë për vitin 2016 dhe dy vitet e mëpasshme fiskale. Këta objektiva janë përfshirë në kuadrin makrofiskal dhe në shtojcat e Ligjit të Buxhetit të vitit 2016. Shqipëria ka miratuar një rregull fiskale në 2016 e cila është në përputhje me objektivat e përmendur më lart.
15.1 Raportimi për rezultatet fiskale	Vlerësimi i dimensionit A	Si pjesë e relacionit shoqëruar të projektbuxhetit të vitit 2017, Ministria e Financave ka përgatitur një analizë të arritjeve të saj kundrejt objektivave të shprehur fiskalë, me ndryshimet përkatëse të bëra me aktin normativ të muajit dhjetor 2016. Kjo analizë përfshin një shpjegim të faktorëve që kanë çuar në shmangie nga objektivat e miratuar, si mosrealizimi i planit të të ardhurave, vonesat me investimet publike dhe pasojat për objektivat, si edhe masat korrigjuese të propozuara. Raporti përshkruan edhe masat e planifikuara nga qeveria në përgjigje të shmangieve, siç parashikohet në legjisllacion.

15.1 Efekti fiskal i propozimeve për politika

Ky dimension vlerëson kapacitetin e qeverisë për të bërë çmuarje të efektit fiskal të propozimeve për politikat e të ardhurave dhe shpenzimeve të hartuara gjatë përgatitjes së buxhetit.

Periodha e vlerësimit mbulon vitet 2014, 2015 dhe 2016, kohë gjatë së cilës Shqipëria ka qenë pjesë e programit të FMN-së. Pjesëmarrja në një program të FMN-së kërkon që vendi të çmojë efektet projektpolitikave të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin ushtrimor dhe vitet e ardhshme. Në kuadër përgatitjeve të buxhetit vjetor Ministria e Financave ka bërë një vlerësim të hollësishëm të masave fiskale që merren çdo vit për arritjen e objektivit të programit. Pasojat e të gjitha ndryshimeve të politikave janë prezantuar për vitin e ardhshëm (viti T) dhe janë mbështetur në supozimin se nuk do të ndryshonin dy vitet e tjera të ardhshme (T+1 dhe T+2). Për vitet e tjera, efekti nuk paraqitet më vete për çdo zë të ardhurash. Efekti fiskal i të gjitha ndryshimeve të politikave është vlerësuar dhe i është paraqitur Kuvendit si pjesë e relacionit të projektbuxhetit dhe është publikuar. Për ndryshimet që kanë ndodhur pas paraqitjes së buxhetit, si heqja e tatimit të biznesit të vogël në vitin 2016, efekti është vlerësuar brenda institucionit por MF nuk i ka publikuar efektet për vitin e ardhshëm. Këto ndryshime të politikave gjatë periudhës nën shqyrtim kanë qenë të kufizuara.

Për ndryshimet e projekt-politikave të shpenzimeve, ndryshimet madhore lidhur me reforma të tilla si shlyerja e detyrimeve të prapambetura, reforma e decentralizimit, rritja e pagave janë vlerësuar plotësisht sa u takon kostove në buxhet dhe sa u takon çmuarjeve për dy vitet e ardhshme fiskale. Të dhënat e kostove dhe supozimet e propozimeve për politikat të miratuar nga qeveria përfshihen në dokumentacionin e buxhetit që i paraqitet legjislativit dhe publikohen në faqen në internet të Ministrisë së Financave. Paketa e buxhetit vjetor përfshin një zbërthim të shpenzimeve sipas klasifikimit kryesor ekonomik - korrente (sipas kategorive) dhe kapitale - dhe një shpjegim të faktorëve të ndryshueshëm të prekin çmuarjet e kostove, si numri i personelit në administratën publike, përfituesit e asistencës sociale dhe investimet kapitale. Projektbuxheti përfshin efektin fiskal të projekt-politikave lidhur me fondet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (p.sh., rritjet e kontributeve të sigurimeve dhe/ose pagesave), njësitë jashtëbuxhetore dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Si pjesë e paketës së buxhetit vjetor, të gjithë zërat e shpenzimeve kapitale i paraqiten legjislativit si shtojcë e projektbuxhetit. Projektbuxheti i vitit 2015 përmban çmuarje për dy vitet e ardhshme (këto çmuarje jepen për vitin 2016, por janë publikuar në bazë programi dhe jo projekti). Në periudhën 2014-2016 hapësira për investime të reja ka qenë shumë e kufizuar, duke qenë se Shqipëria është përpjekur të stabilizojë borxhin publik dhe hapësira e mundshme për shpenzimet është caktuar për projektet ekzistuese të nënshkruara përpara vitit 2014. Në vitin 2016, vetëm 15 për qind e buxhetit kapital financonte projekte të reja. Për projektet madhore kapitale, propozimet nuk përfshijnë kostot e përvitshme të lidhura me projektet e investimeve kapitale. Në veçanti, mirëmbajtja e rrjetit rrugor kombëtar sistematikisht financohet më pak se nevojat, gjë që cenon qëndrueshmërinë e këtij sektori.

Rrjedhojat e konsiderueshme fiskale të masave të ndërmarrja jashtë procesit buxhetori nuk vlerësohen rregullisht, nuk i paraqiten legjislativit dhe nuk publikohen. Këtu përfshihen vendimet për politikat e shpenzimeve që merren pas miratimit të buxhetit, me efekte në vitet e ardhshme fiskale.

TABELA 3.16 Efekti fiskal i propozimeve për politika të paraqitura gjatë përgatitjes së buxhetit

Ministria	Emri i propozimit	Efekti fiskal (miliard lekë)	Informacioni për të ardhurat/kostot
Propozime për politika të ardhurave			A i paraqesin propozimet shumat gjithsej të të ardhurave që do të mbliidhen për të gjitha vitet buxhetore
MF 2014	Përrjashtim nga TVSH i disa barnave dhe shërbimeve mjekësore	-1 miliard lekë	Supozohet e pandryshueshme si përqindje e PBB-së në vitet e tjera
MF 2014	Heqja e përrjashtimeve nga TVSH për naftën	+1,5 miliard lekë	Supozohet e pandryshueshme si përqindje e PBB-së në vitet e tjera
	Rritja e akcizave për alkoolin dhe duhanin në mënyrë graduale nga 2014 deri në 2017	+3,8 miliard lekë	Po
MF 2014	Rritja e taksës së qarkullimit të automjeteve	+5,6 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2014	Futja e tatimit progresiv	-1,5 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2014	Rritja e tatimit mbi fitimin në 15% nga 10%	+ 7 miliard lekë	Supozohet e pandryshueshme si përqindje e PBB-së në vitet e tjera
MF 2015	Rritja e TAP në burim nga 10% në 15%	+5 miliard lekë	Supozohet e pandryshueshme si përqindje e PBB-së në vitet e tjera
MF 2015	Rritja e taksës së qarkullimit	+6,6 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2015	Rritja e akcizës për duhanin	+0,2 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2015	Ulja e rentës minerare për mineralet e përrpunuara në Shqipëri	-0,045 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2015	Përrjashtim nga taksa e qarkullimit për peshkimin	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
MF 2015	Përrjashtim nga TVSH e primit në sektorin e sigurimeve jo-jetë	-	Nuk është vlerësuar
MF 2015	0 % tatim për importet që shërbejnë si faktorë prodhimi në bujqësi	-0,232 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2015	Përrjashtimi i akcizës për bitumin natyror	-0,015 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2015		-0,33 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2016	Ulja e taksës doganore për gomat e reja të automjeteve	-17 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2016	Ndryshimi i akcizës për birrën	0,7 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2016	Rritja e tatimit mbi primin e sigurimit nga 3% në 10%	0,4 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2016	Zbatimi i rentës minerare mbi sasinë ndërsa më parë zbatohet mbi vlerën	0,4 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
MF 2016	Taksa mbi veturat luksoze	1,1 miliard lekë	Nuk është vlerësuar
Nënshuma	Rritja e kontributeve të sigurimeve për disa profesione		n.a.

Propozime për politika të shpenzimeve			A i paraqesin propozimet kostot e plota (përfshirë kostot korrente të projekteve kapitale) për të gjitha vitet buxhetore
MF 2014	Rritja e pagave në gjyqësor, polici dhe asistencë	0,3 miliard lekë	Projektbuxheti diskuton efektet për vitin 2015, duke theksuar se do të ketë kursime nga shkurtimi i numrit të punonjësve në administratën publike
MF 2014	Reforma e decentralizimit		Nuk trajtohet
	Shlyerja e detyrimeve të prapambetura		Kostot llogaritur plotësisht dhe përfshirë në çmuarjet e buxhetit

Burimi: Relacionet shoqëruese të buxheteve për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

Qeveria përgatit çmuarje të ndikimit fiskal (rëndësia materiale siç përkufizohet nga Kuadri PEFA 2016) të çdo ndryshimi të propozuar në politikën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin buxhetor dhe dy vitet e ardhshme.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

15.2 Miratimi i strategjisë fiskale

Ky dimension vlerëson se sa përgatit qeveria një strategji fiskale ku vendosen objektivat fiskale për të paktën vitin buxhetor dhe dy vitet e ardhshme fiskale.

Periodha që vlerësohet përfshin vitin fiskal 2016.

Gjatë vitit 2016 Shqipëria që në vitin e tretë të programit të financimit me FMN-në. Marrëveshjet për këtë program vendosnin objektiva që duheshin arritur nga qeveria sa i takonte bilancit primar dhe të përgjithshëm dhe borxhit publik. Kuadri afatmesëm fiskal i cili miratohet me VKM vendos objektivat për treguesit e mësipërm që duhen arritur gjatë vitit buxhetor dhe dy viteve të tjera. Në përputhje me kuadrin makrofiskal, ligji i buxhetit vjetor e formalizon objektivin e deficitit dhe vendos rrugën për dy vitet e ardhshme. Kuadri afatmesëm fiskal i është paraqitur legjislativit dhe përmban objektiva numerike konkret për të tre vitet.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

Në vitin 2016, ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor vendos një rregull të re fiskale për vendin, e cila ia lë përcaktimin e objektivave sasiorë për borxhin publik kuadrin makrofiskal dhe procesit të buxhetit vjetor, por nuk lejon rritjen e borxhit publik çdo vit përmes futjes së kontigjencave specifike në kategoritë e shpenzimeve.

15.3 Raportimi për rezultatet fiskale

Ky dimension vlerëson se sa vë qeveria në dispozicion - si pjesë e dokumentacionit të buxhetit që i paraqitet legjislativit - një vlerësim të arritjeve kundrejt objektivave të përcaktuar fiskalë.

Si pjesë e relacionit të projektbuxhetit të vitit 2017, Ministria e Financave ka përgatitur një analizë të arritjeve të saj kundrejt objektivave të shprehur fiskalë, me ndryshimet përkatëse të bëra me aktin normativ të muajit dhjetor 2016. Kjo analizë përfshin një shpjegim të faktorëve që kanë çuar në shmangie nga objektivat e miratuar, si mosrealizimi i planit të të ardhurave, vonesat me investimet publike dhe pasojat për objektivat. Relacioni përshkruan edhe masat e planifikuara nga qeveria në përgjigje të shmangieve, siç parashikohet në legjislacion. Relacioni publikohet së bashku me buxhetin e miratuar në faqen në internet të Ministrisë së Financave. Kjo rubrikë e relacionit të projektbuxhetit përfshin një vlerësim të hollësishëm për çdo kategori të ardhurash dhe shpenzimesh sipas titujve kryesorë të klasifikimit buxhetor.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

TP-16. Perspektiva afatmesme në përgatitjen e buxhetit të shpenzimeve

*Ky tregues shqyrton se deri ku buxhetet e shpenzimeve përgatiten për periudhën afatmesme brenda tavaneve eksplicite afatmesme për shpenzimet buxhetore. Treguesi shqyrton se deri ku buxhetet vjetore derivohen nga çmuarjet afatmesme dhe shkallën e harmonizimit midis çmuarjeve buxhetore afatmesme dhe planeve strategjike. Përmban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.*

- *Dimensioni 16.1: Çmuarjet afatmesme për shpenzimet (Periudha kohore: buxheti i fundit i paraqitur legjislativit, buxheti për vitin 2017, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 16.2: Tavanet afatmesme të shpenzimeve (Periudha kohore: buxheti i fundit i paraqitur legjislativit, buxheti për vitin 2017, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 16.3: Harmonizimi i planeve strategjike dhe buxheteve afatmesme (Periudha kohore: buxheti i fundit i paraqitur legjislativit, buxheti për vitin 2017, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 16.4: Përputhshmëria e buxheteve me çmuarjet e vitit të mëparshëm (Periudha kohore: Buxheti i fundit afatmesëm dhe buxheti aktual afatmesëm).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-16. Perspektiva afatmesme në përgatitjen e buxhetit të shpenzimeve	C+	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
16.1. Çmuarjet afatmesme për shpenzimet	Vlerësimi i dimensionit A	PBA 2017-19 dhe buxheti i vitit 2017 përfshijnë çmuarje të shpenzimeve për vitet 2017, 2018, 2019 të zbërthyer sipas institucioneve, programeve, funksioneve dhe kategorive të përgjithshme ekonomike.
16.2. Tavanet afatmesme të shpenzimeve	Vlerësimi i dimensionit C	Tavanet agregate të shpenzimeve për PBA 2017-19 janë miratuar nga Qeveria në janar, përpara nxjerrjes së qarkores së parë të buxhetit në shkurt. Tavanet e shpenzimeve në nivel ministrie për PBA 2017-19 janë miratuar nga Qeveria në mars, pas nxjerrjes së qarkores së parë të buxhetit në shkurt.
16.3. Harmonizimi i planeve strategjike dhe buxheteve afatmesme	Vlerësimi i dimensionit C	Disa ministri përgatisin plane strategjike afatmesme. Disa propozime për politika të shpenzimeve në çmuarjet e buxhetit vjetor përputhen me planet strategjike.
16.4. Përputhshmëria e buxheteve me çmuarjet e vitit të mëparshëm	Vlerësimi i dimensionit D	Analiza e shmangieve midis çmuarjeve të shpenzimeve të vitit të dytë nga viti i fundit dhe të vitit të parë nga viti ushtrimor bëhet vetëm për qëllime të brendshme dhe nuk përfshihet dokumentacionin e buxhetit.

16.1 Çmuarjet afatmesme për shpenzimet

Dy dimension vlerëson se sa përgatiten dhe përditësohen çmuarjet e buxhetit afatmesëm si pjesë e procesit buxhetor vjetor.

Procesi buxhetor në Shqipëri ka perspektivë afatmesme. Kuadri buxhetor afatmesëm përgatitet dhe shërben si bazë për buxhetin vjetor. Çmuarjet e shpenzimeve për PBA-në mbulojnë vitin e ardhshëm buxhetor dhe dy vitet e tjera fiskale. Çmuarjet zbërthehen sipas institucioneve (klasifikimi administrativ), programeve, funksioneve dhe kategorive të përgjithshme ekonomike (shpenzime personeli, shpenzime të tjera korrente, investime kapitale, përfshirë ato të financuara me burime të brendshme dhe të jashtme). PBA mbulon buxhetin e qeverisjes së përgjithshme, përfshirë buxhetin e shtetit, fondin e sigurimeve shoqërore, fondin e sigurimeve shëndetësore dhe buxhetet vendore. PBA i bashkëlidhet buxhetit vjetor i cili mbulon buxhetin e shtetit dhe buxhetet për fondin e sigurimeve shoqërore dhe fondin e sigurimeve shëndetësore. PBA 2017-2019 dhe buxheti i vitit 2017 ka ndjekur formatin e përshkruar më lart.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

16.2 Tavanet afatmesme të shpenzimeve

Ky dimension vlerëson nëse përdoren tavanet e shpenzimeve për çmuarjet e bëra nga ministritë, në mënyrë që të sigurohet që shpenzimet përtej vitit të buxhetit të jenë në përputhje me politikën fiskale dhe objektivat buxhetore të qeverisë.

Procesi i përgatitjes së kërkesave të buxhetit afatmesëm nga ministritë e linjës mbështetëse në tavanet afatmesme të shpenzimeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Tavanet agregate të shpenzimeve miratohen nga Këshilli i Ministrave së bashku me kuadrin makrofiskal dhe me kalendarin e hollësishëm të përgatitjes së PBA-së. Tavanet zbërthehen më tej sipas ministrive të linjës dhe programeve dhe sipas kategorive të përgjithshme të klasifikimit ekonomik. Sipas Ligjit Organik të Buxhetit, tavanet e

hollësishme paraprake pritet të miratohen nga Këshilli i Ministrave përpara se MF të nxjerrë udhëzimin për përgatitjen e PBA-së në fund të muajit shkurt.

Në vitin 2016, kuadri makrofiskal, së bashku me tavanet agregate, u miratua në janar, ndërsa tavanet paraprake të hollësishme u miratuan nga Qeveria në fund të muajit mars (vendim i Qeverisë datë 30 mars), që erdhi pas shpërndarjes së udhëzimit të përgatitjes së PBA 2017-2019 (nxjerrë nga MF më 29 shkurt). Udhëzimi i PBA-së përmend shprehimisht që tavanet do të dalin më vonë. Tavanet janë qarkulluar me shkresën shtesë të Ministrisë së Financave në fillim të muajit prill, çka ua kufizonte kohën në dispozicion ministrive të linjës për të përgatitur kërkesat e tyre të PBA-së në rreth një muaj (afati për dorëzimin e kërkesave që 2 maj 2016).

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

16.3 Harmonizimi i planeve strategjike dhe buxheteve afatmesme

Ky dimension mat shkallën e harmonizimit të propozimeve të miratuara për politika të shpenzimeve me planet strategjike të ministrive ose strategjitë sektoriale me kosto të llogaritura.

Bashkë me kërkesat e PBA-së, ministrive të linjës u kërkohet të paraqesin informacion për qëllimet, objektivat dhe prioritetet e programeve që zbatojnë. Udhëzimi standard për përgatitjen e PBA-së thotë shprehimisht se kërkesat e PBA-së duhet të vendosin lidhje të drejtpërdrejtë midis fondeve të miratuara në buxhet dhe objektivave të politikave të programeve. Baza e përpilimit të këtij informacion ndryshon nga ministria në ministri.

Shqipëria ka një dokument strategjik të nivelit të lartë (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, SKZHI 2) e cila përfshin prioritetet e politikave ndërsektoriale si edhe prioritetet e politikave për sektorët kyç. Në të shkuarën, vendi ka pasur dokumente të shumta strategjike të cilët shpesh nuk lidheshin me njëri-tjetrin, prandaj edhe u zhvillua qasja e sistemit të planifikimit të integruar (SPI), i cili, mes të tjerash, parashikonte pakësimin e numrit të dokumenteve strategjike. Prandaj, jo çdo ministri ka strategji sektoriale apo ndonjë dokument të barasvlershëm të planifikimit strategjik.

Situata në tri ministrinë të linjës të përzgjedhura si kampion përfaqësues në funksion të vlerësimit PEFA është si vijon:

- Ministria e Arsimit (14 për qind e shpenzimeve publike gjithsej të qeverisjes qendrore) ka një strategji aktuale për arsimin pasuniversitar që mbulon dy programet më të mëdha të zbatuara nga kjo ministri (rreth 80 për qind e buxhetit të sektorit të arsimit që administrohet nga kjo ministri). Strategjia ka një rubrikë të llogaritjes së kostove dhe ka shërbyer si bazë për hartimin e kërkesës për PBA 2017-2019.
- Ministria e Shëndetësisë (11 për qind e shpenzimeve gjithsej) nuk ka një strategji aktuale, strategjia e fundit sektoriale ka përfunduar më 2013, strategjia e re 2016-2020 është ende në version paraprak, dhe ende nuk është miratuar.
- Ministria e Transportit (rreth 7 për qind e shpenzimeve publike gjithsej) ka një strategji sektoriale të miratuar kohët e fundit, e cila ka filluar zbatimin më 2016. Kostot e kësaj strategjie janë shumë të larta dhe i kalojnë ndjeshëm burimet në dispozicion të këtij sektori. Strategjia dhe qasja që është ndjekur për llogaritjen e kostove të saj është diskutuar në mbledhjen e Komitetit të Planifikimit Strategjik në 2016. Aty u mor vendimi që strategjia të miratohej me dy skenarë – skenari bazë që është brenda kufizimeve të burimeve të PBA-së, dhe skenari i dytë (ai optimist) nëse realizohen financime të tjera shtesë. Por versioni që gjendet në faqen në internet të Ministrisë së Transportit përfshin vetëm skenarin optimist.

Të gjitha ministritë e linjës me të cilat janë kryer intervista, nxjerrin vendim në fillim të ciklit të përgatitjes së buxhetit, me të cilin ngrenë grupe pune të brendshme për përgatitjen e propozimeve për PBA-në. Çdo grupi i ngarkohet një program i veçantë. Grupet dalin me propozim-kërkesa për programet që u janë ngarkuar, përfshirë edhe prioritetet e politikave dhe të shpenzimeve publike, të cilat më pas shqyrtohen në një mbledhje të posaçme ministrore dhe në bazë të vendimit të kësaj mbledhjeje konsolidohen në një kërkesë të vetme të PBA-së për të gjithë ministrinë. Pra ka një mekanizëm funksional i cili siguron që kërkesat e PBA-së të pasqyrojnë objektivat dhe prioritetet e programeve sektoriale. Por ky mekanizëm jo gjithmonë e siguron lidhjen midis strategjive ekzistuese sektoriale dhe kërkesave të PBA-së, siç e dëshmon strategjia e sektorit të transportit. Në përgjithësi, plane afatmesme strategjike përgatiten për disa/kampionin përfaqësues (rëndësia materiale sipas vlerës të përkufizuar në Kuadrin PEFA 2016) prej ministrive. Disa (siç dëshmohet nga Ministria e Arsimit - rëndësia materiale sipas vlerës të përkufizuar në Kuadrin PEFA) propozime të politikave të shpenzimeve në çmuarjet e buxhetit të vitit janë në përputhje me planin strategjik.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

16.4 Përputhshmëria e buxheteve me çmuarjet e vitit të mëparshëm

Ky dimension vlerëson shkallën me të cilën çmuarjet e shpenzimeve në buxhetin e fundit afatmesëm përbëjnë bazën për buxhetin aktual afatmesëm. Kjo ndodh nëse çdo luhatje shpenzimesh midis viteve përkuese në secilin buxhet afatmesëm mund të shpjegohet plotësisht dhe të shprehet në terma sasiorë.

Në Shqipëri ndodhin shmangie nga çmuarjet midis viteve, siç e tregon tabela 3.17 më poshtë. Drejtoria e Buxhetit në MF bën një analizë të shmangieve midis çmuarjeve të shpenzimeve të vitit të dytë nga viti i fundit dhe të vitit të parë nga viti ushtrimor, por kjo analizë përdoret vetëm për qëllime të brendshme dhe nuk përfshihet në dokumentacionin e buxhetit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D.

TABELA 3.17 Tavanet e miratuara të PBA-së për disa ministri të përzgjedhura

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës milion lekë					
	Për vitin 2015	Për vitin 2016	Për vitin 2017	Për vitin 2018	Për vitin 2019
PBA 2015-2017	42.335	35.616	30.931		
PBA 2016-2018		35.419	41.579	42.262	
PBA 2017-2019			33.264	35.013	35.065
Ministria e Kulturës milion lekë					
	Për vitin 2015	Për vitin 2016	Për vitin 2017	Për vitin 2018	Për vitin 2019
PBA 2015-2017	1.406	1.424	1.426		
PBA 2016-2018		1.709	1.432	1.498	
PBA 2017-2019			1.654	1.712	1.712

Burimi: Raport për monitorimin e MFP-së (version paraprak), SIGMA, maj 2017.

TP-17. Procesi i përgatitjes së buxhetit

Ky tregues mat efektivitetin e pjesëmarrjes së palëve përkatëse të interesit në procesin e përgatitjes së buxhetit, përfshirë udhëheqjen politike, dhe nëse kjo pjesëmarrje bëhet rregullisht dhe në kohë. Përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve:

- *Dimensioni 17.1: Kalendar i buxhetit (Periudha kohore: buxheti i fundit i paraqitur legjislativ, buxheti për vitin 2017, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 17.2: Udhëzues për përgatitjen e buxhetit (Periudha kohore: buxheti i fundit i paraqitur legjislativ, buxheti për vitin 2017, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 17.3: Paraqitja e buxhetit legjislativ (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015, 2016, mbulimi - QQB).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-17. Procesi i përgatitjes së buxhetit	Vlerësimi i përgjithshëm B	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
17.1 Kalendar i buxhetit	Vlerësimi i dimensionit B	Ekziston një kalendar i qartë i buxhetit, por ndodhin disa shmangie prej tij. Në vitin 2016 njësitë buxhetore kishin rreth një muaj kohë në dispozicion për të përgatitur kërkesat e hollësishme të PBA-së dhe pothuaj po aq kohë për t'i përditësuar në fazën e përgatitjes së kërkesave për buxhetin e vitit.
17.2 Udhëzues për përgatitjen e buxhetit	Vlerësimi i dimensionit B	Paketa e udhëzimeve që përdoret për përgatitjen e PBA-së dhe të buxhetit vjetor është e gjithanshme, mbulon shpenzimet buxhetore gjithsej për vitin e plotë fiskal dhe u jep orientime të qarta njësitë buxhetore. Në vitin 2016, tavanet përfundimtare të shpenzimeve u miratuan nga Këshilli i Ministrave pas nxjerrjes së udhëzimit shtesë për përgatitjen e buxhetit vjetor nga Ministria e Financave, por në kohë të mjaftueshme për afatin e dorëzimit të kërkesave për buxhetin vjetor.
17.3 Paraqitja e buxhetit legjislativ	Vlerësimi i dimensionit C	Buxheti për vitin 2014 i është paraqitur Kuvendit në mes të muajit dhjetor, pra më pak se një muaj përpara fillimit të vitit fiskal, buxhetet për vitet 2015 dhe 2016 iu paraqitën Kuvendit më shumë se një muaj përpara fillimit të vitit fiskal.

17.1 Kalendar i buxhetit

Ky dimension mat nëse ka një kalendar të përcaktuar për buxhetin dhe se sa respektohet ky kalendar.

Ligji Organik i Buxhetit e rregullon procesin buxhetor për të gjitha nivelet e buxhetit publik, përfshirë kalendarin e buxhetit i cili integron të gjitha fazat e planifikimit të buxhetit, përgatitjes së buxhetit, shqyrtimit dhe miratimit të tij. Ligji përcakton hapat kryesorë të procesit të buxhetit dhe muajt kur duhet të kryhen këta hapa. Në disa raste, ligji përcakton data konkrete si afate për hapat përkatës, siç e tregon tabela 3.18 më poshtë.

Ligji Organik i Buxhetit parashikon edhe miratimin e një kalendari të hollësishëm të përgatitjes së buxhetit, nga Këshilli i Ministrave më 1 janar. Në vitin 2016, miratimi i kalendarit u vonua me thujse një muaj (kalendar i hollësishëm i miratua me VKM të datës 27 janar). Ndodhën edhe disa shmangie të tjera nga kalendar. Tavanet paraprake të shpenzimeve nuk mund të qarkulloheshin me udhëzimin e MF-së të

nxjerrë në muajin shkurt për shkak të miratimit me vonesë të tyre nga Këshilli i Ministrave dhe u qarkulluan me një shkresë shtesë të MF-së në fillim të muajit prill. Gjithashtu, sipas kalendarit të hollësishëm, afati për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve që data 8 korrik, ndërsa afati për kërkesat buxhetore vjetore nga ministritë e linjës që data 1 shtator. Data faktike e miratimit të taveve përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2017-2019 nga Këshilli i Ministrave që data 13 korrik, ndërsa tavanet iu komunikuan ministrive të linjës me shkresën shtesë të MF-së brenda një jave pas kësaj date, ndërsa udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit doli nga Ministria e Financave më 8 korrik. Ministritë e linjës me të cilat janë bërë intervista konfirmuan se në vitin 2016 kishin afërsisht një muaj kohë për të përgatitur kërkesat e PBA-së dhe pothuaj po aq kohë për t'i rishikuar këto kërkesa për buxhetin vjetor në bazë të informacioneve për tavanet përfundimtare të miratuara të shpenzimeve. Të gjithë personat e intervistuar konfirmuan se koha e caktuar për përgatitjen e kërkesave të PBA-së dhe buxhetit që e mjaftueshme dhe se nuk kishin probleme me respektimin e kalendarit.

TABELA 3.18 Kalendar i përgatitjes së PBA-së dhe buxhetit në Shqipëri

Hapi	LOB	Kalendar i hollësishëm i përgatitjes së PBA-së dhe buxhetit miratuar me VKM datë 27.01.2016	Datat faktike, 2016
Kalendar i hollësishëm i menaxhimit të shpenzimeve publike miratuar nga Këshilli i Ministrave	brenda datës 1 janar		27 janar
Vlerësimi makroekonomik dhe parashikimi afatmesëm makroekonomik përgatitur nga MF për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave	në janar		21 janar
Udhëzimi vjetor për përgatitjen e PBA-së dhe buxhetit nxirret nga MF	në shkurt		29 shkurt
Tavanet paraprake të shpenzimeve u komunikohen njësisë shpenzuese pas miratimit nga Këshilli i Ministrave	në shkurt (si pjesë e udhëzimit vjetor të MF)		Tavanet paraprake të shpenzimeve janë miratuar nga Këshilli i Ministrave më 30 mars dhe u janë komunikuar ministrive të linjës brenda një jave me shkresë të posaçme të MF-së (letra që i drejtohet Ministrisë së Arsimit mban datën 4 prill)
Vlerësimi dhe parashikimi makroekonomik miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe paraqitur në Kuvend	brenda datës 10 mars		29 shkurt
Ministritë e linjës paraqesin në MF kërkesat e PBA-së		2 maj	2 maj
Ministri i Financave paraqet dokumentin e PBA-së për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave	në qershor		24 qershor
Ministria e Financave dërgon Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së PBA-së dhe Buxhetit përfshirë edhe tavanet e miratuara të PBA-së	brenda datës 10 korrik	8 korrik	Udhëzimi plotësuar është nxjerrë nga MF më 8 korrik. Tavanet e PBA-së janë miratuar nga Këshilli i Ministrave më 13 korrik. Tavanet e miratuara u janë komunikuar njësisë shpenzuese me shkresë shtesë të MF-së brenda javës së ardhshme (letra që i drejtohet Ministrisë së Arsimit mban datën 19 korrik)

Hapi	LOB	Kalendari i hollësishëm i përgatitjes së PBA-së dhe buxhetit miratuar me VKM datë 27.01.2016	Datat faktike, 2016
Njësite shpenzuese paraqesin në MF kërkesat e rishikuara të PBA-së dhe buxhetit	brenda datës 1 shtator	1 shtator	1 shtator
Këshilli i Ministrave miraton projekt-PBA-në dhe projektbuxhetin e rishikuar	brenda datës 25 tetor		25 tetor
Kryeministri paraqet projektbuxhetin në Kuvend	1 nëntor		28 tetor
Kuvendi miraton buxhetin vjetor	31 dhjetor		15 dhjetor

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

17.2 Udhëzues për përgatitjen e buxhetit

Ky dimension vlerëson qartësinë dhe gjithanshmërinë e orientimeve të dhëna nga lart për përgatitjen e kërkesave buxhetore. Dimensioni shqyrton qarkoren ose qarkoret e buxhetit, ose dokumente të tjera të barasvlershme, për të konstatuar nëse jepen orientime të qarta për procesin e përgatitjes së buxhetit, përfshirë edhe vendosjen e tavanëve të shpenzimeve apo kufizimeve të tjera të miratimit të fondeve për ministrinë ose njësitë e tjera buxhetore apo fushat funksionale.

Në Shqipëri përdoret një paketë udhëzimesh për të orientuar procesin e përgatitjes së buxhetit. Rendi i nxjerrjes dhe përdorimit të këtyre udhëzimeve përcaktohet në Ligjin Organik të Buxhetit. Udhëzimi kryesor është Udhëzimi për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit, i nxjerrë më 2012 (dhe i përditësuar në fund të vitit 2016). Ky është një dokument i gjithanshëm ku përcaktohen me hollësi proceset e përgatitjes së PBA-së dhe buxhetit vjetor. Udhëzimi standard plotësohet me dy udhëzime vjetore, udhëzimi për përgatitjen e PBA-së dhe udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit vjetor. Udhëzimi kryesor vjetor për përgatitjen e PBA-së nxirret nga MF në fund të muajit shkurt (data e nxjerrjes në 2016 qe data 29 shkurt). Në të përfshihen informacione specifike për vitin përkatës, përfshirë edhe kalendarin e hollësishëm të buxhetit. Pjesë e tij duhet të jenë edhe tavanet orientuese të shpenzimeve, por në vitin 2016 këto tavanë nuk qenë miratuar ende nga Këshilli i Ministrave (u miratuan më 30 mars dhe u qarkulluan dhe një shkresë shtesë).

Udhëzimi plotësues i qarkulluar në korrik pritet të përmbajë tavanet përfundimtare të shpenzimeve dhe parametra të tjerë të rishikuar për të orientuar ministrinë e linjës në finalizimin e kërkesave të tyre buxhetore. Më 2016, Këshilli i Ministrave i miratoi tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2017-2019 më 13 korrik dhe këto u qarkulluan nga MF me shkresë të posaçme. Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave mban datën 8 korrik.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

17.3 Paraqitja e buxhetit legjislativ

Ky dimension vlerëson respektimin e afateve kohore të paraqitjes së projektbuxhetit legjislativ apo një organi tjetër me këtë mandat, në mënyrë që legjislativi të ketë kohë të mjaftueshme për shqyrtimin dhe që projektbuxheti të mund të miratohet përpara fillimit të vitit fiskal.

Buxhetet për dy vitet e fundit fiskale të përfunduara (2015 dhe 2016) i janë paraqitur Kuvendit më shumë se një muaj përpara fillimit të vitit fiskal. Buxheti për vitin 2014 është paraqitur më vonë, në mes të muajit dhjetor.

Datat e sakta të paraqitjes së projektbuxhetit janë si më poshtë:

- Buxheti i vitit 2014 - 12 dhjetor 2013;
- Buxheti i vitit 2015 - 3 nëntor 2014;
- Buxheti i vitit 2016 - 17 nëntor 2015.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

TP-18. Shqyrtimi i buxheteve nga legjislativi

*Ky tregues vlerëson natyrën dhe shkallën e shqyrtimit që i bën legjislativi buxhetit vjetor. Treguesi shikon se sa legjislativi shqyrton, diskuton dhe miraton buxhetin vjetor, përfshirë edhe se sa janë të vendosura dhe sa respektohen procedurat e legjislativit për këtë shqyrtim. Ai vlerëson edhe ekzistencën e rregullave për ndryshimet që mund t'i bëhen gjatë vitit buxhetit pa miratimin paraprak të legjislativit. Ky tregues përmban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M1 (WL)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve:*

- *Dimensioni 18.1 Objekti i shqyrtimit të buxhetit (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 18.2 Procedura legjislative për shqyrtimin e buxhetit (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 18.3 Koha e miratimit të buxhetit (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015, 2016, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 18.4 Rregullat për ndryshimet e bëra në buxhet nga ekzekutivi (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQB).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-18. Shqyrtimi i buxheteve nga legjislativi	Vlerësimi i përgjithshëm C+	Metoda vlerësimit M1 (WL)
18.1 Objekti i shqyrtimit të buxhetit	Vlerësimi i dimensionit B	Shqyrtimi nga Kuvendi fokusohet te shifrat agregate të buxhetit vjetor dhe të hollësitë e shpenzimeve dhe të ardhurave, jo te parashikimet dhe prioritetet fiskale afatmesme
18.2 Procedura legjislativë për shqyrtimin e buxhetit	Vlerësimi i dimensionit C	Kuvendi ka procedurë të qarta dhe të dokumentuara për shqyrtimin e buxhetit të përfshira në Rregulloren e Brendshme të tij. Masat e brendshme organizative për shqyrtimin e buxhetit janë të zhvilluara mirë dhe u ngarkojnë role specifike komisioneve parlamentare dhe personelit teknik. Mungojnë procedurat e formalizuara të negocimit.
18.3 Koha e miratimit të buxhetit	Vlerësimi i dimensionit A	Buxhetet për vitet 2014, 2015 dhe 2016 janë miratuar përpara fillimit të viteve fiskale përkatëse.
18.4 Rregullat për ndryshimet e bëra në buxhet nga ekzekutivi	Vlerësimi i dimensionit A	Ekzistojnë rregulla të qarta për ndryshimet që mund t'i bëjë buxheti ekzekutivi, të cilat vendosin kufizime mbi shkallën dhe natyrën e ndryshimeve që mund të bëhen pa përfshirjen e Kuvendit, dhe këto rregulla respektohen.

18.1 Objekti i shqyrtimit të buxhetit

Ky dimension vlerëson fushëveprimin e shqyrtimit legjislativ. Një shqyrtim i tillë duhet të mbulojë shqyrtimin e politikave fiskale, parashikimeve afatmesme fiskale dhe prioritetëve afatmesme, si edhe hollësive specifike të çmuarjeve të shpenzimeve dhe të ardhurave. Në disa vende, ky shqyrtim mund të bëhet në dy ose më shumë faza, mundësisht me një hapësirë midis shqyrtimit të aspekteve afatmesme dhe shqyrtimit të hollësive të çmuarjeve për vitin e ardhshëm fiskal.

Roli i Kuvendit në procesin e buxhetit është i vendosur në Ligjin Organik të Buxhetit.

Neni 14 parashikon që Kuvendi miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes qendrore, transfertat e pakushtëzuara për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve të tyre, si dhe burimet e financimit të deficitit buxhetor.

Kuvendi ndjek një qasje shumë të gjithanshme për shqyrtimin e projektbuxhetit të paraqitur nga qeveria. Komisioni për Ekonominë dhe Financat udhëheq procesin e shqyrtimit i cili u paraprin seancave plenare. Ky komision ka kalendarin e shqyrtimit dhe organizon seanca të veçanta për të shqyrtuar politikat fiskale, shpenzimet agregate, të ardhurat dhe deficitin/financimin, si edhe hollësitë e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në seanca marrin pjesë përfaqësuesit e MF-së. Janë marrë procesverbalet e mbledhjeve të shqyrtimit, nga të cilat duket se diskutimet gjatë këtyre seancave janë shumë të gjalla dhe të hapura për publikun. Komisionet sektoriale gjithashtu shqyrtojnë hollësitë e shpenzimeve për sektorët e tyre përkatës, ndërsa komisioni i ligjeve shqyrton në thellësi buxhetet e propozuara për organet e ngritura me ligje të veçanta.

I gjithë Kuvendi e diskuton buxhetin në dy seanca. Fokusi kryesor i Kuvendit është buxheti vjetor. Megjithëse informohet edhe për PBA-në e miratuar, nuk zhvillohet asnjë shqyrtim i hollësishëm i prioritetëve dhe/ose objektivave fiskalë afatmesëm.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

18.2 Procedura legislative për shqyrtimin e buxhetit

Ky dimension vlerëson shkallën me të cilën vendosen dhe respektohen procedura të shqyrtimit. Këtu përfshihet organizimi i konsultimeve publike, organizimi i brendshëm dhe masat e shqyrtimit në komisione, mbështetja teknike dhe procedurat e negocimit.

Procedurat legislative për shqyrtimin e projektbuxheteve dokumentohen në Rregulloren e Brendshme të Kuvendit. Në të përcaktohet roli i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, komisionet e tjera, si edhe rendi i seancave plenare. Në të njëjtin dokument parashikohet që seancat për buxhetin, si në nivel komisioni, ashtu edhe në plenare, të jenë të hapura për publikun. Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka kalendarin e vet për seancat e buxhetit, i cili miratohet për çdo vit. Procedura e brendshme e komisionit ia ngarkon rolin e analizës përgatitore dhe përgatitjen e dokumentacionit për seancat e Komisionit sekretariatit teknik të Komisionit. Sekretariati ka 5 punonjës të rregullt. i gjithë Komisioni kishte në vitin 2016 21 anëtarë, shumë prej të cilëve me aftësi të forta në fushën e buxhetit (p.sh., ish-zyrtarë të lartë të Ministrisë së Financave, përfshirë edhe ish-ministra). Mes detyrave të tjera, sekretariati mban procesverbalin e të gjitha seancave të shqyrtimit të cilat gjenden në arshivën e Kuvendit. Boshllëku në kuadrin ekzistues të shqyrtimit të buxhetit është mungesa e procedurave të formalizuara të negocimit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

18.3 Rregullat për ndryshimet e bëra në buxhet nga ekzekutivi

Ky dimension vlerëson masat organizuese për shqyrtimin e ndryshimeve të bëra në buxhet gjatë vitit të cilat nuk kanë nevojë për miratimin e legjislativit. Ndryshime të tilla përbëjnë një tipar të zakonshëm të proceseve të buxheteve vjetore. Për të shmangur cenimin e besueshmërisë së buxhetit të miratuar, çdo autorizim për shtesa dhe ndryshime që bëhen nga ekzekutivi duhet të respektojë rregulla të përcaktuara qartë.

Buxheti i vitit 2014 u miratua nga Kuvendi ditët e fundit të vitit 2013 dhe u bë publik jo më parë se mesi i muajit janar 2014. Momenti i miratimit të buxhetit u vonua për shkak të zgjedhjeve parlamentare. Buxhetet për vitet 2015 dhe 2016 janë miratuar nga Kuvendi kohë përpara fillimit të viteve fiskale përkatëse.

Datat e sakta të miratimi janë si më poshtë:

- Buxheti i vitit 2014 - 28 dhjetor 2013
- Buxheti i vitit 2015 - 27 nëntor 2014
- Buxheti i vitit 2016 - 17 dhjetor 2015.

Në bazë të dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

18.4 Rregullat për ndryshimet e bëra në buxhet nga ekzekutivi

Ky dimension vlerëson masat organizuese për shqyrtimin e ndryshimeve të bëra në buxhet gjatë vitit të cilat nuk kanë nevojë për miratimin e legjislativit. Ndryshime të tilla përbëjnë një tipar të zakonshëm të proceseve të buxheteve vjetore. Për të shmangur cenimin e besueshmërisë së buxhetit të miratuar, çdo autorizim për shtesa dhe ndryshime që bëhen nga ekzekutivi duhet të respektojë rregulla të përcaktuara qartë.

Neni 44 i Ligjit Organik të Buxhetit përcakton rregullat për ndryshimet e bëra në buxhet gjatë vitit. Këshilli i Ministrave autorizohet të miratojë rishpërndarje të fondeve ndërmjet programeve, brenda së njëjtës njësi të qeverisjes qendrore dhe për njësi të ndryshme të qeverisjes qendrore, pa tejkalluar 10 për qind të totalit të programit të miratuar. Rishpërndarja përtej këtij kufiri kërkon miratimin e Kuvendit.

Rishpërndarjet e fondeve të projekteve të investimeve brenda të njëjtit program të njësisë së qeverisjes qendrore kërkojnë miratim nga Ministri i Financave. Rishpërndarjet ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente brenda të njëjtit program, kërkojnë miratimin e nëpunësit të parë autorizues (Sekretari i Përgjithshëm i MF-së). Rishpërndarjet brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese, miratohen nga nëpunësi autorizues i njësive të qeverisjes qendrore, nga e cila varet njësia shpenzuese. Procedurat për paraqitjen e kërkesave për rishpërndarje përcaktohen në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit dhe respektohen.

Sipastë dhënave të vëna në dispozicion nga MF, në vitin 2016 Këshilli i Ministrave miratoi 6 rishpërndarje midis ministrive të linjës si edhe 30 rishpërndarje nga fondi i rezervave dhe 15 rishpërndarje nga fondi i kontigjencave. Janë miratuar 120 ndryshime në nivel të Ministrisë së Financave. Këto ndryshime janë miratuar me kërkesë të ministrive të linjës dhe përbënin rishpërndarje midis programeve dhe/ose kategorive ekonomike të shpenzimeve. Gjithsej, 35 ministri dhe institucione paraqitën kërkesa të tilla për rishpërndarje, numri i kërkesave shkonte nga 1 deri në 12 për ministri, me 3-4 kërkesa mesatarisht për ministri.

Në bazë të dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.



3.5 SHTYLLA V: Parashikueshmëria dhe kontrolli në zbatimin e buxhetit

TP-19. Administrimi i të ardhurave buxhetore

Ky tregues mbulon administrimin e të gjitha të ardhurave tatimore dhe jotatimore për qeverisjen qendrore. Treguesi vlerëson procedurat e përdorura për mbledhjen dhe monitorimin e të ardhurave të qeverisjes qendrore. Vlerësimi mbështetet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) të cilat janë përgjegjëse për më shumë se 90 për qind mbledhjes së të ardhurave të brendshme. Ky tregues përban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve:

- *Dimensioni 19.1: Të drejtat dhe detyrimet për të ardhurat (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 19.2: Menaxhimi i riskut të të ardhurave (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 19.3: Kontrolli dhe hetimi i të ardhurave (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 19.4: Monitorimi i detyrimeve të prapambetura në të ardhurat (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar-2016, mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-19. Administrimi i të ardhurave buxhetore	C+	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
19.1 Masat për të drejtat dhe detyrimet për të ardhurat	Vlerësimi i dimensionit A	DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për më shumë se 90 për qind të të ardhurave të brendshme, përdorin kanale të shumta për t'u siguruar pagesve lehtësi në të drejtën e marrjes së informacioneve të plota dhe të përditësuara lidhur me fushat kryesore të detyrimeve për të ardhurat dhe për të drejtat, përfshirë, të paktën, proceset dhe procedurat e ankimit.
19.2 Menaxhimi i riskut të ardhurave	Vlerësimi i dimensionit C	DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për më shumë se 90 për qind të të ardhurave të brendshme, përdorin qasje që janë pjesërisht të strukturuar dhe sistematike për të vlerësuar dhe prioritetuar risqet e përmbushjes për disa lloje të ardhurash.
19.3 Kontrolli dhe hetimi i të ardhurave	Vlerësimi i dimensionit C	DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për më shumë se 90 për qind të të ardhurave të brendshme, kryejnë kontrole dhe hetime kundër mashtrimit duke përdorur një plan të përmirësimit të përmbushjes dhe e realizojnë shumicën e kontrolleve dhe hetimeve të planifikuara.
19.4 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura në të ardhurat	Vlerësimi i dimensionit D	Performanca është në nivel më të ulët nga sa e kërkon niveli i vlerësimit C.

19.1 Masat për të drejtat dhe detyrimet për të ardhurat

Ky dimension vlerëson se sa individët dhe ndërmarrjet marrin informacion për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si edhe sa kanë të drejtë të përdorin procedura dhe procese për të paraqitur ankesa.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përdorin kanale të shumta për t'u siguruar paguesve lehtësi në të drejtën e marrjes së informacioneve të plota dhe të përditësuara lidhur me fushat kryesore të detyrimeve për të ardhurat dhe për të drejtat, përfshirë edhe proceset dhe procedurat e ankimit. Faqet në internet të DPT-së (www.tatime.gov.al) dhe të DPD-së (<http://www.dogana.gov.al/#>) përmbajnë informacione të gjithanshme për:

- (i) Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me administrimin e të ardhurave buxhetore – tatime, taksa dhe detyrime doganore, kontributet e sigurimeve shoqërore²⁶ dhe të ardhurat jotatimore (<https://www.tatime.gov.al/c/6/legjislacioni>); (<http://www.dogana.gov.al/c/171/198/legjislacioni-doganor>). Ky informacioni është i përshtatur sipas nevojave të veçanta të segmenteve të paguesve, pra sipas llojit të biznesit, individëve, tatimeve, procedurave doganore, regjimeve, importuesve etj.;
- (ii) të drejtat e paguesve dhe fushat kryesore të detyrimeve (regjistrimi, deklarimi në afat, pagimi i detyrimeve në afat dhe plotësimi dhe deklarimi i saktë i informacioneve në deklarata), përfshirë të drejtën e ankimit <https://www.tatime.gov.al/c/8/42/51/klientet-tatimpaguesit> dhe <http://www.dogana.gov.al/#>; Të drejtat dhe detyrimet e paguesit përmbledhen në kartën e paguesit, që është dokument publik i cili synon të nxisë bashkëpunimin midis autoriteteve fiskale dhe paguesve.
- (iii) Shërbimet e ofruara nga autoritetet tatimore dhe doganore (<https://www.tatime.gov.al/c/7/e-sherbime>), përfshirë deklarimin elektronik që është i detyrueshëm për tatimet kryesore. Jepen disa video YouTube (<https://www.tatime.gov.al/eng/c/8/44/142/declaration>) në faqen në internet për t'u dhënë paguesve orientime hap pas hapi në përgatitjen e deklaratave tatimore dhe kërkesave për rimbursim. Në momentin e regjistrimit, paguesit marrin njoftim elektronik lidhur me detyrimet e tyre për të ardhurat dhe pagesat që duhet të bëjnë për secilin tatim për të cilin regjistrohen. Faqja në internet ka edhe një kalendar tatimor (<https://www.tatime.gov.al/eng/kalendar.php>) ku jepen afatet për fushat kryesore të detyrimeve fiskale.

DPT dhe DPD publikojnë fletëpalosje dhe broshura me informacione për tatimet dhe taksat doganore, të cilat janë informative dhe u japin orientime paguesve. Këto përditësohen nëse ka ndryshime në legjislacion ose në mënyrën me të cilën administrohen tatimet dhe taksat doganore. Për shembull, kohët e fundit drejtoria e akcizave pranë DPD-së përgatiti dhe publikoi manualin për bizneset (<http://www.dogana.gov.al/dokument/1008/broshura-biznesi>), i cili synohet të lexohet nga të gjithë administratorët dhe punonjësit e shitësve me pakicë dhe shumicë të pijeve alkoolike; dhe udhëzime për bizneset dhe prodhuesit e verës dhe rakisë (<http://www.dogana.gov.al/dokument/1009/udhezues-per-biznesin-prodhimvere-raki>). Krahas vënies në dispozicion publikisht në faqet në internet, këto fletëpalosje dhe broshura gjenden edhe të printuara në drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave. Secila drejtori rajonale ofron këshilla në kohën e duhur subjekteve (të cilët paraqiten vetë në to) krahas kopjeve të shtypura të materialeve udhëzuese dhe udhëzimeve të tjera. DPT dhe DPD i plotësojnë këto përpjekje me mjete të tjera komunikimi²⁷, si TV, radio, gazeta, Pyetjet që bëhen më shpesh, prezantime dhe mediat sociale. DPD ka vënë në dispozicion të subjekteve një numër falas të gjelbër nëse kanë nevojë për asistencë dhe nëse duan të ankohen për parregullsi. Nga ana tjetër, DPT, nëpërmjet faqes në internet, ofron "live chat" me subjektet, dhe është në proces të ngritjes së një qendre thirrjesh për të ofruar shërbime novatore për bizneset dhe qytetarët.

26. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbledhen nga DPT, si agjent për institutet përkatëse të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Administrimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, i vlerësuar nga ky tregues, bëhet nga DPT

27. Për shembull, DPT ka organizuar një fushatë publike për tatimin e biznesit të vogël dhe tatimin mbi të ardhurat personale

Informacionet që u jepen subjekteve përmes kanaleve të shumta janë falas dhe të përditësuara. Ka procedura të dokumentuara për të siguruar përditësim të rregullt dhe sistematik të informacioneve. Sipas Urdhrit Nr.35, neni 11, nxjerrë nga MF, faqja në internet duhet të përditësohet të paktën çdo të premte në fund të muajit dhe duket se këto procedura respektohen vazhdimisht në praktikë. Në përgjithësi, informacioni në faqen në internet është aktual sa u takon ligjeve dhe procedurave administrative dhe ndryshimet evidentohen me një ngjyrë tjetër në mënyrë që të identifikohen me lehtësi nga subjektet. Subjektet vihen në dijeni të ndryshimeve të ligjeve dhe procedurave administrative që i prekin dhe zakonisht njoftohen paraprakisht për datën e hyrjes në fuqi, siç janë ndryshimet në Ligjin e TVSH-së dhe deklarin elektronik.

Ekipi u takua me përfaqësues të Shoqatës së Investitorëve të Huaj të Shqipërisë (FIAA). Diskutimi për çështjet fiskale nxori në pah se nuk ka shqetësime me rëndësi materiale nga komuniteti i biznesit sa i takon informacionit të vënë në dispozicion për sistemin e administrimit të të ardhurave fiskale dhe mënyrën si funksionon, përfshirë edhe sistemin e ankimit. DPT dhe DPD²⁸ kanë qenë shumë aktive në rritjen e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit. Megjithëse i njohin këto përpjekje, përfaqësuesit e sektorit privat bënë të ditur se do të donin të shihnin më shumë përpjekje nga autoritetet fiskale për t'u konsultuar me komunitetin e biznesit për të gjitha legjislacionet e rëndësishme, siç janë ndryshimet në ligjin për profesionistët e lirë të cilat u dërguan drejt e në Kuvend pa konsultime me komunitetin e biznesit; marrja e informacioneve të përditësuara dhe të përshtatura lidhur me procedura specifike dhe çështje më të ndërlikuara tatimore.

DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për më shumë se 90 për qind të të ardhurave të brendshme, përdorin kanale të shumta për t'u siguruar pagesve lehtësi në të drejtën e marrjes së informacioneve të plota dhe të përditësuara lidhur me fushat kryesore të detyrimeve për të ardhurat dhe për të drejtat, përfshirë, të paktën, proceset dhe procedurat e ankimit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

19.2 Menaxhimi i riskut të ardhurave

Ky dimension vlerëson se sa përdoret një qasje e gjithanshme, e strukturuar dhe sistematike brenda administratave të të ardhurave fiskale për të vlerësuar dhe priorizuar riskun e përmbushjes.

Secili subjekt ka një numër unik identifikues të personit të tatueshëm (NIPT). Përpara se të mund të regjistrohet subjekti, i caktohet një NIPT i verifikuar. Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) kryen të gjitha aktivitetet e regjistrimit për thujse të gjitha bizneset (<http://www.qkr.gov.al/information-on-procedure/business-registration/>), por një përqindje e vogël, siç janë organizatat dhe institucionet shtetërore dhe sindikatat, regjistrohen drejtpërdrejt nga DPT. QKB ia transmeton bazën e të dhënave të regjistrimit DPT-së në mënyrë elektronike dhe në kohë reale. Që subjekti të importojë, i duhet një NIPT dhe duhet të regjistrohet në sistemin "Asycuda World". DPT ka raportuar se informacionet që ka baza e të dhënave, sidomos kodet ekonomike, janë shpesh të pasakta. Kodet e sakta janë me rëndësi kritike për të siguruar një menaxhim efektiv të risqeve të përmbushjes. DPT po merr masa për ta përmirësuar saktësinë e informacioneve që ka baza e të dhënave të regjistrimit; megjithatë këto përpjekje kufizohen nga mungesa e të drejtës ligjore për ta korigjuar bazën e të dhënave të regjistrimit të QKB-së.

Importuesit janë objekt i shtresëzimit sipas kriterëve të vlerësimit të riskut. Prej vitit 2006, DPD përdor sistemin Asycuda World. DPD ka ngritur Komisionin e Menaxhimit të Riskut (KMR)²⁹ dhe Drejtorinë për Analizën dhe Monitorimin e Riskut (DAMR). Qasja për menaxhimin e riskut mbulon të gjitha kategoritë e të ardhurave dhe orientohet nga Manuali udhëzues për menaxhimin e riskut dhe kontrollin mbështetur te

28. Për shembull, DPD ka aktualisht dy marrëveshje me Kofindustria dhe Philip Morris

29. Sipas Urdhrit datë 08.09.2016 "Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Menaxhimit të Riskut"

analiza e riskut. Importuesit janë objekt i shtresëzimit sipas kriterëve të vlerësimit të riskut (lloji i importeve, vendndodhja e furnizimit, historiku i importuesit etj.) dhe ndahen në: i. Kanali jeshil (nuk bëhet kontroll); ii. Kanali blu (kontroll pas zhdoganimit); iii. Kanali i verdhë (kontroll shkresor); iv. Kanali rozë (kontroll pa ndërhyrje) dhe v. Kanali i kuq (kontroll shkresor dhe kontroll fizik). Importuesit mund të përzgjidhen në mënyrë rastësore edhe për kontroll të një niveli më të lartë. Kjo qasje për menaxhimin e riskut bën edhe përditësim të profileve të risqeve të importuesve nga një kanal në një tjetër në bazë të ecurisë së përmbushjes nga ana e tyre. DPD ka futur monitorimin online të magazinave doganore dhe proceset e zhdoganimit e kanë aktualisht nivelin e ndërhyrjes fizike në rreth 10 për qind.

DPD ka arritur progres në rifokusimin e ndërhyrjeve të përmbushjes në segmente me vlerë të lartë dhe risk të lartë në zbatimin e kornizave moderne të menaxhimit të riskut të përmbushjes. Janë organizuar të paktën një herë në vit takime dypalëshe me autoritetet doganore të vendeve fqinje, me fokusin te ndarja e informatave operative në kohë reale. DPD përdor sistemin e shkëmbimit të të dhënave SEED i cili mundëson verifikimin e deklaramit të të dhënave doganore si vlera, origjina, kodi tarifor etj., në momentin e mbërritjes së mallrave. DPD ka prokuruar edhe "sistemin e pullave fiskale" në përputhje me një "sistem ndërkombëtar ndiq dhe gjurmo" (SICPATRACE), i cili është lidhur me një bazë të dhënash. Janë vendosur edhe procedura doganore për ta lidhur bazën e të dhënave me të dhënat për importimin doganor sipas importuesve të produkteve të duhanit.

Siç nënvizohet nga vlerësimi i Mjetit të Vlerësimit Diagnostikues për Administratat Tatimore (TADAT), DPT nuk e ka vënë ende plotësisht në zbatim një proces të strukturuar dhe sistematik të vlerësimit të riskut për vlerësimin, renditjen dhe shprehjen sasiore të risqeve të përmbushjes së tatimpaguesve. Në janar 2015, DPT, me mbështetjen e FMN-së, vuri në zbatim një sistem të ri informatik. Ka një Drejtor të Menaxhimit të Riskut (DMR) dhe një Komitet të nivelit të lartë për Menaxhimin e Riskut të Përmbushjes (MRP). DPT ka hartuar një strategji të MRP-së me synim vënie në zbatim të praktikave të mira ndërkombëtare lidhur me menaxhimin modern të risqeve. Krahas kësaj është përgatitur edhe një plan operacional i MRP-së për vitin 2017.

Hë për hë, risku i përmbushjes vlerësohet automatikisht përmes sistemit informatik dhe kriteret e riskut do të përfitonin nga një informacion më i gjithanshëm nga burime të brendshme dhe të jashtme. Sistemi informatik është instrumenti kryesor për përzgjedhjen e rasteve të kontrollit tatimor dhe ky sistem ka ndihmuar në identifikimin e sektorëve ekonomikë me risqe të larta të përmbushjes.³⁰ Sistemi analizon një gamë të gjerë të dhënash të tatimpaguesve nga burime të brendshme. Edhe pse DPT bashkëpunon me DPD-në në shkëmbimin e informacioneve mbi subjektet, ka një shkëmbim të kufizuar të informacionit me regjistrat e tjerë përkatës shtetërorë, siç janë regjistrat e pasurive të paluajtshme, automjeteve, mjete ujore, licencave tregtare; si edhe me burime të tjera të rëndësishme nga të tretë të tjerë, siç janë bankat dhe ndërmjetësit e tjerë financiarë.

Teorikisht, MRP kuptohet mirë dhe DPT është e angazhuar të vërë në zbatim qasjen moderne të MRP-së në 2-4 vitet e ardhshme. Në fazën e parë të zbatimit të reformave, DMR nuk ka burime të mjaftueshme për të ndjekur një qasje të plotë të menaxhimit të risqeve për përmbushjen e detyrimeve nga subjektet, qasje e cila bën dallim midis subjekteve të mëdha, të mesme dhe të vogla në bazë të një vlerësimi të probabilitetit relativ të mospërputhshmërisë me detyrimet dhe të pasojave të kësaj mospërputhshmërie. Gjatë zbatimit të kuadrit të bërjes së dallimit sipas risqeve, risqet fiskale të çdo subjekti klasifikohen si të larta, të mesme ose të ulëta në raport me subjekte të tjera të ngjashme. DPT nuk kryen asnjë vlerësim sistematik të faktorëve që ndikojnë në sjelljen e përmbushjes dhe në qëndrimet e grupeve të ndryshme të subjekteve dhe të ekspertëve fiskalë të tyre lidhur me përmbushjen. Pjesa më e madhe e punës dhe burimeve të DPT-së është përqendruar te fushata e qeverisë kundër ekonomisë informale.

DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për më shumë se 90 për qind të të ardhurave të brendshme, përdorin qasje që janë pjesërisht të strukturuar dhe sistematike për të vlerësuar dhe priorizuar risqet e përmbushjes për disa (rëndësia materiale sipas vlerës siç përkufizohet nga Kuadri PEFA 2016) lloje të ardhurash.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

30. Dokumenti "Përmbledhje e Strategjisë së Përmbushjes, analiza e riskut", DPT, tetor 2016

19.3 Kontrolli dhe hetimi i të ardhurave

Ky dimension vlerëson nëse ka masa kontrolluese të mjaftueshme në zbatim për të zbuluar evazionin dhe për të siguruar që rastet e mospërbushjes të mos mbeten pa u zbuluar.

DPD ka plan kontrolli, me normë realizimi prej 157 për qind.

TABELA 3.19 Kontrollat nga Departamenti i Analizave & Aposteriorit, viti 2016

Sektori	Numri i kontrolleve	Numri i kontrolleve të planifikuara	Realizimi
Vlerësimi/klasifikimi/origjina	45	25	180%
Kontrolli i regjimeve	57	40	143%
GJITHSEJ	102	65	157%

Burimi: Ministria e Financave, DPD.

DPT ka plan kontrolli, me normë realizimi prej 98 për qind. Të gjitha kontrollet zhvillohen në bazë të një plani mujor të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme, me kontributin e drejtorive rajonale tatimore. Rreth 60 për qind e rasteve të kontrollit të planit mujor të kontrolleve përzgjidhen nëpërmjet sistemit informatik. 40 për qind e rasteve të kontrollit përzgjidhen nga drejtoritë rajonale tatimore dhe mund të jenë objekt abuzimi nga inspektorët e kontrollit tatimor. Plani i kontrollit mbulon tatimet kryesore. Kontrolli i subjekteve të mëdha bëhet nga DRT e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DRTM); por, ky nuk fokusohet te segmentet e tjera të rëndësishme të subjekteve me risqe të larta të përmbushjes, siç janë individët e pasur. Pra, vënia plotësisht në zbatim i një qasjeje moderne të MRP-së do ta përmirësonte mbulimin me kontroll tatimor duke përfshirë edhe segmentet e tatimpaguesve me risk të lartë të përmbushjes.

TABELA 3.20 Kontrollat tatimore, viti 2016

Drejtoria Rajonale Tatimore	Numri i kontrolleve të planifikuara	Numri i kontrolleve të zhvilluara	Realizimi
Berat	114	105	92%
Dibër	47	43	91%
Durrës	242	237	98%
Elbasan	135	139	97%
Fier	203	220	108%
Gjirokastrë	60	58	97%
Korçë	116	94	81%
Kukës	37	25	68%
Lezhë	56	58	104%
Sarandë	43	32	74%
Shkodër	237	226	95%
Vlorë	77	78	101%
Tiranë	343	376	110%
DRTM	445	420	94%
GJITHSEJ	2,155	2,111	98%

Burimi: Ministria e Financave, DPT.

Megjithëse DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për mbledhjen e më shumë se 90 për qind të të ardhurave të brendshme, i realizojnë të gjitha (rëndësia materiale sipas vlerës siç përkufizohet nga Kuadri PEFA 2016) kontrollat dhe hetimet e planifikuara, këto nuk menaxhohen dhe raportohen sipas një plani të dokumentuar për përmirësimin e përmbushjes, po të kemi parasysh se 40 për qind e rasteve të kontrollit nuk përzgjidhen nga sistemi informatik por nga drejtoritë rajonale tatimore, gjë që i vendos këto kontrolle në rrezik abuzimi nga inspektorët.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

19.4 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura në të ardhurat

Ky dimension vlerëson shkallën e menaxhimit si duhet të detyrimeve të prapambetura duke u fokusuar te niveli dhe vjetërsia e detyrimeve të prapambetura.

Funksioni i mbledhjes së borxhit në DPT vuan nga dobësi serioze – stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit fiskal 2016 përbënte 68,3 për qind të mbledhjes së të ardhurave gjithsej, ndërsa detyrimet e prapambetura më të vjetra se 12 muaj përbënin 69,4 për qind të detyrimeve të prapambetura gjithsej për vitin fiskal 2016. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në rritjen e borxhit janë si vijon: i. proceset e punës të mbledhjes së borxhit janë tepër përgjithësuese dhe nuk i njohin risqet e ndryshme ndaj mbledhjes së borxhit që vijnë nga kategoritë e ndryshme të borxhit; ii. procedurat e mbledhjes janë jo efikase dhe në disa raste nuk përdoren; iii. nuk kuptohet sa duhet përbërja e stokut të borxhit; iv. ka mbikëqyrje dhe kontroll të pamjaftueshëm nga niveli drejtues mbi aktivitetet kyçe operacionale; dhe v. moszbatimi i shuarjes së borxhit.

Detyrimet e prapambetura në dogana dhe akciza duket se përbëjnë më pak problem – stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit fiskal 2016 përbënte 16,6 për qind të të ardhurave gjithsej të mbledhura nga DPD. Meqë rregulla e përgjithshme kërkon që mallrat nuk mund të merren nëse nuk janë paguar detyrimet, kjo bën që detyrimet e prapambetura që lindin të jenë kryesisht në lidhje me gjoba.

TABELA 3.21 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve: Stoku i detyrimeve të prapambetura tatimore më 31 dhjetor 2016

Vjetërsia e detyrimeve të prapambetura	TAP	TF	TVSH	Kontributet e sigurimeve shoqërore	Të tjera	Gjithsej
Më pak se 3 muaj	93.785	143.012	1.265.183	1.168.531	3.503.914	6.174.425
3 deri në 6 muaj	105.384	523.958	2.137.732	1.497.953	1.289.969	5.554.995
6 deri në 12 muaj	113.836	5.560.729	2.598.428	1.982.123	23.035.100	33.290.216
1 deri në 2 vjet	211.987	4.725.435	5.425.193	1.481.792	4.118.941	15.963.348
2 deri në 5 vjet	1.499.714	10.500.549	27.410.628	4.765.007	5.910.067	50.085.965
Më shumë se 5 vjet	1.084.475	13.421.061	13.292.733	3.235.442	4.965.410	35.999.121
A. Gjithsej detyrime të prapambetura	3.109.181	34.874.744	52.129.896	14.130.848	42.823.400	147.068.069
B. Gjithsej tatime të mbledhura						215.335.824
C. Detyrime të prapambetura më të vjetra se 12 muaj						102.048.433
Raporti A/B						68,29%
Raporti C/A						69,38%

Burimi: Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

TABELA 3.22 Drejtoria e Përgjithshme e Doganës: Stoku i detyrimeve të prapambetura më 31 dhjetor 2016

Drejtoria e Përgjithshme e Doganës: Stoku i detyrimeve të prapambetura më 31 dhjetor 2016	
Drejtoritë Rajonale Doganore	Gjithsej detyrime të prapambetura (000/lekë)
A. Gjithsej detyrime të prapambetura	24.787.915
B. Gjithsej të ardhura të mbledhura nga dogana	148.432.000
C. Raporti A/B	16,6%

Burimi: Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganës.

Megjithëse stoku i detyrimeve të prapambetura në DPD në fund të vitit fiskal 2016 përbënte 16,6 për qind të të ardhurave gjithsej të mbledhura nga DPD, në nivel agregat për DPT-në dhe DPD-në, stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit fiskal 2016 përbënte 47 për qind³¹ të të ardhurave gjithsej të mbledhura.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D.

TP-20. Kontabiliteti i të ardhurave

Ky tregues vlerëson procedurat e përdorura për regjistrimin dhe raportimin e arkëttimeve të të ardhurave, konsolidimin e të ardhurave të arkëtuara dhe rakordimin e llogarive të të ardhurave tatimore. Treguesi mbulon, si të ardhurat tatimore, ashtu edhe ato jo tatimore, të mbledhura nga qeverisja qendrore. Vlerësimi mbështetet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) të cilat janë përgjegjëse për më shumë se 90 për qind të mbledhjes së të ardhurave të brendshme. Ky tregues përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M1 (WL)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- *Dimensioni 20.1: Informacioni për arkëtimet e të ardhurave (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 20.2: Transferimi i arkëttimeve të të ardhurave (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 20.3: Rakordimi i llogarive të të ardhurave (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-20 Kontabiliteti i të ardhurave	A	Metoda vlerësimit M1 (WL)
20.1 Informacioni për arkëtimet e të ardhurave	Vlerësimi i dimensionit A	MF merr të dhëna për të ardhurat të paktën çdo muaj nga DPT dhe DPD, të cilat mbledhin më shumë se 90 për qind të të ardhurave të qeverisjes qendrore. MF përpilon një raport të konsoliduar fiskal ku mbulohen të ardhurat sipas llojit dhe periudhës së arkëtimit.
20.2 Transferimi i arkëttimeve të të ardhurave	Vlerësimi i dimensionit A	DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për arkëtimin e më shumë se 90 për qind të mbledhjes së të ardhurave të brendshme, ia transferojnë arkëtimet përditë thesarit.
20.3 Rakordimi i llogarive të të ardhurave	Vlerësimi i dimensionit A	DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për arkëtimin e më shumë se 90 për qind të mbledhjes së të ardhurave të brendshme, bëjnë rakordim të plotë të vlerësimit, mbledhjes, detyrimeve të prapambetura dhe transferimeve në thesar të paktën çdo muaj.

31. $(147.068.069 + 24.787.915) / (215.335.824 + 148.432.000) = 47$ për qind

20.1 Informacioni për arkëtimet e të ardhurave

Ky dimension vlerëson se sa një ministri qendrore, pra Ministria e Financave apo një organ me përgjegjësi të ngjashme, bashkërendon aktivitetet e administrimit të të ardhurave dhe mbledh, kontabilizon dhe raporton informacione në kohë për të ardhurat e mbledhura.

Kontabiliteti i të ardhurave është mbi bazën monetare dhe bëhet çdo ditë automatikisht në sistemin informatik. Raportimi mbi të dhënat e të ardhurave bëhet po ashtu automatikisht nëpërmjet SIQF-së. MF merr të dhëna për të ardhurat të paktën çdo muaj nga DPT dhe DPD, të cilat mbledhin më shumë se 90 për qind të të ardhurave të qeverisjes qendrore (të gjitha - rëndësia materiale sipas vlerës të përkufizuar në Kuadrin PEFA 2016). MF përpilon një raport të konsoliduar fiskal ku mbulohen të ardhurat sipas llojit dhe periudhës së arkëtimit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

20.2 Transferimi i arkëtimeve të të ardhurave

Ky dimension vlerëson se sa shpejt transferohen në thesar apo në institucione të tjera të përcaktuara të ardhurat e mbledhura.

Vënia në zbatim e sistemit të ri informatik të thesarit, SIQF, ka pasur për rezultat shlyerjen brenda ditës të të gjitha llogarive të arkëtimit të të ardhurave dhe derdhjen e tyre në Llogarinë Unike të Thesarit (LLUTH). Mundësia që u është dhënë subjekteve tregtare për t'i shlyer detyrime online e ka përmirësuar menaxhimin e likuiditetit. Pra, DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për arkëtimin e më shumë se 90 për qind të mbledhjes së të ardhurave të brendshme, ia transferojnë arkëtimet përditë thesarit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

20.3 Rakordimi i llogarive të të ardhurave

Ky dimension vlerëson shkallën me të cilën vlerat agregate të lidhura me vlerësimet/faturimet, arkëtimet, detyrimet e prapambetura dhe transferimet të (dhe arkëtimet nga) Thesari apo institucione të tjera të përcaktuara bëhen rregullisht dhe rakordohen në kohën e duhur.

Përmes sistemin informatik, DPT i reflekton shumat e vjela dhe të paguara nga secili subjekt automatikisht "në kohë reale" kur deklarata tatimore depozitohet në mënyrë elektronike dhe kur kryhet pagesa, si edhe kur autoriteti tatimor bën rivlerësim. DPT i përditëson dosjet individuale automatikisht çdo ditë nëpërmjet sistemit informatik me t'u kryer pagesat dhe me të arritur në bankat e nivelit të dytë dhe në thesar. DPT bën rakordim mujor sipas llojeve të tatimeve dhe i rakordon pagesat dhe transfertat me thesarin. Pagesa e çdo lloji tatimi rakordohet kundrejt pagesës gjithsej duke qenë se pagesa mund të bëhet agregate për disa lloje tatimesh. Nëse pagesa nuk bëhet brenda afatit, lind e drejta e kamatëvonesës, pas së cilës dërgohet njoftim. i njëjti rakordim i llogarive të të ardhurave vlen edhe për DPD-në. Pra, DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për arkëtimin e më shumë se 90 për qind të mbledhjes së të ardhurave të brendshme, bëjnë rakordim të plotë të vlerësimit, mbledhjes, detyrimeve të prapambetura dhe transferimeve në thesar të paktën çdo muaj.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

TP-21. Parashikueshmëria e shpërndarjes së burimeve brenda vitit

Ky tregues vlerëson se sa është në gjendje MF në nivel qendror të parashikojnë angazhimet dhe kërkesat e likuiditetit dhe t'u japë informacion të besueshëm për gatishmërinë e fondeve njëjësive buxhetore për realizimin e shërbimeve. Përmban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- Dimensioni 21.1: Konsolidimi i tepricave monetare (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQB);
- Dimensioni 21.2: Parashikimi dhe monitorimi i likuiditetit (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQB);
- Dimensioni 21.3: Informacioni për tavanet e angazhimeve (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQB);
- Dimensioni 21.4: Sa të konsiderueshme janë ndryshimet e bëra gjatë vitit në buxhet (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQB).

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-21 Parashikueshmëria e shpërndarjes së burimeve brenda vitit	Vlerësimi i përgjithshëm B	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
21.1 Konsolidimi i tepricave monetare	Vlerësimi i dimensionit D	Tepricat e llogarive jashtë llogarisë unike të thesarit janë më të mëdha se teprica e kësaj llogarie. Raportet për gjendjen e llogarive jashtë llogarisë unike të thesarit merren çdo muaj, por shumica e tepricave jashtë llogarisë unike të thesarit nuk konsolidohen.
21.2 Parashikimi dhe monitorimi i likuiditetit	Vlerësimi i dimensionit B	Drejtoria e Thesarit përgatit parashikimin e flukseve monetare për të gjithë vitin dhe e përditëson në bazë të flukseve monetare faktike me të marrë informacionin burimor të përditësuar. Një prej llojeve të rëndësishme të informacionit burimor - raporti i shërbimit të borxhit - përditësohet jo më shpesh se çdo tremujor, ndërsa llojet e tjera të informacionit përditësohen më shpesh.
21.3 Informacioni për tavanet e angazhimeve	Vlerësimi i dimensionit A	Njësitë buxhetore marrin informacion të besueshëm për tavanet mujore të angazhimeve për të gjithë vitin në janar.
21.4 Sa të konsiderueshme janë ndryshimet e bëra gjatë vitit në buxhet	Vlerësimi i dimensionit B	Janë bërë dy ndryshime të konsiderueshme në buxhet në vitin 2016 përmes rishikimit të buxhetit të miratuar nga Kuvendi. Një prej këtyre dy rasteve ndodhi shumë pranë fundit të vitit fiskal. Praktika e ndryshimeve të bëra në fund të vitit konsiderohet si jo plotësisht transparente nga ministrinë e linjës.

21.1. Konsolidimi i tepricave monetare

Ky dimension vlerëson se sa MF, apo një subjekt tjetër i ngjashëm, arrin të identifikojë dhe konsolidojë tepricat e likuiditetit si bazë informacioni mbi të cilën bën çlirimin e fondeve. Përdorimi i një llogarie unike thesari, apo i llogarive që janë të centralizuara në një bankë të vetme, zakonisht në bankën qendrore, ndihmon në konsolidimin e llogarive bankare. Llogaria unike e thesarit është një llogari bankare ose një tërësi llogarish të lidhura nëpërmjet të cilave qeveria kryen veprimet e arkëtimit dhe pagesave. Kontrolli dhe raportimi për veprimet e veçanta duhet të arrihet nëpërmjet sistemit kontabël, që i jep mundësi Thesarit të veçojë menaxhimin e likuiditetit nga kontrolli mbi veprimet e veçanta. Arritja e konsolidimit të rregullt të llogarive të shumta bankare që nuk mbahen në nivel qendror në përgjithësi kërkon kryerjen e kleringut elektronik dhe marrjen e masave organizuese për pagesat me bankat ku mban llogaritë qeveria.

Në Shqipëri, një pjesë e konsiderueshme e tepricave të likuiditetit ndodhen në llogarinë unike të thesarit e cila është në Bankën e Shqipërisë dhe administrohet nga Drejtoria e Thesarit e MF-së. Konsolidimi i fondeve në llogarinë unike të thesarit bëhet çdo ditë. Mbahen nëntë llogari në Bankën e Shqipërisë, por veçmas nga llogaria unike e thesarit, përfshirë katër llogari të fondeve të veçanta të administruara nga MF, tri llogari të administruara nga fondi i sigurimeve shëndetësore dhe dy llogari të fondit të sigurimeve shoqërore. Gjithashtu, trembëdhjetë llogari të fondeve të ndryshme buxhetore, ekstra-buxhetore dhe speciale mbahen pranë bankave të nivelit të dytë (përfshirë disa llogari të administruara nga MF). Edhe llogaritë e projekteve të financuara nga donatorë mbahen kryesisht në banka të nivelit të dytë. Tepricat e të gjitha llogarive të lartpërmendura mbahen veçmas në bankat përkatëse, nuk transferohen apo nuk centralizohen në asnjë moment dhe në shumicën e rasteve nuk mund të përdoren njësoj si fondet e mbajtura në llogarinë unike të thesarit. Raportet për gjendjen e llogarive jashtë llogarisë unike të thesarit merren çdo muaj, por shumica e tepricave jashtë llogarisë unike të thesarit nuk konsolidohen. Siç e tregojnë të dhënat më poshtë, madhësia e tepricave të mbajtura jashtë llogarisë unike të thesarit është më e madhe se teprica e kësaj llogarie.

TABELA 3.23 Të dhënat për tepricat e likuiditetit në fund të vitit 2016

Llogaritë	Balance (LEKË)
Teprica e likuiditetit në LLUTH	10.089.232.544,78 lekë
Tepricat e likuiditetit jashtë LLUTH	16.382.183.378,86 lekë
në Bankën e Shqipërisë	6.284.923.592,39
në bankat e nivelit të dytë	10.097.259.786,47
llogaritë e projekteve me financim të huaj	7.336.406.361,57

Burimi: Drejtoria e Thesarit, MF.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D.

21.2 Parashikimi dhe monitorimi i likuiditetit

Ky dimension vlerëson se sa parashikohen dhe monitorohen nga MF angazhimet dhe flukset monetare të njësisve buxhetore. Planifikimi, monitorimi dhe menaxhimi efektiv i flukseve monetare nga ana e Thesarit ndihmon në parashikueshmërinë e gatishmërisë së fondeve për njësitë buxhetore.

Drejtoria e Thesarit përgatit dhe përditëson rregullisht parashikime të hollësishme të likuiditetit. Parashikimet mbështeten në planet mujore të shpenzimeve të marra nga njësitë shpenzuese në janar, parashikimet e mbledhjes së të ardhurave nga organet e administrimit të të ardhurave, tabelat e shlyerjes së borxhit të marra nga sektori i menaxhimit të borxhit dhe informacione të tjera përkatëse. Parashikimet, të zbrërthyer sipas muajve dhe ditëve, përgjithësisht ndjekin trendë historikë. Parashikimet përditësohet periodikisht, me të pasur informacione burimore të gatshme. Shpeshtësia e marrjes së informacioneve burimore të përditësuara varet nga lloji i informacioneve (p.sh., informacionet për afatet e shërbimit të borxhit përditësohen çdo tremujor, ndërsa llojet e tjera të informacioneve përditësohen më shpesh).

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

21.3 Informacioni për tavanet e angazhimeve

Ky dimension vlerëson besueshmërinë e informacioneve që u vihen në dispozicion gjatë vitit njësite buxhetore për tavanet për angazhimet e shpenzimeve për periudhat specifike. Parashikueshmëria për njësitë buxhetore sa i takon gatishmërisë së fondeve për angazhimin është e nevojshme për të ndihmuar në planifikimin e aktiviteteve dhe prokurimin e faktorëve për të pasur realizim efektiv të shërbimeve dhe për të shmangur pengimin e zbatimit të këtyre planeve pas fillimit të zbatimit.

Ministria shqiptare e Financave përdor kufijtë mujorë të mbajtjes në kontroll të shpenzimeve gjatë vitit. Këta kufij dalin në bazë të buxhetit vjetor të miratuar dhe të parashikimeve të shpenzimeve mujore të përgatitura nga njësitë shpenzuese dhe të vëna në dispozicion të Ministrisë së Financave nëpërmjet ministrive të linjës në janar. Informacionet për kufijtë mujorë të shpenzimeve u komunikohen ministrive të linjës dhe agjencive të tjera shpenzuese gjatë të njëjtit muaj. Informacionet vihen në dispozicion në formën e një shkrese të posaçme që përfshijnë kufijtë mujorë të shpenzimeve për të 12 muajt. Në rast të rishikimit të buxhetit nga Kuvendi gjatë vitit, kufijtë mujorë rishikohen dhe u komunikohen ministrive të linjës pas rishikimit. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit kanë konfirmuar se shkresat nga MF me kufijtë mujorë të shpenzimeve për vitin 2016 i kanë marrë nga fundi i muajit janar 2016, dhe këto shkresa përmbanin informacion korrekt i cili u ka dhënë mundësi të planifikonin aktivitetet si duhet. Për rrjedhojë, njësitë buxhetore janë në gjendje të planifikojnë dhe angazhojnë shpenzime për të paktën gjashtë muaj përpara, në përputhje me fondet e miratuara në buxhet dhe çlirimin e likuiditeteve/angazhimeve.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

21.4 Sa të konsiderueshme janë ndryshimet e bëra gjatë vitit në buxhet

Ky dimension vlerëson shpeshtësinë dhe transparencën e ndryshimeve të bëra në fondet e miratuara në buxhet. Qeverive mund t'u duhet të bëjnë ndryshime gjatë vitit në fondet e miratuara në buxhet në bazë të ngjarjeve të paparashikuara që prekin të ardhurat ose shpenzimet. Përcaktimi paraprakisht i një mekanizmi lidhur me ndryshime të tilla të prioriteteve të buxhetit të bëra në mënyrë sistematike dhe transparente e minimizon efektin që kanë këto ndryshime të parashikueshmëria dhe të pacenueshmëria e shpërndarjeve fillestare të buxhetit.

Janë bërë dy ndryshime të konsiderueshme të buxhetit të vitit 2016, me nismën e Qeverisë dhe të miratuara nga Kuvendi në përputhje me rregullat për ndryshimet e buxhetit të vendosura në Ligjin Organik të Buxhetit dhe të diskutuara në TP-18.4. Ndryshimi i parë është miratuar në korrik dhe i dyti është miratuar në fund të vitit fiskal, në mes të dhjetorit. Ndryshimet reflektonin realizimin faktik të të ardhurave, si edhe ndryshimet në planet e shpenzimeve të ministrive. Të dy këto ndryshime janë miratuar me akte ligjore ku përcaktoheshin fondet, zërat e shpenzimeve dhe programet e prekura dhe shumat e reja të miratuara për këto zëra por nuk tregonin shumat fillestare për këto zëra dhe objektin e ndryshimeve. Duke pasur parasysh sa afër ndodhi rishikimi i dytë me fundin e vitit fiskal, procesi i rishikimit konsiderohet nga ministrinë e linjës si jo plotësisht transparent dhe i parashikueshëm. Rishikimi i bërë në fund të vitit fiskal 2016 nuk ka qenë i vetmi rishikim i kësaj natyre gjatë viteve të fundit. Në vitin 2015, janë miratuar nga Kuvendi dy rishikime në dhjetor (nga gjithsej tre episode rishikimi atë vit) dhe kjo praktikë është kritikuar në opinionin e KLSH-së në raportin e zbatimit të buxhetit 2015.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

TP-22. Shpenzimet për detyrimet e prapambetura

Ky tregues mat masën e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe se sa një problem i tillë sistematik trajtohet dhe mbahet në kontroll. Përmban dy dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën M1 (WL) për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- Dimensioni 22.1: Stoku i detyrimeve të prapambetura (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të mbyllura-2014, 2015, 2016, mbulimi - QQB);
- Dimensioni 22.2: Monitorimi i detyrimeve të prapambetura (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQB).

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-22 Shpenzimet për detyrimet e prapambetura	Vlerësimi i përgjithshëm C+	Metoda vlerësimit M1 (WL)
22.1. Stoku i detyrimeve eprapambetura	Vlerësimi i dimensionit B	Stoku i shpenzimeve për detyrimet eprapambetura në fund të viteve 2016 dhe 2015 që më pak se 6% e vlerës totale të shpenzimeve për vitin përkatës.
22.2 Monitorimi i detyrimeve e prapambetura	Vlerësimi i dimensionit C	Shpeshtësia standarde e përgatitjes së raporteve të monitorimit të detyrimeve të prapambetura është çdo katër muaj. Raporti vjetor i monitorimit për vitin 2016, përfshirë stokun dhe përbërjen e detyrimeve të prapambetura, gjendej në faqen në internet të MF-së në momentin e vlerësimit.

22.1 Stoku i detyrimeve të prapambetura

Ky dimension vlerëson se sa është stoku i detyrimeve të prapambetura. Stoku preferohet të identifikohet në fund të vitit fiskal dhe të krahasohet me shpenzimet totale për vitin fiskal të shqyrtuar.

Duke pasur parasysh rëndësinë e problemit të detyrimeve të prapambetura në të shkuarën e afërt, në kuadër të programit me FMN-në është kushtuar vëmendje e veçantë për fuqizimin e masave kontrolluese mbi angazhimet dhe për zbatimin e mekanizmave për parandalimin e akumulimit të detyrimeve të reja të prapambetura, krahas shlyerjes së stokut të prapambetur. Në këto masa përfshiheshin ndryshimet legjislative për të sqaruar përkufizimet e termave "angazhim" dhe "detyrime të prapambetura" dhe për të futur datën afat për pagesat. Sipas këtyre ndryshimeve, faturat i duhen paraqitur thesarit brenda 30 ditësh pas marrjes së tyre dhe 30 ditë të tjera i lihen në dispozicion thesarit për të bërë pagesën. Pagesat e njohura si legjitime dhe të papërpunuara brenda këtij afati klasifikohen si detyrime të prapambetura.

Stoku i detyrimeve të prapambetura nga e shkuara është shlyer përgjithësisht në 2016, me përjashtim të disa kontratave objekt mosmarrëveshjeje për disa lloje të veçanta punimesh, shumë prej të cilave janë kundërshtuar në gjykatë (në veçanti, kontratat për riparimin dhe ndërtimin e rrugëve të cilat qenë lidhur nga autoritetet rrugore me afat 5-vjeçar pa mundësi anulimi apo ndryshimi). Janë po këto kontrata të mëparshme afatgjata që vijojnë të krijojnë detyrime të reja të prapambetura. Pra nuk ka qenë e mundur të parandalohej plotësisht akumulimi i detyrimeve të reja të prapambetura, çka përbën shqetësim.

Siç tregohet në tabelën 3.24 më poshtë, në fund të vitit 2015, stoku total i detyrimeve të prapambetura të qeverisë që nën 4 për qind të shpenzimeve totale. Ky stok u ul në më pak se 1 për qind të shpenzimeve totale deri në fund të vitit 2016. Nuk që e mundur të merreshin të dhëna të sakta për fundin e vitit 2014.

TABELA 3.24 Stoku i detyrimeve të prapambetura në shpenzimet buxhetore, qeverisja qendrore

	Detyrimet e prapambetura në fund të vitit milion lekë	Shpenzimet faktike gjithsej në vitin përkatës milion lekë	Raporti i stokut të detyrimeve të prapambetur në fund të vitit mbi shpenzimet gjithsej në atë vit
2014	na	426.447	na
2015	16.050,2	433.790	3,7%
2016	1.803,6	418.746	0,4%

Burimi: Raporti për vitin 2015 vjen nga raporti i monitorimit të MFP-së të përgatitur nga SIGMA, që përkon me vlerën në lek të llogaritur nga ekipi; të dhënat për vitin 2016 vijnë nga raporti i monitorimit të detyrimeve të prapambetura të përgatitur nga MF.

Në bazë të të dhënave të disponueshme, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura në shpenzimet buxhetore

Ky dimension vlerëson se sa identifikohen dhe monitorohen detyrimet e prapambetura në shpenzime. Ai shikon se cilat aspekte të detyrimeve të prapambetura monitorohen dhe sa shpesh dhe sa shpejt nxirret informacion.

Duke pasur parasysh stokun e konsiderueshëm të detyrimeve të prapambetura të akumuluar në të shkuarën e afërt, Shqipëria përgatiti një strategji për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e cila u miratua në vitin 2014 si pjesë e programit me FMN-në. Kjo strategji përfshinte ngritjen e një mekanizmi të posaçëm për të monitoruar detyrimet e prapambetura në shpenzimet publike, ku përfshihet një sistem vetëraportimi nga njësitë e vartësisë i ngritur në çdo ministri të linjës, të cilave u kërkohet t'i paraqesin MF-së informacione të konsoliduara për sektorët e tyre përkatës. Në bazë të informacioneve të paraqitura nga ministrinë e linjës, duhen përgatitur raporte monitorimi të konsoliduara çdo katër muaj, të cilët duhen publikuar në faqen në internet të MF-së brenda një muaji pas përfundimit të periudhës përkatëse. Ky mekanizëm vijon të ketë rëndësi për monitorimin e stokut të mëparshëm të detyrimeve të prapambetura dhe të detyrimeve të reja të prapambetura të lidhura me kontratat e mëparshme shumëvjeçare, që janë lidhur përpara vitit 2016. Raportet përfshijnë të dhëna të zbërthyer sipas ministrisë, institucionit / njësisë shpenzuese në varësi të ministrisë dhe vitit / periudhës kur ka lindur. Raporti vjetor i monitorimit për vitin 2016 gjendej në faqen në internet të MF-së në momentin e vlerësimit.

Pas ndryshimeve legjislative, funksionaliteti i sistemi informatik të thesarit SIQF u zgjerua në vitin 2016, në mënyrë që ky sistem të regjistrojë tani edhe informacione për angazhimet në momentin e regjistrimit të kontratave të nënshkuara, përfshirë angazhimet shumëvjeçare për kontratat që shtrihen në disa vite fiskale. Sistemi mbulon informacion edhe për faturat për kontratat përkatëse, përfshirë edhe informacionin për afatin e pagesës. Pra sistemi i thesarit përmban informacion të saktë për detyrimet e prapambetura që kanë lindur prej vitit 2016, përfshirë edhe të dhëna në nivel të njësisë shpenzuese, kontratës dhe datës se kur ka lindur detyrimi i prapambetur, të dhëna që mund të nxirren në çdo moment. Por nuk ka një kërkesë / format specifik për monitorimin e detyrimeve të prapambetura përmes sistemit të thesarit dhe nuk nxirren raporte të rregullta.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

TP-23. Kontrollat në listë-pagesat

Ky tregues ka të bëjë me fondin e pagave vetëm për nëpunësit civilë: si administrohet, si trajtohen ndryshimet dhe si arrihet njëtrajtshmëria me administrimin e evidencave të personelit. Pagat për marrëdhëniet e përkohshme të punës dhe fondet rezervë të pagës që nuk janë pjesë e fondit të rregullt të pagave përfshihen në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për shpenzimet jo paga, TP-25. Ky tregues përmban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën M1 (WL) për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- *Dimensioni 23.1: Integrimi i evidencave për fondin e pagave dhe për personelin (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 23.2: Menaxhimi i ndryshimeve në fondin e pagave (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 23.3: Kontrolli i brendshëm i fondit të pagave (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 23.4: Auditimi i fondit të pagave (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-23 Masat kontrolluese në listë-pagesat	Vlerësimi i përgjithshëm C+	Metoda vlerësimit M1 (WL)
23.1 Integrimi i evidencave për fondin e pagave dhe për personelin	Vlerësimi i dimensionit B	Fondi i pagave mbështetet me dokumentacion të plotë për të gjitha ndryshimet e bëra në evidencat e personelit çdo muaj dhe kontrollohet kundrejt të dhënave të listë-pagesës së muajit të mëparshëm. Marrjet në punë dhe ngritjet në detyrë mbahen në kontroll përmes një liste të organikës së miratuar. Duke qenë se informacionet për personelin, fondin e pagave dhe pagesat mbahen në shumë sisteme të ndryshme, disa të automatizuara dhe disa manuale, niveli i integritetit është i ulët dhe del nevoja për rakordime të gjera manuale.
23.2 Menaxhimi i ndryshimeve në fondin e pagave	Vlerësimi i dimensionit B	Ndryshimet e nevojshme në evidencat e personelit dhe në fondin e pagave përditësohen të paktën çdo muaj, përgjithësisht në kohën e duhur për pagesat e muajit të ardhshëm. Korrigjimet prapavepruese janë të rralla dhe zakonisht bëhen brenda listë-pagesës së muajit të ardhshëm. Por natyra e decentralizuar e administrimit të fondit të pagave do të thotë se mund të ketë dallime të konsiderueshme në performancë mes ministrive të ndryshme dhe nuk ka qenë e mundur të vlerësohej performanca e mbarë qeverisë në këtë aspekt.
23.3 Kontrolli i brendshëm i fondit të pagave	Vlerësimi i dimensionit C	Ka masa kontrolluese të mjaftueshme për të siguruar pacenueshmërinë e të dhënave me rëndësinë më të madhe për fondin e pagave.
23.4 Auditimi i fondit të pagave	Vlerësimi i dimensionit B	Në tre vitet e fundit fiskale të përfunduara janë kryer auditime të fondit të pagave.

Konteksti

Zbatimi i procedurave të reja të administrimit të burimeve njerëzore ka filluar pak kohë përpara miratimit të Ligjit të Shërbimit Civil (LSHC) dhe shumë prej procedurave janë modifikuar pas shtesave dhe ndryshimeve të bëra në LSHC në dhjetor 2014. Departamenti i Administratës Publike (DPA) ka nxjerrë disa udhëzime dhe ka organizuar kurse trajnimi për njësitë e personelit në ministritë e linjës, institucionet e vartësisë dhe institucionet e pavarura.

Përgjegjësia e DAP përfshin përgatitjen dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore dhe legjislacionit të shërbimit civil; mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga institucionet e administratës shtetërore; miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programeve të trajnimit; administrimin e Regjistratës Qendrore të Personelit; dhe hartimin e strukturës së pagave të administratave qendrore dhe vendore. Mbikëqyrja e pavarur e shërbimit civil sigurohet nëpërmjet Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), krijuar me LSHC si një organ i pavarur publik, i cili emërohet nga Kuvendi dhe raporton përpara Kuvendit³².

LSHC parashikon parimet e administrimit; kuadrin institucional; dosjet dhe regjistrat e personelit; klasifikimin, marrjen në punë dhe karrierën; transferimet, pezullimet dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës; zhvillimin profesional dhe vlerësimin e performancës; të drejtat (përfshirë të drejtën për pagë të rregullt) dhe detyrimet; dhe disiplinën.

LSHC i ri ka një fushëveprim shumë më të gjerë në krahasim me ligjin e mëparshëm, ngaqë përfshin administratën shtetërore (106 institucione, përfshirë Kryeministrinë, ministritë dhe institucionet qendrore të vartësisë, përfshirë edhe degët në rrethe), 19 institucione të pavarura (administratën e Kuvendit, Presidencën, administratat e gjykatave dhe prokurorive, si edhe institucionet e pavarura të ngritura me Kushtetutë apo me ligj, të cilat raportojnë përpara Kuvendit) dhe njësitë e qeverisjes vendore. Nga kjo fushë veprimi përjashtohen gjyqtarët dhe prokurorët, administrata gjyqësore civile, personeli ushtarak, shërbimi informativ shtetëror dhe institucionet që realizojnë drejtpërdrejt shërbime. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në LSHC në dhjetor 2014 përfshinë në këto përjashtime agjentët/oficerët e policisë gjyqësore dhe punonjësit që mbajnë armë, civilët në strukturat e forcave të armatosura, punonjësit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, punonjësit e bordeve të kullimit dhe avokatët e Avokatit të Shtetit. LSHC përcakton qartë kufirin ndarës midis të emëruarve politikë, nëpunësve publikë dhe personelit mbështetës. Postet e mëposhtme politike nuk përfshihen në shërbimin civil: zyrtarët e zgjedhur, ministrat dhe zëvendësministrat, zyrtarët e emëruar nga organet kushtetuese (Kuvendi, Presidenti dhe KM) dhe zyrtarët e kabinetit. Kjo vlen edhe për funksionet administrative, që përfshin punonjësit që kryejnë detyra administrative, të sekretarisë, të mirëmbajtjes të shërbimit ose kujdestarisë dhe të cilët nuk ushtrojnë autoritet publik. Punonjësit publikë të përjashtuar nga LSHC janë objekt i Kodit të Punës³³, legjislacionit të sektorit përkatës nëse ka (siç është rasti i arsimit, shërbimeve sociale dhe shëndetësisë, për shembull)³⁴, kontratat kolektive të punës dhe kontratave individuale të punës.

Në vitin 2016, kishte 164.635 punonjës të sektorit publik, që përbënin 15,7 për qind të krahut të punës gjithsej, një përqindje që ka rënë vitet e fundit. Në fund të vitit 2016, kishte 7.743 nëpunës civilë që punonin në administratën qendrore, të cilët përbënin 4,7 për qind të gjithë punonjësve të sektorit publik. Procesi i dhënies së statusit të nëpunësit civil ka përfunduar në administratën shtetërore.

32. Vendim nr.98, datë 04.12.2014, i Kuvendit, për strukturën, organikën dhe kategorizimin e pagave të Sekretariatit Teknik të KMSHC-së

33. Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me Ligjin nr.136/2015

34. Mes të tjerash, Ligji nr.10 107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar"; Ligji nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr.10 011, datë 30.10.2008 dhe Ligjin nr. 10 434, datë 23.06.2011; Ligji nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore". Nuk ishte e mundur të shiheshin me hollësi dispozitat që mbulojnë profesionet jashtë shërbimit civil

23.1 Integrimi i evidencave për fondin e pagave dhe për personelin

Ky dimension vlerëson se sa të integruara janë të dhënat për personelin, pagat dhe buxhetin.

Pavarësisht nga progresi pozitiv i arritur që prej vlerësimit të bërë në vitin 2011, sistemi i ri i informacionit të menaxhimit të Burimeve Njerëzore ende nuk është funksional dhe nuk zbatohet nga të gjitha njësitë e administratës shtetërore. Sistemet e përfshira tani në caktimin dhe menaxhimin e fondit të pagave nuk mund të komunikojnë me njëri-tjetrin. Prandaj del nevoja për rakordime të bëra me dorë.

Ka disa komponentë të procesit të menaxhimit të fondit të pagave:

- Masat kontrolluese të strukturës organizative. Menaxhohen nga Departamenti i Administratës Publike. Kërkohej miratimi i ndryshimeve në organikat ekzistuese përpara se të mund të përfshihet kërkesa përkatëse në kërkesën e buxhetit.
- Kontrolli buxhetor. MF përcakton fondin gjithsej të pagave, tavanin buxhetor të institucioneve dhe shpenzimet për pagat dhe shpenzimet e lidhura në nivel institucioni³⁵, tavanin buxhetor për planin fiskal dhe buxhetin vjetor të ardhshëm, në bazë të organikave të miratuara³⁶ të njësive të administratës shtetërore dhe shkallët e miratuara të pagave³⁷, duke përdorur një mjet standard të llogaritjes së kostove. Institucionet buxhetore pastaj i fusin këto nivele të organikës dhe kostot e tyre në kërkesat buxhetore. Thesari monitoron shfrytëzimin e buxhetit të miratuar për institucionin dhe kufijtë mujorë të caktuar si më lart si pjesë e rregullt e aktiviteteve të përpunimit dhe kontrollit të pagesave. Buxheti mbështetet në organikën e miratuar; prandaj në buxhet parashikohen të gjitha marrjet në punë dhe ngritjet në detyrë në bazë të organikës së miratuar.
- Evidencat e personelit. Këto mbahen brenda institucionit buxhetor si dosje fizike për secilin individ, nga drejtoria e burimeve njerëzore. Këto dosje përmbajnë informacion të përgjithshëm për punonjësën - datëlindja, seksi, gjendja civile, arsimit dhe kualifikime të tjera profesionale etj. Drejtoria e burimeve njerëzore në të gjitha institucionet mbledh të dhëna për të gjithë punonjësit. Kjo plotësohet me një regjistër të punonjësve të mbajtur në funksion të pensioneve, ku shënohet për çdo punonjës emri, datëlindja, data e fillimit të marrëdhënie të punës, kategoria e pagës dhe data e daljes në pension. Këto dosje mund të shihen vetëm nga specialistët e burimeve njerëzore të caktuar nga sektori i burimeve njerëzore ose drejtori i drejtorisë.
- Listë-prezenca. Mbahet për çdo punonjës dhe nënshkruhet nga përgjegjësi çdo muaj. Në varësi të institucioneve, marrja dhe konsolidimi i këtij informacioni menaxhohet ose nga drejtoria e personelit ose nga drejtoria e financës, dhe përdoret për të dokumentuar llogaritjen e listë-pagesës.
- Evidencat e listë-pagesës. Menaxhimi i fondit të pagës, mbajtja e evidencave dhe pagesat janë përgjegjësi e drejtorit të financës. Tabelat e përmuajshme të listë-pagesave përfshijnë pagën bruto, shpërblimet (nëse ka), zbritjet e mbajtura në pagë dhe pagën neto për të gjithë punonjësit. Në të gjitha organizatat buxhetore, kryesisht të gjitha evidencat për listë-pagesat dhe burimet njerëzore janë sisteme manuale dhe për kryerjen e këtyre funksioneve përdoren skedarë në Excel. Këto kanë nevojë për rakordim të vazhdueshëm. Në disa organizata jobuxhetore, përdoren sisteme të informacionit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe raportet e nxjerra nga sistemet rakordohen me tabelat e llogaritjeve të listë-pagesave. Listë-pagesat

35. Pagat dhe shpenzimet e lidhura me to paraqiten më vete në të gjitha raportet e buxhetit, thesarit dhe kontabilitetit, përkatësisht përdoren kategoritë ekonomike 600 për pagat dhe shpenzimet të tjera personeli dhe llogaria 601 për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

36. Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, akte ligjore dhe nënligjore në varësi të institucionit

37. VKM për kategorizimin e pagave

mujore dhe ndryshimet në statusin e personelit depozitohen në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit të sistemin informatik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Pagimi i shpenzimeve për pagat bëhet përmes sistemit të thesarit për organizatat buxhetore dhe përmes llogarive bankare për institucionet e tjera, në mënyrë të ngjashme me pagesat e tjera.

Njësitë e auditimit të brendshëm me të cilat janë bërë intervista konfirmuan se pagat janë një fushë me risk të lartë dhe se bëhen rregullisht auditime në këtë fushë. Në bazë të këtyre intervistave, shpeshësia e auditimeve të pagave qe nga dy deri në tre vjet³⁸.

Mbikëqyrja e pavarur e shërbimit civil sigurohet nëpërmjet Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), krijuar me LSHC si një organ i pavarur publik, i cili emërohet nga Kuvendi dhe raporton përpara tij³⁹. Prej krijimit në vitin 2014, Komisioneri ka kryer disa mbikëqyrje dhe inspekte në institucionet që bëjnë pjesë në shërbimin civil, përfshirë institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Për ta përmbledhur, fondi i pagave mbështetet me dokumentacion të plotë për të gjitha ndryshimet e bëra në evidencat e personelit çdo muaj dhe kontrollohet kundrejt të dhënave të listë-pagesës së muajit të mëparshëm. Marrjet në punë dhe ngritjet në detyrë mbahen në kontroll përmes një listë të organikës së miratuar. Por duke qenë se informacionet për personelin, fondin e pagave dhe pagesat mbahen në shumë sisteme të ndryshme, disa të automatizuara dhe disa manuale, niveli i integritimit është i ulët dhe del nevoja për rakordime të gjera manuale.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

Vijon puna për të ngritur një sistem informatik menaxhimi të burimeve njerëzore që të jetë plotësisht funksional. Ky sistem do të shërbente jo vetëm si regjistër i kompjuterizuar personeli, por edhe si sistem i menaxhimit të burimeve njerëzore për të gjitha institucionet e sektorit publik, në mbështetje të zbatimit homogjen dhe transparent të praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore. Të gjitha institucionet e administratës qendrore, institucionet e vartësisë, njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura duhet t'i fusin të dhënat e punonjësve në këtë sistem informatik të menaxhimit të burimeve njerëzore⁴⁰. Është ecur përpara me plotësimin e bazës së të dhënave dhe trajnimin e përdoruesve. Në sistemin informatik të menaxhimit të burimeve njerëzore janë përfshirë strukturat e të gjitha institucioneve të administratës shtetërore. Numri gjithsej i institucioneve/njësive shpenzuese, përfshirë edhe degët në rrethe, që parashikohen të përfshihen në këtë sistem është mbi 800. Nga këto, deri në fund të vitit 2016 qenë plotësuar në sistem strukturat organizative të 330 njësive shpenzuese, kryesisht nga administrata shtetërore⁴¹. Për këto njësi, ka përfunduar regjistrimi i dhënave për 11.000 dosje punonjësish.

Janë zhvilluar ndërfaqe midis këtij sistemi dhe Gjendjes Civile për shkëmbimin automatik të të dhënave personale të punonjësve përmes numrave të identifikimit dhe midis këtij sistemi dhe bazës së të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Është mundësuar vetë-verifikimi i të dhënave të personelit nga punonjësi nëpërmjet përdorimit të platformës e-Albania të shërbimeve elektronike shtetërore. Ka përfunduar ndërfaqja që lidh sistemin informatik të menaxhimit të burimeve njerëzore me sistemin e Thesarit dhe janë kryer teste pilot të shkëmbimit të informacioneve midis të dy sistemeve dhe për llogaritjen automatike të pagave dhe krijimin automatik të listë-pagesave. Në vitin 2016 është hartuar një formulë e unifikuar për automatizimin e llogaritjes së listë-pagesave⁴² e cila

38. Si pjesë e auditimeve të plota ose e detyrave të veçanta

39. Vendim nr.98, datë 04.12.2014, i Kuvendit, për strukturën, organikën dhe kategorizimin e pagave të Sekretariatit Teknik të KMSHC-së

40. Vendim Nr. 117 i Këshillit të Ministrave, datë 5.3.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"

41. DAP, Raport Vjetor 2016, f.35

42. Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Ministrisë të Financave nr. 4, datë

është futur në modulin e listë-pagesave të sistemit informatik të menaxhimit të burimeve njerëzore i cili po testohet dhe pritet të vihet në zbatim brenda fundit të vitit 2017 në të paktën 30 për qind të njësive të administratës shtetërore që bëjnë pjesë në shërbimin civil. Mbeten ende për t'u marrë vendimet për protokollin e shkëmbimit të të dhënave midis DAP dhe MF dhe për zyrtarizimin e ndarjes së autoritetit dhe përgjegjësisë në procesin e menaxhimit të pagave. Gjatë vitit 2018, DAP do të vijojë punën për ta zgjeruar sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore në njësitë e administratës shtetërore që nuk bëjnë pjesë në shërbimin civil, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.

23.2 Menaxhimi i ndryshimeve në fondin e pagave

Ky dimension vlerëson se sa në kohën e duhur bëhen ndryshime në të dhënat për personelin dhe pagat. Çdo ndryshim që kërkohet të bëhet në bazën e të dhënave të personelit do të duhej të përpunohej në kohën e duhur nëpërmjet një raporti për ndryshimin dhe do të duhej të linte një gjurmë kontrolli.

Ekipi është informuar nga intervistat me institucionet buxhetore dhe MF se përditësimet mujore në listë-pagesa mbështeten në ndryshimet e bëra në evidencat e personelit gjatë të njëjtit muaj. Nuk u vu asnjë informacion në dispozicion se sa ditë kalojnë nga ndryshimi i bërë në evidencat e personelit te ndryshimi në listë-pagesë, por në bazë të atyre që i janë thënë ekipit, mesatarisht nuk kalojnë më shumë se 4 javë. Çdo ndryshim në evidencat e personelit, si transferimet, marrjet dhe largimet nga puna miratohet nga DAP dhe menjëherë i komunikohet drejtorisë së burimeve njerëzore të organizatës dhe drejtorisë së financës për të vepruar më tej. Zakonisht, ndryshimet që ndodhin gjatë një muaji të caktuar reflektohen në ciklit e listë-pagesës të po atij muaji.

Gjithashtu, sipas legjislacionit tatimor në fuqi, të gjitha ndryshimet e statusit të punonjësit si marrja në punë dhe largimi nga puna dhe posti, paga, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe tatimi mbi të ardhurat deklarohen në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit në internet të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve brenda 24 orëve nga data e marrjes në punë dhe jo më vonë se 10 ditë nga data e largimit nga puna⁴³. Listë-pagesa mujore dhe zbritjet përkatëse deklarohen në mënyrë elektronike jo më vonë se 20 ditë nga fundi i muajit⁴⁴. Pra të dhënat në Excel që mbahen nga specialisti i listë-pagesës rakordohen çdo muaj me bazën e të dhënave të deklaratave online për të verifikuar zbatimin e saktë të ndryshimeve të listë-pagesës.

Për shkak të mungesës së sistemeve informatike për personelin dhe listë-pagesat dhe të integritetit të automatizuar, nevojiten aktivitete të gjera kontrolluese për të siguruar plotësinë dhe kohën e duhur të të dhënave të ndryshimit të listë-pagesave, të cilat hë për hë nuk ekzistojnë.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

23.3 Kontrolli i brendshëm i fondit të pagave

Ky dimension vlerëson masat kontrolluese që zbatohen për bërjen e ndryshimeve në të dhënat për personelin dhe pagat. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm do të duhej: ta kufizonte autoritetit për ndryshimin e evidencave dhe listë-pagesave; të kërkonte verifikim të veçantë; dhe të kërkonte vënien në dispozicion të një gjurme kontrolli që të jetë adekuate për ruajtjen e një historiku të përhershëm të transaksioneve së bashku me të dhënat e nëpunësve autorizues.

Përgjegjësia e përgjithshme për mbajtjen në kontroll të gjitha aspekteve të evidencave të personelit dhe pagave i është ngarkuar nëpunësit autorizues me Ligjin e menaxhimit të sistemit buxhetor dhe Ligjin e menaxhimit dhe kontrollit financiar. Ekipi i vlerësimit është informuar se ka një ndarje adekuate të

43. Formulari E-SIG 027

44. Formulari E-SIG 025

funksioneve midis drejtorisë së burimeve njerëzore dhe drejtorisë së financës. Përgjegjësia e burimeve njerëzore duhet të mbajë dhe përditësojë dosjet e personelit. Drejtorja e financës, në bazë të listë-prezencës, llogarit pagat, shpërblimet dhe zbritjet e mbajtura në pagë siç janë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Drejtuesit e departamenteve mbikëqyrin marrjen dhe raportimin e listë-prezencës për punonjësit përkatës çdo muaj. Ky informacion pastaj konsolidohet nga drejtorja e financës ose e burimeve njerëzore në varësi të organizimit. Të gjitha ndryshime në të dhënat e personelit përputhen me vendimet origjinale që u jepen në kohë drejtorive të burimeve njerëzore dhe financës.

Listë-pagesa mujore miratohet nga shefi i financës. Krahas kësaj, zbritjet e mbajtura në pagë për TAP dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe paga neto llogariten duke përdorur një mjet online për raportimin e listë-pagesave dhe zbritjeve të DPT. Llogaritja e zbritjeve bëhet e automatizuar dhe ekziston kërkesa për të raportuar marrjet e reja në punë dhe largimet nga puna. Të dy skedarët rakordohen me njëri-tjetrin. Në fund, pagesa miratohet nga nëpunësi ekzekutues dhe nëpunësi autorizues dhe dërgohet për ekzekutim përmes thesarit. Zbatohen masa kontrolluese mujore të thesarit për pagesat e lidhura me pagat.

Mungesa e sistemeve të integruara për personelin, pagat dhe pagimit e ndërthurur me ekzistencën e sistemeve manuale e rrit riskun në lidhje me listë-pagesat; nevojiten aktivitete kontrolluese të gjera manuale për të siguruar vlefshmërinë, plotësinë dhe kohën e duhur të ndryshimeve dhe saktësinë e llogaritjeve. Nga diskutimi me shefin e financës në disa njësi të përzgjedhura, informohemi se janë identifikuar vetëm disa gabime të vogla në llogaritjen e pagave kur ka pasur ndryshime, të cilat janë korrigjuar në muajt e ardhshëm.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

23.4 Auditimi i fondit të pagave

Ky dimension vlerëson shkallën e pacenueshmërisë së pagave. Auditimet e fondit të pagave do të duhej të kryheshin rregullisht për të identifikuar punonjësit fiktivë, për të mbushur boshllëqet në të dhëna dhe për të identifikuar dobësitë.

Njësitë e auditimit të brendshëm dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit rregullisht i përfshijnë pagat si një fushë auditimi me risk të lartë në programet e auditimit. Intervistat me një sërë njësisish të auditimit të brendshëm dhe shqyrtimi i planeve vjetore të auditimit tregojnë se cikli i auditimit për auditimet e plota për të gjitha subjektet e qeverisjes qendrore është çdo 2-3 vjet. Auditimet e plota përfshijnë edhe auditimin e aktiviteteve kontrolluese dhe testim material.

Po kështu, Kontrolli i Lartë i Shtetit kryen auditim të përputhshmërisë dhe rregullsisë në të gjitha institucionet me shpeshtësi 2-3 vjet. Pagat përfshihen në programin e auditimit të KLSH-së.

Intervistat me njësitë e auditimit të brendshëm dhe KLSH-në dhe shqyrtimi i disa raporteve të përzgjedhura tregojnë se nuk ka probleme të ndjeshme lidhur me llogaritjen e pagave, sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat personale për punonjësit. Shumica e problemeve të raportuara lidhur me pagat kanë të bëjnë me përputhshmërinë me kuadrin ligjor në marrjen në punë ose largimin nga puna dhe ekzistencën e lëvizjeve të pajustificuara të punonjësve. Pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin profesional prej vitit 2014⁴⁵, kapacitetet e dobëta në funksionin e auditimit të brendshëm dhe në KLSH e ulin cilësinë e auditimeve të tilla dhe aftësinë e tyre për të identifikuar dobësitë në masat kontrolluese dhe rastet e mashtrimit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

45. Nisma të tilla diskutohen si pjesë e vlerësimit të TP-26

TP-24. Prokurimi

Ky tregues shqyrton aspektet kyçe të menaxhimit të prokurimeve. Treguesi fokusohet te transparencja e masave organizative, theksi te procedura të hapura dhe konkurruese, monitorimi i rezultateve të prokurimit dhe e drejta për të apeluar dhe masat organizative për ankimin. Përmban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- Dimensioni 24.1: Monitorimi i prokurimeve (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQ)
- Dimensioni 24.2: Metodatat e prokurimeve (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQ)
- Dimensioni 24.3: E drejta e publikut për të parë informacionet për prokurimet (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQ)
- Dimensioni 24.4: Menaxhimi i ankesave për prokurimet (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQ).

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-24 Prokurimi	B+	Metoda e vlerësimit M2 (AV).
24.1 Monitorimi i prokurimeve	Vlerësimi i dimensionit A	Mbahen baza të dhënash ose evidenca për të gjitha kontratat përfshirë të dhënat për ato që janë prokuruar, vlerën e prokurimit dhe kush është fitues i kontratës. Planet e prokurimit publikohen në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe bëhet krahasim i planit me faktin. Prokurimi elektronik është i detyrueshëm për të gjitha metodatat e prokurimit (me përjashtim të kontraktimit të drejtpërdrejtë) edhe për kontratat me vlerë të vogël.
24.2 Metodatat e prokurimeve	Vlerësimi i dimensionit B	Të gjitha agjencitë ndjekin metodën e konkurrimit të hapur, si mundësi e parë e caktuar me ligj. Por, kontraktimi me një burim të vetëm (metoda pa konkurrim) përbën 30 për qind të vlerës gjithsej të të gjitha kontratave publike të lidhura në vitin 2016, sipas raportit të APP-së. Metoda jo konkurruese shpesh përdoret për të përmbushur nevojat e autoriteteve kontraktuese përpara miratimit të fondeve në buxhet.
24.3 E drejta e publikut për të parë informacionet për prokurimet	Vlerësimi i dimensionit A	Kuadri ligjor për prokurimin, plani i prokurimit për vitin 2017, realizimi i operacioneve të prokurimit për vitin 2016 si edhe mundësitë për tender dhe kontratat e fituara gjenden në faqen në internet të APP-së në kohën e duhur. Në faqen në internet të KPP-së publikohen brenda 48 orësh nga depozitimi i ankesave informacione për të gjitha ankesat që i shkojnë KPP-së.
24.4 Menaxhimi i ankesave për prokurimin	Vlerësimi i dimensionit B	Sistemi i ankesave për prokurimet i përmbush shumicën e kriterëve (5 nga 6) me përjashtim të dhënies së vendimeve në kohën e duhur. Janë raportuar vonesa të shpeshta, për shkak të ngarkesës së punës së KPP-së.

Efektiviteti i përgjithshëm i sistemit të prokurimeve publike në Shqipëri është përmirësuar gjatë viteve të fundit. Progres ka pasur sidomos sa i takon kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional, si edhe zhvillimit dhe funksionimit të sistemit të prokurimit elektronik. Ligji i Prokurimit Publik (LPP) zbatohet për të gjitha prokurimet publike të financuara nga buxheti i shtetit, me përjashtim të disa kategorive të caktuara që zakonisht përjashtohen nga legjislacioni i prokurimit në shumicën e vendeve. Por transparencja, performanca dhe efektiviteti i prokurimit publik mund të rriteshin shumë edhe më tej. Problemet e raportuara më shumë janë numri i lartë i rasteve të kontraktimit të drejtpërdrejtë, mungesa e të dhënave për administrimin e kontratave, shtesat e shpeshta në kontrata të cilat çojnë në rritje të konsiderueshme të çmimit të kontratës. Sektori privat vijon të raportojë mungesë besimi

në transparencën dhe rregullsinë e tenderëve publikë. Mekanizmi i shqyrtimit të ankesave është në fazë kalimtare, drejt të qenit plotësisht i pavarur pas miratimit të shtesave dhe ndryshimeve të fundit ligjore të miratuara nga Kuvendi. Numri i lartë i ankesave (1.393 gjatë vitit 2016, 19,4 për qind më shumë se një vit më parë) e cenon efektivitetin e këtij mekanizmi.

24.1 Monitorimi i prokurimeve

Ky dimension vlerëson se deri ku ka sisteme për monitorim dhe raportim qendror brenda qeverisë për të siguruar leverdishmërinë ekonomike dhe pacenueshmërinë e funksioneve të besuara.

Evidencat e prokurimeve, të cilat përfshijnë natyrën e prokurimit/informacion se çfarë është prokuruar, si edhe për vëllimin dhe vlerën e kontratave të lidhura, kohën se kur është hapur procedura e prokurimit, metodën e prokurimit dhe identifikimin e fituesve të kontratës për të gjitha⁴⁶ metodat e prokurimit për mallrat, punët dhe shërbimet, gjenden publikisht në portalin e prokurimit elektronik dhe në buletin javor të prokurimeve. Të dhënat ruhen dhe mund të shihen në arshivën elektronike të APP-së të paktën deri dy vjet pas fitimit të kontratës. Krahas kësaj, sistemi i prokurimit elektronik është i detyrueshëm⁴⁷, përfshirë edhe metodat e prokurimit me vlerë të ulët dhe mbledh dhe analizon të dhëna deri në fitimin e kontratës. Nuk ka informacione për monitorimin e kontratës duke qenë se ky funksion u përket autoriteteve kontraktuese. Palët e kontraktuara janë të detyruara t'i depozitojnë ofertat në mënyrë elektronike. APP e ka fuqizuar funksionin e monitorimit dhe ka nisur përgatitjen e një sistemi të monitorimit të performancës dhe përputhshmërisë së prokurimeve në bazë të treguesve të performancës.⁴⁸

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

24.2 Metodat e prokurimeve

Ky dimension analizon përqindjen e vlerës gjithsej të kontratave të lidhura me dhe pa konkurrim.

LPP parashikon përdorimin e metodave të mëposhtme të prokurimit:

- Procedura e hapur;
- Procedura e kufizuar;
- Procedura me negociim, me ose pa publikimin e njoftimit të kontratës;
- Kërkesë për propozime;
- Konkurs projektimi;
- Procedura për shërbim konsulence dhe
- Prokurimet me vlerë të vogël.

LPP konfirmon se procedura e hapur është metoda e preferuar e prokurimit. Në të përkufizohen ato situata në të cilat mund të përdoren metodat e tjera, raste që kushtëzohen ose nga vlera financiare prag ose nga natyra/objekti që prokurohet. Përdorimi i çdo metode prokurimi lihet në dorë të autoritetit kontraktues në përputhje me kushtet e parashikuara në LPP. LPP parashikon edhe procedura të ndryshme prokurimi në varësi të vlerës së kontratës. Mbi pragjet me vlerë të lartë, është

46. Edhe pse kontraktimi i drejtpërdrejtë/procedura me negociim, me ose pa publikimin e njoftimit të kontratës, bëhet jashtë portalit elektronik, publikimi i njoftimit për fitimin e kontratës lidhur me këtë është i detyrueshëm

47. Sipas Vendimit nr. 918, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike", shumica dërrmuese e procedurave të prokurimit publik duhet të kryhen në mënyrë elektronike

48. Raport-Progresi i KE-së 2016

i detyrueshëm konkursi i hapur; midis pragjeve të vlerave të larta dhe të ulëta, konkursi kërkohet duke ftuar të paktën tre operatorë ekonomikë. Pragjet vendosen çdo dy vjet me VKM. Pragjet e rishikuar më së fundmi, më 29 dhjetor 2014, janë si vijon:

(a) Pragjet vlerë të larta:

- 1.200.000.000 (një miliard dyqind milion) lekë (afërsisht 9,5 milion dollarë) për kontratat e punëve publike;
- 200.000.000 (dyqind milion) lekë (afërsisht 1,6 milion dollarë) për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

(b) Pragjet vlerë të vogla:

- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë (afërsisht 96.000 dollarë) për kontratat e punëve publike;
- 8.000.000 (tetë milionë) lekë (afërsisht 64.000 dollarë) për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

(c) Prokurimet me vlerë të vogël: prokurime me vlerë më pak se 800.000 lekë (afërsisht 7.000 dollarë) në një vit kalendarik konsiderohen se janë prokurime me vlerë të vogël. Procedurat për prokurimet me vlerë të vogël janë të thjeshtuara, por kryhen përmes sistemit elektronik të prokurimit.

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara në faqen zyrtare në internet të APP-së qe **5.109**⁴⁹ (479 më shumë se në 2015) me vlerë 95,44 miliard lekë. Kërkesa për propozime është metoda e përdorur më shpesh (3.106), pas së cilës vijnë procedurat me negociim (2.186) pa shpallje paraprake (kontraktimi i drejtpërdrejtë). Tenderimi i hapur (kombëtar dhe ndërkombëtar) është përdorur në 1.850 raste.

Numri çuditërisht i lartë i procedurave me negociim pa shpallje paraprake vjen për shkak të i. përdorimit të kësaj mënyre nga autoritetet kontraktuese (AK) përmes bërjes së ndryshimeve në kontratat ekzistuese për një vlerë deri në 20 për qind të kontratës fillestare për të përmbushur nevojat e tre muajve të parë në fillim të vitit, ndonjëherë shkaktuar nga vonesat në caktimin e buxhetit nga Drejtoria e Thesarit në MF për AK-të. Financimi i këtyre kontratave rregullohet nga MF; dhe ii. përdorimit të kësaj mënyre në kushtet e situatave të jashtëzakonshme (sidomos për mallra dhe shërbime bazë, si ushqimet, shërbimet e pastrimit etj.), kur ka një proces të zgjatur të shqyrtimit të ankesave nga KPP për kontratat e reja për mallra dhe shërbime.

49. Nuk përfshin procedurat me negociim pa shpallje paraprake

TABELA 3.25 Prokurimet publike, viti 2016, sipas llojit dhe vlerës

Lloji i prokurimit	Numri i prokurimeve	Vlera e prokurimeve (miliard lekë)	Gjithsej vlera e prokurimit (%)
Konkurs i hapur ndërkombëtar	15	7,6	0,2%
Konkurs i hapur kombëtar	1.835	79,9	25%
Kërkesë për propozime	3.106	7,7	42%
Procedura me negociim (përzgjedhje e drejtpërdrejtë)	2.186	8,1	30%
Shërbime të konsulencës dhe të tjera ⁵⁰	113	1,15	1,5%
Prokurime totale	(7.255) (5.109 ⁵¹ të publikuara dhe përfshira në portalin elektronik)	105,05	100,0%

Burimi: Raport Vjetor, 2016, APP

Metoda jo konkurruese shpesh përdoret për të përmbushur nevojat e autoriteteve kontraktuese në fillim të vitit përpara miratimit të fondeve në buxhet. APP raporton se kjo përbën rreth 30 për qind të kontraktimit të drejtpërdrejtë.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

24.3 E drejta e publikut për të parë informacionet për prokurimet

Ky dimension shqyrton nivelin e të drejtës së publikut për të parë informacione të plota, të besueshme dhe në kohë mbi prokurimin.

TABELA 3.26 Përmbledhje e dëshmive dhe rezultateve të vlerësimit për dimensionin 24.3

Elementi / Kërkesat	Përmbushur (po/jo)	Dëshmitë e përdorura / Komente
Kuadri ligjor dhe rregullator për prokurimin	Po	Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, përfshirë edhe dokumentet standarde të tenderit gjenden në portalin e APP-së
Planet e prokurimit të qeverisë	Po	Të gjitha planet e prokurimit publikohen në portalin e APP-së
Mundësitë për tenderë	Po	Të gjitha mundësitë e tenderit (përfshirë kontratat me vlerë të vogël) publikohen në portalin e APP-së
Shpallja e fituesit të kontratës (qëllimi, pala e kontraktuar dhe vlera)	Po	Të gjitha kontratat e fituara (përfshirë edhe me kontraktim të drejtpërdrejtë) publikohen në portalin e APP-së.
Të dhënat për zgjidhjen e ankesave për prokurimet	Po	KPP i publikon vendimet në faqen e vet në internet dhe të gjitha të dhënat konsolidohen në raportin vjetor.
Statistikat vjetore për prokurimet	Po	Statistikat vjetore të prokurimeve vihen në dispozicion në raportin vjetor të APP-së i cili publikohen në portalin e APP-së.

50. Shërbimet e tjera kanë të bëjnë me procedurën me konkurs projektimi

51. Shifrat përkojnë me procedurat e publikuara, ndërsa ato që janë finalizuar me kontratë janë 5.067. Numri gjithsej i procedurave të prokurimit të publikuara nga APP nuk përfshin kontraktimin e drejtpërdrejtë

E drejta e publikut për të parë informacionet për prokurimet realizohet përmes faqes në internet të APP-së www.app.gov.al/. Informacioni jepet në mënyrë të plotë, përfshirë edhe kuadrin ligjor dhe rregullator për prokurimin, planet vjetore të prokurimit të njësive vendore, mundësitë për tenderë dhe kontratat e fituara (qëllimi, pala e kontraktuar dhe vlera). Sistemi i APP-së është projektuar në atë mënyrë që të sigurojë transparencën dhe integritetin e procedurave. Sistemi i APP-së mundëson shqyrtimin e planeve të prokurimeve, megjithëse publikimet elektronike nuk janë të pajisura me funksione të kërimit, çka e bën të vështirë për përdoruesit. Sistemi mundëson përpunimin elektronik të prokurimeve publike përfshirë njoftimin elektronik, dokumentacionin elektronik të tenderit, dorëzimin elektronik dhe, deri diku, vlerësimin elektronik. Sipas ligjit të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese janë të detyruara ta përdorin sistemin kur shumat janë më të mëdha se 100.000 lekë (900 dollarë). Sistemi është në funksionim të plotë. Planet vjetore të prokurimit për vitin 2017 dhe aktivitetet e prokurimit në vitin 2016 i janë dërguar APP-së në janar 2017 dhe janë afishuar në faqen në internet të APP-së. Shpallja e finalizimit të procesit të tenderit dhe shpallja e fituesit si edhe shpallja e kontratës së nënshkruar publikohen në buletin mujor të APP-së, ku përfshihet informacion nga të gjitha autoritetet kontraktuese.

Ankesat dhe i gjithë dokumentacioni përkatës dorëzohet dhe mbahet në formë të shtypur dhe jo në format elektronik (p.sh., në një bazë të dhënash apo në sistemin elektronik të prokurimeve). Vendimet KPP-së bëhen publike dhe afishohen në faqen në internet të KPP-së. Publikimi i vendimeve u jep mundësi palëve të interesuara të jenë më të informuara sa i takon përputhshmërisë dhe rregullsisë së procesit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

24.4 Menaxhimi i ankesave për prokurimin

Ky dimension vlerëson ekzistencën dhe efektivitetin e një mekanizmi të pavarur të zgjidhjes administrative të ankesave.

TABELA 3.27 Përmbledhje e dëshmive dhe rezultateve të vlerësimit për dimensionin 24.4

Elementi / Kërkesat	Përbushur (po/jo)
Ankesat shqyrtohen nga një organ që nuk është i përfshirë në veprimet e prokurimit apo në procesin që çon në marrjen e vendimit për fituesin e kontratës	Po
Organi i ankesave nuk kërkon tarifa që e pengojnë përdorimin e tij nga palët e interesuara	Po
Ndiqen procese për depozitimin dhe zgjidhjen e ankesave, të cilat janë përcaktuar qartë dhe gjenden publikisht	Po
Organi i ankesave e ushtron autoritetin për ta pezulluar procesin e prokurimit	Po
Organi i ankesave i merr vendimet brenda afatit të përcaktuar në rregullore	Jo
Organi i ankesave merr vendime që janë të detyrueshme për çdo palë	Po

KPP është organi më i lartë administrativ të cilit i është ngarkuar shqyrtimi i ankesave në lidhje me prokurimin publik. Përgjegjësia kryesore e KPP-së është shqyrtimi i ankesave që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit publik dhe garantohet me ligj që anëtarët e KPP-së nuk mund të përfshihen në veprime dhe vendime prokurimi. Vendimet e KPP-së janë përfundimtare dhe mund të kundërshtohen përpara Gjykatës Administrative të Tiranës. Gjithashtu, KPP shqyrton edhe ankesat në lidhje me kontratat e koncesionit, ankandet dhe lejet minerare.

LPP i jep të drejtën e ankimit çdo personi që ka një interes në aktivitetin e prokurimit. Por LPP thotë se procesi i shqyrtimit të ankesave nuk mund të përdoret për ankesa që lindin në lidhje me kontratat për të cilat nuk kërkohet shpallje publike në vetvete: procedura me negociim pa shpallje paraprake, prokurimet me vlerë të vogël dhe kontratat e lidhura në bazë të marrëveshjeve kuadër. Kjo përjashton nga mekanizmi i shqyrtimit të ankesave thujse 30 të aktiviteteve gjithsej të prokuruar me procedurë me negociim pa shpallje paraprake.

Ankesat kundër vendimeve të AK-së i duhen drejtuar fillimisht AK-së brenda shtatë ditëve nga data e publikimit kur ankuesi ka marrë dijeni ose duhej të kishte marrë dijeni për vendimin e autoritetit kontaktues i cili kundërshtohet. Me marrjen e ankesës, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar dhe nxjerr një vendim brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Në këtë rast, titullari i autoritetit kontraktor mund të vendosë që ankesa të shqyrtohet nga punonjës që nuk janë përfshirë në vendimmarrjen objekt i ankimit.

Nëse autoriteti kontraktor nuk i përgjigjet ankuesit brenda 7 ditëve nga marrja e ankesës, ose nëse përgjigjet por e refuzon ankesën si të pabazë, ankimesi mund të paraqesë ankesë me shkrim në KPP brenda 10 ditëve kundrejt një tarife (duke paguar një tarifë të barasvlershme me 0,5 për qind të vlerës së buxhetit të caktuar për kontratën). Dokumentacionit të tenderit i bashkëlidhet një formular për depozitimin e ankesës.

Vartësia është ndryshuar kohët e fundit përmes një ndryshimi në LPP (me Ligjin nr.47/2017). KPP pritet të jetë organ i pavarur që jep llogari përpara Kuvendit. KPP përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar nga Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave me mandat pesëvjeçar që mund të përsëritet edhe me një mandat tjetër. KPP po kalon në një fazë kalimtare për gjashtë muaj deri sa të zgjidhen anëtarët e rinj. Më shumë se 70 për qind⁵² e ankesave bëhen brenda afatit të vendosur në Ligjin e Prokurimit Publik. Ankesat dhe i gjithë dokumentacioni përkatës dorëzohet dhe mbahet në formë të shtypur dhe jo në format elektronik (p.sh., në një bazë të dhënash apo në sistemin elektronik të prokurimeve). Për shkak të kësaj analiza e të dhënave bëhet e vështirë dhe kërkon shumë kohë. Është e vështirë të nxirren statistika sipas llojit të ankesës, sektorit, kategorisë së prokurimit, operatorit ekonomik etj., në një moment specifik. Vendimet KPP-së bëhen publike dhe afishohen në faqen në internet të KPP-së. Publikimi i vendimeve u jep mundësi palëve të interesuara të jenë më të informuara sa i takon përputhshmërisë dhe rregullsisë së procesit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

TP-25. Sistemi i kontrollit të brendshëm për shpenzime jo paga

*Ky tregues mat efektivitetin e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm për shpenzimet jo paga. Masat kontrolluese të veçanta për shpenzimet lidhur me pagat e shërbimit civil shihen në TP-23. Ky tregues përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve:*

- *Dimensioni 25.1: Ndarja e detyrave (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 25.2: Efektiviteti i masave kontrolluese mbi angazhimet e shpenzimeve (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 25.3: Përputhshmëria me rregullat dhe procedurat e pagimit (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ).*

52. Sipas konstatimit të Raportit të Bankës Botërore për Prokurimin dhe Zbatimin e Kontratave në Shqipëri (nxjerrë më qershor 2017)

Konteksti

Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm bazohet në vlerësimin e riskut të kontrollit të të gjitha sistemeve dhe proceseve të menaxhimit financiar. Sistemi i kontrollit të brendshëm duhet të jetë pjesë e rëndësishme e një sistemi kontrolli me efektivitet të kostos për të nxitur përputhshmërinë me kërkesat ligjore, për të ulur mundësitë për mashtrim dhe korrupsion, për të mbrojtur pasurinë publike dhe për të siguruar krijimin në kohën e duhur të informacioneve financiare të sakta dhe të plota. Që sistemi të funksionojë me efikasitet, duhet të kuptohet gjerësisht dhe të respektohet nga të gjithë pjesëmarrësit e sistemit të menaxhimit financiar.

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-25 Sistemi i kontrollit të brendshëm për shpenzime jo paga	Vlerësimi i përgjithshëm B	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
25.1 Ndarja e detyrave	Vlerësimi i dimensionit C	Ndarja e detyrave parashikohet në të gjithë procesin e shpenzimeve. Mund të ketë nevojë për një përcaktim më preciz të përgjegjësive të rëndësishme.
25.2 Efektiviteti i masave kontrolluese mbi angazhimet e shpenzimeve	Vlerësimi i dimensionit C	Ekzistojnë procedura të mbajtjes në kontroll të angazhimeve të shpenzimeve, të cilat sigurojnë mbulim të pjesshëm dhe janë pjesërisht efektive.
25.3 Përputhshmëria me rregullat dhe procedurat e pagimit	Vlerësimi i dimensionit A	Të gjitha pagesat janë në përputhje me procedurat e rregullta të pagesave. Të gjitha përjashtimet autorizohen si duhet paraprakisht dhe justifikohen.

25.1 Ndarja e detyrave

Ky dimension vlerëson ekzistencën e ndarjes së detyrave, që është një element themelor i kontrollit të brendshëm për të parandaluar që një punonjës ose një grup punonjësish të jenë në gjendje të kryejnë ose të fshehin gabime apo mashtrime në kryerjen e detyrave.

Në Ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 22⁵³, veprimtaritë e kontrollit përshkruhen si masa kontrolluese minimale të cilat duhet të zbatohet çdo titullar njësie të sektorit publik. Ndër veprimtaritë më të konsiderueshme të kontrollit përfshihen: 1. ndarja e detyrave; 2. sistemi i dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë; dhe 3. rregullat për dokumentimin e të gjitha transaksioneve dhe të veprimtarive që lidhen me mbarëvajtjen e njësisë.

Roli i palëve të ndryshme të përfshira në sistemin e kontrollit të menaxhimit financiar përcaktohet në Ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"⁵⁴ dhe Ligjin "Për menaxhimin e sistemin buxhetor"⁵⁵ dhe në aktet nënligjore të lidhura me to⁵⁶. Këtu përfshihen Ministri i Financave, nëpunësi i parë autorizues (Sekretari i Përgjithshëm i MF-së), nëpunësi autorizues i njësisë dhe nëpunësit autorizues të vartësisë, nëpunësit zbatues dhe eprorët e linjës. Këto role janë përcaktuar qartë në legjislacion, një udhëzim i veçantë rregullon rolet dhe përgjegjësitë brenda njësive publike për menaxhimin e aktiveve⁵⁷.

Sipas ligjit, nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore dhe njësive të fondeve speciale të qeverisjes qendrore japin llogari dhe raportojnë përpara nëpunësit të parë autorizues për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin dhe kontabilizimin e buxhetit

53. Ligji nr. 10 296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015.

54. Nenet 6-12 të Ligjit

55. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr.57 datë 02.06.2016

56. Udhëzimi i Ministrisë të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"

57. Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik"

të tyre. Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme cakton nëpunës autorizues të nivelit të dytë, drejtuesin e programeve, nënprogrameve, në çdo strukturë dhe njësi të vartësisë së drejtpërdrejtë. Në njësitë publike me disa nivele të njësisve shpenzuese, nëpunësit autorizues përcaktohen si nëpunës autorizues i nivelit të dytë ose të tretë nga titullari i institucionit.

Gjithashtu, njësitë e sektorit publik duhet të ngrenë një strukturë organizative në formë shkresore; ku të përshkruhen rregullat për caktimin dhe ndarjen e detyrave, detyrimeve dhe përgjegjësisë, si edhe hierarkia dhe linjat e raportimit. Gjatë shqyrtimit të përbërjes së drejtorive të financës dhe buxhetit të organizatave, është vënë re se drejtoritë e financave vuajnë nga numri i pakët i punonjësve, çka cenon parimet e ndarjes së punës dhe detyrave dhe për pasojë arritjen e objektivave të njësisë së sektorit publik.

Struktura organizative plotësohet me rregulloret e brendshme dhe përshkrimet e punës. DAP ka vërejtur se shumica e institucioneve nuk i kanë reflektuar ndryshimet më të fundit organizative në rregulloren e brendshme⁵⁸; për rrjedhojë, rolet dhe përgjegjësitë nuk janë lidhur me strukturën e re. Janë vënë re dobësi edhe në cilësinë e përshkrimeve të punës të përgatitura nga organizata⁵⁹. Gjatë vitit 2016 DAP ka përgatitur përshkrimet e punës dhe termat e referencës për ato pozicione që nuk ndryshojnë mes organizatave dhe përshkrimet e përgjithshme të punës, që janë pjesë integrale e VKM nr.142, datë 12.03.2014, me ndryshimet e mëpasshme.

Raporti vjetor i KBFP-së për vitin 2016 vërente se manualet dhe gjurmët e auditimit që përshkruajnë proceset dhe veprimtaritë e kontrollit⁶⁰ nuk përgatiten dhe nuk zbatohen në të gjitha institucionet, pavarësisht arritjen e njëfarë progresi në këtë fushë. Harta e procesit dhe gjurma e auditimit përgatitet vetëm në fushën e prokurimit. Në praktikë, ka mungesë të kuptuarit të nevojës për përshkrime të proceseve të punës, të cilat shpesh ngatërrohen me përshkrimet e punës. Gjatë intervistave të vlerësimit të kryera në disa institucione të përzgjedhura, është vërejtur se politikat dhe procedurat e padokumentuara për procesin e zbatimit të buxhetit kanë çuar në mungesa të efikasitetit në procesin e menaxhimit të kërkesave, angazhimeve, pagesave dhe raportimit. Kjo ka ndodhur ngaqë rolet dhe përgjegjësitë në departamentet e ndryshme nuk janë të përcaktuara dhe dokumentuara qartë.

Ka edhe praktika jo në përputhje sa u takon masave organizuese për zbatimin lidhur me projektet e financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare. Ka raste kur ngrihen njësi të veçuara për zbatimin e projekteve të donatorëve, si njësi shpenzuese më vete pranë agjencisë kryesore zbatuese (ministri ose institucione të vartësisë). Në raste të tilla, ka një risk më të lartë kontrolli për shkak të mungesës së faktorit udhëheqës, kontrollit mbikëqyrës dhe ndarjes së detyrave.

Zhvillimet e kohëve të fundit në këtë fushë e vënë theksin te zhvillimi praktik i llogaridhënies së menaxhimit dhe delegimit të detyrave. Në shumicën e institucioneve nuk zbatohet delegimi i detyrave, siç thuhet në nenet 9, 12 dhe 15 të Ligjit "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

25.2 Përputhshmëria me rregullat dhe procedurat e pagimit

Ky dimension vlerëson se sa respektohen rregullat dhe procedurat e masave kontrolluese mbi pagesat në bazë të dëshmive të disponueshme.

Kontrollet e angazhimit mbi veprimet financiare paga dhe jo paga janë të pranishme në sistemet e

58. Ministria e Financave, Projekt-Raporti vjetor i KBFP-së për vitin 2016

59. Departamenti i Administratës Publike, Raport Vjetor 2016, f. 24

60. Siç e kërkon neni 16 i Ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin

kontrollit të njërive të qeverisjes qendrore. Sipas nenit 40 të ligjit organik të buxhetit, me ndryshimet e muajit qershor 2016, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria e Financave që fondet, të cilat synohet të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime. Me t'u mbyllur me sukses procedura e prokurimit dhe me t'u nënshkruar kontrata, angazhimi/urdhër-blerja regjistrohet në sistemin informatik të thesarit (SIQF). Kërkesë-pagesat dorëzohen më pas kundrejt urdhër-blerjes së regjistruar.

Sikurse thuhet në TP-22, pavarësisht nga përmirësimet e kohëve të fundit në masat kontrolluese mbi angazhimet, ka ende raste kontratash të vjetra të pafaturuara që janë lidhur përpara vënies në zbatim këtij kadri të ri organizativ, të cilat nuk janë të regjistruara në sistem.

Sistemi informatik i thesarit nën kontrollin e MF-së (SIQF) nuk u jep të drejta hyrjeje të drejtpërdrejtë të gjitha njërive buxhetore⁶¹, çka do të thotë se sistemet manuale mbizotërojnë dhe rrezikojnë efektivitetin e masave kontrolluese mbi angazhimet dhe mbi pagesat e tjera. Edhe atëherë kur është dhënë kjo e drejtë hyrjeje në sistem, numri i kufizuar i përdoruesve dhe ndarja jo efikase e detyrave midis përdoruesve e pakëson efektivitetin e kontrolleve të sistemit.

Gjatë intervistave, ekipi i vlerësimit vërejtë se nuk ka masa kontrolluese monitoruese. Masa të tilla kontrolluese si shqyrtimi i vjetërimit të urdhër-pagesave të hapura dhe kërkesë-pagesave, rakordimet dhe monitorimi dhe ndjekja e zërave me afat të kaluar, apo raportet e menaxhimit do ta rrisnin efektivitetin e masave kontrolluese mbi angazhimet. Në përgjithësi ekzistojnë procedura të mbajtjes në kontroll të angazhimeve të shpenzimeve, të cilat sigurojnë mbulim të pjesshëm dhe janë pjesërisht efektive.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

25.3 Përputhshmëria me rregullat dhe procedurat e pagimit

Ky dimension vlerëson se sa respektohen rregullat dhe procedurat e masave kontrolluese mbi pagesat në bazë të dëshmive të disponueshme.

Udhëzimet e thesarit për regjistrimin, përpunimin dhe raportimin e transaksioneve janë të qarta dhe respektohen nga nëpunësit e financës të përfshirë në përgatitjen dhe regjistrimin e transaksioneve. Në Shqipëri, degët e Thesarit (DTH) kanë përgjegjësinë e fundme për kryerjen e pagesave. Sistemi informatik i Thesarit (SIQF) ka kontrolle të gjera të integruara brenda tij, të cilët sigurojnë zbulimin e gabimeve përpara se të futen në sistem dhe korigjimin e tyre gjatë përpunimit. Konkretisht, çdo urdhër-pagese që paraqitet nga institucionet buxhetore kontrollohet nga nëpunësit e financës të DTH-së përpara se të përpunohet, pavarësisht nëse njësia ka ose jo të drejtë hyrjeje në sistem.

Duke filluar prej vitit 2015, Ministria e Financave monitoron performancën e një pakete treguesish kyç për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në të gjitha njësitë e sektorit publik në qeverisjes qendrore dhe vendore dhe rezultatet paraqiten në raportin vjetor të KBFP-së⁶². Ka pasur përmirësim me kalimin e viteve, në ecurinë e treguesit që vlerëson respektimin e rregullave dhe procedurave të pagesave, sipas vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Në vitin 2016, treguesi që mat shkallën e refuzimit nga DTH të urdhër-shpenzimeve (kërkesë-pagesave) të lëshuara nga ministritë e linjës luhatet mes 0 deri 1,9 për qind e të gjitha kërkesë-pagesave.

Auditimet e përputhshmërisë të kryera nga njësitë e auditimit të brendshëm por edhe nga KLSH gjatë viteve të fundit nuk kanë raportuar mangësi të konsiderueshme dhe mospërputhje të veprimeve të

61. 15 institucione (ministri të linjës, agjenci kombëtare dhe Bashkia Tiranë) janë përdorues të drejtpërdrejtë të SIQF-së nëpërmjet GovNet. Institucionet e tjera buxhetore funksionojnë nëpërmjet degëve të thesarit

62. Urdhër i Ministrit të Financave nr.89 datë 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike"

pagesave për shpenzimet jo paga me procedurat e vendosura (procedurat e rregullta dhe procedurat për përjashtimet).

Në përgjithësi, të gjitha (rëndësia materiale sipas vlerës të përkufizuar në Kuadrin PEFA 2016) pagesat janë në përputhje me procedurat e rregullta të pagesave. Të gjitha (rëndësia materiale sipas vlerës të përkufizuar në Kuadrin PEFA 2016) përjashtimet autorizohen si duhet paraprakisht dhe justifikohen.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

TP-26. Auditimi i brendshëm

Ky tregues vlerëson standardet dhe procedurat e zbatuara në auditimin e brendshëm. Përmban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën M1 (WL) për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- *Dimensioni 26.1: Mbulimi i auditimit të brendshëm (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 26.2: Natyra e auditimeve dhe standardeve të përdorura (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 26.3: Zbatimi i auditimeve të brendshme dhe raportimit (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 26.4: Reagimi ndaj auditimeve të brendshme (Periudha kohore: raportet e auditimit për vlerësimin duhet të kenë dalë në tre vitet e fundit fiskale, 2014, 2015, 2016, mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-26 Auditimi i brendshëm	Vlerësimi i përgjithshëm C+	Metoda vlerësimit M1 (WL)
26.1 Mbulimi i auditimit të brendshëm	Vlerësimi i dimensionit A	Funksioni i auditimit të brendshëm është funksional për të gjitha subjektet e qeverisjes qendrore.
26.2 Natyra e auditimeve dhe standardeve të përdorura	Vlerësimi i dimensionit C	Funksioni i auditimit të brendshëm ende nuk ka natyrë sistematike apo diagnostikuese në vlerësimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm.
26.3 Zbatimi i auditimeve të brendshme dhe raportimit	Vlerësimi i dimensionit A	Në bazë të informacioneve të njësisë qendrore të harmonizimit gjatë vitit 2016, është zbatuar 90 për qind e planit të auditimit. Në organizatat e vizituara të gjitha ndryshimet e planit fillestar të auditimit janë miratuar nga titullari i organizatës mbështetur në justifikim. Audituesit e brendshëm ia paraqesin raportet ministrit dhe titullarit të subjektit publik të audituar.
26.4 Reagimi ndaj auditimeve të brendshme	Vlerësimi i dimensionit B	Niveli drejtues reagon në mënyrë të pjesshme ndaj rekomandimeve të auditimeve për të gjitha subjektet e audituara brenda 12 muajve pas nxjerrjes së raportit.

Konteksti

Auditimi i brendshëm, siç e kërkon Ligji nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", duhet të përmbushë standardet ndërkombëtare sa i takon a. strukturës së duhur, sidomos lidhur me pavarësinë profesionale, b. gjerësisë së mjaftueshme të mandatit, të drejtës për t'u informuar dhe kompetencës për të raportuar dhe c. përdorimit të metodave profesionale të auditimit, përfshirë edhe teknikat e vlerësimit të riskut. Ky ligj siguron pavarësinë funksionale të funksionit të auditimit të brendshëm përmes vartësisë dhe dhënies llogari drejtpërdrejt te titullari i organizatës. Aktiviteti i auditimit

të brendshëm monitorohet në mënyrë të përvitshme nga njësia qendrore e harmonizimit pranë MF-së. Funkzioni i auditimit të brendshëm fokusohet te raportimi për çështjet e rëndësishme për sistemin, në lidhje me: besueshmërinë dhe pacenueshmërinë e informacioneve financiare dhe operative; efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve; ruajtjen e aktiveve; dhe përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore dhe me kontratat.

Ligji nr. 114 ka zëvendësuar Ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007 "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik". Ndryshimet në ligj janë fokusuar kryesisht në fuqizimin e proceseve të 1. marrjes në punë, 2. certifikimit dhe 3. zhvillimit të vazhdueshëm profesional të audituesve të brendshëm. Krahas kësaj, Ligji fut në zbatim për herë të parë komitetin e auditimit në subjektet publike, si një organ i pavarur monitorues dhe këshillues për nivelin e lartë drejtues. Në vitin 2015 është ngritur me mbështetjen e donatorëve një program i ri certifikimi për audituesit e brendshëm që futen në këtë profesion. Në kuadër të programit të trajnimit në formë zhvillimi të vazhdueshëm profesional me të njëjtin projekt, gjatë periudhës 2014-2017 të gjithë audituesit e brendshëm që punojnë në sektorin publik kanë ndjekur trajnimin e detyrueshëm. Në të shkuarën nuk ka pasur aktivitete të tilla të ngritjes së kapaciteteve.

Sipas ligjit, audituesit e brendshëm duhet të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet, Audituesi i brendshëm në nivel fillestar duhet të ketë përvojë pune 3 vjet në lidhje me diplomën e nivelit të dytë dhe brenda 2 viteve të para që punon si auditues i brendshëm duhet t'i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si "Auditues i brendshëm", procedurë e cila administrohet nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm pranë MF-së. Audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet ose në fusha të lidhura ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm. Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë po ashtu i certifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm. Aktualisht ka 1.874 auditues të brendshëm të certifikuar nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, nga të cilët 197 aktualisht punojnë në administratën shtetërore së bashku me 26 auditues të lartë. 214 punonjësit e auditimit të brendshëm në administratën e qeverisjes qendrore punojnë në 58 njësi të auditimit të brendshëm.

26.1 Mbulimi i auditimit të brendshëm

Ky dimension vlerëson shkallën me të cilën subjektet shtetërore janë objekt i auditimit të brendshëm.

Njësitë e auditimit të brendshëm në të gjitha subjektet e qeverisjes qendrore dhe të qeverisjes vendore janë ngritur sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr.83, datë 03.02.2016. VKM kërkon që të krijohen njësi të auditimit të brendshëm në:

- Të gjitha ministritë e linjës, institucionet e varësisë të organizuara me degë territoriale dhe të gjitha bashkitë;
- Të gjitha subjektet e tjera publike (që krijojnë të ardhura, OJQ dhe sipërmarrjet e përbashkëta) të cilat zotërohen, kontrollohen dhe financohen nga një njësi e qeverisjes qendrore, që përmbushin këto kriterë: i. 400 milion lekë të ardhura (ekuivalent 3 milion euro) dhe ii. 300 punonjës gjatë 3 viteve të fundit të veprimtarisë;
- Për subjektet publike që nuk kanë njësi të auditimit të brendshëm, funksioni i auditimit të brendshëm kryhet nga institucioni publik në varësi të të cilit është vendosur njësia;
- Subjektet publike që nuk përmbushin kriteret për krijimin e një njësie të auditimit të brendshëm dhe nuk janë në varësi të një njësie tjetër mund ta sigurojnë funksionin e auditimit të brendshëm nëpërmjet marrëveshjes me subjekte publike që kanë njësi të auditimit të brendshëm ose me konsulentë të certifikuar të auditimit të brendshëm.

Janë krijuar dhe ushtrojnë aktivitet 112 njësi të auditimit të brendshëm, nga të cilat 58 në institucione dhe subjekte të qeverisjes qendrore. Gjithashtu, 7 institucione të qeverisjes qendrore i kanë siguruar shërbimet e auditimit të brendshëm nga brenda qeverisjes qendrore.

TABELA 3.28 Përmbledhje e subjekteve të qeverisjes që janë objekt i auditimit të brendshëm

	Njësi AB	Siguruar nga jashtë njësisë	Gjithsej
Ministritë e linjës	16		16
Institucione të tjera të qeverisjes qendrore	20		20
Spitale	8		8
Universitete	5		5
Institucione të pavarura shtetërore	9	7	16
Gjithsej	58	7	65

Siç thuhet në Ligjin e Auditimit, roli i auditimit të brendshëm është të ndihmojë njësinë publike për të arritur objektivat. Në raportin vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2016, përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave, vihet re se 90% e NJAB-ve i kanë objektivat e tyre në përputhje me objektivat e njësisë publike. Sipas Ligjit për auditimin e brendshëm, njësia e auditimit të brendshëm identifikon dhe vlerëson risqet e subjekteve publike gjatë procesit të planifikimit. Si rezultat i këtij vlerësimi, njësitë me risk të lartë janë përfshirë në planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit. Plani strategjik i auditimit 2017-2019 dhe plani vjetor i auditimit 2017 janë miratuar nga drejtuesit e njësisë publike deri në fund të vitit 2016 dhe i janë paraqitur Ministrisë së Financave për shqyrtim dhe komente. Objekti dhe perioda e mbulimit të auditimit ndryshon nga një subjekt në tjetrin dhe me sa kuptojnë vlerësuesit gjatë procesit të përgatitjes së planifikimit të auditimit mbulimi në përqindje sa i takon raportit shpenzime/të ardhura që i nënshtrohen auditimit nuk merret në konsideratë duke qenë se procesi ndjek një qasje të bazuar në vlerësimin e riskut. Në organizatat e vizituara, është vënë re se subjektet e varësisë auditohen të paktën çdo dy vjet. Vetëm në disa raste disa njësi të vogla auditohen të paktën çdo 5 vjet. Për çdo detyrë auditimi, përgatitet një program auditimi për të cilin bihet dakord me drejtuesit e njësisë së audituar përpara se të fillojë puna në terren. Ka lista kontrolli dhe modele standarde që përdoren për dokumentimin e të gjithë hapave të auditimit. E gjithë puna bëhet me dorë dhe dokumentacioni standard dhe dëshmitë e tjera arkivohen në dosje fizike. Në dosjet e auditimit ka prova të shqyrtimit nga personeli në nivele të larta. Raportet e auditimit dhe korrespondenca përkatëse me njësitë e audituara mbahet në dosje. Ka dëshmi të veprimtarive pasuese, si angazhimet e ndjekjes në vijimësi të kryera nga njësitë e auditimit të brendshëm, ndjekjet në vijimësi të bëra nga niveli drejtues në mënyrë periodike dhe/ose të përfshira si aktivitet në programin e auditimit të ardhshëm nga njësia e auditimit të brendshëm.

Gjatë vizitave, ekipi i vlerësimit vërejt se njësitë e auditimit të brendshëm të krijuara në ministritë e linjës ende bëjnë auditim të subjekteve në varësi që kanë krijuar edhe ato një funksion të auditimit të brendshëm sipas VKM-së, pavarësisht se kjo nuk lejohet me ligj. Për pasojë, burimet e auditimit të brendshëm nuk përdoren me efikasitet dhe efektivitet në të gjitha organizatat. Krahas kësaj, është raportuar vazhdimisht se njësitë e auditimit të brendshëm nuk përfshijnë rregullisht në planin e auditimit auditimin e veprimtarive të ministrisë së linjës. Pavarësisht dobësive të vërejtura, në përgjithësi, auditimi i brendshëm është funksional për të gjitha (rëndësia materiale sipas vlerës të përkufizuar në Kuadrin PEFA 2016) subjektet e qeverisjes siç dëshmohet nga ekzistenca e akteve ligjore dhe nënligjore dhe/ose e procedurave dhe nga ekzistenca e programeve të punës së auditimit, dokumentacionit të auditimit, raportimit dhe aktiviteteve të ndjekjes në vijimësi që çojnë në arritjen e objektivave të auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

26.2 Natyra e auditimeve dhe standardeve të përdorura

Ky dimension vlerëson natyrën e auditimeve të kryera dhe shkallën e respektimit të standardeve profesionale.

Kuadri ekzistues rregullator i njësive të auditimit të brendshëm, përfshirë Ligjin për Auditimin e Brendshëm, Manualin e Auditimit, Kodin Etik, Kartën e Auditimit të Brendshëm si edhe akte të tjera ligjore, është në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm. Respektimi i këtij kuadri vlerësohet në mënyrë periodike nga MF dhe trajnimi për zhvillim të vazhdueshëm profesional realizohet periodikisht në bazë të nevojave vjetore për trajnim.

Sipas manualit të auditimit të brendshëm, ka gjashtë lloje auditimi që mund të kryejë njësia e auditimit të brendshëm gjatë veprimtarive të veta: auditim i plotë, auditim financiar, auditim i përputhshmërisë, auditim i performancës dhe i teknologjisë informatike ose auditime të kombinuara. Gjatë vitit 2016, 53 për qind e auditimeve të kryera nga njësitet e auditimit të brendshëm qenë auditime të plota, ndërsa 26 për qind dhe 5 për qind, përkatësisht, qenë auditime të përputhshmërisë dhe auditime financiare⁶³.

Në praktikë, audituesit e brendshëm përballen me mungesë mbështetjeje dhe me keqinterpretim të funksionit të tyre nga ana e drejtuesve të lartë. Funksioni i auditimit të brendshëm në shumicën e rasteve është kthyer në një lloj tjetër veprimtarie kontrolluese dhe kryesisht konsiston në shqyrtime pas faktit të fokusuar te verifikimi i veprimit financiar dhe i përputhshmërisë. Audituesit e kuptojnë në mënyrë të kufizuar auditimin e bazuar në sistem dhe kërkesat si të tilla nuk pasqyrohen në materialet dhe raportet e punës së tyre, pavarësisht se plani i auditimit thotë se do të kryejnë vlerësim auditimi të sistemeve të veçanta. Dokumentacioni i auditimit për vlerësimin e riskut dhe testimin e kontrollit të brendshëm, pavarësisht se përdor modelet e miratuar dhe listat standarde të kontrollit nuk i pasqyron kërkesat e vendosura në manualin e auditimit. Dhe në fund, raportet nuk përmirësohen me ndonjë analizë më të hollësishme të sistemit të kontrollit të brendshëm, përshkrim të konstatimeve, efektit dhe rekomandimin përkatës për çdo konstatim.

Krahas aftësive të dobëta teknike, funksioni i auditimit të brendshëm nuk i ka në çdo rast burimet e nevojshme dhe strukturën për t'i mbështetur plotësisht aktivitetet e planifikuara. Aktualisht, struktura e 15 njësive nga 58 njësi janë të pajisura me një ose dy auditues dhe në 9 njësi nuk ka ende drejtues të njësive. Si për ta përkeqësuar situatën, edhe ato pak burime që janë nuk përdoren me efikasitet dhe efektivitet nga drejtuesit e organizatës. Gjithashtu mungojnë aftësitë e specializuara, si audituesit e teknologjisë informatike, sidomos në ato institucione që mbështeten shumë te sistemet informatike. Kufizime të tilla, përveç se prekin cilësinë e auditimeve, nuk do të lejonin ndarjen e duhur të punës dhe ushtrimin si duhet të aktivitetëve të sigurimit të cilësisë.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, pavarësisht se ka pasur progres pozitiv në këtë fushë pas vlerësimit të mëparshëm, aktivitetet e auditimit të brendshëm sigurojnë garanci të kufizuara sa i takon nivelit adekuat dhe efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe fokusohen kryesisht te përputhshmëria financiare.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

63. Burimi: MF, Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

26.3 Zbatimi i auditimeve të brendshme dhe raportimit

Ky dimension vlerëson dëshmitë specifike për një funksion efektiv të auditimit të brendshëm (ose monitorimi të sistemeve) siç dëshmohet nga përgatitja e programeve vjetore të auditimit dhe zbatimi faktik i tyre përfshirë edhe vënien në dispozicion të raporteve të auditimit të brendshëm.

Sipas Ligjit për auditimin e brendshëm, njësia e auditimit të brendshëm identifikon dhe vlerëson risqet e subjekteve publike gjatë procesit të planifikimit. Si rezultat e këtij vlerësimi, njësitë me risk të lartë janë përfshirë në planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit (ose të programit vjetor të auditimit siç e përkufizon Kuadri PEFA 2016). Këto dokumente miratohen nga drejtuesit e njësiteve publike deri në fund të vitit dhe i paraqiten Ministrisë së Financave për shqyrtim dhe komente. Në bazë të të dhënave të MF-së, të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm kanë përgatitur programe të auditimit të brendshëm për vitin 2016.

Në organizatat e vizituara të gjitha ndryshimet e planit fillestar të auditimit janë miratuar nga titullari i organizatës mbështetur në justifikim. Shkaqet kryesore të ndryshimeve të tilla janë i. mbivendosja me planin e kontrollit të KLSH-së, ii. ndryshimet në vlerësimin e riskut që ndodhin gjatë vitit dhe iii. ndryshimet në prioritetet gjatë vitit. Audituesit e brendshëm ia paraqesin raportet ministrit dhe titullarit të subjektit publik të audituar. Nxirret një raport vjetor i punës për aktivitetet e auditimit në vitin e fundit, ku jepet informacion për angazhimet faktike të auditimit të kryera, raportet e hartuara dhe të shpërndara, rekomandimet dhe ndjekjen në vijimësi. Një raport i tillë pune i paraqitet titullarit të institucionit dhe pastaj Ministrisë së Financave nga të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm.

Në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë MF-së lidhur me aktivitetin e auditimit të brendshëm në qeverisjen qendrore gjatë vitit 2016⁶⁴, numri i angazhimeve të auditimit të përfunduara gjatë vitit 2016 qe 10 për qind nën planin (833 nga 929, apo 90 për qind realizim). Pra, **të gjitha** (rëndësia materiale sipas vlerës të përkufizuar në Kuadrin PEFA 2016) auditimet e programuara kryhen.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

64. Në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga njësitë e auditimit të brendshëm në raportet vjetore të punës

26.4 Reagimi ndaj auditimeve të brendshme

Ky dimension vlerëson se sa veprohet nga drejtuesit në përgjigje të konstatimeve të auditimit të brendshëm.

Përgjegjësia për zbatimin e rekomandimeve u bie drejtuesve të subjekteve të audituara, njësitë e auditimit të brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve që kanë lënë. Në institucionet e vizituara, ekipi i vlerësimit vërejt se njësitë e auditimit të brendshëm bëjnë ndjekjen në vijimësi. Kjo ndjekje në vijimësi dokumentohet në forma të ndryshme si angazhimet e ndjekjes në vijimësi të kryera nga njësitë e auditimit të brendshëm, ndjekjet në vijimësi të bëra nga niveli drejtues në mënyrë periodike dhe/ose të përfshira si aktivitet në programin e auditimit të ardhshëm nga njësitë e auditimit të brendshëm. Gjatë ndjekjes në vijimësi, njësitë e auditimit të brendshëm konfirmon nëse është zbatuar rekomandimi apo janë marrë masa nga ekipi drejtues dhe nëse reagimi përkatës është i përshtatshëm. Nga auditimet e shqyrtuara, duket se konstatimet dhe rekomandimet janë diskutuar me drejtuesit e subjektit të audituar dhe janë bërë ndryshimet sipas rastit. Tabelat e miratuara të planit të auditimit nuk përdoren gjerësisht si mjet monitorimi. Megjithëse në përgjithësi cilësia e rekomandimeve të auditimit është përmirësuar duke u fokusuar më shumë te përmirësimi i kuadrit të kontrollit të brendshëm, struktura organizative dhe ngritja e kapaciteteve të personelit, vërehen ende mangësi të gjitha organizatat, si: rekomandime që kanë të bëjnë me veprimet financiar dhe jo me sistemin e kontrollit të brendshëm, rekomandime që nuk mbështeten në konstatimet e auditimit dhe nuk ofrojnë zgjidhje të qarta dhe konkrete.

Analiza e të dhënave të përgjithshme të funksionit të auditimit të brendshëm⁶⁵ për 3 vitet e fundit tregon se megjithëse pranimi konstatimeve të auditimeve nga drejtuesit e subjekteve të audituara është në nivel relativisht të lartë (99 për qind e konstatimeve pranohen nga subjektet e audituara), mesatarisht gjatë 3 viteve të fundit jo më shumë se 55 për qind e rekomandimeve janë zbatuara brenda 12 muajsh pas daljes së raportit. Pra ekipi i vlerësimit arriti në përfundimin se brenda një viti pas daljes së raportit të auditimit, për **të gjitha** subjektet e audituara, drejtuesit e subjekteve të audituara **reagojnë në mënyrë të pjesshme** ndaj rekomandimeve të lëna nga auditimi.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

65. Analizë e bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave në bazë të të dhënave të raportuara çdo vit nga të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm të krijuara në organizatat/njësitë e administratës shtetërore e të paraqitura në raportin vjetor të punës



3.6 SHTYLLA VI: Kontabiliteti dhe raportimi

TP-27. Paprekshmëria e të dhënave financiare

Ky tregues vlerëson se sa llogaritë bankare të thesarit, llogaritë e përkohshme dhe llogaritë për fondet paradhënie rakordohen rregullisht dhe se si proceset e zbatuara e mbështesin pacenueshmërinë e të dhënave. Përmban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- *Dimensioni 27.1: Rakordimi i llogarive bankare (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit mbulon vitin fiskal paraardhës, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 27.2: Llogaritë e përkohshme (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit mbulon vitin fiskal paraardhës, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 27.3: Llogaritë paradhënie (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit mbulon vitin fiskal paraardhës, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 27.4: Proceset e integritetit të të dhënave financiare (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQB).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-27 Paprekshmëria e të dhënave financiare	Vlerësimi i përgjithshëm B+	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
27.1 Rakordimi i llogarive bankare	Vlerësimi i dimensionit B	Rakordimi bankar për të gjitha llogaritë bankare aktive të qeverisjes qendrore bëhet të paktën çdo muaj, në nivel agregat dhe të detajuar dhe zakonisht brenda një jave pas fundit të muajit.
27.2 Llogaritë e përkohshme	Vlerësimi i dimensionit A	Rakordimi i llogarive të përkohshme bëhet të paktën çdo muaj, brenda një muaji pas fundit të çdo muaji. Llogaritë e përkohshme mbylljen brenda afateve, jo më vonë se fundi i vitit fiskal, nëse përndryshe nuk justifikohet rregullisht.
27.3 Llogaritë paradhënie	Vlerësimi i dimensionit A	Në përgjithësi, paradhëniet përdoren vetëm në kontratat e projekteve të financuara nga donatorë/institucione financiare ndërkombëtare dhe ka një grafik kohor të përcaktuar mirë për rakordimin dhe mbylljen në përputhje me marrëveshjet kontraktore. Në përgjithësi, kryhet në mënyrë të përmuajshme, brenda një muaji, kur sipërmarrësi lëshon faturat, raportet përmbledhëse dhe situacionet dhe kur këto miratohen nga drejtuesit e njësisë.
27.4 Proceset e integritetit të të dhënave financiare	Vlerësimi i dimensionit B	E drejta për të hyrë në evidenca dhe për t'i ndryshuar ato është e kufizuar dhe e regjistruar dhe lë pas gjurmë auditimi.

27.1 Rakordimi i llogarive bankare

Ky dimension vlerëson rregullsinë e rakordimit bankar.

Thesari rakordon përditë të gjitha tepricat e likuiditetit me nënlllogaritë e llogarisë unike të thesarit dhe llogaritë e tjera bankare në Bankën Qendrore të Shqipërisë të administruar nga Ministria e Financave. Llogaritë jashtë llogarisë unike të thesarit të mbajtura në Bankën e Shqipërisë konsistojnë në fondet speciale të shpronësimit, kompensimin e ish-pronarëve dhe një numër i kufizuar i llogarive të përcaktuara bankare për projektet e financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare/donatorët, në lekë, euro dhe dollarë. Llogaritë bankare të mbajtura në bankat e nivelit të dytë kanë të bëjnë me llogaritë bankare operative për projektet e financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare/donatorët, llogaritë bankare të administruara nga institucionet buxhetore të kërkuara me ligj, si prokuroria dhe agjencia e kompensimit të pronarëve. Llogaritë në bankat e nivelit të dytë rakordohen çdo muaj dhe raportet përkatëse dorëzohen në Ministrinë e Financave brenda 5 ditësh pas fundit të muajit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

27.2 Llogaritë e përkohshme

Ky dimension vlerëson se sa llogaritë e përkohshëm, përfshirë edhe depozita/detyrime të ndryshme, rakordohen rregullisht dhe mbyllen në kohën e duhur.

Sipas Ministrisë së Financave llogaritë e përkohshme kanë të bëjnë me klasën e llogarive 480 "Të ardhura për t'u klasifikuar ose për t'u rregulluar" që përdoren përkohësisht për të regjistruar të ardhura ose arkëtime që janë në pritje të klasifikimit. Duke qenë se të ardhurat dhe arkëtimet mbledhen nga bankat e nivelit të dytë në emër të DPT-së, DPD-së, FSKSH-së ose FSSH-së, arkëtimet regjistrohen përkohësisht në këtë llogari dhe më pas riklasifikohen në llogaritë përkatëse të të ardhurave për tatimet, taksat doganore dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Rregullimi bëhet përditë për të ardhurat e arkëtuara në emër të DPT-së dhe çdo muaj për arkëtimet e mbledhura në emër të DPD-së. Nuk paraqitet asnjë tepricë lidhur me këto dy kategori në pozicionin financiar në mbyllje të vitit. Çdo tepricë e mbetur (0,09 për qind e të ardhurave gjithsej në fund të vitit 2016) ka të bëjë me arkëtimet për llogari të FSKSH-së dhe FSSH-së, të cilat rregullohen nga institucionet përkatëse në bazë të procedurave të tyre operative. Diferencat ose zërat që kërkojnë sqarim ndiqen në vijimësi. Në përgjithësi ka një grafik kohor të përcaktuar mirë që ndiqet për çdo diferencë. Nuk ka llogari të përkohshme të lidhura me llogaritë e shpenzimeve të mundësuar nga funksionet e sistemit të thesarit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

27.3 Llogaritë paradhënie

Ky dimension vlerëson shkallën se sa rakordohen dhe rregullohen llogaritë paradhënie.

Paradhëniet në bazë të kontratave për furnitorët, sipërmarrësit dhe konsulentët nuk lejohen, nëse në kontratë nuk citohet shprehimisht legjislacioni i zbatueshëm. Në këto raste, paradhëniet do të lejoheshin deri atëherë sa është garancia e performancës (e kontratës) e depozituar nga sipërmarrësi, zakonisht 10 për qind. Përrjashtim nga kjo rregull bëjnë kontratat me rëndësi të veçantë me miratim paraprak të Ministrisë së Financave. Në praktikë, paradhëniet përdoren më së shumti për kontratat e nënshkruara në kuadër

të projekteve të financuara nga donatorët/institucionet financiare ndërkombëtare sipas rregullave të prokurimit të parashikuara në marrëveshjen e grantit/kredisë. Shuma e paradhënies në përgjithësi nuk është më e madhe se 10 për qind dhe rregullohet sipas afateve të parashikuara në marrëveshjet kontraktore. Paradhëniet për udhëtime u jepen zakonisht punonjësve por rregullohen menjëherë pas kthimit nga shërbimi. Llogaritë e arkës nuk lejohen më. Nuk ka një praktikë kontabël të njëtrajtshme në të gjitha njësitë buxhetore për kontabilizimin e paradhënieve, megjithëse parimet e zbatueshme kontabël përcaktojnë njohjen si aktiv. Në përgjithësi, paradhëniet kontabilizohen si shpenzime në vlerën 100 për qind kur paguhen. Paradhëniet për kontratat e investimeve kapitale kontabilizohen si aktive. Llogaritë e paradhënieve në raportet financiare të fund-vitit të përgatitura nga njësitë buxhetore qendrore përafrohen me zero.

Në përgjithësi, paradhëniet përdoren vetëm në kontratat e projekteve të financuara nga donatorë/institucione financiare ndërkombëtare dhe ka një grafik kohor të përcaktuar mirë për rakordimin dhe rregullimin, të parashikuar në marrëveshjet kontraktore. Në përgjithësi, kryhet në mënyrë të përmuajshme, brenda një muaji, kur sipërmarrësi lëshon faturat, raportet përmbledhëse dhe situacionet dhe kur këto miratohen nga drejtuesit e njësisë. E njëjta mënyrë përdoret për çlirimin e garancisë së lidhur (dorëzani bankare ose garanci kontrate).

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

27.4 Proceset e integritetit të të dhënave financiare

Ky dimension vlerëson se sa e mbështesin proceset dhënien e informacioneve financiare dhe fokusohet te pacenueshmëria e të dhënave e përkufizuar si saktësi dhe plotësi (Standardi ndërkombëtar ISO/IEC, 2014).

Sistemi kryesor informatik që shfrytëzohet nga Ministria e Financave tani për tani është sistemi informatik i thesarit (zyrtarisht i quajtur sistemi informatik financiar i Qeverisë, SIQF⁶⁶). Funksionet e automatizuara nëpërmjet këtij sistemi përfshijnë zbatimin e buxhetit, menaxhimin e angazhimeve, menaxhimin e likuiditetit, kontabilitetin dhe raportimin. Vënë në zbatim në 2010, ky sistem është përdorur fillimisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, degët e thesarit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Por u pa se ky sistem do të ishte edhe më efektiv nëse edhe njësitë shpenzuese u jepeshin të drejta në të. Testimi pilot i dhënies së të drejtave të drejtpërdrejta në këtë sistem ka nxjerrë në pah kufizime teknike dhe financiare madhore mbi zbatimin e tij (për shkak të nevojave për të bërë ndryshime në softuer dhe të kostove të larta të licencimit). Më pas u vendos të krijohet një portal në rrjet për t'u dhënë njësitë shpenzuese të drejta (pa pagesë ose me kosto të ulët) në atë funksionalitet të sistemit që nevojitet në nivelin e tyre. Aktualisht, MF po zhvillon në bazë të SIFQ-së, zgjidhje TIK për një sistem informatik të integruar të menaxhimit financiar (SIIMF) dhe dy module të ndërlidhura të sistemit informatik që do të administrohen nga Kryeministria (Kryeministria do të administrojë modulën e planifikimit të integruar, SISPI, dhe modulën e asistencës së jashtme, EAMIS).

Një vlerësim i risqeve të sigurisë së teknologjisë informatike, i zhvilluar më 2015, ka zbuluar shumë dobësi të konsiderueshme për të cilat nevojitet një përgjigje e menjëhershme. Për këtë arsye është përgatitur një plan zbatimi për strategjinë e zbutjes së risqeve. Shumë fusha me risk të lartë janë trajtuar gjatë vitit 2016, si zbatimi i një BCC me vendndodhje të jashtme⁶⁷ dhe një programi BCC, zbatimi i një politike për hyrjen fizike dhe fjalëkalimet dhe përdorimi i regjistrave të auditimit në nivel databaze. Në vitin 2016 serverët e databazave dhe aplikacioni janë përditësuar me teknologjinë më të re. Por mbeten ende fusha me risk të konsiderueshëm që mund të cenojnë sigurinë e të dhënave, të cilat kërkojnë vëmendje dhe ndjekje në vijimësi.

66. Regjistruar në listën e bazës së të dhënave shtetërore me VKM nr. 352 datë 11.05.2016 ku përcaktohen të dhënat, institucionet përgjegjëse, nivelet e të drejtave në sistem dhe përgjegjësitë administrative për çdo institucion

67. Në vitin 2016, është zbatuar BCC në Qendrën e të Dhënave të AKSHI-t për sistemin SIQF

Në përgjithësi, hyrja në sistem kufizohet me anë të një sistemi të fortë me fjalëkalime të hyrjes në të, siç parashikohet në politikën për teknologjinë informatike. Ka në zbatim një politikë të përcaktuar mirë për menaxhimin e përdoruesve⁶⁸, e cila vendos kërkesat dhe procedurat për krijimin e përdoruesve të rinj, ndryshimin e profileve dhe çaktivizimin e përdoruesve. Mund të krijohen apo modifikohen regjistrime pa lënë një gjurmë kontrolli. Gjurmët e kontrollit mundësojnë llogaridhënien individuale, zbulimin e hyrjeve të paautorizuara dhe analizën e problemeve. Gjurmët e kontrollit të krijuara nga Oracle Audit Vault (OAV) japin informacion se kush ka hyrë në të dhënat, kush ka filluar transaksionin, orën dhe datën e regjistrimit, llojin e regjistrimit, çfarë fushash informacioni përmban dhe cilët skedarë janë përditësuar. OAV mirëmbahet nga AKSHI, por deri tani nuk është kryer asnjë auditim apo shqyrtim nga AKSHI për të verifikuar pacenueshmërinë financiare të të dhënave. Aktualisht, nuk ka njësi funksionale, as në MF, as gjetkë, që të jetë përgjegjëse dhe të kryejë shqyrtime për pacenueshmërinë e të dhënave. E drejta administrative për auditimin e sistemit i jepet Ministrisë së Financave⁶⁹, por për këtë nuk është krijuar ende asnjë njësi.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

TP-28. Raportet buxhetore gjatë vitit

Ky tregues vlerëson gjithanshmërinë, saktësinë dhe kohën e duhur të informacioneve për zbatimin e buxhetit. Raportet buxhetore gjatë vitit duhet të jenë në përputhje me mbulimin dhe klasifikimet buxhetore për të mundësuar monitorimin e performancës buxhetore dhe, nëse është nevoja, përdorimin në kohën e duhur të masave korrigjuese. Ky tregues përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M1 (WL)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- *Dimensioni 28.1: Mbulimi dhe krahasueshmëria e raporteve (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 28.2: Koha e përgatitjes së raporteve buxhetore gjatë vitit (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioni 28.3: Saktësia e raporteve buxhetore gjatë vitit (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, 2016, mbulimi - QQB).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-28 Raportet buxhetore gjatë vitit	Vlerësimi i përgjithshëm D+	Metoda vlerësimit M1 (WL)
28.1 Mbulimi dhe krahasueshmëria e raporteve	Vlerësimi i dimensionit D	Mbulimi dhe klasifikimi i të dhënave nuk mundëson krahasim të drejtpërdrejtë me buxhetin fillestar.
28.2 Koha e përgatitjes së raporteve buxhetore gjatë vitit	Vlerësimi i dimensionit B	Raportet e realizimit të buxhetit përgatiten çdo muaj dhe nxirren brenda katër javëve.
28.3 Saktësia e raporteve buxhetore gjatë vitit	Vlerësimi i dimensionit C	Ka shqetësime lidhur me saktësinë e të dhënave. Shpenzimet kapen si informacion në fazën e pagesës.

68. Miratuar me Urdhër të Ministrisë së Financave nr.89, datë 12.11.2014

69. VKM nr. 352 datë 11.05.2016

28.1 Mbulimi dhe krahasueshmëria e raporteve

Ky dimension vlerëson shkallën me të cilën informacioni paraqitet në raportet gjatë vitit dhe në një formë që krahasohet lehtësisht me buxhetin fillestar (pra, i njëjti mbulim, baza kontabël dhe paraqitja).

Raportet buxhetore gjatë vitit në përgjithësi janë në përputhje me mbulimin dhe klasifikimin buxhetor për të mundësuar monitorimin e performancës buxhetore dhe përdorimin në kohën e duhur të masave korigjuese. Raportet buxhetore gjatë vitit përdoren për të matur ecurinë e deritanishme nëpërmjet analizës së të ardhurave dhe shpenzimeve faktike në raport me çmuarjet buxhetore. Por janë projektuar dhe përgatiten raportet buxhetore për të krahasuar mbulimin dhe klasifikimin e të dhënave për realizimin e buxhetit me çmuarjet buxhetore të rishikuara (pra, jo me çmuarjet buxhetore fillestare). Çmuarjet buxhetore fillestare nuk përdoren për raportet, por të dhënat mund të gjenden menjëherë dhe mund të përdoren me përditësime të sistemit të raportimit.

Pas çdo procesi rishikimi të buxhetit, çmuarjet e rishikuara buxhetore përditësohen në sistemin informatik dhe kështu ndryshojnë në të çmuarjet fillestare buxhetore. Duke qenë se çdo vit ushtrimor buxhetor u nënshtrohet të paktën 2 rishikimeve gjatë vitit, çmuarjet e rishikuara buxhetore mund të ndryshojnë ndjeshëm nga çmuarjet fillestare buxhetore.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D për shkak të mungesës së krahasimit me buxhetin fillestar të miratuar.

28.2 Koha e përgatitjes së raporteve buxhetore gjatë vitit

Ky dimension vlerëson nëse informacionet dorëzohen në kohën e duhur dhe shoqërohen me analizë dhe shpjegues për zbatimin e buxhetit.

Raportet mujore të realizimit të buxhetit përgatiten çdo muaj dhe nxirren brenda katër javëve pas fundit të muajit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

28.3 Saktësia e raporteve buxhetore gjatë vitit

Ky dimension vlerëson saktësinë e informacioneve të paraqitura, përfshirë faktin nëse jepen informacione për shpenzimet si për fazën e angazhimit ashtu edhe për atë të pagesës.

Shpenzimet faktike regjistrohen dhe raportohen sipas kontabilitetit me bazë monetare të modifikuar, ndërsa të ardhurat faktike të arkëtuara paraqiten sipas kontabilitetit me bazë monetare. Por raportet nuk shoqërohen me analizë dhe shpjegues të hollësishëm të zbatimit të buxhetit për shembull në lidhje me ndryshimet që u janë bërë shpërndarjeve buxhetore midis titujve. Nuk paraqitet asnjë informacion në fazën e angazhimit të shpenzimeve.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

TP-29. Raportet financiare vjetore

Ky tregues vlerëson se sa të plotë, sa në kohë dhe sa në përputhje janë pasqyrat financiare vjetore me parimet dhe standardet kontabël përgjithësisht të pranuar. Kjo është me rëndësi të madhe për llogaridhënien dhe transparencën në sistemin e MFP-së. Përmban tre dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën M1 (WL) për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve:

- *Dimensioi 29.1: Plotësia e raporteve financiare vjetore (Periudha kohore: viti i fundit fiskal i përfunduar, mbulimi - QQB);*
- *Dimensioi 29.2: Paraqitja e raporteve për auditim të jashtëm (Periudha kohore: raporti i fundit financiar i paraqitur për auditim; mbulimi - QQB);*
- *Dimensioi 29.3: Standardet e kontabilitetit (Periudha kohore: raportet financiare të tre viteve të fundit; mbulimi - QQB).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioi	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-29 Raportet financiare vjetore	D+	Metoda vlerësimit M1 (WL)
29.1 Plotësia e raporteve financiare vjetore	Vlerësimi i dimensionit D	Përgatiten raporte financiare vjetore, por këto nuk paraqesin një krahasim midis buxhetit fillestar dhe zbatimit faktik.
29.2 Paraqitja e raporteve për auditim të jashtëm	Vlerësimi i dimensionit B	Raportet financiare të vitit 2015 janë paraqitur për auditim të jashtëm brenda 6 muajve.
29.3 Standardet e kontabilitetit	Vlerësimi i dimensionit C	Standardet e kontabilitetit të zbatuara për të gjitha raportet financiare janë në përputhje me kuadrin ligjor të vendit dhe sigurojnë njëtrajtshmërinë e raportimit me kalimin e kohës. Dallimet midis standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare nuk bëhen të ditura.

29.1 Plotësia e raporteve financiare vjetore

Ky dimension vlerëson plotësinë e raporteve financiare.

Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (i ndryshuar me Ligjin nr.9477, datë 9.2.2006) kërkon që (neni 12): "Pasqyrat financiare vjetore, përveç atyre që parashikohen në mënyrë të specifikuar nga standardet kontabël kombëtare, duhet të përmbajnë këto dokumente: a) bilancin kontabël; b) pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve; c) pasqyrën e ndryshimeve në kapital; ç) pasqyrën e rrjedhjes së parasë (cash flow); d) anekset e pasqyrave financiare, që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues."

Raportet financiare vjetore përfshijnë informacione për të ardhurat, shpenzimet, tepricat e likuiditetit, aktivet financiare dhe të trupëzuara, pasivet, përfshirë detyrimet afatmesme dhe afatgjata. Për vitin fiskal 2015, deri në datën e misionit kryesor të vlerësimit në prill 2017, raportet vjetore nuk përfshinin dorëzanitë dhe pasivet e tjera të kushtëzuara (siç janë ato të lidhura me partneritet publike private). Raporti ekuivalent i QQB-së që paraqitet zyrtarisht për auditim nuk përmban bilancin e konsoliduar dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto. Raportet financiare përfshijnë pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, por i krahasojnë shifrat faktike vetëm me rishikimin më të fundit të buxhetit (pra, jo me buxhetin fillestar të miratuar). Siç shpjegohet për

treguesin TP-28.1, çmuarjet e rishikuara të buxhetit përdoren në formatet e raportimit, përfshirë edhe për raportet financiare vjetore, por jo shifrat e buxhetit fillestar.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është D për shkak të mungesës së krahasimit me buxhetin fillestar të miratuar.

29.2 Paraqitja e raporteve për auditim të jashtëm

Ky dimension vlerëson kohën e paraqitjes së raporteve financiare të rakorduara të fund-vitit për auditim të jashtëm.

Raportet financiare vjetore i jepen për auditim të jashtëm Kontrollit të Lartë të Shtetit. Me ligj, raportet vjetore për zbatimin e buxhetit duhet të dorëzohen nga MF në KLSH brenda pesë muajve pas fundit të vitit fiskal (31 dhjetor). Në përgjithësi për këto vitet e fundit, raportet financiare vjetore për zbatimin e buxhetit janë paraqitur brenda afatit, me disa vonesa shumë të vogla (disa-ditore). Në momentin e misionit të vlerësimit në prill 2017, raporti i fundit financiar vjetor i përfunduar mbulonte vitin fiskal 2015. Raportet vjetore të vitit fiskal 2015 i janë dorëzuar KLSH-së më 1 qershor 2016.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

29.3 Standardet e kontabilitetit

Ky dimension vlerëson se sa janë të kuptueshme për përdoruesit raportet financiare vjetore dhe se sa kontribuojnë në llogaridhënie dhe transparencë.

Standardet e kontabilitetit të zbatuara për të gjitha raportet financiare janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe udhëzimet financiare në vend për të siguruar njëtrajtshmërinë e raportimit me kalimin e kohës. Standardet e përdorura në përgatitjen e raporteve financiare vjetore bëhen të ditura, por nuk shpjegohet shmangia nga standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (domethënë, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, SNKSP). Në përgjithësi, standardet kontabël që përdoren kanë dallime të konsiderueshme në raport me SNKSP-të. Gjatë muajve të fundit, Qeveria ka punuar me Bankën Botërore për një projekt më vete për të vlerësuar shkallën e përputhshmërisë së standardeve shqiptare të kontabilitetit të sektorit publik me SNKSP-të. Raporti fillestar tregon se ka dallime të konsiderueshme midis standardeve shqiptare të kontabilitetit të sektorit publik dhe SNKSP-ve dhe pritet që një raport përfundimtar më i hollësishëm ku të përshkruhet shkalla e përdorimit të SNKSP-ve dhe hendeku në përputhshmëri do të jetë i gatshëm në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2017.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.



3.7 SHTYLLA VII: Shqyrtimi dhe auditimi i jashtëm

TP-30. Auditimi i jashtëm

Ky tregues shqyrton karakteristikat e auditimit të jashtëm. Përmban katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën M1 (WL) për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.

- *Dimensioni 30.1: Mbulimi dhe standardet e auditimit (Periudha vjetore: tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 30.2: Paraqitja e raporteve të auditimit legjislativ (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 30.3: Aktivitetet e ndjekjes në vijimësi pas auditimit të jashtëm (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 30.4: Pavarësia e institucionit të lartë të auditimit (Periudha kohore: në momentin e vlerësimit; mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-30 Auditimi i jashtëm	C+	Metoda vlerësimit M1 (WL)
30.1 Mbulimi dhe standardet e auditimit	Dimension score B	Pasqyrat financiare të subjekteve të qeverisjes qendrore që përfaqësojnë diku te 75-85% të shpenzimeve dhe të ardhurave gjithsej janë audituar duke përdorur standardet kombëtare të auditimit gjatë tre viteve të fundit fiskale të përfunduara.
30.2 Paraqitja e raporteve të auditimit legjislativ	Dimension score B	Raportet e auditimit i janë paraqitur legjislativ brenda 6 muajve pas marrjes së raporteve financiare, për 3 vitet e fundit.
30.3 Aktivitetet e ndjekjes në vijimësi pas auditimit të jashtëm	Dimension score C	Ka reagime zyrtare nga subjektet e audituara lidhur me auditimet për të cilat priten aktivitete të ndjekjes në vijimësi, gjatë 3 viteve të fundit të përfunduara.
30.4 Pavarësia e institucionit të lartë të auditimit	Dimension score B	KLSH funksionon në mënyrë të pavarur nga ekzekutivi sa u takon procedurave të emërimit të Kryetarit, planifikimit të angazhimeve të auditimit, bërjes publike të raporteve dhe miratimit dhe realizimit të buxhetit KLSH-së. Kjo pavarësi garantohet me ligj. KLSH ka të drejtë të pakufizuar dhe në kohën e duhur në evidenca, dokumentacione dhe informacione. Por Ligji ka një kriter subjektiv për klauzolën e shkarkimit të Kryetarit të KLSH-së.

Ligji nr.154/2014, datë 27 nëntor 2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" jep bazën ligjore për të siguruar që Kontrolli i Lartë i Shtetit të funksionojë si një institucion modern auditimi. Ky ligj i ri ka zëvendësuar ligjin e vjetër të KLSH-së, të vitit 1997.

30.1 Mbulimi dhe standardet e auditimit

Ky dimension vlerëson elementet kyçe të auditimit të jashtëm lidhur me objektin dhe mbulimin e auditimit, si edhe respektimin e standardeve të auditimit.

Ligji nr.154/2014 parashikon llojet e auditimit që mund të kryhen nga KLSH, siç janë auditimet financiare, auditimet e përputhshmërisë, auditimet e performancës dhe auditimet e TI-së. Në praktikë, shumica e kontrolleve të KLSH-së janë auditime përputhshmërie me fokusin te gjetja e parregullsive si edhe te nënvijëzimi i problemeve me rëndësi materiale dhe i risqeve të sistemit dhe kontrollit. Kontrollat e raporteve të qeverisjes qendrore për vitet fiskale 2013-2015 janë kryer më së shumti si auditime të përputhshmërisë. Këto auditime mbulojnë edhe njësitë jashtëbuxhetore dhe dy fondet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Auditimet e KLSH-së kanë siguruar një shkallë mbulimi prej 75,52 për qind për vitin 2013, 85,21 për qind për vitin 2014 dhe 75,39 për qind për vitin 2015.

TABELA 3.28 Mbulimi i auditimit me dhënie opinionit për realizimin e buxhetit të shtetit në institucionet qendrore

Mbulimi i auditimit me dhënie opinionit për realizimin e buxhetit të shtetit në institucionet qendrore. milion lekë			
VITET	2013	2014	2015
I- Totali i shpenzimeve të audituara nga KLSH	275.135	345.844	304.073
II- Totali i shpenzimeve të buxhetit të shtetit (MF)	364.331	405.864	403.342
Përqindja e mbulimit të auditimit = I / II	75,52%	85,21%	75,39%

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

Është duke u vënë në zbatim një proces reforme për të siguruar që KLSH të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve të larta të auditimit (ISSAI), ku ka edhe një strategji për të vënë në zbatim ISSAI-t. Paralelisht me këtë, KLSH është duke përfunduar strategjinë për zhvillimin institucional për periudhën 2015-2017 dhe duke përgatitur strategjinë për periudhën 2018-2021. Kjo po realizohet nga disa projekte binjakëzimi me institucione të tjera të larta të auditimit që janë në fazë të zhvilluar, siç janë ato të Polonisë dhe Kroacisë. Këto projekte do ta ndihmojnë KLSH-në të zhvillohet më tej, t'i përmirësojë manualat dhe procedurat e auditimit dhe të kryejë më shumë auditime financiare. Janë kryer 3 auditime financiare pilot në vitin 2016 dhe 10 auditime financiare planifikoheshin për vitin 2017.

30.2 Paraqitja e raporteve të auditimit legjislativ

Ky dimension vlerëson kohën e paraqitjes së raporteve të auditimit për realizimin e buxhetit legjislativ.

Ligji 154/2014 nuk ka ndonjë dispozitë për kohën e paraqitjes së raporteve të auditimit legjislativ. Legjislativët e tjera përkatëse, si Kushtetuta dhe Ligji Organik i Buxhetit kërkojnë që paraqitja nga KLSH në Kuvend e auditimit të vitit të mëparshëm të bëhet përpara se Kuvendi të fillojë diskutimin dhe të bëjë miratimin e buxhetit të vitit të ardhshëm. Në momentin e misionit të vlerësimit në prill 2017, raporti i fundit financiar vjetor i përfunduar i paraqitur për auditim mbulonte vitin fiskal 2015. Në praktikë është vënë re se raportet e auditimit për periudhën 2013-2015 i janë paraqitur legjislativ brenda gjashtë muajve pas marrjes së raporteve financiare vjetore, siç shpjegohet më poshtë:

- Viti fiskal 2015: Raportet financiare janë marrë më 1 qershor 2016 dhe auditimi i është paraqitur legjislativit më 4 tetor 2016;
- Viti fiskal 2014: Raportet financiare janë marrë më 5 qershor 2015 dhe auditimi i është paraqitur legjislativit më 19 tetor 2015;
- Viti fiskal 2013: Raportet financiare janë marrë më 24 qershor 2014 dhe auditimi i është paraqitur legjislativit më 3 tetor 2014.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

30.3 Aktivitetet e ndjekjes në vijimësi pas auditimit të jashtëm

Ky dimension vlerëson shkallën me të cilën ekzekutivi ose subjektet e audituara ndërmarrin aktivitete efektive dhe në kohën e duhur për ndjekjen në vijimësi të rekomandimeve ose vërejtjeve të auditimit të jashtëm.

Siç e kërkon Ligji 154/2014, pas nxjerrjes së projekt-raportit të auditimit, subjekti i audituar duhet të përgjigjet brenda një muaji lidhur me gjetjet e auditimit, dhe vërejtjet e subjektit përfshihen në raportin përfundimtar të auditimit. Ligji 154/2014 kërkon edhe që subjekti i audituar t'i raportojë KLSH-së brenda një periudhe gjashtëmujore duke filluar nga data e nxjerrjes së raportit përfundimtar të auditimit, lidhur me zbatimin e rekomandimeve. Në praktikë është vërejtur se ka pasur reagime zyrtare nga subjektet e audituara lidhur me auditimet për të cilat priteshin aktivitete të ndjekjes në vijimësi, gjatë tre viteve të fundit të përfunduara. Niveli i zbatimit të rekomandimeve ka qenë 69,7 për qind gjatë vitit 2014, 70,6 për qind gjatë vitit 2015 dhe 32,5 për qind gjatë vitit 2016. Sipas intervistave me zyrtarë të KLSH-së, që është konfirmuar edhe nga Ministria e Financave, niveli relativisht i ulët i zbatimit të rekomandimeve (sidomos gjatë vitit 2016) është shpjeguar me një interes më të ulët nga ministrinë e linjës për t'i trajtuar këto rekomandime, ndërsa është rritur numri gjithsej i rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

Reformat e tanishme përfshijnë një protokoll të miratuar kohët e fundit midis KLSH-së dhe Kuvendit për krijimin e një nënkomisioni për auditimin e llogarive publike, si pjesë e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Pritet që kur Kuvendi të fillojë punë në vjeshtën e vitit 2017, të ecin përpara edhe diskutimet për krijimin e nënkomisionit për auditimin. Por nuk është ende e qartë se kur dhe nëse do të krijohet një nënkomision i tillë për auditimin.

30.4 Pavarësia e institucionit të lartë të auditimit

Ky dimension vlerëson pavarësinë nga ekzekutivi të institucionit të lartë të auditimit.

Ligji 154/2014 garanton që KLSH të funksionojë në mënyrë të pavarur nga ekzekutivi sa i përket planifikimit të angazhimeve të auditimit, organizimit të publikimit të raporteve të auditimit dhe miratimit dhe zbatimit të buxhetit të KLSH-së, si edhe lidhur me sigurimin e të drejtës së pakufizuar dhe në kohën e duhur të KLSH-së për të hyrë në evidencat, dokumentacionin dhe informacionin që u përket të gjitha subjekteve të audituara. Ligji nr.154 vendos kuadrin për një institucion modern dhe të

pavarur të kontrollit të lartë të shtetit, në përputhje me deklaratat e Limës dhe Meksikës për pavarësinë e institucioneve të larta të auditimit. Por Ligji nr.154/2014 ka një kriter subjektiv për klauzolën e shkarkimit të Kryetarit të KLSH-së, kur Kryetari "kryen një veprim ose sjellje që e diskretiton rëndë postin dhe imazhin e tij". Kjo dispozitë ligjore mund të konsiderohet objekt interpretimi, pra mund të ndërhynte në pavarësinë e shkarkimit të kryetarit të KLSH-së. Gjithsesi, shqyrtimet dhe monitorimet kolegjiale të KLSH-së të kryera kohët e fundit nga institucioni i lartë i auditimit i Austrisë dhe nga SIGMA e BE-së kanë konfirmuar vlerësimin më të lartë me notën A të pavarësisë së KLSH-së. Sipas intervistave me zyrtarë të KLSH-së, kriteri subjektiv i përmendur më lart nuk është përdorur asnjëherë, por edhe sikur të përdorej, procedura do të duhej të vihej në lëvizje nga Presidenti i Republikës, nismë e cila pastaj do të duhej të miratohej nga Kuvendi, prandaj mund të konsiderohet se nuk ndërhyt në pavarësinë e KLSH-së nga ekzekutivi.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

TP-31. Shqyrtimi që u bën legjislativi raporteve të auditimit

*Ky tregues fokusohet te shqyrtimi që u bën legjislativi raporteve financiare të audituara të qeverisjes qendrore, përfshirë njësitë institucionale, për aq sa a) ua kërkon ligji t'i paraqesin legjislativit raporte të audituara ose b) njësia mëmë ose kontrolluese e tyre duhet t'u përgjigjet pyetjeve dhe të veprojë në emër të tyre. Ka katër dimensionet e mëposhtme dhe përdor metodën **M2 (AV)** për agregimin e vlerësimeve të dimensioneve.*

- *Dimensioni 31.1: Koha e shqyrtimit të raporteve të audituara (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 31.2: Seancat dëgjimore për konstatimet e auditimeve (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 31.3: Rekomandimet e legjislativit për auditimin (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ);*
- *Dimensioni 31.4: Transparenca e shqyrtimit që u bën legjislativi raporteve të auditimit (Periudha kohore: tre vitet e fundit fiskale të përfunduara; mbulimi - QQ).*

Tabela e performancës dhe përmbledhja e vlerësimit

Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Justifikim i shkurtër i vlerësimit
TP-31. Shqyrtimi që u bën legjislativi raporteve të auditimit	B	Metoda e vlerësimit M2 (AV)
31.1 Koha e shqyrtimit të raporteve të audituara	Vlerësimi i dimensionit A	Shqyrtimi i raporteve të auditimit për raportet financiare vjetore është kryer nga legjislativi brenda një muaji pas marrjes së raporteve, për 3 vitet e fundit të përfunduara.
31.2 Seancat dëgjimore për konstatimet e auditimeve	Vlerësimi i dimensionit C	Zhvillohen rregullisht seanca dëgjimore të shqyrtimit në thellësi të konstatimeve më kryesore të raporteve të auditimit, vetëm me përfaqësues të KLSH-së dhe zyrtarë të MF-së.
31.3 Rekomandimet e legjislativit për auditimin	Vlerësimi i dimensionit C	Legjislativi jep rekomandime për masat që duhen zbatuar, por nuk ka një sistem gjurmimi për ndjekjen në vijimësi të këtyre rekomandimeve.
31.3 Transparenca e shqyrtimit që u bën legjislativi raporteve të auditimit	Vlerësimi i dimensionit B	Seancat dëgjimore zhvillohen publikisht me disa përjashtime (BSH), si edhe përveç rasteve të sigurisë kombëtare ose të diskutimeve të ngjashme delikate.

31.1 Koha e shqyrtimit të raporteve të audituara

Ky dimension vlerëson kohën e shqyrtimit nga legjislativi, që është një faktor kyç në efektivitetin e funksionit të llogaridhënies.

Shqyrtimi nga legjislativi i raporteve të auditimit kryhet fillimisht nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave pranë Kuvendit, nga ku dalin rezultate dhe rekomandime që më pas miratohen nga Kuvendi. Koha e shqyrtimit legjislativ për 3 vitet e fundit të përfunduara ka qenë shumë e mirë, sepse shqyrtimi i raporteve të auditimit është kryer nga legjislativi brenda një muaji pas marrjes së raporteve të auditimit. Datat faktike për 3 vitet e fundit fiskale të përfunduara jepen më poshtë:

- Viti fiskal 2015: Raportet e auditimit janë marrë më 5 tetor 2016 dhe janë miratuar nga legjislativi më 20 tetor 2016;
- Viti fiskal 2014: Raportet e auditimit janë marrë më 23 tetor 2015 dhe janë miratuar nga legjislativi më 6 nëntor 2015;
- Viti fiskal 2013: Raportet e auditimit janë marrë më 3 tetor 2014 dhe janë miratuar nga legjislativi më 16 tetor 2014.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është A.

31.2 Seancat dëgjimore për konstatimet e auditimeve

Ky dimension vlerëson se sa zhvillohen seanca dëgjimore për konstatimet më kryesore të institucionit të lartë të auditimit.

Zhvillohen rregullisht seanca dëgjimore të shqyrtimit në thellësi të konstatimeve të auditimit, me përfaqësues të KLSH-së dhe zyrtarë të MF-së. Përfaqësuesit e ministrive të linjës ose të subjekteve të tjera të audituara nuk marrin pjesë në këto seanca dëgjimore. Kuvendi bën ndjekjen e çështjeve me ministrinë e linjës dhe subjektet e tjera të audituara lidhur me trajtimin e konstatimeve të auditimeve dhe zbatimin e rekomandimeve të bëra nga KLSH. Subjekteve të audituara u kërkohet t'i raportojnë Kuvendit se si janë trajtuar konstatimet dhe rekomandimet e auditimeve.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

31.3 Rekomandimet e legjislativit për auditimin

Ky dimension vlerëson se sa jep rekomandime legjislativi dhe se sa e ndjek legjislativi zbatimin e rekomandimeve të dhëna prej tij.

Legjislativi jep rekomandime për konstatimet më kryesore të auditimeve. Zakonisht këto rekomandime nuk kanë afate për zbatimin e tyre. KLSH e ndjek punën me subjektet e audituara për zbatimin e rekomandimeve dhe zakonisht i raporton përsëri legjislativit në kuadër të procesit të seancave dëgjimore të vitit të ardhshëm. Nuk mund të merrej asnjë dëshmi të përdorimit të ndonjë sistemi gjurmimi nga ana e legjislativit për të ndjekur nëse zbatohen dhe sa zbatohen rekomandimet e tij.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është C.

31.4 Transparenca e shqyrtimit që u bën legjislativi raporteve të auditimit

Ky dimension vlerëson transparencën e funksionit të shqyrtimit sa i takon të drejtës së publikut për t'u informuar për të.

Seancat dëgjimore zhvillohen publikisht me disa përjashtime (auditimet e Bankës së Shqipërisë, si bankë qendrore), si edhe përveç rasteve të sigurisë kombëtare ose të diskutimeve të ngjashme delikate. Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ia ka vënë në dispozicion raportet e tij Kuvendit në seancë dhe këto raporte publikohen edhe në faqen zyrtare në internet të Kuvendit.

Në bazë të analizës dhe dëshmive mbështetëse, rezultati i vlerësimit për këtë dimension është B.

4. Përfundime nga analiza e sistemeve të MFP-së

4.1 Vlerësimi i integruar i performancës së MFP-së

Rezultatet e vlerësimit tregojnë ecuri mikse në të shtatë shtyllat e kuadrit PEFA 2016. Notat për 15 nga të 31 treguesit janë nga A në B, që reflekton një performancë të fortë, ndërsa notat për 16 treguesit e tjerë janë nga C në D, që reflekton performancë të dobët. Çdo shtyllë ka pika të forta dhe pika të dobëta, një përmbledhje e të cilave jepet më poshtë.

Besueshmëria e buxhetit

Shmangiet nga shpenzimet e miratuara fillimisht në buxhet tregojnë se ka dobësi përkatëse në sistemin e MFP-së. Shpenzimet faktike agregate kanë qenë 95 dhe 96 për qind e buxhetit të miratuar në secilin prej tre viteve të fundit fiskale të përfunduara. Ky rezultat ka përmirësim të konsiderueshëm në krahasim me vitet e shkuara dhe vlerësimin e mëparshëm. Por në të tre vitet, shpenzimet sipas funksioneve paraqesin një ndryshueshmëri të madhe: midis 26,7 për qind në 2014 dhe 21 për qind në 2015. Ka shpesh rishpërndarje nga buxheti i miratuar fillimisht, të cilat reflektojnë problemet më të hasura në sistem lidhur me përgatitjen e buxhetit, menaxhimin e investimeve publike, zbatimin dhe monitorimin e projekteve të mëdha të infrastrukturës, dhe diçka më pak edhe pamundësi për të realizuar planin e të ardhurave fiskale.

Performanca faktike e të ardhurave është përmirësuar gjatë periudhës së vlerësimit, çka reflekton një qasje më realiste për parashikimin e të ardhurave. Për periudhën që vlerësohet, të ardhurat faktike kanë qenë 97,5 për qind të të ardhurave të parashikuara në buxhet në 2016 dhe 100,1 për qind të të ardhurave të parashikuara në buxhet në 2014. Në vitin 2015, të ardhurat faktike kanë qenë 92,2 për qind të të ardhurave të parashikuara në buxhet, çka reflekton një mosrealizim me bazë të gjerë në akcizë, TAP dhe tatimet e lidhura me naftën. Ky mosrealizim plani tatimor ka pasqyruar probleme në administrimin tatimor dhe bashkërendimin midis institucioneve përgjegjëse. Rol kanë luajtur edhe problemet me parashikimin në përgatitjen e buxhetit të vitit 2015, ku pati një nënvlerësim të stokut të tepricave kreditore në sistem dhe shkallë më të ulëta nga sa pritej në lidhje me rritjen e PBB-së, normave të interesit dhe çmimeve të naftës.

Transparenca e financave publike

Shqipëria jep informacione të gjera lidhur me financat e qeverisjes qendrore. Klasifikimi i buxhetit dhe plani kontabël bazohen në çdo nivel të klasifikimit ekonomik, administrativ dhe funksional (dhe nënfunksional) duke përdorur standardet GFS/COFOG. Në dokumentacionin e buxhetit vjetor jepen informacione të gjithanshme. Publikut i jepet mundësi e plotë për të parë informacionet më kritike (TP-9) me përjashtim të raporteve të auditimit të jashtëm.

Një numër i konsiderueshëm njësisish jashtëbuxhetore nuk i japin Qeverisë raporte financiare. Megjithëse dëshmitë që gjenden tregojnë se operacionet e këtyre njësisve janë të pakonsiderueshme dhe risqet e mundshme fiskale të lidhura me to janë të papërfillshme, kjo nuk mund të verifikohet në mungesë të informacioneve të sakta.

Janë kryer nivele të konsiderueshme transfertash drejt qeverisjes vendore përmes granteve të pakushtëzuara. Qeverisja qendrore u jep burime financiare bashkive nëpërmjet dy llojesh transfertash: grante të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara. Në vitin 2016, 60,8 për qind e transfertave

janë vendosur me sisteme transparente të mbështetura në rregulla; por janë përdorur edhe grante të konsiderueshme të pakushtëzuara për njësitë e qeverisjes vendore, çka ka prekur shpërndarjen e mbështetur në rregulla.

Ministritë japin informacione me nivel të arsyeshëm plotësie për programet, objektivat, zbatimin e buxhetit dhe diskutimin e objektivave të ecurisë, për të cilët raportohet çdo vit. Por nuk ka prurje të njëtrajtshme dhe të rregullt nga poshtë lart të informacioneve për shfrytëzimin e burimeve, në drejtim të ministrive përgjegjëse nga ana e njësive të realizimit të shërbimeve.

Menaxhimi i aktiveve dhe pasiveve

Dobësitë e konsiderueshme në menaxhimin e investimeve publike përbëjnë një sfidë të veçantë në Shqipëri dhe cenojnë efikasitetin dhe efektivitetin e shpenzimeve kapitale. Të gjitha projektet madhore të investimeve i janë nënshtruar vlerësimit teknik dhe analizës kosto-përfitim. Ka rregulla për shqyrtimin që u bën DMIP investimeve kapitale, por këto nuk zbatohen sistematikisht për shkak të aspekteve politike dhe presionit për të ruajtur nivelin e shpenzimeve kapitale. Buxheti përfshin informacion për shpenzimet korrente dhe kapitale, por nuk përfshin informacion për kostot gjithsej të projekteve dhe as një zberthim sipas nënprogrameve apo projekteve. Ka rregullore për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin, por sistemi për monitorimin nuk është plotësisht i gjithanshëm dhe cilësia e të dhënave nuk ka qenë gjithmonë adekuate.

Qeveria mban evidenca bazë të aktiveve financiare, por nuk ka asnjë evidencë të gjithanshme të aktiveve jofinanciare. Mbahet evidencë e të gjitha kategorive madhore të aktiveve financiare, por nuk publikohet informacion për performancën. Megjithatë njësive të sektorit publik u kërkohet të mbajnë evidenca të aktiveve jofinanciare, nuk ekziston një regjistër i plotë dhe i gjithanshëm. Ka një strategji të gjithanshme për menaxhimin e borxhit dhe qeveria mban sisteme adekuate për regjistrimin dhe raportimin e borxhit dhe dorëzaneve.

Ka një sërë fushash të tjera ku shteti mund ta përmirësojë monitorimin dhe raportimin e aktiveve dhe pasiveve të qeverisë. Dokumentet e buxhetit tregojnë transfertat që bëhen drejt shoqërive publike dhe llogaritë e tyre gjenden publikisht, por nuk ka pasqyra financiare të konsoliduara për portofolin e qeverisë në shoqëritë tregtare apo të aktiviteteve thuajse fiskale. Pasivet e kushtëzuara eksplicite në formën e dorëzaneve shtetërore monitorohen dhe publikohen çdo tremujor. Programi i Reformës Ekonomike 2017-2019 përmban informacion për pasivet e tjera të kushtëzuara, si partneritetet publike-private (PPP) të cilat krijojnë pasive të drejtpërdrejta për buxhetin. Por nuk ka asnjë raport të rregullt e të plotë për PPP-të apo për pasivet e tjera të kushtëzuara në formën e sigurimit të depozitave, sigurimit të bimëve bujqësore, dhe çështjeve gjyqësore të pambyllura ende.

Strategjia fiskale dhe përgatitja e buxhetit në bazë të politikave

Përgatiten parashikime të gjithanshme afatmesme makroekonomike për një periudhë trevjeçare. Parashikimet e përditësuar përgatiten në bazë të kuadrit të përditësuar makroekonomik, por dallimet midis parashikimit përfundimtar fiskal të miratuar dhe parashikimeve të përfshira në buxhetin e miratuar nuk identifikohen, shpjegohen apo publikohen më vete si pjesë e procesit të buxhetit vjetor. Përgatiten parashikime fiskale në skenarë makroekonomikë alternativë dhe një analizë e qëndrueshmërisë së borxhit çdo vit, të cilët vihen në dispozicion të publikut.

Përgatiten çmuarje të ndikimit fiskal të çdo ndryshimi të propozuar në politikën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin buxhetor dhe dy vitet e ardhshme; por efekti i ndryshimeve të politikave lidhur me shpenzimet nuk shprehet qartë në projektbuxhetet e paraqitura në Kuvend. MF përgatit një analizë të arritjeve të saj, ku përfshihet një shpjegim i faktorëve që kanë çuar në shmangie nga

objektivat e miratuar, ecuria e arritur në raport me strategjinë fiskale dhe një shpjegim i arsyeve për shmangiet nga objektivat.

Kuadri i gjithanshëm buxhetor afatmesëm përgatitet dhe shërben si bazë për buxhetin vjetor. Në vitin 2016 janë përgatitur tavane në vlerë agregate dhe në nivel ministrie; por tavanet në nivel ministrie janë nxjerrë pas daljes së qarkores së parë të buxhetit. Ka një mekanizëm funksional i cili siguron që kërkesat e PBA-së të pasqyrojnë objektivat dhe prioritetet e programeve sektoriale, por ky mekanizëm jo gjithmonë e siguron lidhjen midis strategjive ekzistuese sektoriale dhe kërkesave të PBA-së.

Paketa e udhëzimeve që përdoret për përgatitjen e PBA-së dhe të buxhetit vjetor është e gjithanshme, mbulon shpenzimet buxhetore gjithsej për vitin e plotë fiskal dhe u jep orientime të qarta njësisë buxhetore. Ekziston një kalendar i qartë i buxhetit, i cili në përgjithësi respektohet, paçka se me disa shmangie. Në vitin 2016, tavanet përfundimtare të shpenzimeve u miratuan nga Këshilli i Ministrave pas nxjerrjes së udhëzimit shtesë për përgatitjen e buxhetit vjetor nga MF, por në kohë të mjaftueshme për afatin e dorëzimit të kërkesave për buxhetin vjetor. Buxhetet për vitet 2015 dhe 2016 i janë paraqitur Kuvendit më shumë se një muaj përpara fillimit të vitit fiskal, ndërsa paraqitja e buxhetit të vitit 2014 u bë me vonesë.

Shqyrtimi nga Kuvendi fokusohet te shifrat agregate të buxhetit vjetor dhe te hollësitë e shpenzimeve dhe të ardhurave, jo te parashikimet dhe prioritetet fiskale afatmesme. Buxhetet për të tri vitet e përfshira në vlerësim janë miratuar përpara fillimit të vitit fiskal. Legjislativi ka procedurë të qarta dhe të dokumentuara për shqyrtimin e buxhetit, të cilat u ngarkojnë role specifike komisioneve parlamentare dhe personelit, por nuk përcaktojnë rregulla për negociimin. Ekzistojnë rregulla të qarta për ndryshimet që mund t'i bëjë buxhetit ekzekutivi, të cilat vendosin kufizime mbi shkallën dhe natyrën e ndryshimeve që bëhen pa përfshirjen e Kuvendit.

Parashikueshmëria dhe kontrolli në zbatimin e buxhetit

Ka hapësirë të konsiderueshme për përmirësim të sistemeve të mbledhjes së të ardhurave në Shqipëri. Organet e të ardhurave fiskale nuk e kanë zbatuar plotësisht një proces të strukturuar dhe sistematik të vlerësimit të risqeve të përmbushjes. Funkcioni i mbledhjes së borxhit në DPT vuan nga dobësi serioze; stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2016 përbënte 68,3 për qind të mbledhjes së të ardhurave gjithsej, 69,4 për qind të të cilave qenë detyrime të prapambetura më të vjetra se 12 muaj. Pavarësisht këtyre dobësive, të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesve janë të gjithanshme dhe të përditësuara. Si DPD, ashtu edhe DPT, kanë një sistem të kënaqshëm për regjistrimin dhe kontabilizimin e të ardhurave.

Mbahen teprica monetare të konsiderueshme jashtë llogarisë unike të thesarit, të cilat megjithëse raportohen çdo muaj, nuk konsolidohen. Parashikimet e flukseve monetare përgatiten dhe përditësohen të paktën çdo tremujor. Janë bërë ndryshime të konsiderueshme në buxhet në vitin 2016, një prej të cilave shumë pranë fundit të vitit buxhetor. Megjithëse këto janë miratuar në Kuvend, praktika e ndryshimeve të mëdha në fund të vitit nuk konsiderohet si transparente nga ministrinë e linjës.

Pas problemeve të konsiderueshme në të shkuarën, stoku i detyrimeve të prapambetura në krahun e shpenzimeve buxhetore në fund të viteve 2016 dhe 2015 që vënë nën kontroll. Pas nivelit të konsiderueshëm të detyrimeve të prapambetura në të shkuarën e afërt, këtij problemi i është kushtuar vëmendje e veçantë dhe funksionaliteti i sistemit të thesarit tani kap informacion për angazhimet përmes regjistrimit të kontratave të nënshkruara dhe monitorimit të kontratave shumëvjeçare. Pavarësisht nga këto masa, nuk ka raportim specifik apo monitorim të rregullt të detyrimeve të

prapambetura nëpërmjet sistemit të thesarit. Shqetësim mbetet mosparandalimi plotësisht i akumulimit të detyrimeve të prapambetura të reja.

Modernizimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe ligjet buxhetore po marrin kohë të integrohen plotësisht brenda institucioneve buxhetore. Ndryshimet e fundit ligjore kanë pasur si qëllim qartësimin e roleve dhe përgjegjësiave brenda sistemit buxhetor, përfshirë përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin dhe kontabilizimin e buxhetit. Shumë institucione buxhetore mbetet ende t'i reflektojnë këto ligje në rregulloret e tyre të brendshme dhe prandaj rolet dhe përgjegjësitë nuk janë të lidhura me këto struktura të reja. Megjithëse SIQF është duke u zhvilluar, shumë masa kontrolluese mbi angazhimet dhe pagesat ende kryhen me dorë. Numri i kufizuar i përdoruesve sjell ndarje të pamjaftueshme të detyrave në subjektet buxhetore dhe e ul më tej efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, auditimet e përputhshmërisë nuk kanë raportuar mangësi të konsiderueshme në lidhje me përputhshmërinë me procedurat e vendosura për shpenzimet jo paga.

Duke qenë se informacionet për personelin, fondin e pagave dhe pagesat mbahen në sisteme të ndryshme, niveli i integritetit është i ulët dhe rakordimi është i vështirë. Sistemet e personelit, fondit të pagave dhe pagesave përditësohen të paktën çdo muaj. Në tre vitet e fundit fiskale janë kryer auditime të fondi të pagave.

Efektiviteti i përgjithshëm i sistemit të prokurimeve publike në Shqipëri është përmirësuar gjatë viteve të fundit, por një pjesë e konsiderueshme e kontratave jepen përmes procedurave pa konkurrim. Progres ka pasur sidomos sa i takon kuadrin ligjor, rregullator dhe institucional, si edhe zhvillimit dhe funksionimit të sistemit të prokurimit elektronik, që është i detyrueshëm për të gjitha metodat e prokurimit (me përjashtim të kontraktimit të drejtpërdrejtë). Publika ka të drejtë të shohë planet e prokurimit, mundësitë për tender dhe kontratat e fituara në faqen në internet të APP-së. Por metodat jo konkurruese të prokurimit përdoren shpesh për të përmbushur nevojat e autoriteteve kontraktuese. Raportohen vonesa të shpeshta për vendimet e KPP-së, që është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave lidhur me vendimet e prokurimeve publike.

Është arritur njëfarë progresi në zhvillimin e një funksioni të auditimit të brendshëm, por mbeten ende shumë sfida. Në përputhje me ligjin, të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore e kanë një funksion të auditimit të brendshëm, por shumë njësi nuk janë të pajisura me numrin e duhur të punonjësve dhe/ose u mungon përgjegjësi i njësisë. Edhe pse ligji pasqyron standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, shprehitë teknike janë ende në zhvillim e sipër dhe raportet ende nuk përfshijnë një analizë të hollësishme të mangësive të sistemit të kontrollit, një përshkrim të konstatimeve, efektet dhe rekomandimet. Megjithëse thuhet se niveli i pranimin të konstatimeve të auditimeve është i lartë, vetëm 55 për qind e konstatimeve janë zbatuar brenda 12 muajve. Problem është edhe cilësia e rekomandimeve të auditimeve; konstatimet e auditimeve fokusohen në transaksione të veçanta financiare dhe jo në dobësitë në sistem të kontrollit të brendshëm apo në rekomandime për përmirësim.

Kontabiliteti dhe raportimi

Rakordimi i llogarive dhe paprekshmëria e të dhënave financiare janë pika të forta të sistemit të MFP-së, por ka ende pika të dobëta në raportimin fiskal. Raportet buxhetore gjatë vitit janë në përputhje me mbulimin dhe klasifikimin buxhetor për të mundësuar monitorimin e performancës buxhetore. Por buxhetet e rishikuara buxhetore ndryshojnë pa gjurmë shpërndarjet fillestare buxhetore, kështu që përdoruesit nuk mund të bëjnë një krahasim me buxhetin fillestar në raportet financiare gjatë vitit. As pasqyrat financiare vjetore nuk paraqesin një krahasim midis buxhetit fillestar dhe zbatimit të tij. Standardet kombëtare të kontabilitetit bëhen të ditura, por jo shmangiet nga SNKSP-të.

Shqyrtimi dhe auditimi i jashtëm

Ka pasur një përkeqësim në masat e marra nga ekzekutivi për të trajtuar dobësitë e identifikuara në raportet e auditimit të KLSH-së. Janë audituar subjektet e qeverisjes qendrore që përbëjnë 75-85 për qind të totalit të shpenzimeve dhe të ardhurave publike. Në praktikë, shumica e kontrolleve të KLSH-së janë auditime përputhshmërie me fokusin te gjetja e parregullsive si edhe te nënvijëzimi i problemeve me rëndësi materiale dhe i dobësive të sistemit të kontrollit. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së ka rënë gjatë vitit 2016, çka është shpjeguar me një nivel më të ulët angazhimi nga ministritë e linjës për t'i trajtuar rekomandimet e KLSH-së dhe për të bërë ndjekjen në vijimësi të auditimeve gjatë vitit të fundit. Shqyrtimi nga legjislativi i raporteve të auditimit kryhet nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave pranë Kuvendit, në mënyrë të rregullt, por vetëm me pjesëmarrjen e zyrtarëve të KLSH-së dhe MF-së; përfaqësuesit e ministrive të linjës dhe të subjekteve të tjera të audituara nuk marrin pjesë. Nuk ka asnjë sistem për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve të bëra nga legjislativi, në bazë të konstatimeve kryesore të auditimeve.

4.2 Efektiviteti i kuadrit të kontrollit të brendshëm

Mjedisi i kontrollit

Ligji i menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) siguron një kuadër të shëndoshë ligjor për zhvillimin e MFK-së dhe është në përputhje me Ligjin Organik të Buxhetit. Sipas këtij ligji, kërkesa për të futur në zbatim MFK zbatohet për të gjitha institucionet publike, përfshirë fondet jashtëbuxhetore dhe organizatat tregtare që janë pjesërisht në pronësi të shtetit. Shtylla 5 e Strategjisë së Qeverisë për Menaxhimin e Financave Publike trajton zbatimin e MFK-së si pjesë e së cilës synohet krijimi i sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm nëpërmjet një game të gjerë produktesh, ku përfshihen çështje të tilla si sistemet e informacionit për një MFK efektiv dhe ngritje të statusit të shefit të financës, si edhe shtatë zbatime pilot të MFK-së. Roli i palëve të ndryshme të përfshira në sistemin e kontrollit të menaxhimit financiar përcaktohet në Ligj. Këtu përfshihen Ministri i Financave, nëpunësi i parë autorizues (Sekretari i Përgjithshëm i MF-së), nëpunësi autorizues i njësisë dhe nëpunësit autorizues të vartësisë, nëpunësit zbatues dhe eprorët e linjës.

Qeveria është duke bërë hapa praktikë drejt zhvillimit të llogaridhënies së menaxhimit dhe delegimit të detyrave në përputhje me ligjin. Zbatimi plotësisht i kërkesave të këtij legjislacioni do të kërkojë kohë për t'u arritur i plotë në organet publike. Shumë drejtori të financës vuajnë nga numri i pakët i punonjësve, çka cenon parimet e ndarjes së detyrave dhe arritjen e objektivave të njësisë së sektorit publik. Njësitë e sektorit publik duhet të krijojnë një strukturë organizative që mundëson arritjen e objektivave dhe përputhshmërinë me funksionet e ngarkuara me legjislacion. Ky duhet paraqitur në formë shkresore, ku të përshkruhen qartë rregullat për caktimin dhe ndarjen e detyrave, detyrimeve dhe përgjegjësisë, si edhe hierarkia dhe linjat e raportimit. Krahas kësaj, duhen përditësuar rregulloret e brendshme dhe përshkrimet e punës për të pasqyruar plotësisht ndryshimet më të fundit rregullatore.

Vlerësimi i Riskut

Zbatimi i praktikave moderne të menaxhimit të riskut është ende në hapat e parë në Shqipëri. Sipas Ligjit të MFK-së, koordinatori për risqet është nëpunësi autorizues i institucionit. Raportet më të fundit të KBFP-së vërejnë progresin në zhvillimin e këtij funksioni dhe një numër në rritje institucionesh po përgatisin regjistra të risqeve. Në të njëjtën kohë, raporti pranon se shumë pak, në mos aspak, organizata i përdorin këto regjistra si mjet drejtimi për të arritur objektivat e punës.

Aktivitetit e kontrollit

Raportet më të fundit vjetore të KBFP-së vërejnë një sërë mangësish në aktivitetet, proceset dhe procedurat e kontrollit. Raporti ka vërejtur se manualet dhe gjurmët e auditimit që përshkruajnë proceset dhe veprimtaritë e kontrollit nuk përgatiten dhe nuk zbatohen në të gjitha institucionet. Gjithashtu, përshkrimet e proceseve zyrtare të punës shpesh mbeten të padokumentuara.

Shumë subjekte buxhetore ende nuk i kanë automatizuar dhe integruar plotësisht sistemet e menaxhimit financiar. Pavarësisht nga disa përmirësime të kohëve të fundit, **masat kontrolluese mbi angazhimet** e shpenzimeve (TP-25) ende sigurojnë mbulim dhe efektivitet të pjesshëm. Po kështu, lidhur me **masat kontrolluese në listë-pagesat** (TP-23) subjektet buxhetore i mbajnë informacionet për personelin, fondin e pagave dhe pagesat në sisteme të ndryshme, disa të automatizuara dhe disa manuale. Mungesa e kapaciteteve është një prej shkaqeve për sistemet e dobëta të kontrollit të brendshëm. Ka një **ndarje të pamjaftueshme të detyrave** (TP-25) për shkak të mospajisjes me personelin e mjaftueshëm të drejtorive të financës dhe administratës, çka vjen si pasojë e kufizimeve buxhetore dhe qarkullimit të shpeshtë të personelit.

Pavarësisht shqetësimeve të mësipërme, Shqipëria merr vlerësim të mirë për treguesit e lidhur me **përputhshmërinë me rregullat dhe procedurat e pagimit** (TP-25.3) dhe proceset e paprekshmërisë së të dhënave financiare (TP-27.4).

Informacioni dhe komunikimi

Raportet më të fundit të KBFP-së vërejnë se ka një mungesë të përgjithshme të të kuptuarit se si mund të përdoren informacionet financiare për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin. Cilësia e informacioneve financiare është gjithashtu problem, sikurse tregohet nga dobësitë e identifikuar në raportet buxhetore gjatë vitit (TP-28) dhe raportet financiare vjetore (TP-29). Shqetësim përbën edhe përdorimi i shifrave të buxhetit të rishikuar dhe jo atij fillestar; kjo e kufizon efektivitetin e tyre si mjet monitorimi për nivelin drejtues.

Monitorimi

NJQH/MFK aktualisht është pajisur plotësisht me të gjashtë punonjësit dhe ka zhvilluar një sistem të gjithanshëm monitorimit të KBFP. Roli i saj është të orientojë dhe mbështesë institucionet dhe të sigurojë bashkërendimin e një ankete vjetore vetëvlerësimi për gjendjen e MFK-së. Rezultatet e kësaj ankete përfshihen në raportin vjetor të KBFP-së, por janë pjesë edhe e 20 treguesve për monitorimin e performancës së ministrive dhe të bashkive më të mëdha. Kjo paketë treguesish përfshihet edhe në raportin vjetor të KBFP-së, si edhe të dhënat nga drejtoritë e buxhetit dhe të thesarit pranë MF-së dhe të NJQH/MFK dhe NJQH/AB. Vlerësimi agregat i institucioneve është konvertuar në një paketë tabelash të lidhura. Raporti vjetor i KBFP-së përfshin një vlerësim të çdo organizate.

Vlerësimi ka nënvizuar disa fusha me rëndësi ku mund të përmirësoheshin aktivitetet e monitorimit:

- *Monitorimi i shoqërive publike (TP-10.1).* Ministria e Ekonomisë nuk përgatit pasqyra financiare të konsoliduara për portofolin e qeverisë në shoqëritë tregtare dhe as nuk raporton aktivitetet thuajse fiskale.
- *Pasivet e kushtëzuara dhe risqet e tjera fiskale (TP-10.3).* Subjektet dhe institucionet e qeverisjes qendrore i shprehin në mënyrë sasiore disa pasive të kushtëzuara të rëndësishme në raportet e tyre financiare, por nuk ka asnjë raport të plotë për PPP-të dhe koncesionet.
- *Cilësia e monitorimit të aktiveve financiare të qeverisjes qendrore (TP-12.1).* Mbahet evidencë e kategorive kryesore të aktiveve financiare të zotëruara prej qeverisë, por kjo nuk publikohet.

- *Cilësia e monitorimit të aktiveve jofinanciare të qeverisjes qendrore (TP-12.2).* Nuk ka një regjistër të plotë të aktiveve jofinanciare.
- *Monitorimi i detyrimeve të prapambetura në të ardhurat (TP-19.4).* Proceset e punës të mbledhjes së borxhit të DPT-së janë tepër përgjithësuese dhe nuk kanë arritur të trajtojnë akumulimin e nivelit të konsiderueshëm të detyrimeve të prapambetura tatimore.
- *Monitorimi i detyrimeve të prapambetura në shpenzimet buxhetore (TP-22.2).* Nuk ka raportim specifik të rregullt për të monitoruar detyrimet e prapambetura nëpërmjet sistemit të thesarit.

4.3 Pikat e forta dhe pikat e dobëta të MFP-së

Disiplina fiskale agregate

Disiplina fiskale agregate kërkon mbajtje efektive në kontroll të risqeve totale fiskale të menaxhimit të buxhetit. Ruajtja e drejtpeshimit midis të ardhurave dhe shpenzimeve, nivelit të borxhit dhe agregateve të tjera fiskale kërkon vendosjen e kufizimeve të forta që më parë, ku të mbështeten vendimet për buxhetin, si atë vjetor, ashtu edhe atë afatmesëm.

Në një nivel agregat qeveria i ka arritur objektivat fiskalë, por disiplina fiskale cenohet nga luhajtjet e mëdha në përbërjen e shpenzimeve sipas funksionit. Këto kryesisht kanë të bëjnë me pastrimin e detyrimeve të prapambetura të mbartura nga më parë, kostot e papritura të zbatimit të projekteve të investimeve dhe, në vitin 2015, mosrealizimi i planit të të ardhurave. Pas mosrealizimit të të ardhurave në vitin 2015, përmirësimet në parashikimin e të ardhurave tregojnë se qeveria ka procedurë më të mira për hipotezat makroekonomike dhe për vlerësimin e politikave të reja.

Përmirësimet në funksionin e thesarit dhe strukturën e kontrollit i kanë mbajtur nën kontroll shpenzimet dhe e kanë shmangur përsëritjen e problemeve të detyrimeve të prapambetura gjatë kësaj periudhe. Por Qeveria mbetet e ekspozuar ndaj niveleve të pakuantifikuara deri tani të tronditjeve fiskale për shkak të mos monitorimit, raportimit dhe menaxhimit adekuat të risqeve të tilla fiskale si veprimtaritë thuajse fiskale të shoqërive tregtare publike, partneritetet publike private (PPP) ose pasivet e tjera të kushtëzuara.

Shpërndarja strategjike e burimeve

Shpërndarja strategjike e burimeve përfshin planifikimin dhe zbatimin e buxhetit në përputhje me prioritetet e qeverisë me synim arritjen e objektivave të politikave. Shpërndarja e burimeve kërkon informacione për rëndësinë dhe efektivitetin e aktiviteteve dhe programeve të qeverisë.

Aspektet teknike të procesit të përgatitjes së buxhetit janë të zhvilluara mirë, por mund të përmirësohej fokusi politik dhe strategjik i buxhetit. Qeveria përgatit parashikime të gjithanshme afatmesme makroekonomike për një periudhë trevjeçare. Shpërndarja e fondeve buxhetore pasqyron objektivat dhe prioritetet e politikave afatmesme, të hartuara në përputhje me kërkesat e paraqitura nga ministritë në kuadër të procesit të PBA-së. Por fokusi strategjik i buxhetit dobësohet nga ndryshueshmëria e gatishmërisë së strategjive sektoriale ku të mbështeten kërkesat e PBA-së. Gjithashtu, natyra tejet ambicioze e disa prej strategjive sektoriale ekzistuese i shndërron në dokumente thjesht aspiruese duke i ulur mundësitë për t'i vënë në jetë nëpërmjet buxhetit.

Menaxhimi i investimeve publike është i dobët dhe ka nevojë të ngutshme për vëmendje. Mungesa e shqyrtimeve globale të projekteve të investimeve kapitale dhe monitorimit dhe raportimit të mëposhëm e ul efektin që kanë në mbështetje të objektivave të qeverisë për zhvillim shoqëror dhe ekonomik.

Përdorimi efikas i burimeve në funksion të realizimit të shërbimeve

Përdorimi efikas i burimeve për realizimin e shërbimeve kërkon përdorimin e të ardhurave buxhetore për të arritur nivelet më të mira të shërbimeve publike brenda burimeve që kemi në dispozicion. Shërbimet janë pika kritike kontakti midis qytetarëve dhe qeverisë. Edhe përsa përmirësimi i shërbimeve publike shkon përtej MFP-së, ka disa aspekte të MFP-së që kontribuojnë në këtë gjë, përfshirë prokurimet publike, investimet dhe menaxhimin e aktiveve.

Elementet përbërëse bazë të kuadrit shqiptar të MFP-së ekzistojnë, por do të duhet ende punë për ngritje të kapacitetit për t'u fokusuar te performanca dhe efikasiteti dhe efektiviteti i realizimit të shërbimeve. Mungesa e qarkullimit të njëtrajtshëm dhe të rregullt nga ana e njësive të realizimit të shërbimeve të informacioneve për shfrytëzimin e burimeve, ua kufizon mundësinë ministrive të linjës për ta monitoruar performancën. Rishpërndarjet e konsiderueshme buxhetore shumë afër fundit të vitit buxhetit nuk kanë transparencë dhe mund të çojnë në tkurrje të shërbimeve të planifikuara. Praktikrat e prokurimit publik po përmirësohen, por niveli i lartë i kontraktimit të drejtpërdrejtë e cenon efikasitetin e realizimit të shërbimeve dhe arritjen e vlerës më të mirë për fondet e shpenzuara për blerjet e qeverisë. Auditimi i brendshëm vijon të përqendrohet te përputhshmëria e jo te trajtimi i problemeve të sistemit apo të performancës. Auditimet e performancës nga ana e KLSH-së sapo kanë filluar të bëhen dhe këto raporte nuk publikohen ose nuk bëhen objekt i diskutimeve më të gjera në shoqëri. Shqetësim të veçantë përbën mungesa e përgjithshme e reagimit nga niveli drejtues lidhur me rekomandimet e lëna nga KLSH dhe legjislativi, çka mbase do të thotë se nuk shfrytëzohen mundësitë për ta përmirësuar efikasitetin e përdorimit të burimeve.

4.4 Ndryshimet e performancës në krahasim me vlerësimin e fundit

Vlerësimi i vitit 2016 është i treti vlerësim i performancës së MFP-së për Shqipërinë, mbështetur në kuadrin PEFA. Po të shihet performanca agregate në nivel treguesi midis këtij vlerësimi dhe vlerësimit të fundit të kryer më 2011, nuk ka pasur asnjë ndryshim të performancës për të gjashtëmbëdhjetë treguesit. Për pesë tregues ka pasur përmirësim të performancës dhe për shtatë tregues është vërejtur një notë më e ulët. Nga të shtatë treguesit, tri nota nuk kishin lidhje me ndryshim të performancës por me një interpretim tepër optimist të kuadrit në 2011.

Përmirësimet kryesore janë vërejtur në fushat e mëposhtme:⁷⁰

- *TP-2 - Të ardhurat agregate faktike në krahasim me buxhetin e aprovuar fillimisht:* Gjatë periudhës së vlerësimit, parashikimi i të ardhurave është bërë më realist (me përjashtim të vitit 2015).
- *TP-4 - Stoku dhe monitorimi i detyrimeve të prapambetura në pagimin e shpenzimeve buxhetore:* Theksi më i fortë te menaxhimi dhe raportimi i angazhimeve dhe i detyrimeve të prapambetura në pagimin e shpenzimeve ka sjellë përmirësim të performancës.
- *TP-6 Gjithanshmëria e informacionit të përfshirë në dokumentacionin e buxhetit dhe TP-10 E drejta e publikut për të parë informacione kyçe fiskale:* Jepen më shumë informacione kyçe në paketën e buxhetit, ndërsa informacionet kyçe fiskale i vihen në dispozicion publikut.
- *TP-19 Konkurrenca, maksimizimi i vlerës së fondeve dhe masat kontrolluese në prokurim:* Ka pasur përmirësime sa i takon të drejtës së publikut për të parë informacione të plota, të besueshme dhe në kohë mbi prokurimin.

70. Treguesit e performancës (TP) të përfshirë në listë janë numërtuar sipas versionit të vitit 2011 të kuadrit PEFA

Rënie të performancës janë vërejtur në fushat e mëposhtme:

- *TP-7 Shkalla e operacioneve të padeklaruar:* Rënie për shkak të nivelit të mbledhjes së të dhënave në lidhje me njësitë jashtëbuxhetore.
- *TP-8 Transparenca e transfertave fiskale ndërqeveritare:* Rënie për shkak të rritjes së përqindjes së buxhetit që shkon për grante të pakushtëzuara, të cilat nuk janë plotësisht në përputhje me sistemin e bazuar në rregulla.
- *TP-11 Rregullsia dhe pjesëmarrja në procesin vjetor të buxhetit:* Rënie e performancës për shkak të nxjerrjes së taveve buxhetore pas qarkores së buxhetit në 2016 dhe aprovimit me vonesë të buxhetit 2014.
- *TP-28 Shqyrtimi që u bën legjislativi raporteve të auditimit të jashtëm:* Përkeqësim i performancës për shkak të mungesës së pjesëmarrjes së ministrive të linjës në seancat dëgjimore që zhvillohen në përgjigje të rekomandimeve të lëna nga raportet e auditimit.

Këto lëvizje të performancës mund të përmbliidhen sipas rezultateve buxhetore si më poshtë:

Disiplina fiskale agregate është fuqizuar nëpërmjet përmirësimeve në parashikimin e të ardhurave dhe monitorimin e detyrimeve të prapambetura në pagimin e shpenzimeve.

Shpërndarja strategjike e burimeve është prekur negativisht nga devijimet nga kalendari i aprovuar i PBA-së.

Efektet që kanë pasur ndryshimet e performancës të *përdorimi efikas i burimeve* në funksion të realizimit të shërbimeve ka qenë i përzier. Ka pasur efekt pozitiv nga përmirësimet e dimensioneve të ndryshme të treguesve të transparencës, përfshirë dokumentimin e buxhetit, të drejtën e publikut për informim dhe të drejtën për të pasur informacion prokurimi të besueshëm dhe në kohë. Ka pasur efekt negativ nga niveli më i ulët i mbledhjes së të dhënave të gjithanshme në lidhje me njësitë jashtëbuxhetore dhe përkeqësimi i transparencës së transfertave që u shpërndahen njësitëve të qeverisjes vendore. Gjithashtu, mungesa e veprimtari në përgjigje të dobësive të nënvizuara në raportet e auditimit mund të sjellë mosshfrytëzim të mundësive për t'i përdorur në mënyrë sa më efektive burimet brenda qeverisë.

5. Procesi i reformës së MFP-së në qeveri

5.1 Qasja për reformat e MFP-së

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë ka miratuar një strategji për reformën e menaxhimit të financave publike (MFP) për periudhën 2014-2020⁷¹ dhe një plan veprimi përkatës. Objektivi madhor i strategjisë është rivendosja e disiplinës makroekonomike dhe në të trajtohen të gjitha aspektet e sistemit të menaxhimit të financave publike të Shqipërisë. Kjo strategji përbën një sipërmarrje ambicioze dhe ka ndikim të drejtpërdrejt në kuadrin institucional, kapacitetet njerëzore dhe teknike dhe proceset e MFP-së të analizuara në këtë vlerësim.

Prioritetet e reformës

Prioritetet kryesore tematike të strategjisë së reformës në planin afatmesëm mund të përmblihen në pikat e mëposhtme:

- Kuadër makroekonomik dhe politikë fiskale e matur, me objektivin e uljes së raportit të borxhit publik mbi PBB-në në planin afatmesëm;
- Shlyerja e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i përsëritjes së tyre;
- Kontrolli më i fortë i angazhimeve financiare, i angazhimeve shumëvjeçare dhe angazhimeve paraprake dhe një sistem i përmirësuar i kontrollit financiar;
- Një proces i buxhetimit shumëvjeçar funksional dhe i kujdesshëm;
- Përmirësim i mbledhjes së të ardhurave dhe përputhshmëri me objektivin për uljen e evazionit fiskal;
- Një funksion i trajnuar mirë dhe i aftë i auditimit të brendshëm;
- Mekanizma të zgjeruar dhe më të mirë të transparencës dhe llogaridhënies;
- Sistem efikas i prokurimit publik duke përmirësuar cilësinë e shpenzimeve publike.

Krahas këtyre, disa prioritetet e Strategjisë së MFP-së përshkojnë të gjithë spektrin e reformave të administratës publike dhe MFP-së:

- Një administratë publike profesionale me aftësi të përmirësuara në menaxhimin e fondeve publike;
- Zbatim efikas i rregullave dhe procedurave, trajnime të mirë-shënjestruara për rritjen e kapaciteteve në administratën publike në nivel qendror dhe vendor;

71. <http://MoF/www.financa.gov.al/al/raportime/strategjia-per-menaxhimin-e-financave-publike-2014-2020>

- Zbatim i plotë dhe uniform i sanksioneve për shkeljet administrative në fushën e menaxhimit financiar publik;
- Luftë efektive kundër korrupsionit në administratën publike.

Komponentët dhe instrumentet kryesore

Strategjia e reformës së MFP-së është organizuar në gjashtë shtylla:

- Shtylla 1 - Kuadër i qëndrueshëm dhe i matur fiskal;
- Shtylla 2 - Planifikim dhe buxhetim i mirë-integruar dhe efikas i shpenzimeve publike;
- Shtylla 3 - Ekzekutim efikas i buxhetit;
- Shtylla 4 - Raportim transparent financiar qeveritar;
- Shtylla 5 - Kontrollë të brendshme efektive;
- Shtylla 6 - Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike.

5.2 Veprimet e kohëve të fundit dhe aktuale të reformës

Autoritetet shqiptare kanë bërë përpjekje të gjerësishme për të zbatuar reforma të MFP-së nëpërmjet strategjisë. Përpjekjet e para janë fokusuar te hedhja e themeleve për reformën, krijimi i kuadrit institucional dhe hartimi i ndryshimeve legislative. Kuadri i monitorimit dhe raportimit për zbatimin e reformave të MFP-së është tani plotësisht në funksionim (përskruhet më tej në vijim).

Sipas vetëvlerësimit më të fundit të MF-së, janë bërë këto arritje lidhur me strategjinë:

Shtylla 1 - Kuadër i qëndrueshëm dhe i matur fiskal: Janë futur në legjisllacion dispozita për të trajtuar parashikimet tejet optimiste dhe për të futur rregulla të reja për borxhin dhe deficitin. Është krijuar në MF një njësi e re për riskun fiskal. Procesi i monitorimit dhe raportimit të riskut fiskal ka filluar së fundmi dhe MF planifikon të hartojë një deklaratë të risqeve fiskale për t'ia bashkëlidhur projektbuxhetit të vitit 2018.

Shtylla 2 - Planifikim dhe buxhetim i mirë-integruar dhe efikas i shpenzimeve publike: Përgjegjësia për mbikëqyrjen dhe monitorimin e menaxhimit të investimeve publike i është kthyer MF-së. Këtu po vendosen kritere për vendosjen e prioriteteve dhe vlerësimin paraprak të projekteve të mëdha të investimeve kapitale. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në LOB vendosin kufizime mbi koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP) dhe parashikojnë krijimin e një fondi rezervë për të mbrojtur nga mosrealizimi i mundshëm i të ardhurave dhe/ose lëvizjet e paparashikueshme të normave të interesit.

Shtylla 3 - Ekzekutim efikas i buxhetit: Masat kontrolluese të shpenzimeve janë përmirësuar me regjistrimin e angazhimeve (përfshirë angazhimet shumëvjeçare) në sistemin e thesarit. Sistemi i thesarit tani merr raporte nga fondet e sigurimeve shoqërore. Zbatimi i një strategjie për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e ka ulur stokun e detyrimeve

të prapambetura gjatë vitit 2016. Automatizimi i sistemit të MFP-së ka progres të ngadaltë - 15 subjekte kanë të drejta hyrjeje online në SIQF dhe ka përfunduar përzgjedhja e shoqërisë që i është ngarkuar zgjerimi i SIQF-së në Sistemin e Informacionit të Menaxhimit Financiar në Shqipëri.

Shtylla 4 - Raportim transparent financiar qeveritar: Janë përmirësuar formati dhe procedurat për raportimin financiar gjatë vitit, ku publikohen informacione mujore për shpenzimet për ministrinë dhe përdoruesit e tjerë të buxhetit në bazë dhe çdo tremujor për të dhënat financiare të pushtetit vendor.

Shtylla 5 - Kontrolle të brendshme efektive: NJQH/MFK është pajisur me staf dhe Shkolla e Administratës Publike tani ofron trajnim për MFK-në. NJQH/MFK ka hartuar një plan për vizita institucionale (duke filluar nga viti 2017) për të verifikuar çështjet e përfshira në pyetësorët e vetëvlerësimit për MFK-në. Rishikimet e Ligjit të MFK-së në vitin 2015 siguruan një përkufizim më të qartë të MFK-së, krijuan rolin e koordinatorëve të MFK-së dhe menaxhimit të riskut, si edhe siguruan kuadrin ligjor për Këshillin e KBFP-së. Janë miratuar aktet nënligjore në formën e urdhrave, udhëzimeve dhe një manual i rishikuar i MFK-së.

Ligji për auditimin e brendshëm është rishikuar në vitin 2015 për ta harmonizuar më mirë me standardet ndërkombëtare duke përmendur kartat e auditimit dhe kodin etik, si edhe konceptin e kompetencës në parimet e përgjithshme. Janë miratuar aktet nënligjore përkatëse për të ofruar orientime të mëtejshme për një sërë çështjesh të ngritura nga ligji i auditimit të brendshëm, si Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, ngritja e komiteteve të auditimit të brendshëm pranë subjekteve publike dhe kriteret për krijimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Shtylla 6 - Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike. KLSH ka futur në përdorim disa ISSAI të reja dhe kjo ka çuar në rritje të përqindjes që zënë auditimet financiare dhe të performancës (nga 6 për qind më 2015 në 13 për qind më 2016). Shqetësimet lidhur me rënien e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së janë trajtuar nëpërmjet një rregulloreje të Kuvendit që synon sigurimin e një mekanizmi më efektiv për monitorimin e aktiviteteve të ndjekjes në vijimësi të konstatimeve të auditimeve.

5.3 Aspekte institucionale

Masat organizative

Gjatë viteve të fundit, autoritetet shqiptare kanë bërë përpjekje të gjerësishme për t'i çuar më tej reformat e MFP. Zbatimi i këtyre reformave menaxhohet nëpërmjet Strategjisë për reformën e menaxhimit të financave publike për periudhën 2014-2020 (Strategjia e MFP-së). Përpjekjet e para u përqendruan te hedhja e themeleve për vënien në zbatim të reformave, si ngritja e strukturave për drejtimin e reformës, hartimi i shtesave dhe ndryshimeve në legjislacion dhe përmirësimin i kapaciteteve në fushat më kryesore. Kuadri i monitorimit dhe raportimit për zbatimin e reformave të MFP-së është tani plotësisht në funksionim. Në vitin 2015-2016, procesi i monitorimit të Strategjisë së MFP-së u fuqizua me hartimin e metodikës dhe udhëzuesit të hollësishëm për treguesit e performancës ("Pasaportat e treguesve").

Ministria e Financave e bashkërendon MFP-në mes të gjitha institucioneve pjesëmarrëse dhe brenda MF-së. MF e ushtron këtë funksion nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit të Reformave në Fushën e Menaxhimit Financiar Publik (DMRFMFP), e krijuar në fund të vitit 2016. Ndër të tjera, roli i kësaj drejtorie është t'u japë mbështetje logjistike drejtuesve kryesorë në përmbushjen e detyrave të tyre

dhe të përgatisë raporte të rregullta progresi për strategjinë. Krahas kësaj, ka edhe një Komitet Teknik Reforme për MFP-në, që përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i MF-së dhe drejtuesit kryesorë.

Për të mbikëqyrur zbatimin e Strategjisë është krijuar një komitet drejtues ndërministror me Urdhër të Kryeministrit. Komiteti Drejtues kryesohet nga Ministri i Financave dhe anëtarët e tij janë si më poshtë vijon:

- Zëvendësministri i Financave;
- Zëvendësministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
- Zëvendësministri i Ministrisë së Integritimit Evropian;
- Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore;
- Drejtori i Departamentit të Administratës Publike;
- Dy përfaqësues të Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave;
- Drejtori i Agjencisë së Prokurimit;
- Kryetari i Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjatë vitit 2016 janë zhvilluar dy mbledhje të Komitetit Drejtues.

Transparenca e Programit të MFP-së

Strategjia e Reformës dhe raportet e monitorimit të saj publikohen në faqen në internet të MF-së. Raporti më i fundit vjetor i monitorimit të menaxhimit të financave publike mbulon periudhën 1 janar 2016-31 dhjetor 2016. Këto raporte monitorimi i japin Komitetit Drejtues të MFP-së informacione për arritjet dhe vështirësitë në përmbushjen e objektivave të Strategjisë së MFP-së. Nëpërmjet pasaportave të treguesve, Raporti i monitorimit jep përshkrime të hollësishme metodike të matjes për të gjithë treguesit në nivel produkti, që janë të përfshirë në Strategjinë e MFP-së.

Shtojcat

Shtojca 1. Përmbledhje e treguesve të performancës

Në këtë shtojcë jepet një tabelë përmbledhëse e performancës, në nivel treguesi dhe dimensionit. Tabela paraqet vlerësimet, krahas një shpjegimi të shkurtër lidhur me vlerësimin përkatës për secilin tregues dhe dimension.

EMRI I VENDIT: Shqipëria		Vlerësimi i vitit 2017	
Shtylla	Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Përshkrimi i kërkesave të përmbushura
Besueshmëria e buxhetit	TP-1 Shpenzimet faktike agregate	A	Shpenzimet faktike agregate qenë midis 95% dhe 105% të shpenzimeve agregate të miratuara në buxhet në 2016 dhe 2014 dhe 94,5% në 2015.
	TP-2 Përbërja faktike e shpenzimeve	D+	
	i. Përbërja faktike e shpenzimeve sipas funksionit	D	Varianca e përbërjes midis shpenzimeve faktike sipas funksionit dhe shpenzimeve të parashikuara në buxhet është më shumë se 20 për qind në të tre vitet e vlerësimit.
	ii. Përbërja faktike e shpenzimeve sipas llojit ekonomik	A	Varianca në përbërjen e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik ka qenë më pak se 5% në vitin 2014 dhe 2016. Varianca e përbërjes së shpenzimeve është më shumë se 5% në vitin 2015.
	iii. Shpenzimet nga fondet rezervë	A	Shpenzimet faktike të bëra nga fondi rezervë qenë mesatarisht sa 0,1% e buxhetit fillestar gjatë periudhës 2014-2016.
	TP-3 Të ardhurat faktike	B+	
	i. Të ardhurat faktike agregate	A	Të ardhurat faktike qenë midis 97% dhe 106% të të ardhurave të parashikuara në buxhet në 2014 dhe 2016.
	ii. Përbërja faktike e të ardhurave	B	Varianca e përbërjes së të ardhurave ka qenë më pak se 10% në vitin 2014 dhe 2016.

EMRI I VENDIT: Shqipëria			Vlerësimi i vitit 2017	
Shtylla	Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Përshkrimi i kërkesave të përbushura	
Transparenca e financave publike	TP-4 Klasifikimi I buxhetit	A	Klasifikimi i buxhetit dhe plani kontabël bazohen në çdo nivel të klasifikimit ekonomik, administrativ dhe funksional (dhe nënfunksional) duke përdorur standardet GFS/COFOG dhe mund të japin informacione që janë në përputhje me standardet GFS 2014.	
	TP-5 Dokumentimi i buxhetit	A	Për QQB-në, Shqipëria përbush 10 elemente, përfshirë çdo element bazë (1-4) të dokumentacionit të buxhetit.	
	TP-6 Operacionet e qeverisjes qendrore jashtë raporteve financiare	D		
	i. Shpenzimet jashtë raporteve financiare	D*	Informacioni për shpenzimet jashtë raporteve financiare është i paplotë sepse mbulon vetëm 17 nga 63 njësitë jashtëbuxhetore sipas listës së INSTAT-it; megjithëse dëshmitë në dispozicion sugjerojnë se shumica gjithsej jo e raportuar është më pak se 5% e shpenzimeve të QQB-së, kjo nuk mund të konfirmohet.	
	ii. Të ardhurat jashtë raporteve financiare	D*	Të ardhurat e njësisve jashtëbuxhetore aktive jo të raportuara nuk mund të konfirmohen.	
	iii. Raportet financiare të njësisve jashtëbuxhetore	D	Njësitë jashtëbuxhetore aktive nuk i japin Qeverisë së Shqipërisë raporte të rregullta financiare.	
	TP-7 Transferrat drejt qeverisjes vendore	C+		
	i. Sistemi që përdoret për caktimin e transfertave	C	Shpërndarja horizontale e granteve të pakushtëzuara dhe specifike për njësitë e qeverisjes vendore nga qeverisja qendrore bëhet me sisteme transparente të mbështetura në rregulla. Këto përbëjnë 60,8 për qind të transfertave gjithsej për NJQV-të	
	ii. Dhënia në kohë e informacioneve për transferrat	B	Deri në dhjetor çdo vit, NJQV-të i dinë shumat e transfertave të pakushtëzuara dhe specifike që do të marrin.	
	TP-8 Informacioni për performancën lidhur me realizimin e shërbimeve	C+		
	i. Planet e performancës për realizimin e shërbimeve	B	Çdo program i Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Shëndetësisë ka të përcaktuar objektivat, produktet e synuara dhe fondet e miratuara për shpenzimet për periudhën afatmesme dhe këto raportohen në mënyrë tremujore dhe vjetore.	
	ii. Performanca e arritur për realizimin e shërbimeve	B	Informacionet për produktet e realizuara publikohen çdo vit për shumicën e ministrive.	
	iii. Burimet që marrin njësitë e realizimit të shërbimeve	D	Një ministri e madhe (Arsimi) ka informacione për burimet e qeverisjes qendrore që marrin njësitë e realizimit të shërbimeve në bazë (shkollat), për pagat dhe shpenzimet e tjera të investimeve: por, shpenzimet e tjera të shkollave mbulohen nga njësitë e qeverisjes vendore, pra nuk ka një raport të plotë.	
iv. Vlerësimi i performancës për realizimin e shërbimeve	B	KLSH ka kryer "auditimet e performancës" si vijon: VF 2014-7; VF 2015-11; VF 2016-13, dhe raportet gjenden në faqen në internet të KLSH-së.		
TP-9 E drejta e publikut për të parë informacione fiskale	B	Qeveria vë në dispozicion të publikut shtatë elemente, përfshirë pesë elemente bazë, në afatet e përcaktuara.		

EMRI I VENDIT: Shqipëria		Vlerësimi i vitit 2017	
Shtylla	Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Përshkrimi i kërkesave të përmbushura
Menaxhimi i aktiveve dhe pasiveve	TP-10 Raportimi i risqeve fiskale	C	
	i. Monitorimi i shoqërive publike	C	Qeveria merr raportet financiare nga shumica e shoqërive publike brenda nëntë muajve pas përfundimit të vitit fiskal.
	ii. Monitorimi i njësive të qeverisjes në nivelin qendror	C	Pasqyrat financiare për të gjitha njësitë e qeverisjes në nivelin qendror publikohen çdo muaj në formë të konsoliduar për të gjitha NJQV-të dhe çdo tre muaj në nivel njësie. Auditimi i QNJV-ve bëhet një herë në dy vjet nga KLSH-ja.
	iii. Pasivet e kushtëzuara dhe risqet e tjera fiskale	C	Subjektet dhe institucionet e qeverisjes qendrore i shprehin në mënyrë sasiore disa pasive të kushtëzuara të rëndësishme në raportet e tyre financiare, përfshirë statistikën për borxhin, programin e reformës ekonomike dhe shtojcën e projektbuxhetit. Por nuk ka një raport të gjithanshëm në të cilin të përfshihen të gjitha PPP-të dhe koncesionet të cilat, tani për tani, mund të mos kenë rrjedhoja të drejtpërdrejta për buxhetin por që mund të përbëjnë një risk të kushtëzuar.
	TP-11 Menaxhimi i investimeve publike	C+	
	i. Analiza ekonomike e propozimeve për investime	C	Kryhen analiza ekonomike për të vlerësuar të gjitha projektet madhore të investimeve. Por ekipit të vlerësimit nuk iu vu në dispozicion asnjë publikim i dokumentuar i rezultateve të analizës ekonomike të këtyre projekteve madhore të investimeve.
	ii. Përzgjedhja e projekteve të investimeve	D*	Përpara përfshirjes në buxhet, disa prej projekteve madhore të investimeve prioritetizohen nga një subjekt qendror, megjithëse përqindja nuk mund të konstatohet.
	iii. Llogaritja e kostove të projekteve të investimeve	C	Parashikimet e kostos kapitale gjithsej të projekteve madhore të investimeve, së bashku me kostot kapitale për periudhën trevjeçare, përfshihen në dokumentet e buxhetit.
	iv. Monitorimi i projekteve të investimeve	B	Kostoja gjithsej dhe ecuria fizike e projekteve madhore të investimeve monitorohet nga njësi zbatuese. Ka procedura dhe rregulla standarde për zbatimin e projekteve, ndërsa informacioni për projektet madhore të investimeve publikohet çdo vit.
	TP-12 Menaxhimi i aktiveve publike	D+	
	i. Monitorimi i aktiveve financiare	C	Qeveria mban evidencë të të gjitha kategorive madhore të aktiveve financiare që zotëron.
	ii. Monitorimi i aktiveve jofinanciare	D	Performanca është në nivel më të ulët nga sa e kërkon niveli i vlerësimit C.
	iii. Transparenca e heqjes së aktiveve	C	Janë vendosur procedura dhe rregulla për kalimin ose heqjen e aktiveve jofinanciare. Informacionet për kalimin dhe heqjen e aktiveve përfshihen në dokumentet e buxhetit, raportet financiare ose raporte të tjera.
	TP-13 Menaxhimi i borxhit	A	
	i. Regjistrimi dhe raportimi i borxhit dhe i dorëzave	B	Evidencat e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm dhe borxhit të garantuar janë të plota, të sakta dhe përditësohen çdo tremujor. Shumica e informacionit rakordohet çdo tremujor. Të paktën çdo vit dalin raporte të plota të menaxhimit dhe statistika që mbulojnë shërbimin, stokun dhe operacionet e borxhit.
ii. Miratimi i borxhit dhe i dorëzave	A	Legjislacioni parësor i jep autorizim për të marrë hua, për të emetuar borxh të ri dhe për të lëshuar dorëzani në emër të qeverisë qendrore një subjekti të vetëm përgjegjës për menaxhimin e borxhit. Politikat dhe procedurat e dokumentuara japin udhëzime për marrjen e huar, për emetimin e borxhit të ri dhe për ndërmarrjen e veprimeve të lidhura me borxhin, për lëshimin e dorëzave dhe për monitorimin e veprimeve të menaxhimit të borxhit nga një subjekt i vetëm i menaxhimit të borxhit. Huamarrja vjetore duhet të miratohet nga qeveria ose legjislativi.	
iii. Strategjia e menaxhimit të borxhit	A	Raportohet publikisht një strategji aktuale afatmesme e menaxhimit të borxhit e cila mbulon borxhin ekzistues dhe të parashikuar të qeverisë, me një horizont prej të paktën tre vjetësh. Strategjia përfshin fasha objektive për tregues të tillë si normat e interesit, rifinancimi dhe risqet monedhës së huaj. Legjislativi i vihen në dispozicion raporte vjetore kundrejt objektivave të menaxhimit të borxhit. Plani vjetor i qeverisë për huamarrjen është në përputhje me strategjinë e miratuar.	

EMRI I VENDIT: Shqipëria		Vlerësimi i vitit 2017	
Shtylla	Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Përshkrimi i kërkesave të përmbushura
Strategjia fiskale dhe përgatitja e buxhetit në bazë të politikave	TP-14 Parashikimi makroekonomik dhe fiskal	A	
	i. Parashikimet makroekonomike	A	Qeveria përgatit parashikime të treguesve kyç makroekonomikë, të cilët, së bashku me supozimet bazë, përfshihen në dokumentacionin e buxhetit që i paraqitet legjislativit. Këto parashikime përditësohen të paktën një herë në vit zakonisht të formalizuara me një akt normativ të miratuar në mes të vitit. Parashikimet mbulojnë vitin e buxhetit dhe dy vitet e ardhshme fiskale. Parashikimet janë shqyrtuar nga FMN në kuadër të mbështetjes buxhetore që ka dhënë FMN për periudhën 2014-2017.
	ii. Parashikimet fiskale	B	Qeveria përgatit parashikime të treguesve kryesorë fiskalë, përfshirë të ardhurat sipas llojit, shpenzimet sipas llojit dhe bilancin e buxhetit për vitin e buxhetit dhe dy vitet e ardhshme fiskale. Këto parashikime, së bashku me supozimet bazë përfshihen në kuadrin makroekonomik që miratohet me VKM dhe në shtojcat e projektbuxhetit që i paraqitet legjislativit dhe miratohen nga Kuvendi.
	iii. Analiza e ndjeshmërisë makroekonomike	A	Qeveria përgatit një varg skenarësh të parashikimeve fiskale në bazë të supozimeve alternative makroekonomike dhe këta skenarë publikohen, së bashku me parashikimin qendror si pjesë e programit të qeverisë për reformat ekonomike.
	TP-15 Strategjia fiskale	A	
	i. Efekti fiskal i propozimeve për politika	B	Qeveria ka përgatitur çmuarje të ndikimit fiskal të çdo ndryshimi të propozuar në politikën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin buxhetor dhe dy vitet e ardhshme gjatë periudhës së vlerësimit 2014-2016. Por efekti i ndryshimeve të politikave lidhur me shpenzimet dhe disa prej të ardhurave nuk është shprehur qartë në projektbuxhetet e paraqitura në Kuvend. Ndryshimet e politikave që janë miratuar pas procesit të buxhetit nuk vlerësohen dhe publikohen me njëtrajtshmëri.
	ii. Miratimi i strategjisë fiskale	A	Qeveria ka miratuar, ka paraqitur në legjislativ dhe ka publikuar një strategji fiskale korrente e cila përfshin objektiva eksplicitë fiskalë të shprehur me terma sasiorë dhe kohorë së bashku me objektiva cilësorë për vitin 2016 dhe dy vitet e mëpasshme fiskale. Këta objektiva janë përfshirë në kuadrin makroekonomik dhe në shtojcat e Ligjit të Buxhetit të vitit 2016. Shqipëria ka miratuar një rregull fiskale në 2016 e cila është në përputhje me objektivat e përmendur më lart.
	iii. Raportimi për rezultatet fiskale	A	Si pjesë e relacionit të projektbuxhetit të vitit 2017, Ministria e Financave ka përgatitur një analizë të arritjeve të saj kundrejt objektivave të shprehur fiskalë, me ndryshimet përkatëse të bëra me aktin normativ të muajit dhjetor 2016. Kjo analizë përfshin një shpjegim të faktorëve që çojnë në shmangie nga objektivat e miratuar, si mosrealizimi i planit të të ardhurave, vonesat me investimet publike dhe pasojat për objektivat, si edhe masat korrigjuese të propozuara. Raporti përshkruan edhe masat e planifikuara nga qeveria në përgjigje të shmangieve, siç parashikohet në legjislativ.
	TP-16 Perspektiva afatmesme në përgatitjen e buxhetit të shpenzimeve	C+	
	i. Çmuarjet afatmesme për shpenzimet	A	PBA 2017-19 dhe buxheti i vitit 2017 përfshijnë çmuarje të shpenzimeve për vitet 2017, 2018, 2019 të zbrërthyer sipas institucioneve, programeve, funksioneve dhe kategorive të përgjithshme ekonomike.
	ii. Tavanet afatmesme të shpenzimeve	C	Tavanet agregate të shpenzimeve për PBA 2017-19 janë miratuar nga Qeveria në janar, përpara nxjerrjes së qarkores së parë të buxhetit në shkurt.
	iii. Harmonizimi i planeve strategjike dhe buxheteve afatmesme	C	Tavanet e shpenzimeve në nivel ministrie për PBA 2017-19 janë miratuar nga Qeveria në mars, pas nxjerrjes së qarkores së parë të buxhetit në shkurt.
	iv. Përputhshmëria e buxheteve me çmuarjet e vitit të mëparshëm	D	Disa ministri përgatisin plane strategjike afatmesme. Disa propozime për politika të shpenzimeve në çmuarjet e buxhetit vjetor përputhen me planet strategjike.

EMRI I VENDIT: Shqipëria		Vlerësimi i vitit 2017	
Shtylla	Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Përshkrimi i kërkesave të përmbushura
TP-17	Procesi i përgatitjes së buxhetit	B	Analiza e shmangieve midis çmuarjeve të shpenzimeve të vitit të dytë nga viti i fundit dhe të vitit të parë nga viti ushtrimor bëhet vetëm për qëllime të brendshme dhe nuk përfshihet në dokumentacionin e buxhetit.
	i. Kalendar i buxhetit	B	Ekziston një kalendar i qartë i buxhetit, por ndodhin disa shmangie prej tij. Në vitin 2016 njësitë buxhetore kishin rreth një muaj kohë në dispozicion për të përgatitur kërkesat e hollësishme të PBA-së dhe pothuaj po aq kohë për t'i përditësuar në fazën e përgatitjes së kërkesave për buxhetin e vitit.
	ii. Udhëzues për përgatitjen e buxhetit	B	Paketa e udhëzimeve që përdoret për përgatitjen e PBA-së dhe të buxhetit vjetor është e gjithanshme, mbulon shpenzimet buxhetore gjithsej për vitin e plotë fiskal dhe u jep orientime të qarta njësisive buxhetore. Në vitin 2016, tavanet përfundimtare të shpenzimeve u miratuan nga Këshilli i Ministrave pas nxjerrjes së udhëzimit shtesë për përgatitjen e buxhetit vjetor nga Ministria e Financave, por në kohë të mjaftueshme për afatin e dorëzimit të kërkesave për buxhetin vjetor.
	iii. Paraqitja e buxhetit legjislativ	C	Buxheti për vitin 2014 i është paraqitur Kuvendit në mes të muajit dhjetor, pra më pak se një muaj përpara fillimit të vitit fiskal, buxhetet për vitet 2015 dhe 2016 iu paraqitën Kuvendit më shumë se një muaj përpara fillimit të vitit fiskal.
TP-18	Shqyrtimi i buxheteve nga legjislativi	C+	
	i. Objekti i shqyrtimit të buxhetit	B	Shqyrtimi nga Kuvendi fokusohet te shifrat agregate të buxhetit vjetor dhe të hollësitë e shpenzimeve dhe të ardhurave, jo te parashikimet dhe prioritetet fiskale afatmesme.
	ii. Procedura legjislative për shqyrtimin e buxhetit	C	Kuvendi ka procedurë të qarta dhe të dokumentuara për shqyrtimin e buxhetit të përfshira në Rregulloren e Brendshme të tij. Masat e brendshme organizative për shqyrtimin e buxhetit janë të zhvilluara mirë dhe u ngarkojnë role specifike komisioneve parlamentare dhe personelit teknik. Mungojnë procedurat e formalizuara të negociimit.
	iii. Koha e miratimit të buxhetit	A	Buxhetet për vitet 2014, 2015 dhe 2016 janë miratuar përpara fillimit të viteve fiskale përkatëse.
	iv. Rregullat për ndryshimet e bëra në buxhet nga ekzekutivi	A	Ekzistojnë rregulla të qarta për ndryshimet që mund t'i bëjë buxhetit ekzekutivi, të cilat vendosin kufizime mbi shkallën dhe natyrën e ndryshimeve që mund të bëhen pa përfshirjen e Kuvendit, dhe këto rregulla respektohen.

EMRI I VENDIT: Shqipëria		Vlerësimi i vitit 2017	
Shtylla	Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Përshkrimi i kërkesave të përmbushura
Parashikueshmëria dhe kontrolli në zbatimin e buxhetit	TP-19 Administrimi i të ardhurave buxhetore	C+	
	i. Masat për të drejtat dhe detyrimet për të ardhurat	A	DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për më shumë se 90 për qind të të ardhurave të brendshme, përdorin kanale të shumta për t'u siguruar paguesve lehtësi në të drejtën e marrjes së informacioneve të plota dhe të përditësuara lidhur me fushat kryesore të detyrimeve për të ardhurat dhe për të drejtat, përfshirë, të paktën, proceset dhe procedurat e ankimit.
	ii. Menaxhimi i riskut të ardhurave	C	DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për më shumë se 90 për qind të të ardhurave të brendshme, përdorin qasje që janë pjesërisht të strukturuar dhe sistematike për të vlerësuar dhe priorizuar risqet e përmbushjes për disa lloje të ardhurash.
	iii. Kontrolli dhe hetimi i të ardhurave	C	DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për më shumë se 90 për qind të të ardhurave të brendshme, kryejnë kontrole dhe hetime kundër mashtrimit duke përdorur një plan të përmirësimit të përmbushjes dhe e realizojnë shumicën e kontrolleve dhe hetimeve të planifikuara.
	iv. Monitorimi i detyrimeve të prapambetura në të ardhurat	D	Performanca është në nivel më të ulët nga sa e kërkon niveli i vlerësimit C.
	TP-20 Kontabiliteti i të ardhurave	A	
	i. Informacioni për arkëtimet e të ardhurave	A	MF merr të dhëna për të ardhurat të paktën çdo muaj nga DPT dhe DPD, të cilat mbledhin më shumë se 90 për qind të të ardhurave të qeverisjes qendrore. MF përpilon një raport të konsoliduar fiskal ku mbulohe të ardhurat sipas llojit dhe periudhës së arkëtimit.
	ii. Transferimi i arkëtimeve të të ardhurave	A	DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për arkëtimin e më shumë se 90 për qind të mbledhjes së të ardhurave të brendshme, ia transferojnë arkëtimet përditë thesarit.
	iii. Rakordimi i llogarive të të ardhurave	A	DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për arkëtimin e më shumë se 90 për qind të mbledhjes së të ardhurave të brendshme, bëjnë rakordim të plotë të vlerësimit, mbledhjes, detyrimeve të prapambetura dhe transferimeve në thesar të paktën çdo muaj.
	TP-21 Parashikueshmëria e shpërndarjes së burimeve gjatë vitit	B	
	i. Konsolidimi i tepricave monetare	D	Tepricat e llogarive jashtë llogarisë unike të thesarit janë më të mëdha se teprica e kësaj llogarie. Raportet për gjendjen e llogarive jashtë llogarisë unike të thesarit merren çdo muaj, por shumica e tepricave jashtë llogarisë unike të thesarit nuk konsolidohen.
	ii. Parashikimi dhe monitorimi i likuiditetit	B	Drejtoria e Thesarit përgatit parashikimin e flukseve monetare për të gjithë vitin dhe e përditëson në bazë të flukseve monetare faktike me të marrë informacionin burimor të përditësuar. Një prej llojeve të rëndësishme të informacionit burimor - raporti i shërbimit të borxhit - përditësohet jo më shpesh se çdo tremujor, ndërsa llojet e tjera të informacionit përditësohen më shpesh.
	iii. Informacioni për tavanet e angazhimeve	A	Njësitë buxhetore marrin informacion të besueshëm për tavanet mujore të angazhimeve për të gjithë vitin në janar.
	iv. Sa të konsiderueshme janë ndryshimet e bëra gjatë vitit në buxhet	B	Janë bërë dy ndryshime të konsiderueshme në buxhet në vitin 2016 përmes rishikimit të buxhetit të miratuar nga Kuvendi. Një prej këtyre dy rasteve ndodhi shumë pranë fundit të vitit fiskal. Praktika e ndryshimeve të bëra në fund të vitit konsiderohet si jo plotësisht transparente nga ministrinë e linjës.
	TP-22 Detyrimet e prapambetura në pagimin e shpenzimeve buxhetore	C+	
i. Stoku i detyrimeve të prapambetura në shpenzimet buxhetore	B	Stoku i detyrimeve të prapambetura në krahun e shpenzimeve buxhetore në fund të viteve 2016 dhe 2015 qe më pak se 6% e vlerës totale të shpenzimeve për vitin përkatës.	
ii. Monitorimi i detyrimeve të prapambetura në shpenzimet buxhetore	C	Shpeshtësia standarde e përgatitjes së raporteve të monitorimit të detyrimeve të prapambetura është çdo katër muaj.	

EMRI I VENDIT: Shqipëria		Vlerësimi i vitit 2017	
Shtylla	Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Përshkrimi i kërkesave të përmbushura
TP-23	Kontrolli i listë-pagesave	C+	
	i. Integrimi i evidencave për fondin e pagave dhe për personelin	B	Fondi i pagave mbështetet me dokumentacion të plotë për të gjitha ndryshimet e bëra në evidencat e personelit çdo muaj dhe kontrollon kundrejt të dhënave të listë-pagesës së muajit të mëparshëm. Marrjet në punë dhe ngritjet në detyrë mbahen në kontroll përmes një liste të organikës së miratuar. Duke qenë se informacionet për personelin, fondin e pagave dhe pagesat mbahen në shumë sisteme të ndryshme, disa të automatizuara dhe disa manuale, niveli i integritit është i ulët dhe del nevoja për rakordime të gjera manuale.
	ii. Menaxhimi i ndryshimeve në fondin e pagave	B	Ndryshimet e nevojshme në evidencat e personelit dhe në fondin e pagave përditësohen të paktën çdo muaj, përgjithësisht në kohën e duhur për pagesat e muajit të ardhshëm. Korrigjimet prapavepruese janë të rralla dhe zakonisht bëhen brenda listë-pagesës së muajit të ardhshëm. Por natyra e decentralizuar e administrimit të fondit të pagave do të thotë se mund të ketë dallime të konsiderueshme në performancë mes ministrive të ndryshme dhe nuk ka qenë e mundshme të vlerësohej performanca e mbarë qeverisë në këtë aspekt.
	iii. Kontrolli i brendshëm i fondit të pagave	C	Ka masa kontrolluese të mjaftueshme për të siguruar pacenueshmërinë e të dhënave me rëndësinë më të madhe për fondin e pagave.
	iv. Auditimi i fondit të pagave	B	Në tre vitet e fundit fiskale të përfunduara janë kryer auditime të fondit të pagave.
TP-24	Prokurimi	B+	
	i. Monitorimi i prokurimeve	A	Mbahen baza të dhënash ose evidenca për të gjitha kontratat përfshirë të dhënat për ato që janë prokuruar, vlerën e prokurimit dhe kush është fitues i kontratës. Planet e prokurimit publikohen në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe bëhet krahasim i planit me faktin. Prokurimi elektronik është i detyrueshëm për të gjitha metodat e prokurimit (me përjashtim të kontraktimit të drejtpërdrejtë) edhe për kontratat me vlerë të vogël.
	ii. Metodatat e prokurimeve	B	Shumica e agjencive ndjekin metodën e konkurrimit të hapur, si mundësi e parë e caktuar me ligj. Por, kontraktimi me një burim të vetëm (metoda pa konkurrim) përbën 30 për qind të vlerës gjithsej të të gjitha kontratave publike të lidhura në vitin 2016, sipas raportit të APP-së. Metodatat jo konkurruese shpesh përdoret për të përmbushur nevojat e autoriteteve kontraktuese përpara miratimit të fondeve në buxhet.
	iii. E drejta e publikut për të parë informacionet për prokurimet	A	Kuadri ligjor për prokurimin, plani i prokurimit për vitin 2017, realizimi i operacioneve të prokurimit për vitin 2016 si edhe mundësitë për tender dhe kontratat e fituara gjenden në faqen në internet të APP-së në kohën e duhur. Në faqen në internet të KPP-së publikohen brenda 48 orësh nga depozitimi i ankesave informacione për të gjitha ankesat që i shkojnë KPP-së.
	iv. Menaxhimi i ankesave për prokurimin	B	Sistemi i ankesave për prokurimet i përmbush shumicën e kriterëve (5 nga 6) me përjashtim të dhënies së vendimeve në kohën e duhur. Janë raportuar vonesa të shpeshta, për shkak të ngarkesës së punës së KPP-së.
TP-25	Sistemi i kontrollit të brendshëm për shpenzime jo paga	B	
	i. Ndarja e detyrave	C	Ndarja e detyrave parashikohet në të gjithë procesin e shpenzimeve. Mund të ketë nevojë për një përcaktim më preciz të përgjegjësisë të rëndësishme.
	ii. Efektiviteti i masave kontrolluese mbi angazhimet e shpenzimeve	C	Ekzistojnë procedura të mbajtjes në kontroll të angazhimeve të shpenzimeve, të cilat sigurojnë mbulim të pjesshëm dhe janë pjesërisht efektive.
TP-26	Efektiviteti i auditimit të brendshëm	C+	
	i. Mbulimi i auditimit të brendshëm	A	Funksioni i auditimit të brendshëm është funksional për të gjitha subjektet e qeverisjes qendrore.
	ii. Natyra e auditimeve dhe standardeve të përdorura	C	Funksioni i auditimit të brendshëm ende nuk ka natyrë sistematike apo diagnostikuese në vlerësimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm.
	iii. Zbatimi i auditimeve të brendshme dhe raportimit	A	Në bazë të informacioneve të njësisë qendrore të harmonizimit gjatë vitit 2016, është zbatuar 90 për qind e planit të auditimit. Në organizatat e vizituara të gjitha ndryshimet e planit fillestar të auditimit janë miratuar nga titullari i organizatës mbështetur në justifikim. Audituesit e brendshëm ia paraqesin raportet ministrit dhe titullarit të subjektit publik të audituar.
	(iv) Response to internal audits	B	Niveli drejtues reagon në mënyrë të pjesshme ndaj rekomandimeve të auditimeve për të gjitha subjektet e audituara brenda 12 muajve pas nxjerrjes së raportit.

EMRI I VENDIT: Shqipëria		Vlerësimi i vitit 2017	
Shtylla	Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Përshkrimi i kërkesave të përmbushura
Kontabiliteti dhe raportimi	TP-27 Integriteti i të dhënave financiare	B+	
	(i) Rakordimi i llogarive bankare	B	Rakordimi bankar për të gjitha llogaritë bankare aktive të qeverisjes qendrore bëhet të paktën çdo muaj, në nivel agregat dhe të detajuar dhe zakonisht brenda një jave pas fundit të muajit.
	ii. Llogaritë e përkohshme	A	Rakordimi i llogarive të përkohshme bëhet të paktën çdo muaj, brenda një muaji pas fundit të çdo muaji. Llogaritë e përkohshme mbyllen brenda afateve, jo më vonë se fundi i vitit fiskal, nëse përndryshe nuk justifikohet rregullisht.
	iii. Llogaritë paradhënie	A	Në përgjithësi, paradhënie përdoren vetëm në kontratat e projekteve të financuara nga donatorë/institucione financiare ndërkombëtare dhe ka një grafik kohor të përcaktuar mirë për rakordimin dhe kliringun në përputhje me marrëveshjet kontraktore. Në përgjithësi, kryhet në mënyrë të përmuajshme, brenda një muaji, kur sipërmarrësi lëshon faturat, raportet përmbledhëse dhe situacionet dhe kur këto miratohen nga drejtuesit e njësisë.
	iv. Proceset e paprekshmërisë së të dhënave financiare	B	E drejta për të hyrë në evidenca dhe për t'i ndryshuar ato është e kufizuar dhe e regjistruar dhe lë pas gjurmë auditimi.
	TP-28 Raportet buxhetore gjatë vitit	D+	
	i. Mbulimi dhe krahasueshmëria e raporteve	D	Mbulimi dhe klasifikimi i të dhënave nuk mundëson krahasim të drejtpërdrejtë me buxhetin fillestar.
	ii. Koha e përgatitjes së raporteve buxhetore gjatë vitit	B	Raportet e realizimit të buxhetit përgatiten çdo muaj dhe nxirren brenda katër javëve.
	iii. Saktësia e raporteve buxhetore gjatë vitit	C	Ka shqetësime lidhur me saktësinë e të dhënave. Shpenzimet kapen si informacion në fazën e pagesës.
	TP-29 Raportet financiare vjetore	D+	
	i. Plotësia e raporteve financiare vjetore	D	Përgatiten raporte financiare vjetore, por këto nuk paraqesin një krahasim midis buxhetit fillestar dhe zbatimit faktik.
	ii. Paraqitja e raporteve për auditim të jashtëm	B	Raportet financiare të vitit 2015 janë paraqitur për auditim të jashtëm brenda 6 muajve.
	iii. Standardet e kontabilitetit	C	Standardet e kontabilitetit të zbatuara për të gjitha raportet financiare janë në përputhje me kuadrin ligjor të vendit dhe sigurojnë njëtrajshmërinë e raportimit me kalimin e kohës. Dallimet midis standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare nuk bëhen të ditura.

EMRI I VENDIT: Shqipëria		Vlerësimi i vitit 2017	
Shtylla	Treguesi/Dimensioni	Vlerësimi	Përshkrimi i kërkesave të përmbushura
Shqyrtimi dhe auditimi i jashtëm	TP-30 Auditimi i jashtëm	C+	
	i. Mbulimi dhe standardet e auditimit	B	Pasqyrat financiare të subjekteve të qeverisjes qendrore që përfaqësojnë diku te 75-85% të shpenzimeve dhe të ardhurave gjithsej janë audituar duke përdorur standardet kombëtare të auditimit gjatë tre viteve të fundit fiskale të përfunduara.
	ii. Paraqitja e raporteve të auditimit legjislativ	B	Raportet e auditimit i janë paraqitur legjislativit brenda 6 muajve pas marrjes së raporteve financiare, për 3 vitet e fundit.
	iii. Aktivitetet e ndjekjes në vijimësi pas auditimit të jashtëm	C	Ka reagime zyrtare nga subjektet e audituara lidhur me auditimet për të cilat priten aktivitete të ndjekjes në vijimësi, gjatë 3 viteve të fundit të përfunduara.
	(i) Pavarësia e institucionit të lartë të auditimit	B	KLSH funksionon në mënyrë të pavarur nga ekzekutivi sa u takon procedurave të emërimit të Kryetarit, planifikimit të angazhimeve të auditimit, bërjes publike të raporteve dhe miratimit dhe realizimit të buxhetit KLSH-së. Kjo pavarësi garantohet me ligj. KLSH ka të drejtë të pakufizuar dhe në kohën e duhur në evidenca, dokumentacione dhe informacione. Por Ligji ka një kriter subjektiv për klauzolën e shkarkimit të Kryetarit të KLSH-së.
	TP-31 Shqyrtimi që u bën legjislativi raporteve të auditimit	B	
	i. Koha e shqyrtimit të raporteve të audituara	A	Shqyrtimi i raporteve të auditimit për raportet financiare vjetore është kryer nga legjislativi brenda një muaji pas marrjes së raporteve, për 3 vitet e fundit të përfunduara.
	ii. Seancat dëgjimore për konstatimet e auditimeve	C	Zhillohen rregullisht seanca dëgjimore të shqyrtimit në thellësi të konstatimeve më kryesore të raporteve të auditimit, vetëm me përfaqësues të KLSH-së dhe zyrtarë të MF-së.
	iii. Rekomandimet e legjislativit për auditimin	C	Legjislativi jep rekomandime për masat që duhen zbatuar, por nuk ka një sistem gjurmimi për ndjekjen në vijimësi të këtyre rekomandimeve.
	iv. Transparenca e shqyrtimit që u bën legjislativi raporteve të auditimit	B	Seancat dëgjimore zhvillohen publikisht me disa përjashtime (BSH), si edhe përveç rasteve të sigurisë kombëtare ose të diskutimeve të ngjashme delikate.
Gjithsej vlerësimi		31	

Shtojca 2. Përmbledhje e gjetjeve për kuadrin e kontrollit të brendshëm

Komponentët dhe elementet e kontrollit të brendshëm	Përmbledhje e gjetjeve
1. Mjedisi i kontrollit	Ligji i menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) siguron një kuadër të shëndoshë ligjor për zhvillimin e MFK-së dhe është në përputhje me Ligjin Organik të Buxhetit. Sipas këtij ligji, kërkesa për të futur në zbatim MFK zbatohet për të gjitha institucionet publike, përfshirë fondet jashtëbuxhetore dhe organizatat tregtare që janë pjesërisht në pronësi të shtetit. Shtylla 5 e Strategjisë së Qeverisë për Menaxhimin e Financave Publike trajton zbatimin e MFK-së si pjesë e së cilës synohet krijimi i sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm nëpërmjet një game të gjerë produktesh, ku përfshihen çështje të tilla si sistemet e informacionit për një MFK efektiv dhe ngritje të statusit të shefit të financës, si edhe shtatë zbatime pilot të MFK-së.
1.1 Integriteti personal dhe profesional dhe vlerat etike të drejtuesve dhe punonjësve, përfshirë qëndrimin mbështetës kundrejt kontrollit të brendshëm vazhdimisht në të gjithë organizatën	Nuk ka informacion nga vlerësimi PEFA.
1.2 Angazhimi kundrejt aftësisë	Nuk ka informacion nga vlerësimi PEFA.
1.3 "Toni nga lart" (d.m.th., filozofia dhe stili i punës i nivelit drejtues)	Nuk ka informacion nga vlerësimi PEFA.
1.4 Struktura organizative	Roli i palëve të ndryshme të përfshira në sistemin e kontrollit të menaxhimit financiar përcaktohet në Ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Këtu përfshihen Ministri i Financave, nëpunësi i parë autorizues (Sekretari i Përgjithshëm i MF-së), nëpunësi autorizues i njësive dhe nëpunësit autorizues të vartësisë, nëpunësit zbatues dhe eprorët e linjës. Qeveria është duke bërë hapa praktikë drejt zhvillimit të llogaridhënies së menaxhimit dhe delegimit të detyrave në përputhje me ligjin. Zbatimi plotësisht i kërkesave të këtij legjislacioni do të kërkojë kohë për t'u arritur i plotë në organet publike. Shumë drejtori të financës vuajnë nga numri i pakët i punonjësve, çka cenon parimet e ndarjes së detyrave dhe arritjen e objektivave të njësive së sektorit publik. Njësitë e sektorit publik duhet të krijojnë një strukturë organizative që mundëson arritjen e objektivave dhe përputhshmërinë me funksionet e ngarkuara me legjislacion. Ky duhet paraqitur në formë shkresore, ku të përshkruhen qartë rregullat për caktimin dhe ndarjen e detyrave, detyrimeve dhe përgjegjësisë, si edhe hierarkia dhe linjat e raportimit. Krahas kësaj, duhen përditësuar rregulloret e brendshme dhe përshkrimet e punës për të pasqyruar plotësisht ndryshimet më të fundit rregullatore.
1.5 Politika dhe praktika për burimet njerëzore	Nuk ka informacion nga vlerësimi PEFA.
2. Vlerësimi i riskut	Zbatimi i praktikave moderne të menaxhimit të riskut është ende në hapat e parë në Shqipëri. Sipas Ligjit të MFK-së, koordinatori për risqet është nëpunësi autorizues i institucionit. Raportet më të fundit të KBFP-së vërejnë progresin në zhvillimin e këtij funksioni dhe një numër në rritje institucionesh po përgatisin regjistra të risqeve. Në të njëjtën kohë, raporti pranon se shumë pak, në mos aspak, organizata i përdorin këto regjistra si mjet drejtimi për të arritur objektivat e punës.
2.1 Identifikimi i riskut	Këta janë disa tregues të performancës për të cilët ka identifikim të riskut, më kryesisht: Analiza ekonomike e propozimeve për investime ka marrë vlerësimin "C" në 11.1 - Nuk bëhet asnjë shqyrtim i analizave ekonomike të projekteve të investimeve kapitale përveç se nga subjekti kërkuar. Strategjia e menaxhimit të borxhit ka marrë vlerësimin "A" në 13.3 - Raportohet publikisht një strategji afatmesme e menaxhimit të borxhit e cila mbulon borxhin ekzistues dhe të parashikuar të qeverisë, me një horizont prej të paktën tre vjetësh, e cila përfshin fasha objektivash për tregues të tillë si normat e interesit, rifinancimi dhe risqet monedhës së huaj. Analiza e ndjeshmërisë makro-fiskale ka marrë vlerësimin "A" në 14.3 - Qeveria përgatit një varg skenarësh të parashikimeve fiskale në bazë të supozimeve alternative makroekonomike dhe këta publikohen, së bashku me parashikimin qendror si pjesë e programit të qeverisë për reformat ekonomike. Menaxhimi i riskut të ardhurave ka marrë vlerësimin "C" në 19.2 - DPT nuk e ka vënë ende plotësisht në zbatim një proces të strukturuar dhe sistematik të vlerësimit të riskut për vlerësimin, renditjen dhe shprehjen sasiore të risqeve të përmbushjes së tatimpaguesve. Risku i përmbushjes vlerësohet automatikisht përmes sistemit informatik dhe kriteret e riskut do të përfitonin nga një informacion më i gjithanshëm nga burime të brendshme dhe të jashtme. Parashikimi dhe monitorimi i flukseve monetare ka marrë vlerësimin "B" në 21.2 - Drejtorja e Thesarit përgatit dhe përditëson rregullisht parashikime të hollësishme të likuiditetit. Parashikimet mbështeten në planet mujore të shpenzimeve të marra nga njësitë shpenzuese në janar, parashikimet e mbledhjes së të ardhurave nga organet e administrimit të të ardhurave, tabelat e shlyerjes së borxhit të marra nga sektori i menaxhimit të borxhit dhe informacione të tjera përkatëse. Parashikimet përditësohet periodikisht, me të pasur informacione burimore të gatshme.
2.2 Vlerësimi i riskut (rëndësia dhe gjasa)	Shih identifikimin e riskut (2.1 më lart)

2.3 Analiza vlerësuese e riskut	Në bazë të informacioneve të njësisë qendrore të harmonizimit gjatë vitit 2016, është zbatuar 90 për qind e planit të auditimit. Në organizatat e vizituara të gjitha ndryshimet e planit fillestar të auditimit janë miratuar nga titullari i organizatës mbështetur në justifikim. Audituesit e brendshëm ia paraqesin raportet ministrit dhe titullarit të subjektit publik të audituar. (Zbatimi i auditimeve të brendshme dhe raportimit - 26.3 - ka marrë vlerësimin "A"). Por, funksioni i auditimit të brendshëm ende nuk ka natyrë sistematike apo diagnostikuese në vlerësimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm. (Natyra e auditimeve të brendshme dhe standardet e zbatuara - 26.2 - ka marrë vlerësimin "C").
2.4 Vlerësimi i dëshirës për të marrë risk	Nuk ka informacion nga vlerësimi PEFA
2.5 Reagimet ndaj riskut (transferimi, tolerimi, trajtimi ose ndërprerja)	Nuk ka informacion nga vlerësimi PEFA
3. Aktivitetet e kontrollit	Raportet më të fundit vjetore të KBFP-së vërejnë një sërë mangësish në aktivitetet, proceset dhe procedurat e kontrollit. Raporti ka vërejtur se manualet dhe gjurmët e auditimit që përshkruajnë proceset dhe veprimtaritë e kontrollit nuk përgatiten dhe nuk zbatohen në të gjitha institucionet. Gjithashtu, përshkrimet e proceseve zyrtare të punës shpesh mbeten të padokumentuara.
3.1 Procedurat e autorizimit dhe miratimit	<p>Proceset e paprekshmërisë së të dhënave financiare kanë marrë vlerësimin "B" në 27.4. E drejta për të hyrë në evidenca dhe për t'i ndryshuar ato është e kufizuar dhe e regjistruar dhe lë pas gjurmë auditimi.</p> <p>Regjistrimi dhe raportimi i borxhit dhe i dorëzanave ka marrë vlerësimin "B" në 13.1. Evidencat e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm dhe borxhit të garantuar janë të plota, të sakta dhe përditësohen çdo tremujor. Shumica e informacionit rakordohet çdo tremujor. Të paktën çdo vit dalin raporte të plota të menaxhimit dhe statistikave që mbulojnë shërbimin, stokun dhe operacionet e borxhit.</p> <p>Miratimi i borxhit dhe i dorëzanave ka marrë vlerësimin "A" në 13.2. Legjislacioni parësor i jep autorizim për të marrë hua, për të emetuar borxh të ri dhe për të lëshuar dorëzani në emër të qeverisë qendrore një subjekti të vetëm përgjegjës për menaxhimin e borxhit. Politikat dhe procedurat e dokumentuara japin udhëzime marrjen hua, për emetimin e borxhit të ri dhe për ndërmarrjen e veprimeve të lidhura me borxhin, për lëshimin e dorëzanave dhe për monitorimin e veprimeve të menaxhimit të borxhit nga një subjekt i vetëm i menaxhimit të borxhit. Huamarrja vjetore duhet të miratohet nga qeveria ose legjislativi.</p> <p>Efektiviteti i masave kontrolluese mbi angazhimet e shpenzimeve ka marrë vlerësimin "C" në 25.2. Ekzistojnë procedura të mbajtjes në kontroll të angazhimeve të shpenzimeve, të cilat sigurojnë mbulim të pjesshëm dhe janë pjesërisht efektive.</p> <p>Integrimi i evidencave të pagave dhe personelit ka marrë vlerësimin "B" në 23.1. Fondi i pagave mbështetet me dokumentacion të plotë për të gjitha ndryshimet e bëra në evidencat e personelit çdo muaj dhe kontrollohet kundrejt të dhënave të listë-pagesës së muajit të mëparshëm. Marrjet në punë dhe ngritjet në detyrë mbahen në kontroll përmes një listë të organikës së miratuar. Duke qenë se informacionet për personelin, fondin e pagave dhe pagesat mbahen në shumë sisteme të ndryshme, disa të automatizuara dhe disa manuale, niveli i integritetit është i ulët dhe rakordimi është i vështirë.</p> <p>Menaxhimi i ndryshimeve në fondin e pagave ka marrë vlerësimin "B" në 23.2. Ndryshimet e nevojshme në evidencat e personelit dhe në fondin e pagave përditësohen të paktën çdo muaj, përgjithësisht në kohën e duhur për pagesat e muajit të ardhshëm. Korrigjimet propavepruese janë të rralla dhe zakonisht bëhen brenda listë-pagesës së muajit të ardhshëm. Marrjet e decentralizuara e administrimit të fondit të pagave do të thotë se mund të ketë dallime të konsiderueshme në performancë mes ministrive të ndryshme dhe nuk ka qenë e mundur të vlerësohet performanca e mbarë qeverisë në këtë aspekt.</p> <p>Përputhshmëria me rregullat dhe procedurat e pagimit të pagave ka marrë vlerësimin "C" në 23.3. Ka masa kontrolluese të mjaftueshme për të siguruar pacenueshmërinë e të dhënave me rëndësinë më të madhe për fondin e pagave.</p>
3.2 Ndarja e detyrave (autorizimi, përpunimi, regjistrimi, shqyrtimi)	Ndarja e detyrave ka marrë vlerësimin "C" në 25.1. Megjithatë ndarja e detyrave parashikohet në të gjithë procesin e shpenzimeve, shumë organizata kanë nevojë të përditësojnë rolet dhe përgjegjësitë në përputhje me ndryshimet e kohëve të fundit në rregulloret e brendshme.
3.3 Masat kontrolluese mbi të drejtat mbi burimet dhe evidencat	Përputhshmëria me rregullat dhe procedurat e pagesave ka marrë vlerësimin "A" në 25.3. Të gjitha pagesat janë në përputhje me procedurat e rregullta të pagesave. Të gjitha përjashtimet autorizohen si duhet paraprakisht dhe justifikohen. <p>Proceset e paprekshmërisë së të dhënave financiare kanë marrë vlerësimin "B" në 27.4. E drejta për të hyrë në evidenca dhe për t'i ndryshuar ato është e kufizuar dhe e regjistruar dhe lë pas gjurmë auditimi.</p>
3.4 Verifikimet	Saktësia e raporteve buxhetore gjatë vitit ka marrë vlerësimin "C" në 28.3. Raportet buxhetore gjatë vitit nuk paraqesin një analizë të saktë të shpenzimeve dhe nuk janë plotësisht të dobishme për analizën e zbatimit të buxhetit sepse nuk japin informacion për fazën e angazhimit dhe të pagimit, duke e bërë kështu të vështirë monitorimin e plotë të zbatimit të buxhetit. Në raporte nuk evidentohen problemet me të dhënat në lidhje me çmuarjet e rishikuara buxhetore.
3.5 Rakordimet	Rakordimi i llogarive bankare ka marrë vlerësimin "B" në 27.1. Rakordimi bankar për të gjitha llogaritë bankare aktive të qeverisjes qendrore bëhet të paktën çdo muaj, në nivel agregat dhe të detajuar dhe zakonisht brenda një jave pas fundit të muajit. <p>Rakordimi i llogarive rregulluese ka marrë vlerësimin "A" në 27.2. Rakordimi i llogarive të përkohshme bëhet të paktën çdo muaj, brenda një muaji pas fundit të çdo muaji. Llogaritë e përkohshme mbyllen brenda afateve, jo më vonë se fundi i vitit fiskal, nëse përndryshe nuk justifikohet rregullisht.</p>

3.6 Shqyrtimet e performancës së shfrytëzimit	Kontrolli dhe hetimi i të ardhurave ka marrë vlerësimin "C" në 19.3. DPT dhe DPD, të cilat janë përgjegjëse për arkëtimin e më shumë se 90 për qind të mbledhjes së të ardhurave të brendshme, kryejnë kontrole dhe hetime të rasteve të mashtrimit. Por nuk ka një plan të përmirësimit të përbushjes dhe 40 për qind e rasteve të kontrollit përzgjidhen nga drejtoritë rajonale tatimore dhe jo nga sistemi informatik.
3.7 Shqyrtimet e operacioneve, proceseve dhe aktiviteteve	Monitorimi i prokurimeve ka marrë vlerësimin "A" në 24.1. Mbahen baza të dhënash ose evidenca për të gjitha kontratat përfshirë të dhënat për ato që janë prokuruar, vlerën e prokurimit dhe kush është fitues i kontratës. Planet e prokurimit publikohen në faqen në internet të APP-së dhe bëhet krahasim i planit me faktin. Prokurimi elektronik është i detyrueshëm për të gjitha metodat e prokurimit (me përjashtim të kontraktimit të drejtpërdrejtë) edhe për kontratat me vlerë të vogël.
3.8 Mbikëqyrja (ngarkimi i detyrave, shqyrtimi dhe miratimi, orientimi dhe trajnimi)	Nuk ka informacion nga vlerësimi PEFA.
4. Informacioni dhe komunikimi	Raportet më të fundit të KBFP-së vërejnë se ka një mungesë të përgjithshme të të kuptuarit se si mund të përdoren informacionet financiare për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin. Cilësia e informacioneve financiare është gjithashtu problem, sikurse tregohet nga dobësitë e identifikuara në raportet buxhetore gjatë vitit (TP-28) dhe raportet financiare vjetore (TP-29). Shqetësim të veçantë përbën edhe përdorimi i shifrave të buxhetit të rishikuar dhe jo atij fillestar; kjo e kufizon efektivitetin e tyre si mjet monitorimi për nivelin drejtues.
5. Monitorimi	NJQH/MFK aktualisht është pajisur plotësisht me të gjashtë punonjësit dhe ka zhvilluar një sistem të gjithanshëm monitorimi të KBFP. Roli i saj është të orientojë dhe mbështesë institucionet dhe të sigurojë bashkërendimin e një ankete vjetore vetëvlerësimi për gjendjen e MFK-së. Rezultatet e kësaj ankete përfshihen në raportin vjetor të KBFP-së, por janë pjesë edhe e 20 treguesve për monitorimin e performancës së ministrive dhe të bashkive më të mëdha. Kjo paketë treguesish përfshihet edhe në raportin vjetor të KBFP-së, si edhe të dhënat nga drejtoritë e buxhetit dhe të thesarit pranë MF-së dhe të NJQH/MFK dhe NJQH/AB. Vlerësimi agregat i institucioneve është konvertuar në një paketë tabelash të lidhura. Raporti vjetor i KBFP-së përfshin një vlerësim të çdo organizate.
5.1 Monitorimi i vazhdueshëm	<p>Vlerësimi ka evidentuar një sërë fushash të lidhura me aktivitetet e monitorimit të vazhdueshëm: Burimet që marrin njësitë e realizimit të shërbimeve ka marrë vlerësimin "D" në 8.3. Megjithëse nuk ka prurje të njëtrajtshme dhe të rregullt nga poshtë lart të informacioneve për shfrytëzimin e burimeve, në drejtim të ministrive përgjegjëse, Ministria e Arsimit ka të dhëna të gjithanshme në nivel të 3.000 e ca shkollave publike (Ministria e Arsimit dhe Ministria e Bujqësisë nuk kanë të dhëna të ngjashme të zbërthyer).</p> <p>Monitorimi i shoqërive publike ka marrë vlerësimin "C" në 10.1. Qeveria merr raportet financiare nga shumica e shoqërive publike brenda nëntë muajve pas përfundimit të vitit fiskal.</p> <p>Monitorimi i njësive të qeverisjes nën nivelin qendror ka marrë vlerësimin "C" në 10.2. Pasqyrat financiare për të gjitha njësitë e qeverisjes nën nivelin qendror publikohen çdo muaj në formë të konsoliduar për të gjitha NJQV-të dhe çdo tre muaj në nivel njësie. Auditimi i QNJV-ve bëhet një herë në dy vjet nga KLSH-ja. Pasivet e kushtëzuara dhe risqet e tjera fiskale ka marrë vlerësimin "C" në 10.3. Subjektet dhe institucionet e qeverisjes qendrore i shprehin në mënyrë sasiore disa pasive të kushtëzuara të rëndësishme në raportet e tyre financiare, përfshirë statistikën për borxhin, programin e reformës ekonomike, por nuk ka një raport të gjithanshëm ku përfshihen të gjitha PPP-të dhe koncesionet.</p> <p>Monitorimi i projekteve të investimeve ka marrë vlerësimin "B" në 11.4. Kostoja gjithsej dhe ecuria fizike e projekteve madhore të investimeve monitorohet nga njësia zbatuese. Ka procedura dhe rregulla standarde për zbatimin e projekteve, ndërsa informacioni për projektet madhore të investimeve publikohet çdo vit.</p> <p>Cilësia e monitorimit të aktiveve financiare të qeverisjes qendrore ka marrë vlerësimin "C" në 12.1. Qeveria mban evidencë të të gjitha kategorive madhore të aktiveve financiare që zotëron, por kjo nuk publikohet.</p> <p>Cilësia e monitorimit të aktiveve jofinanciare të qeverisjes qendrore ka marrë vlerësimin "D" në 12.1. Nuk ka një regjistër të plotë dhe aktual të aktiveve jofinanciare.</p> <p>Monitorimi i detyrimeve të prapambetura në të ardhurat ka marrë vlerësimin "D" në 19.4. Funkcioni i mbledhjes së borxhit në DPT vuan nga dobësi serioze.</p> <p>Monitorimi i detyrimeve të prapambetura në shpenzimet buxhetore ka marrë vlerësimin "C" 22.2. Shpeshësia standarde e përgatitjes së raporteve të monitorimit të detyrimeve të prapambetura është çdo katër muaj. Raporti vjetor i monitorimit për vitin 2016, përfshirë stokun dhe përbërjen e detyrimeve të prapambetura në shpenzimet buxhetore, gjendet në faqen në internet të MF-së.</p> <p>Monitorimi i prokurimeve ka marrë vlerësimin "A" në 24.1. Mbahen baza të dhënash ose evidenca për të gjitha kontratat përfshirë të dhënat për ato që janë prokuruar, vlerën e prokurimit dhe kush është fitues i kontratës. Planet e prokurimit publikohen në faqen në internet të APP-së dhe bëhet krahasim i planit me faktin. Prokurimi elektronik është i detyrueshëm për të gjitha metodat e prokurimit (me përjashtim të kontraktimit të drejtpërdrejtë) edhe për kontratat me vlerë të vogël. Zbatimi i auditimeve të brendshme dhe raportimit ka marrë vlerësimin "A" në 26.3. Është zbatuar 90 për qind e planit të auditimit. Në organizatat e vizituara të gjitha ndryshimet e planit fillestar të auditimit janë miratuar nga titullari i organizatës mbështetur në justifikim. Audituesit e brendshëm ia paraqesin raportet ministrit dhe titullarit të subjektit publik të audituar.</p>
5.2 Vlerësimet	Vlerësimi i performancës për realizimin e shërbimeve ka marrë vlerësimin "B" në 8.4. Përzgjedhja e projekteve të investimeve ka marrë vlerësimin "D" në 11.2.
5.3. Reagimet nga niveli drejtues	Reagimi ndaj auditimeve të brendshme ka marrë vlerësimin "B" në 26.4. Niveli drejtues reagon në mënyrë të pjesshme ndaj rekomandimeve të auditimeve për të gjitha subjektet e audituara brenda 12 muajve pas nxjerrjes së raportit. Ndjekja në vijimësi e auditimit të jashtëm ka marrë vlerësimin "C" në 30.3. Ka reagime zyrtare nga subjektet e audituara lidhur me auditimet për të cilat priten aktivitete të ndjekjes në vijimësi, gjatë 3 viteve të fundit të përfunduara.

Shtojca 3A. Burimet e informacionit: anketa dhe raporte analitike

- Raportet PEFA jo në nivel vendi 2016 (Bashkitë Tiranë, Berat, Tropojë, Kuçovë dhe Fier), SECO dhe USAID, mars 2017
- Raport vjetor progresi i Komisionit Evropian, 2016
- Vlerësimi PEFA 2011, Banka Botërore
- Projektraport për përmirësimin e raportimit financiar në sektorin publik, Banka Botërore, 2017
- Raport për Prokurimin dhe Zbatimin e Kontratave në Shqipëri, Banka Botërore, 2017
- Shqyrtim funksional i financave publike në Shqipëri, Banka Botërore, qershor 2016
- Raport për menaxhimin e likuiditetit, Banka Botërore, 2017
- Vlerësimi dhe menaxhimi i risqeve fiskale nga partneritetet publike-private (PPP), Banka Botërore, qershor 2017
- Zhvillimi i tregut të borxhit shtetëror, Banka Botërore, qershor 2017
- Raporti i Misionit të FMN-së për statistikat financiare shtetërore, FMN, prill 2017
- Raport vlerësimi i performancës së Shqipërisë sipas Mjetit të Vlerësimit Diagnostikues për Administratat Tatimore (TADAT), Departamenti i Çështjeve Fiskale, FMN, gusht 2016
- Vlerësimi i menaxhimit të investimeve publike, FMN, qershor 2016
- Raporti i FMN-së për transparencën fiskale në Shqipëri, 2015
- Raporti i FMN-së për statistikat financiare shtetërore, qershor 2016
- Parimet e Administratës Publike / Menaxhimi i Financave Publike - SIGMA, nëntor 2017
- Parimet e Administratës Publike / Menaxhimi i Financave Publike - SIGMA, prill 2015
- Raport monitorimi për Shqipërinë, 2016, SIGMA
- Anketa e hapur e buxhetit 2015 (IBP)
- Anketa e hapur e buxhetit, dhjetor 2016, përditësim (IBP)
- Raporti i transparencës së buxhetit, MF, mars 2015
- Raporti vjetor i KBFP-së 2015 dhe 2016, MF
- Raportet vjetore për 2015-2016 të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)
- Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020, Raporti i Monitorimit 2015, MF, mars 2016
- Raporti vjetor i vitit 2016 i Komisionit të Prokurimit Publik (KPP)
- Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020, Raporti i Monitorimit 2016, MF, mars 2017

Shtojca 3B. Burimet e informacionit sipas treguesve

Treguesit e performancës	Burimet e informacionit Dokumente, faqe në internet
TP-1	<ul style="list-style-type: none"> • http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2014 • http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2015 • http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2016 • Udhëzimi i Ministrit të Financave datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". • Ligji nr.185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", (http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Buxheti_2014/204-2013.pdf) • Ligji nr.160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015" (http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2015) • Ligji nr.147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016" (http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2016/ligji-i-buxhetit-2016) • Treguesit fiskalë 2014 (http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Programimi_EkonomikoFiskal/Raporte_dhe_Statistika_Fiskale_Mujore/Statistika_Fiskale_Mujore/Viti_2014/dhjetor/Statistika_Fiskale_Janar_-_Dhjetor_2014.pdf) • Treguesit fiskalë 2015 (http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Programimi_EkonomikoFiskal/Raporte_dhe_Statistika_Fiskale_Mujore/Statistika_Fiskale_Mujore/2015/dhjetor/Statistika_Fiskale_Janar_-_Dhjetor_2015_(1).pdf) • Treguesit fiskalë 2016 (http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Programimi_EkonomikoFiskal/Raporte_dhe_Statistika_Fiskale_Mujore/Statistika_Fiskale_Mujore/2016/Treguesit_analitik_fiskal_-_DHJETOR_2016_perfundimtare.pdf) • Akti normativ nr. 1, datë 17.09.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013 "Për buxhetin e vitit 2014", (http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2014) • Akti normativ nr. 2, datë 29.12.2014 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar. • Akti normativ nr. 1, datë 29.7.2015 Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015" • Akti normativ nr. 2, datë 11.12.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar. (http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2015) • Akti normativ nr. 3, datë 28.12.2015, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar. • Ligji nr.9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në korrik 2016. • MF, Manuali i të ardhurave • MF, Manuali i shpenzimeve • Udhëzimi nr.23, datë 22.11.2016 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm" • http://www.financa.gov.al/al/raportime/thesari/gfs-ne-vite

TP-2	<ul style="list-style-type: none"> • http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2014 • http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2015 • http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2016 • Udhëzimi i Ministrisë së Financave datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". • Ligji nr.185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", (http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Buxheti_2014/204-2013.pdf) • Ligji nr.160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015" (http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2015) • Ligji nr.147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016" (http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2016/ligji-i-buxhetit-2016) • Treguesit fiskalë 2014 (http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Programimi_EkonomikoFiskal/Raporte_dhe_Statistika_Fiskale_Mujore/Statistika_Fiskale_Mujore/Viti_2014/dhjetor/Statistika_Fiskale_Janar_-_Dhjetor_2014.pdf) • Treguesit fiskalë 2015 (http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Programimi_EkonomikoFiskal/Raporte_dhe_Statistika_Fiskale_Mujore/Statistika_Fiskale_Mujore/2015/dhjetor/Statistika_Fiskale_Janar_-_Dhjetor_2015_(1).pdf) • Treguesit fiskalë 2016 (http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Programimi_EkonomikoFiskal/Raporte_dhe_Statistika_Fiskale_Mujore/Statistika_Fiskale_Mujore/2016/Treguesit_analitik_fiskal_-_DHJETOR_2016_perfundimtare.pdf) • Akti normativ nr. 1, datë 17.09.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013 "Për buxhetin e vitit 2014", (http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2014) • Akti normativ nr. 2, datë 29.12.2014 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar. • Akti normativ nr. 1, datë 29.7.2015 Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015" • Akti normativ nr. 2, datë 11.12.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar. (http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2015) • Akti normativ nr. 3, datë 28.12.2015, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar. • Ligji nr.9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në korrik 2016.
------	--

